

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE  
SOUTH-EAST EUROPEAN UNIVERSITY  
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА



FAKULTETI I BIZNESIT DHE EKONOMISË  
FACULTY OF BUSINESS AND ECONOMY  
ФАКУЛТЕТ ЗА БИЗНИС И ЕКОНОМИЈА

## STUDIME PASDIPLOMIKE - CIKLI I I TRETË

### TEMA E DISERTACIONIT TË DOKTORATURËS

KONTRIBUTI I NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME NË  
RRITJEN E PUNËSIMIT NË KOSOVË- POLITIKAT MBËSHTETËSE  
DHE EFEKTET

---

**KANDIDATI :**  
Kosovare UKSHINI,  
**MA i Menaxhment dhe informatikë**

**MENTORI:**  
**Prof. Dr. Izet ZEIQIRI**

Dhjetor, 2018

## DEKLARATË

Deklaroj se punimi *Kontributi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në rritjen e punësimit në Kosovë - politikat mbështetëse dhe efektet* është punim original i imi, nën mentorimin e prof. dr. Izet Zeqirit, nga Fakulteti i Biznesit, Universiteti i Evropës Juglindore në Maqedoni, me qëllim të marrjes së titullit Doktor i shkencave ekonomike.

Deklaroj se punimi në fjalë nuk është botuar më parë për ndonjë vlerësim apo kualifikim tjetër në dhe nga ndonjë institucion arsimor apo tjetër. Nuk ka tekst apo argument të përdorur në punim që është shkruar nga dikush tjetër, përpos rasteve të cilat janë të cituara dhe referuar autorëve përkatës.

Kosovare Ukshini

Nënshkrimi dhe data

## Përbajtja

<b>1 HYRJE DHE QËLLIMI I HULUMTIMIT .....</b>	<b>6</b>
1.1 Shpjegimi teorik i qëllimit të punimit.....	10
1.2 Përkufizimi i problemit.....	12
1.3 Hipotezat e hulumtimit .....	13
1.4 Pyetjet e kërkimore .....	14
1.5 Objektivat e hulumtimit .....	14
1.6 Metodologjia e hulumtimit .....	15
1.7 Rëndësia e hulumtimit .....	17
1.8 Kufizimet e hulumtimit.....	18
1.9. Rezultatet e pritura .....	19
<b>2 KAPITULLI II - RISHIKIMI I LITERATURË .....</b>	<b>21</b>
2.1 Vështrim i përgjithshëm mbi ndikimin e NVM-ve në krijimin e vendeve të punës .....	21
2.1. Teoritë e rritjes së firmës .....	32
2.1.1. Teoria e madhësisë .....	32
2.1.2. Teoria e rritjes së firmës sipas Edith Penrose .....	32
2.1.3. Teoria e rritjes së firmës sipas Gibrat .....	35
2.2. Strategjité dhe organizatat mbështetëse për sektorin privat në Kosovë .....	35
2.3. Studime individuale mbi kontributin e NVM-ve në rritjen e punësimit.....	37
<b>3 KAPITULLI III- NDËRMARRËSIA DHE NVM-të .....</b>	<b>41</b>
3.1 Ndërmarrësia si proces .....	41
3.2 Teoritë ekonomike të ndërmarrësisë.....	47
3.2.1 Richard Canillton (1725) Teoria më e vjetër e ndërmarrësisë.....	47
3.2.2 Teoria e kreacionit destruktiv e Joseph Schumpeter (1934):.....	48
3.2.3 Qasja Marshalliane e ndërmarrësisë (1949):.....	48
3.2.4 Teoria e mbajtjes së riskut sipas Frank Knight (1971): .....	49
3.3 Roli dhe rëndësia e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme .....	50
3.3.1 Klasifikimi i NVM-ve .....	56
3.3.2 Karakteristikat e NVM-ve.....	59

3.3.3	Kontributi i NVM-ve .....	60
3.3.5	Ndikimi i NVM-ve në vendet të ndryshme të botës .....	68
3.4	Karakteristikat e firmave të vogla si faktorë të krijimit të vendeve të reja të punës.....	73
3.5	Faktorët që ndikojnë në rritjen NVM-ve .....	81
<b>4</b>	<b>KAPITULLI IV- MJEDISI BIZNESOR DHE STRUKTURA E NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME NË KOSOVË.....</b>	<b>96</b>
4.1	Mjedisi biznesor në Kosovë.....	96
4.1.1	Struktura e bizneseve në Kosovë .....	101
4.1.2	Klasifikimi i NVM-ve në Kosovë.....	102
4.1.3	Karakteristikat NVM-ve në Kosovë .....	105
4.2	PUNËSIMI DHE PAPUNËSIA NË KOSOVË .....	118
4.2.1	Politikat e punësimit .....	128
4.2.2	Struktura e të punësuarve/ të papunëve sipas grup moshave .....	130
4.2.3	Struktura dhe trendet e papunësisë .....	135
4.2.4	Manifestimi i papunësisë përmes varfërisë në Kosovë .....	141
4.2.5	Dobësitë e zhvillimit të NVM-ve në Kosovë.....	144
<b>5</b>	<b>KAPITULLI V- FORMAT E PËRKRAHJEVE TË NVM-VE NË KOSOVË</b> <b>148</b>	
5.1	Përkrahja nga qeveria .....	151
5.1.1	Ndryshimet mbi ligjin e tatimeve .....	153
5.1.2	Subvencionet .....	155
5.1.3	Fondi i Garantimit të Kredive .....	159
5.1.4	Formimi i zonave ekonomike .....	163
5.1.5	Skemat e mbështetjes për NVM-të nga agjenci shtetërore KIESA .....	165
5.2	Përkrahja përmes investimeve kapitale .....	166
5.3	Përkrahja nga sektori bankar .....	169
<b>6</b>	<b>KAPITULLI VI- METODOLOGJIAA HULUMTUESE SHKENCORE .....</b>	<b>176</b>
6.1	Burimi i të dhënave .....	177
6.2	Modeli i regresionit OLS .....	178
6.2.1	Analiza e rezultateve të regresionit .....	180
6.2.2	Të gjetura empirike nga studiues të tjerë.....	186

6.2.3	Testimi i modelit të OLS .....	188
6.2.4	Testi Shapiro-Wilk W për shpërndarje normale të të dhënave.....	189
6.2.5	Testi Breusch-Pagan / Cook-Weisberg për heteroskedasticiteti .....	190
6.2.6	Testet për autokorrelacion .....	191
6.3	Modeli II- GMM (Generalized Method of Moments).....	192
6.3.1	Përkufizimi i vlerësuesit GMM.....	193
6.3.2	GMM ESTIMATOR:.....	194
6.3.3	IV – GMM .....	195
6.3.4	Përshkrimi statistikor .....	195
6.3.5	Gjetjet nga modeli GMM .....	196
7	<b>Përfundimi.....</b>	<b>200</b>
8	<b>Rekomandimet.....</b>	<b>205</b>
9	<b>Referencat.....</b>	<b>208</b>
9.1	Referencat nga punimet dhe hulumtimet shkencore.....	208
9.2	Referenca nga raporte, dokumente dhe publikime nga institucione vendore e ndërkombëtare .....	216
9.3	Linqet e shfrytëzuara.....	221
10	<b>Shtojcat .....</b>	<b>222</b>

### **Listë e tabelave**

Tabela 1. *Përshkrimi i ndërmarrësisë nga autorë të ndryshëm*

Tabela 2. *Klasifikimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në nivel evropian*

Tabela 3. *Përqindja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme sipas madhësisë në vendet e Ballkanit Perëndimor*

Tabela 4. *Kontributi i NVM-ve, i shprehur në përqindje në vendet e Ballkanit Perëndimor*

Tabela 5. *Klasifikimi dhe kontributi i ndërmarrjeve në vendet e EU28*

Tabela 6. *Klasifikimi i NVM-ve në Kosovë*

Tabela 7. *Statistika e Përpërjes së Normës së Papunësisë/ Punësimit në Kosovë për Periudhat 2006-2016*

Tabela 8. *Rezultatet empirike – OLS Modeli*

Tabela 9. *Testimi për shpërndarje normale të të dhënave- Modeli OLS*

Tabela 10. *Testi Breusch-Pagan / Cook-Weisberg për heteroskedasticitet- Modeli OLS*

Tabela 11. *Testi Durbin-Watson për Autokorrelacion- Modeli OLS*

Tabela 12. *Testi Breusch- Godfrey Lagrange Multiplier për autokorrelacion- Modeli OLS*

Tabela 13. *Statistikat përbledhëse të variablate ekzogjene dhe endogjene*

Tabela 14. *Rezultatet empirike- GMM Modeli*

### **Listë e grafikonëve**

Grafiku 1. Kontributi i NVM-ve në punësimin e përgjithshëm

Grafiku 2. Kontributi i NVM-ve në punësim i krahasuar me të ardhurat e vendit

Grafiku 3. Ndryshimi në punësim krahasuar me moshën e kompanisë për periudhat 2010-2013, EU28.

Grafiku 4. *Shpërndarja e Punësimit Sipas Sektorëve në Vendet e EU28*

Grafiku 5. *Kontributi i NVM-ve në Punësim në Vendet e Ballkanit Perëndimor*

Grafiku 6. Problemet më të Shprehura te të Cilat Ballafaqohen NVM-të - Krahasimi I Rezultateve të Fundit të Sondazhit SAFE

Grafiku 7. Përqindja e Regjistrimeve/ Çregjistrimeve të Shoqërive Tregtare në Kosovë.

Grafiku 8. Numri i Ndërmarrjeve Aktive në Kosovë për Periudhat 2008-2016

Grafiku 9. Trendi i Regjistrimit të Ndërmarrjeve të Reja në Kosovë për Periudhën 2006-2016

Grafiku 10. Trendi i Shuarjes së Ndërmarrjeve në Kosovë për Periudhat 2006-2016

Grafiku 11. Shpërndarja e Bizneseve Sipas Sektorëve në Kosovë

Grafiku 12. Struktura e ndërmarrjeve aktive në Kosovë e ndarë sipas veprimtarisë së tyre për periudhat 2006-2016

Grafiku 13. Qarkullimi i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme në Kosovë të Ndara Sipas Numrit të Punëtorëve 2006-2016

Grafiku 14. Shkalla e Papunësisë Sipas Nivelit të Arsimit në Kosovë

Grafiku 15. Norma e Papunësisë në Kosovë për Periudhat 2006-2016

Grafiku 16. Krahasimi i normave të papunësisë me vendet e rajonit

Grafiku 17. Papunësia tek të rinjt në Kosovë 2016-2017

Grafiku 18. Struktura e të Punësuarve Sipas Grupmoshave në Kosovë

Grafiku 19. Papunësia/ Punësimi e Shprehur në Numra në Kosovë për Periudhat 2006-2016

Grafiku 20. Trendi i Rritjes së të Punësuarve në dy Industritë më të Zhvilluara në Kosovë për Periudhat 2008-2016

Grafiku 21. Vlera e Subvencioneve dhe Transfereve të Shpërndara nga Buxheti i Kosovës për Periudhat 2006-2016

Grafiku 22. Shuma e Mjeteve si Garanci e Kredive për NVM-të në Kosovë

Grafiku 23. Vlera e Investimeve Kapitale në Kosovë për Periudhën 2006-2016

Grafiku 24. Vlera e Kredive për NVM-të Në Kosovë për Periudhat 2006-2016

Grafiku 25. Norma Reale Interesit për Kreditë në Kosovë për Periudhat 2006-2016

## Abstrakt

Rritja e punësimit në Kosovë është një nga çështjet më të ndjeshme nga njëra anë, dhe më sfidueset, nga ana tjetër, për politikëbërësit. Meqë Kosova radhitet ndër vendet që tentojnë të zhvillohen mbi baza të ekonomisë të tregut të lirë, sektori privat llogaritet si bartësi kryesor i krijimit të vendeve të reja të punës. Qëllimi i këtij punimi është të shohim kontributin që ka pasur ky sektor në rritjen e punësimit në Kosovë, përmes rritjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Andaj, punimi është përqendruar në matjen e efekteve të politikave mbështetëse për NVM-të, si subvencionet, investimet kapitale, norma e interesit dhe kreditë, e parë kjo në qarkullimin e NVM-ve. Matja e këtyre efekteve u bë në saje të përdorimit të modeleve ekonometrike si OLS dhe GMM, rezultatet e të cilave nxorën një lidhje të dobët mes këtyre politikave dhe rritjes së NVM-ve dhe se nuk u përkthyen në rritje të punësimit, të paktën jo në sektorin formal. Orientimi i mjeteve kreditore e investive në fusha me pak peshë në krijimin e vlerës së shtuar dhe jo prioritare, e mbështetur edhe nga një sektor privat i bizneseve i fragmentuar, ka bërë që këto politika të mos i ndihmojnë NVM-të të kontribuojnë në rritjen e punësimit.

Duke u bazuar në të gjeturat e punimit, rekomandimet morën theks të veçantë në harmonizimin e objektivave të strategjive zhvillimore kombëtare me kërkesat nga sektorët me prioritet, arsimt me biznesin në veçanti. Mjetet e financimit, si kreditë dhe subvencionet, të orientohen nga sektorë më me peshë në rritjen e bazës ekonomike, si ajo e prodhimit. Gjithashtu, del të jetë kërkesë urgjente reduktimi i informalitetit, pasi kjo dukuri ka efekt në zbatimin e politikave të përdorur, rrjedhimisht, edhe në rezultatet e punimit.

**Fjalët kyçe:** politikat mbështetëse, efektet, rritja e NVM-ve, rritja e punësimit

## Abstract

Increasing employment in Kosovo is on the one hand one of the most sensitive issues, and on the other hand more challenging for policymakers. Since Kosovo ranks among the countries that tend to develop on the basis of a free market economy, the private sector is accounted for as the main provider of employment possibilities. The aim of this paper is to see the contribution that this sector has in increasing employment in Kosovo through the growth of Small and Medium Enterprises. Therefore, the paper focused on measuring the effects of support policies for Small and Medium Enterprises (SME) such as subsidies, capital investments, interest rates, and loans, seen in the turnover of SMEs. Measuring these effects was made on the use of econometric models like OLS and GMM, the results of which led to a weak link between these policies and SME growth and did not become an increase in employment, at least not in the formal sector. Orientation of credit and investment vehicles in areas with less importance in creating value-added but non-priority ones, also supported by a fragmented private sector of businesses, has led these policies not to help SMEs to contribute to employment growth.

Based on the findings of the paper, the recommendations showed special emphasis on harmonizing the objectives of national development strategies with requirements from sectors of particular priority, amongst the education sector and business in particular. Financing tools such as loans and subsidies should be oriented from the most important sectors to the growth of the economic base, such as production. It also appears urgent to reduce informality, as this phenomenon has an effect on the implementation of the policies used, and consequently on the results of this paper.

**Key words:** support policies, effects, growth of SMEs, increase of employment

## HYRJE

### 1.1 *Shpjegimi teorik i qëllimit të punimit*

Në të gjitha ekonomitë e botës, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (tutje NVM) kanë rol të rëndësishëm në rritjen ekonomike përmes krijimit të vendeve të reja të punës, por jo vetëm. Kur shohim rastin e Kosovës, edhe pas 18 vite pas luftës, këto ndërmarrje nuk duket të kenë efektin e zhvillimit siç e përmenda më lart, ngase Kosova ka numrin më të madh të NVM-ve në vendet e Ballkanit Perëndimor edhe normën e papunësisë më të madhe, po ashtu. Andaj, gjersa themi se këto ndërmarrje kanë rol të veçantë në krijimin e vendeve të punës, është i nevojshëm një studim për të shpjeguar se si funksionojnë të njëjtat në Kosovë, sjelljen e tyre, ndikimin dhe efektet që kanë arritur t'i krijojnë në këtë vend. Gjithsesi, në të gjitha literaturat dhe rastet e tjera studimore<sup>1</sup> shohim se NVM-të luajnë rol qenësor, dhe këtë efekt duhet ta shtrijnë edhe në Kosovë.

Bazuar në këto konstatime, rasti i Kosovës duket të jetë më specifik meqë vendi përballet me situatë të rëndë ekonomike, e përcjellë kështu me dështime të mëdha të bizneseve të vogla ose të mesme, pavarësisht se ndërhyrja e Bashkimit Evropian në të gjitha instancat ka bërë që Kosova të gëzojë përkrahje të madhe dhe në forma të ndryshme.

Megjithatë, mjedisi në Kosovë është mjaft i kufizuar dhe jo aq i favorshëm për rritjen dhe zhvillimin e NVM-ve, gjë që do t'i hapte rrugë zhvillimit të vendit. Elemente si politikat jo të mira fiskale, konkurenca jo lojale, raport negativ i bilanceve tregtare, i pengojnë NVM-të që të japid efektet si në vendet e tjera.

Një tjetër element, i cili e bën situatën edhe më të vështirë, është fakti se Kosova nuk ka traditë të bizneseve dhe kjo ndikon të mos ketë ndërmarrje inovative, përpos të

---

<sup>1</sup> High-Growth SMEs and Employment, Organisation For Economic Co-Operation And Development, 2002, fq.10--28

karakterit imitues, gjë që nuk krijon vlera të reja, siç do të duhej, dhe kështu bëhet vetëm barrë financiare e shtetit dhe pasojë për qytetarët e saj.

Karshi kësaj, mendoj se Kosova ka nevojë për një model më produktiv të përkrahjes së NVM-ve, sepse këto që kanë qenë deri më tani vetëm sa e kanë çuar papunësi në shkallën prej 29.97% (World Bank, 2014), e cila, zbërthyer në shifra, nënkupton se nga numri i përgjithshëm i banorëve - 1,191,630, dhe fuqi punëtore 483,193 individë, 144,829 persona janë të papunë.<sup>2</sup> Andaj, konsideroj se ky punim do të arrijë të japë një model për të rritur nivelin e vendeve punës përmes modeleve më të përshtatshme dhe më të nevojshme të përkrahjes së NVM-ve.

Duke mos dashur të nënvljerësojmë seriozitetin e situatës, Kosova është një vend në tranzicion dhe pritet që këto ndërmarrje të kenë efektin e tyre themelor në rritjen e punësimit dhe do ta arrijnë, sigurisht me përkrahjen konkrete, dhe atë jo vetëm financiare, por edhe intelektuale, që të rrisin njohuritë dhe aftësitë sipërmarrëse, duke i bërë ato të janë më të sigurta në treg, por edhe më të përgatitura për t'u përballur me konkurrencën.

Sigurisht, nuk themi që në Kosovë këto ndërmarrje nuk kanë krijuar aspak vlera të reja dhe vende pune, por kanë qenë të përkohshme, më tepër se që duhet, dhe kjo po krijon më tepër kosto sesa benefit kur marrim në konsideratë faktin se ato janë më fleksibile se format e tjera të biznesit. Prandaj, bazuar në përvojat e vendeve të tjera dhe studimeve<sup>3</sup> ekziston lidhje pozitive në mes të përkrahjes së NVM-ve dhe rritjes së punësimit. Përmes përkrahjes, NVM-të do të ndihmohen që të pavarësohen dhe të janë më stabile, ky stabilitet do t'i ndihmojë ato të rrisin sigurinë dhe pavarësinë e përpalljes

<sup>2</sup> Agjencia e Statisikave të Kosovës, 2015, <http://askdata.rks-gov.net>

<sup>3</sup> Responsible entrepreneurship. A collection of good practice cases among small and medium-sized enterprises across Europe, EU, Enterprise DG, Brussels, <http://europa.eu.int/comm/enterprise/csr/index.htm>

me faktorët që gjenden në treg, do të janë më kreative dhe inovative dhe kjo do t'ju mundësojë të janë më efektive dhe konkurrente në treg.

Më lartë kemi thënë se NVM-të në Kosovë karakterizohen edhe me mungesë të traditës së ndërmarrësisë, e kjo i bën ndërmarrësit kosovarë shumë të varur nga përkrahja dhe nevoja për mjete financiare. Gjersa kjo situatë të vazhdojë e tillë, gjersa të mos ndikohet që kjo varësi të konvertohet në aftësi për vetmenaxhim dhe vetëkontroll, situata do të vazhdojë të jetë e rënduar. Vetëkontrolli rrit vetëbesimin e ndërmarrësve, ua zgjeron atyre pamjen e problemit, dhe sa më e madhe të jetë kjo “fotografi” aq më shumë gjasa ka për të gjetur zgjidhje. Rrija e firmës është një problem jo vetëm që ndikohet nga faktorë të jashtëm, por edhe të brendshëm, dhe për këtë kanë shkruar shumë studiues. Edhe në Kosovë, gjithnjë e më tepër, bibliotekat janë duke u mbushur me literaturë e studime për ndërmarrësinë dhe rritjen e aftësive ndërmarrëse. Kjo është një mënyrë se si të menaxhohet mungesa e përvojës në ndërmarrësi.

Andaj, duke marrë në konsideratë gjithë këto që thamë më lart, ky punim do të paraqesë, masë dhe interpretojë situatën e NVM-ve në Kosovë, duke përfshirë një periudhë 10 vjeçare, që nga viti 2006, përkrahje që janë bërë për NVM-të dhe efektet direkte që kanë dhënë këto përkrahje në proceset e vet NVM-ve, pastaj edhe në jetën e qytetarëve. Për ta realizuar këtë studim do të përdoren metoda kualitative dhe kuantitative.

## 1.2 *Përkufizimi i problemit*

NVM-të konsiderohen si ndër format më të përshtatshme të biznesit për shumë arsy, ndër to fleksibiliteti, lehtësia e themelimit dhe lehtësia menaxhimit, gjëra këto që i bëjnë të janë më të privilegjuara ndaj formave të tjera të bizneseve dhe të kenë rol qendror në politikat zhvillimore të vendeve. Kur këto ndërmarrje nuk japidin efektet

zhvillimore që priten të jepin, atëherë bëhen problem i vendit dhe krijojnë ngecje në zhvillim ekonomik.

Një rast i tillë është me Kosovën, e cila tash e sa vite nuk po arrin të përmirësojë performancën ekonomike të saj, pavarësisht se ka pasur mjaft tendenca dhe angazhime të institucioneve qeveritare dhe të tjera ndërkontaktore për ta rritur performancën. Kështu, me anë të këtij hulumtimi dëshirojmë ta shohim situatën më qartë dhe të propozojmë një model të përkrahjes dhe zhvillimit të NVM-ve për të qenë në gjendje të krijojnë vende të reja dhe të qëndrueshme pune.

Mendoj se NVM-të e vendeve në tranzicion, duke e shfrytëzuar situatën e mbështetjeve dhe asistencave të institucioneve kombëtare dhe ndërkontaktore, po bëhen të varura, kjo varësi i të papërgatitura ndaj ndonjë krize dhe po dështojnë. Kështu, modeli në fjalë konsiston në efektet e politikave mbështetëse për rritjen e NVM-ve, e që, rrjedhimisht, një firmë më e madhe, si në numër ashtu edhe në kapacitetet e saj, do të ndikojë pozitivisht në rritjen e numrit të të punësuarve. Pavarësisht se vendet e punës të krijuara nga NVM-të janë të karakterizuara nga paqëndrueshmëria, krijimi i tyre, krijon situatë të re, e cila prodhon efekte të reja mikroekonomike.

### **1.3 Hipotezat e hulumtimit**

H1: Përkrahja e NVM-ve nga qeveria përmes subvencioneve dhe granteve ndikon pozitivisht në rritjen e tyre

H2: Kreditë për NVM-të, kanë ndikim pozitiv në rritjen e NVM-ve

H3 Norma e interesit ndikon negativisht në rritjen e NVM-ve

H4: Rritja e investimeve kapitale ndikon pozitivisht në rritjen e NVM-ve

H5: Rritja e NVM-ve ndikon pozitivisht në rritjen punësimit

Tërë kohën themi se NVM-të kanë nevojë të përkrahen, dhe gjatë tërë këtij studimi përkrahet një gjë e tillë, por mendoj se në vendet si Kosova, ku rëniet ekonomike janë të shpeshta dhe zgjasin shumë, ndërsa rritjet nuk japid efekte të mëdha, NVM-të dinë të krijojnë varësi ndaj politikave mbështetëse dhe kjo i bën ato të mos janë imune ndaj krizave dhe kështu shumë shpejt shuhën. Kjo situatë e shuarjes së bizneseve është tipike për Kosovën dhe për vendet e ngjashme, pra të varfra.

#### **1.4 Pyetjet e kërkimore**

Duke u bazuar në thelbin e temës, e cila trajtohet në këtë punim, dhe ajo çfarë është thënë në përkufizimin e problemit, disa pyetje mund të ndihmojnë realizimin dhe të kuptuarit më mirë të punimit.

- A ndikojnë NVM-të në Kosovë në rritjen e normës së punësimit?
- Çfarë ndikimi ka mbështetja nga politikat e jashtme për NVM-të në rritjen e punësimit?
- Në çfarë mase ndikojnë masat mbështetëse të qeverisë në rritjen e NVM-ve në Kosovë ?
- Në çfarë mase ndikojnë politikat kreditore në rritjen e NVM-ve në Kosovë?
- A kanë ndikuar politikat mbështetëse në rritjen e qëndrueshmërisë së tyre?

#### **1.5 Objektivat e hulumtimit**

Tema e këtij punim është shumë e rëndësishme dhe aktuale, madje është ndër shqetësimet më të mëdha dhe sfidat kryesore të politikës qeveritare në Kosovë. Duke qenë kështu, punimi mundohet ta skanojë gjendjen, ta analizojë dhe të japë përfundime e rekomandime. Si objektiva kryesorë të punimit janë:

- Të vlerësojë kontributin e NVM-ve në rritje të punësimit,
- Të vlerësoj nevojën e NVM-ve në Kosovë për mbështetje,
- Të masë ndikimin e politikave mbështetës të qeverisë për rritjen e NVM-ve

- Të masë ndikimin e politikave mbështetëse kreditore për rritjen e NVM-ve
- Të vlerësoj ndikimin e NVM-ve në zhvillimin ekonomik dhe
- Të vlerësoj gjendjen e funksionimit të sektorit privat në Kosovë përmes pasqyrimit të gjendjes së NVM-ve.

### **1.6 Metodologja e hulumtimit**

Metodologja e hulumtimit paraqet pjesën thelbësore të punimit. Kjo është e varur nga qëllimi i punimit dhe mënyra e interpretimit të të dhënavë. Meqë punimi do ta matë efektin e politikave dhe masave mbështetëse për NVM-të, të cilat konsiderohen si motor të zhvillimit ekonomik, qoftë përmes sjelljes së produkteve të reja, konkurrencës, por më së shumti përmes krijimit të vendeve të reja të punës.

Punimi ka filluar me një interpretim të thjeshtë statistikor të të dhënavë, duke treguar për numrin e ndërmarrjeve ndër vite dhe për ndikimin e tyre në rritjen e punësimit. Për gjenerimin e këtyre të dhënavë janë përdorur të dhëna sekondare, të cilat janë siguruar nga institucione relevante dhe përgjegjëse.

Nga Agjencia e Statistikave e Kosovës (tutje ASK) janë siguruar të dhëna të sakta mbi numrin e ndërmarrjeve të përgjithshme, por edhe të ndara në seri kohore, ashtu që i kanë shërbyer më së miri metodologjisë së analizimit të të dhënavë për të marrë përgjigje në pyetjet kërkimore.

Ky institucion ka qenë baza e informatave thelbësore të përdorura në hulumtim, sidomos përmes aplikacionit [www.askdata.rks-gov.net](http://www.askdata.rks-gov.net), i cili përban të dhëna të përditësuara dhe në forma të ndryshme apikative, të lehta për përdorim. Të dhënat e marra nga ky aplikacion kanë shërbyer për të pasqyruar trendin e rritjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe statistika mbi normën e punësimit si dhe trendet dhe tendencat për ndryshim të numrit të të punësuarve në sektorin privat.

Ministria e Financave e Republikës së Kosovës (tutje MF) ka qenë burim informacioni për të dhëna financiare si; mjete të ndara në forma të ndryshme në emër të sektorit privat në përgjithësi, e NVM-ve në veçanti. Raporte buxhetore dhe të tjera statistika kanë shërbyer për të kuptuar sasinë e mjeteve të ndara për rritjen e punësimit. Duke qenë se punësimi është problem makroekonomik, të dhëna për të dhe rrëth tij janë të disponueshme në shumë burime zyrtare të informacionit, përmendim këtu institucionet shtetërore si Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (MZHE), Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), pastaj KIESA dhe organizata ndërkombëtare me mision për mbështetje të NVM-ve.

Pas analizimit të të dhënave të disponueshme si nga aspekti teorik (literatura), por edhe praktik (institucionet e lartshënuara), për matjen e efekteve të variablate në njëra tjetrën në orientim të gjetjeve sipas pyetjeve kërkimore, janë përdorur modele ekonometrike, si modele më të përshtatshme për rezultate të serive kohore, nga të cilat mund t'i vërtetojmë hipotezat e lartshënuara.

Në fakt, punimi me të dhënat në dispozicion iu është nënshkruar dy modeleve atë të metodës së katrorëve të vegjël (Ordinary Lienear Squar-OLS) dhe të momenteve të përgjithësuara (General Methos of Moments- GMM).

Përmes metodës OLS do të matim efektin e politikave në rritjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme parë në qarkullimin e tyre. Formula bazë për matjen e këtij efekti është

$$\log(QI) = \beta_0 \log(\text{log}) + \beta_1 \log(\text{sub}) + \beta_2 \log(\text{Cr}) + \beta_3 \log(\text{rl}) + \beta_4 \log(\text{CI}) \\ + \beta_5 \log(\text{unemp})$$

Ku shkurtesat paraqesin variablat që janë përdorur në model:

**QI:** qarkullimi i mjeteve

**Sub:** subvencionet

**Cr:** kreditë

**rl:** norma reale e interesit

## CI: investimet kapitale

Ndërsa instrumentet testuese për stabilitet të modelit janë

- **Testi Shapiro-Wilk W për shpërndarje normale të të dhënave-** duke pasur parasysh një mostër  $X_1, \dots, X_n$  e vëzhgimeve të vlerësuara me vlerë reale, testi Shapiro-Wilk (**Shapiro dhe Wilk, 1965**) është një provë e hipotezës së përbërë që të dhënat janë i.i.d. (të pavarur dhe të shpërndarë në mëynrë identike) dhe normale, dmth.  $N(\mu, \sigma^2)$  për disa  $\mu$  reale të panjohur dhe disa  $\sigma > 0$ .
- **Testi Breusch-Pagan / Cook-Weisberg për heteroskedasticiteti-** teston hipotezën e pavlefshme se variancat e gabimit janë të gjithë të barabartë kundrejt alternativës se variancat e gabimit janë një funksion multiplikativ i një ose më shumë ndryshoreve.
- **Testi Durbin-Watson-** testojnë hipotezën e pavlefshme se mbetjet nga një regresioni i zakonshëm më pak me katorë nuk është i autokorreluar kundrejt alternativës që mbetjet ndjekin një proces AR1. Shkalla e **Durbin-Watson** shkon në vlerë prej 0 deri në 4.

Modele të tilla kanë arritur të na shpijnë në rezultate konkrete bazuar edhe nga të dhëna sekondare të literaturave të ndryshme shkencore, por edhe më shumë të studimeve individuale të studiuesve të shumë që janë marrë me të njëjtën problematikë.

### 1.7 Rëndësia e hulumtimit

Në vendet e zhvilluara, NVM-të jepin efekte të dukshme dhe të rëndësishme në zhvillimin ekonomik, por në vendet e varfra dhe ato në tranzicion nuk i jepin këto efekte, për arsyet që i kemi dhënë më lart. Në vendet në tranzicion, NVM-të nuk kanë ndonjë politikë të mirëfilltë për zhvillim vetëm se i shfrytëzojnë ato pak momente euforike që krijojnë vendet në tranzicion dhe vrapojnë për t'i konsumuar asistencat financiare që vijnë nga faktorë mbështetës. Por, a janë në të vërtetë NVM-të elemente që ndikojnë në krijimin e vendeve të reja të punës?! Nga të gjitha literaturat dhe të gjitha gjendjet ekonomike të cilat janë të matshme, shohim se janë NVM-të ato të cilat i jepin dinamizëm zhvillimit ekonomik dhe janë katalizatorë të krijimit të vendeve të reja të punës

A ka Kosova biznese të tilla, të cilat po luajnë rolin e faktorit kryesor që ndikon në rritjen e punësimit? A duhet të jasin efekte të njëjtë të gjitha NVN-të në vende të ndryshme apo varen nga politikat mbështetëse? Cilat janë politikat që i favorizojnë ato përsituata të ndryshme në të cilat ndodhen? A janë ndërmarrësit, ata të cilët i bëjnë ndërmarrjet të jenë të qëndrueshme dhe krijuese të vendeve të reja të punës? Apo janë kushtet e mjedisit faktorët që i bëjnë NVM-të të jenë çdo herë të rrezikuara nga humbja? A kanë nevojë për mbështetje NVM-të? A mundet qeveria të ndikojë në rritjen e firmave përimes programeve mbështetëse dhe politikave të mira biznesore? Kreditë, a mund të jenë faktorë për rritjen e NVM-ve, duke u ofruar atyre mjete financiare në masë më të madhe, gjersa dihet se një nga faktorët më sfidues në firmën e vogël është mungesa financiare? A është përgjegjëse qeveria apo kreditë për rritjen, gjegjësisht shuarjen e NVM-ve? A minden investimet e huaja të kontribuojnë në qëndrueshmërinë e NVM-ve?! A është duke përdorur Kosova strategji të duhura për ta ndihmuar iniciativën e lirë?...

Përgjigjet për këto pyetje dhe të tjera, do t'i jasin kuptim këtij punimi, i cili do të vërë në pah nevojën për modele të përshtatshme përkrahjeje dhe zhvillimore për NVM-të

### **1.8 Kufizimet e hulumtimit**

- Të dhënat në dispozicion janë marrë nga ente të ndryshme statistikash në Kosovë, andaj nuk kanë nivel të lart besueshmërie për faktin se ndërmarrjet edhe i rezistojnë dhënieve së informatave të sakta. Kjo mund t'i dëmtojë edhe rezultatet e nxjerra. Për shembull, Agjencia e Statistikave të Kosovës tash së voni ka formuar një platformë online për qasje në të dhëna, por problemi është se ka diskrepancë të madhe në mes të institucioneve shtetërore rreth paraqitjes së të dhënavë zyrtare.

- Periudha e hulumtimit përfshin një dekadë dhe të dhënat, për shkak të modelit që është përdorur, do të duhej të ishin të serive kohore çdo muaj. Andaj, natyra e disa të dhënavë është e tillë që nuk mund të mblidhen në periudha të tilla, apo edhe ndoshta për periudha të caktuara, institucionet kompetente nuk kanë arritur të sigurojnë të dhëna të sakta, kështu i kanë marrë si mesatare e periudhave paraprake. Mënyra e raportimit të këtyre të dhënavë mund të ndikojë në rezultatin e hulumtimit.
- Natyra e politikave mbështetëse është e tillë që jo të gjitha NVM- të kanë qenë përfituese të tyre, ose jo të gjitha NVM-të janë pjesë e marrëdhënieve kreditore, por të dhënat për performancën e NVM-ve janë marrë për të gjitha NVM-të për të parë nivelin e përgjithshëm të ndikimit
- Klasifikimi i NVM-ve në Kosovë dallon nga shumë vende, andaj përvojat dhe krahasimet mund të mos paraqesin çdo herë situatën reale.

### **1.9. *Rezultatet e pritura***

Bazuar në përvojën e vendeve të tjera, rishikimin e literaturës dhe rezultatin e pritshëm në mënyrë logjike, konstatojmë se përkrahja nga ana e faktorëve të jashtëm në forma financiare do t'i hapë rrugë të ndritshme kontributit të madh që NVM-të mund të kenë në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Kjo bazohet edhe në rezultatet pozitive të lidhjeve në mes të rritjes së investimeve qeveritare për mbështetjen e NVM-ve dhe rritjes së NVM-ve, e rrjedhimisht rritjes së punësimin. Gjithsesi, jo vetëm mbështetja financiare, por qeveria ka politika mbështetëse të formave të ndryshme që i mundësojnë firmës së vogël të ketë gjasa më të mëdha të mbijetojë në treg. Stabiliteti është një garanci për zhvillimin ekonomik në saj të krijimit të vendeve të reja të punë.

Prandaj, në bazë të përfundimeve që kemi nxjerrë, japim propozimet apo rekomandimet e mëposhtme:

- Aspekti finansiar i NVM-ve është shumë i ndjeshëm dhe thelbësor për mbijetesën e firmave. Konform kësaj, mbështetja për NVM-të është proces mjaft i rëndësishëm në jetën e firmës së vogël. NVM-të në Kosovë nuk mund të funksionojnë pa mbështetje të jashtme, ngase kanë mungesë të mjeteve vetanake.
- Subvencionet dhe grantet kanë shumë ndikimin në rritjen dhe qëndrueshmërinë e firmave të vogla në Kosovë. Nga ana tjetër, investimet kapitale janë shumë afatgjata për t'i ndjerë efektet e saj NVM-të, kështu, pavarësisht rëndësise që kanë këto investime në zhvillimin ekonomik, efekti i tyre në rritje të punësimit përmes NVM-ve është objektiv i pa përbushur. Pra, për të rritur punësimin, NVM-të kanë nevojë për fonde më të shpejta dhe në masë më të madhe. Këta faktorë mbështetës, duhet ta kenë parasysh faktorin kohë dhe masë, në mënyrë që qëllimet e politikave mbështetëse të tyre të zënë vend.
- Rekomandimi tjetër ka të bëjë me qasjen në burimet financiare kreditore. Kreditë janë burim shumë i rëndësishëm në rriten dhe sigurinë e NVM-ve, por, meqë janë të vogla, dhe situata ekonomike në Kosovë është e paqëndrueshme, atëherë bankat hezitojnë të jepin shuma të mëdha të mjeteve për NVM-të. Me këtë konstatojmë se NVM-të kanë nevojë për më shumë mjete kreditore, pa cenuar dhe rritur kriteret për përfitim të kredive.

## KAPITULLI II - RISHIKIMI I LITERATURËS

### 2.1 Vështrim i përgjithshëm mbi ndikimin e NVM-ve në krijimin e vendeve të punës

Ndarja e ndërmarrjeve në të vogla dhe të mëdha është përcaktim që nuk është unifikuar ende. Për shtetet anëtare të **OECD-së**, emërtimi i tillë është bazuar në numrin e punëtorëve, i cili më NVM-të është më pak se 250 punëtorë<sup>4</sup>. Në shumë teori dhe punime shkencore vërtetohet se NVM-të kanë ndikim të madh në krijimin e vendeve të reja të punës<sup>5</sup> andaj edhe kanë zënë vend të veçantë në politikat zhvillimore të vendeve në përgjithësi.

Kështu, janë krijuar masa të ndryshme për t'i mbështetur NVM-të në mënyrë që ato të luajnë rolin e tyre në mënyrën më të mirë të mundshme. Kundruall kësaj, potencojmë se roli më i madh i NVM-ve është pikërisht kontributi që ato mund të kenë në rritjen e punësimit, objektiv ky që has në sfida të mëdha dhe kjo sfidë është edhe më e rëndë në vendet e pazhvilluara.

---

<sup>4</sup> OECD, Anual Report 2005 45<sup>th</sup> Anniversary

<sup>5</sup> Emilia Herman, Emerging Markets Queries in Finance and Business , SMEs and their Effect on the Romanian Employment, Procedia Economics and Finance 3, fq. 290 – 297, 2012

Brian Ashcroft James H. Love, Firm births and employment change in the British Counties: 1981-89, APERS IN REGIONAL SCIENCE: The Journal of the RSAI 75, 1996

<http://www.geo.ut.ee/nbc/paper/smallbone.htm>

R. Baptiste, V. Escaria, P. Madruga, The Effects of New Businesses on Economic Development (January 2008), Small Business Economics Vol. 30, pp. 49-58 2007

Delmar, F. and Davidsson, P. and Gartner, W. Arriving at the high growth firm. Journal of Business Venturing 18(2):pp. 189-216. 2003

Fahrad Anaoui, Azhdar Karami, Strategic Management in Small and Medium Enterprises, 2003, fq. 276

Pavarësisht, bindjes që tregojnë se NVM-të luajnë rol të madh në krijimin e vendeve të reja të punës, nuk është se nuk ka autorë që nuk e kanë kontestuar atë.<sup>6</sup> Sipas këtij punimi, janë shkrime të cilat shprehin skepticizmin dhe kundërshtimin e konkluzioneve se NVM-të luajnë rol shumë të rëndësishëm në krijimin e vendeve të reja të punës, si p.sh. **Davis, Haltiwanger & Schuh, Thorsten Beck, Asli Demirguc-Kunt, Haltiwanger.**<sup>7</sup> Sipas këtyre autorëve, nëse këto ndërmarrje qenkan faktorë të tillë, atëherë pse në pothuajse të gjitha konkluzionet, thuhet ato kanë nevojë për mbështetje?!

Duhet cekur se numri dhe karakteristikat e NVM-ve janë të ngjashme në të gjitha vendet e botës, por trajtimi i tyre ndryshon nga vendi në vend. Kjo për shkak se vendet u japin prioritet gjërave të ndryshme, të cilat e sfidojmë zhvillimin ekonomik përkatës.

Duke i parë kaq të rëndësishme këto ndërmarrje, vendet janë shumë të interesuara që t'i përdorin si instrument për ta zbutur papunësinë dhe varfërinë. Por, për shkak të karakteristikave të këtyre ndërmarrjeve, ato nuk janë në gjendje ta realizojnë misionin e tyre pa mbështetjen e faktorëve të jashtëm, me të cilat ajo (ndërmarrja e vogël) është në mënyrë direkte apo indirekte e lidhur. Një nga këta faktorë shumë i rëndësishëm për jetën e ndërmarrjes së vogël është qeveria, si organ ekzekutues i vendimeve ligjore që dalin nga kuvendi. Këto vendime dinë të janë shumë apo pak përkrahëse për NVM-të, por efektin

---

<sup>6</sup> Per davn, Leif Lindmark, Christer Olofsson, The extent of overestimation of small firm job creation - an empirical examination of the "regression bias" Small Business Economics, fq. 87-100. 1998

<sup>7</sup> Thorsten Beck Asli Demirguc-Kunt, Small and medium-size enterprises: Access to finance as a growth constraint \*, 2006

Steven J. Davis, John Haltiwanger, Scott Schuh Small Business and Job Creation: Dissecting the Myth and Reassessing the Facts, Small Business Economics, October, 1993, The Quarterly Journal of Economics, Vol. 107, No. 3, pp. 819-863, <http://www.jstor.org/stable/2118365?origin=JSTOR-pdf>, 1992

Steven J. Davis and John Haltiwanger Gross Job Creation, Gross Job Destruction, And Employment Reallocation,

e tyre e bartin, andaj është shumë e rëndësishme ta dimë se i këto politika po ndikojnë në jetën e ndërmarrjeve. Për shembull, një formë e mbështetjes së qeverisë për NVM-të që ta arrijnë këtë objektiv, konsiderohen ofrimi dhe zbatimi i politikave favorizuese në krijimin e një ambienti shoqërore për biznes dhe një ambienti ligjor të përshtatshëm.

Studimet rrreth kontributit të NVM-ve në shumë vende pajtohen në pikën që zhvillimi ekonomik i seilit vend është i lidhur shumë ngushtë me zhvillimin e NVM-ve.<sup>8</sup> Gjithashtu, sipas **Ayyagari, Beck& Kunt**,<sup>9</sup> kontributi i NVM-ve në vendet e zhvilluara dhe atyre me të ardhura të larta, është afër 50% e GDP-së në mesatare. Ndërmarrjet e vogla ofrojnë mekanizma për stimulimin e ndërmarrjeve indigjene në shumë vende, duke krijuar mundësi punësimi dhe duke ndihmuar zhvillimin e teknologjisë lokale.<sup>10</sup> Kontribut më i zbehur i NVM-ve shihet në vendet me të ardhura të vogla për shkak të pafuqisë për të krijuar vlera të reja dhe për shkak të disekulibrimit të tregut, po gjithsesi, ato luajnë rol jashtëzakonisht të dobishëm në nxitjen e zhvillimit ekonomik. E para gjë, të cilën kanë provuar ta bëjnë vendet në tranzicion, ka qenë transformimi i ekonomisë nga sistem i mbyllur në atë hapur, proces i cili është përcjellë me defekte të ndryshme dhe ka penguar zhvillimin e sektorit privat, dhe si e tillë ka prolonguar edhe zhvillimin ekonomik. Vendet e Ballkanit Perëndimor janë shembuj tipikë të proceseve të stërgjatura apo edhe të dështuara të procesit të privatizimit. Në vendet si Sllovenia, Kroacia, Hungaria, Bulgaria, Rumania, etj., procesi i privatizimit është zhvilluar më shpejt, ndërsa Shqipëria, Maqedonia, Bosnja, Kosova, etj., janë ende duke u ballafaquar me pasojat e privatizimit, dhe duket të shkojë kohë deri sa t'i korrin fryshtet e këtij proces..

---

<sup>8</sup> Thorsten B., Aslı Demirgürç-Kunt, and Levine R. "SMEs, Growth, and Poverty: Cross-Country Evidence," Journal of Economic Growth. 2005

<sup>9</sup> Ayyagari, M., Thorsten B, and Aslı Demirgürç-K.. "Small and Medium Enterprises Across the Globe," Small Business Economics 2007

<sup>10</sup> World Bank. Private sector development in low income countries, Washington, D.C. 1995

Në **raportin e Bankës Evropiane** për Investime thuhet se në Kosovë, Maqedoni dhe Serbi, kontributi i NVM-ve në punësimin total është mbi mesataren e BE-së, në masën prej 67%, ndërkojë që është përafërsisht i njëjtë edhe në Bosnjë dhe Hercegovinë, ndërsa në Shqipëri dhe Mal të Zi nuk është e përcaktuar qartë.<sup>11</sup> Duke iu referuar ende këtij raporti, është një situatë tejet e kënaqshme dhe interesante ku citohet se NVM- të në Bosnjë Hercegovinë, Maqedoni dhe në Mal të Zi, kontributi në vlerën e shtuar është më i lartë se mesatarja e Evropës, në ndërkojë që ka vende të Ballkanit Perëndimor që kanë pasur prosperitet të bizneseve të mëdha dhe kanë krijuar avantazh ndaj vendeve fqinje, si rasti i Serbisë.

Rritja ekonomike në vendet e zhvilluara të tillë si Japonia, Koreja, Tajvani dhe shumë të tjera, gjenerohet dukshëm nga aktivitetet e NVM- ve<sup>12</sup>. **Referuar po këtij punimi**, kontributi i përqindjes së NVM-ve te Produkti i Brendshëm Bruto (BPV)/Vlera totale e shtuar shkon nga% 60 në Kinë, 57% në Gjermani, 55.3% në Japoni dhe 50% në Kore, krahasuar me 47.3% të arritur nga Malajzia. NVM-të, gjithashtu, kanë luajtur rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të Kinës. Aktualisht, atje ka më shumë se 10 milionë NVM që përbëjnë 99% të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve në Kinë.<sup>13</sup>. NVM-të kontribuojnë me 60% të vëllimit të prodhimit industrial dhe 40% të tatimeve dhe fitimeve totale të realizuara nga ndërmarrjet në vendin aziatik. Kontributi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Japoni është 65%, Gjermania 48%, ndërsa në SHBA 45% e saj. NVM-të në SHBA prodrojnë

---

<sup>11</sup> European Investment Bank, Assesment on financing needs of SEMs in the Western Balkans Countries, Sythesis Report, Augurst 2016

<sup>12</sup> Ngui Thomas Katua. International Journal of Education and Research Vol. 2 No. 12 December 2014 461  
The Role of SMEs in Employment Creation and Economic Growth in Selected Countries. fq.467

<sup>13</sup> Po aty, fq.468

më shumë se gjysmën e prodhimit të brendshëm bruto të vendit (BPV).<sup>14</sup>

Po ashtu, në vendet në zhvillim, NVM-të zënë hapësirë me 45% të punësimit të përgjithshëm dhe 33% në të ardhurat kombëtare (PBB).<sup>15</sup> Referuar po këtij burimi, për të absorbuar më shumë se 600 milionë fuqi punëtore, do të duhen 15 vjet ta lokalizojnë këtë fuqi në vende përkatëse të punës, dhe 4 nga 5 vendet e punës që do të duhesin të hapeshin, do të sigurohen nga NVM-të

Marrë në konsideratë Raportin botëror për zhvillim (**World Report Development**) të vitit 2013, për krijimin e vendeve të punës, kuptojmë se punësimi në masën më të konsiderueshme në vendet në zhvillim nuk vjen as nga ndërmarrjet e vogla e as të mesme, por ato mikro. Pra, jemi dëshmitarë se si ndërmarrjet me më pak se 10 punëtorë, kontribuojnë me aq shumë vende pune, pavarësisht faktit se janë më pak stabile, kontributi i NVM-ve në krijimin e vendeve të punës është një fakt i vërtetuar praktikisht. Firmat e vogla prodrojnë më shumë vende pune se sa të mëdhatë dhe karakteristika, pothuajse, të njëjta i përshkruajnë të gjitha vendet e Evropës. Në Gjermani, të dhënat kombëtare tregojnë përfaktin se si ndërmarrjet e mesme kontribuojnë më pak në krijimin e vendeve të punës, konkretisht rreth 50%, ndërsa më shumë në shkatërrimin e tyre, konkretisht rreth 70%, ndërsa mikro dhe ndërmarrjet e vogla më shumë krijojnë se sa shkatërrojnë vende pune.<sup>16</sup>

Në Francë, NVM-të janë burim i vendeve të reja të punës rreth 63%, ndërsa është bartëse rritjes së shkatërrimit të vendeve të punës rreth 38% të tyre.<sup>17</sup> Rasti më i veçantë për ndikimin e NVM-ve në krijimin e neto vendeve të reja të punës është Luksemburgu, cili

---

<sup>14</sup> Ngui Thomas Katua. International Journal of Education and Research Vol. 2 No. 12 December 2014 461  
The Role of SMEs in Employment Creation and Economic Growth in Selected Countries. fq.468

<sup>15</sup> <http://www.worldbank.org/en/topic/financialsector/brief/smss-finance>

<sup>16</sup> Komisioni Evropian, Raporti Vjetor mbi NVM-të evropian 2014/2015, fq.83.

<sup>17</sup> Po aty.

karakterizohet me kontributin e NVM-ve në krijimin e vendeve të reja të punës në shifrën prej 12000 vende punë në vetëm 6 vjet, ndërsa po për këtë periudhë është përgjegjëse për shuarjen e 4000 vendeve të punës. Pra, siç shihet ka një bilanc të kënaqshëm në mes të vendeve të reja të punës të krijuara nga mirkondërmarrjet, konkretisht 8000 neto vende pune të krijuara nga viti 2006-2012.<sup>18</sup>

Një tjetër karakteristikë e NVM-ve në vendet në zhvillim kundrejt atyre të zhvilluara është edhe mundësia e rritjes. Në vendet në zhvillim, duke marrë parasysh që firmat janë shumë të vogla dhe se mezi i mbijetojnë situatës nëpër të cilën zhvillohen proceset ekonomike të vendeve të tyre, andaj edhe nuk kanë fuqi që të zgjerohen. Nga ana tjetër, firmat e tillë në vendet e zhvilluara, në periudha afatgjata arrijnë fitim normal<sup>19</sup> dhe pastaj presin t'i shohin ditët e lulëzimit dhe të përjetojnë rritjen, që nënkupton edhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Vështruar nga aspekti social, krijimi i vendeve të punës rezulton në rritje të të ardhurave nga taksat dhe ulja e shpenzimeve të jetesës, andaj kjo është një nga pikat më të forta të interesit për të ndihmuar dhe mbështetur rritjen e NVM-ve.

Disa studime në SHBA dhe në Britani të Madhe kanë pohuar se këto firma shumë të vogla, të ashtuquajtura “fletushka” apo “gazele”, janë krijuesit e vërtetë të vendeve të punës në ekonomi.<sup>20</sup> Sipas të të njëjtit burim, shumica e vendeve të punës të krijuara, nuk janë dyfishim i punëve nga firmat ekzistuese, pra nuk janë rezultat i performancës së tyre, sa janë rezultat i hyrjes së firmave të reja. Gjithsesi, kjo gjë nuk ka mundur të vërtetohet njëjtë në të gjitha vendet. Për shembull, në Suedi, studimet nuk kanë qenë në gjendje të konfirmojmë në mënyrë absolute se këto forma të firmave të vogla, të

<sup>18</sup> Komisioni Evropian, Raporti Vjetor mbi NVM-të evropian 2014/2015, fq.83.

<sup>19</sup> A. Manquellari, S. Haderi, S. Qirici, Hyrje në Ekonomi, 1987

<sup>20</sup> Magnus Henrekson and Dan Johansson, Gazelles as Job Creators – A Survey and Interpretation of the Evidence, IFN Working Paper No. 733, January 22, 2009

ashtuquajtura “gazele” kanë luajtur rol të madh në krijimin e vendeve të reja të punës.<sup>21</sup> Gjithsesi, këto ndryshime janë si rezultat i karakteristikave që kanë vendet e caktuara.

Sipas **Narayan (2002)**, i cili kishte bërë një hulumtim me 60000 njerëz të varfér në më shumë se 50 shtete dhe kishte nxjerrë rezultatin se mënyra më e përshtatshme dhe efektive për të dalë nga varfëria është “hapja e një biznesit të ri” - rreth 63% e të anketuarve mendonin njëjtë.

Rezultatet më të mira në aspektin e performancës u regjistruan në SME-të në Gjermani dhe Austri, dhe performancat më të këqija në Hungari, Lituani, Bullgari dhe Rumani.

Performanca e lartë e regjistruar nga NVM-të në Austri dhe Gjermani u bazua në tre faktorë:

- përqendrimi i stafit të NVM-ve në fushat e teknologjisë së lartë;
- ekzistenza e një lidhjeje të drejtpërdrejtë midis produktivitetit të punës, investimeve dhe eksportit;
- rritjen e punësimit duke rritur produktivitetin.

Megjithatë, analiza e korrelacionit midis inovacionit dhe konkurrueshmërisë tregon se vendet me performancën më të lartë ekonomike në Bashkimin Evropian kanë, gjithashtu, përqindjen më të madhe të NVM-ve në fushat e prodhimit dhe shërbimeve të teknologjisë së lartë.<sup>22</sup>

---

<sup>21</sup> Delmar, F. and Davidsson, P. and Gartner, W. Arriving at the high growth firm. Journal of Business Venturing 18(2):pp. 189-216. 2003

<sup>22</sup> Mirela I. A., Daniela L. T., Andreea C.Ş, The role of small and medium enterprises in improving employment and in the post-crisis resumption of economic growth in Romania, Theoretical and Applied Economics Volume XXI, No. 1(590), pp. 87-102,.2012

Mbështetja e NVM-ve është shumë e rëndësishme për faktin se ajo ka pjesëmarrje të lart në punësim dhe ndikim të madh në zhvillimin ekonomik, duke e pasuar tregun me produkte të reja, si dhe duke nxitur konkurrencën.

Mbështetjen më të madhe për NVM-në mund ta japë vet menaxhmenti i saj, i cili është i thirrur t'i orientojë resurset e saj në vende ku nuk rrezikohen, por edhe i sigurojnë fitim ndërmarrjes. Por, duke qenë se NVM-të janë firma të vogla, ato janë të kufizuara në treg dhe në këtë situatë nuk mund t'i rrisin kapacitetet e tyre ose t'u mbijetojnë faktorëve të jashtëm sikur mos të kishin edhe mbështetje nga jashtë.

Duke marrë parasysh se themi se NVM-të kanë kapital të kufizuar, atëherë mbështetja apo asistenca financiare është një politikë e efektshme për to. Përkrahja e tillë mund të vijë nga qeveria dhe nga sistemi bankar, që është edhe qëllim i studimit tonë. Nga ana tjetër, për NVM-të që janë në proces tranzicioni, përkrahja në përmirësimin e menaxhimit dhe udhëheqjes së orientimit të resurseve të saj, po ashtu ka pasur mjaft efekt.

Për këtë qëllim janë bërë edhe shumë punime të tjera në vende të ndryshme, të cilat janë munduar të shohin ndikimin e këtyre faktorëve në rritjen e NVM-ve, të cilat rrjedhimisht do të arrinin të rrisnin pjesëmarrjen në punësimin e përgjithshëm.

Problemi i punësimit është sfidë me të cilin nuk ballafaqohen vetëm vendet e pazhvilluara, por edhe ato të zhvilluara, porse në vendet e pazhvilluara problemi është më akut dhe kërkon zgjidhje më të shpejtë për t'i reduktuar pasojat. Për këtë arsy, s faktorët që ndikojnë në uljen e papunësisë, gjegjësisht i rritjes së punësimit, janë bërë objekt i hulumtimeve të shumta shkencore e projekteve të ndryshme zhvillimore për ta parandaluar degradimin e fuqisë punëtore, e cila kur nuk gjen vend pune për profilin përkatës, në secilën herë duke u bërë barrë e shoqërisë dhe e qeverisë, zhvlerësohet dhe shton kostot e papunësisë.

Përfundimet e këtyre hulumtimeve tregojnë për faktorë të ndryshëm që ndikojnë në krijimin e vendeve të punës, e ndër to përmendet qeveria si faktor shumë i rëndësishëm në jetën e NVM-ve. Punime të tilla përkrahnin teorinë kejnsiane të zhvillimit, pasi që Kejnsi ka paraparë si të paqëndrueshme ekonominë, nëse në dukuritë e saj nuk ndërhyt një forcë e llojit të një institucioni ekzekutiv: qeveria. Pra, ndër objektivat e një stabiliteti të qëndrueshëm ekonomik është edhe rritja e punësimit, e kjo duhet të jetë objektiv i qeverisë, e cila me masa përkatëse dhe të ndryshme, mund ta arrijë atë. Teoria në fjalë stimulon ekonominë, duke i bërë njerëzit të ndihen më krenarë dhe më të motivuar për të punuar, kur dinë që në mbështetje të tyre qëndron shteti.

Kufizimet financiare paraqesin një ndër faktorët me ndikim në rritjen e NVM-ve, respektivisht mosrritjen e tyre. Një mangësi e tillë është theksuar dukshëm në ndërmarrjet e vogla evropiane. Kështu, në një studim, **Rein Wagenvoort**<sup>23</sup> njohës i politikave zhvillimore të NVM-ve, tregon se me hulumtimin e më se 200.000 firmave prodhuase dhe ndërtuese evropiane, vërteton se këto ndërmarrje vuajnë nga kufizime të mëdha financiare dhe këto bëjnë që të prolongojnë procesin e përparimit dhe zhvillimit të tyre, dhe kjo bën që ato të rriten shumë ngadalë. Sipas këtij hulumtimi, del se në mungesë të mjeteve financiare, kredia del si burimi i dytë financiar për NVM-të, konkretisht ndërmarrjet që kanë qarkullim deri në 10 milion euro në vit, paraqesin peshën më të madhe në kredimarrje në banka.<sup>24</sup> Një detaj interesant në këtë hulumtim është se ndërmarrjet prodhuase kategorizohen si ndërmarrje që më së paku marrin kredi, tipike kjo për ndërmarrjet evropiane për shkak se kjo është sfida më e madhe e shumë vendeve në këtë rajon, gjersa të njëjtat vuajnë nga stagnimi i zhvillimit ekonomik, pikërisht për shkak të prodhimit të ultë.

Në veçanti, vërehet se kufizimet financiare kanë tendencë të pengojnë rritjen e firmave të vogla dhe shumë të vogla dhe të jenë më pak të detyrueshme për ndërmarrjet e

---

<sup>23</sup> Rein Wagenvoot, Volume 8 N° 2, 2003, pg. 97

<sup>24</sup> Po aty,

mesme. Nëse krahasohet me ndërmarrjet e mëdha, NVM-të janë më të kufizuara nga disponueshmëria e financimit të brendshëm. Studime të tjera empirike<sup>25</sup> kanë konfirmuar se disponueshmëria e kufizuar e financave ndikon në rritjen e firmës së vogël. Megjithëse firmat më të vogla kërkojnë të arrijnë një shkallë minimale efikase, ata kanë më shumë gjasa të jenë të paafta për të marrë kapital të mjaftueshëm nga burimet e jashtme në mënyrë që ta zgjerojnë bizneset e tyre. Në veçanti, në kushtet e këqija ekonomike, financimi i brendshëm mund të ketë një ndikim më të madh në rritjen e NVM-ve. Për më tepër, përdorimi intensiv i financave të brendshme minimizoj kostot e rritjes pasi burimet e brendshme kushtojnë më pak se burimet e jashtme. Kjo është për shkak të faktit se qasja në tregjet financiare dhe sigurimi i burimeve të jashtme janë më problematike për firmat e vogla.

Autorë të ndryshëm dhe raporte të ndryshme, të përshkruara më poshtë tekstit, kanë studiuar efektet e kredisë në rritjen e firmës. Një nga elementet që e bënë kreditin të favorshme apo jo, nuk janë vetëm kriteret për kredimarrje, ajo është çmimi i saj, i cili për firmat në përgjithësi, e firmat e vogla në veçanti është faktorë shumë i ndjeshëm. Çmimi i kredisë quhet normë e interesit ose kamatë, që zakonisht në vendet e pazhvilluara përcillet me norma të larta, të cilat i bëjnë edhe më të papërshtatshme kreditë për ndërmarrjet.

Nga ana tjetër, duke dalë nga sfera bankare si masë mbështetëse për ndërmarrjet, qeveria luan një rol shumë të rëndësishëm, dhe aq më tepër për shkak të autoritetit që

---

<sup>25</sup> Leonardo Becchetti and Giovanni Trovato, The determinants of growth for SMEs sized firms. the role of the availability of external finance, 2002, fq.13

Daniel Makina, Ashenafi Beyene Fanta , Kingstone Mutsonziwa,Jabulani Khumalo ,Obert Maposa, Financial Access and SME Size in South Africa, December 2015

OECD (2011), Small businesses, job creation and growth: facts, obstacles and best practices, The Council of Europe Development Bank (CEB)

OECD, Enhancing SME access to diversified financing instruments, Plenary session 2. Fq 6.

ka si organ i vetëm kushtetues ekzekutiv mbi vendosjen e taksave dhe tatimit, të cilat politikat janë, po ashtu, të ndjeshme për firmat. Në rastin e Kosovës, politikat tatimore, sidomos për firmat e vogla, konsiderohen favorizuese, pastaj tatimi mbi të ardhurat personale, që do të mund të ndikonte mbi politikat e personelit nëpër firma, nuk kanë ndryshuar një kohë të gjatë, dhe aq më tepër nuk kanë ndryshuar për periudhën për të cilën është bërë ky punim, andaj edhe nuk është marrë si masë mbështetëse për NVM-të.

Gjithsesi, qeveria përpos politikave të mira tatimore mund të ndikojë në jetën e firmës edhe duke i krijuar asaj kushte për të punuar, një ambient miqësore, ku zotëron ligji, një infrastrukturë të mirë, por edhe përkrahje në formë materiale, grante dhe subvencione. Politika të tilla sigurojnë ambient të qëndrueshëm për të bërë biznes, por që faktori sundim i ligjit, e që me NVM-të lidhet, bie fjala, me respektimin e kontratave, mbetet ende një pengesë, e cila duket se do t'u kushtojë investimeve në Kosovë, sidomos të huaja pasi që investitorët nuk i duan vendet me probleme - sidomos në sundimin e ligjit, pasi që nuk duan ta rrezikojnë kapitalin e tyre.

Në kuadër të politikave investive kapitale, në strategjinë për zhvillim të NVM-ve, është parë paraprakisht si pengesë infrastruktura e dobët, andaj edhe është propozuar në raportin në fjalë përmirësimi i këtij aspekti, duke iu referuar qëllimit se për t'i përmirësuar lidhjet rajonale duhet përmirësuar rrjetin e transportit, përfshirë këtu korridorin panevropian VIII (rruga Merdarë - Morinë) dhe korridori X (rruga Prishtinë - Shkup) e që, po ashtu, është përkushtuar të përmirësojë cilësinë e rrjetit rrugor brenda vendit.<sup>26</sup>

Kështu, infrastruktura sot është bërë njëra nga faktorët më pozitiv për investitorët e që në rezultatet e këtij punimi pritet të japë ndikim në performancën e NVM-ve.

<sup>26</sup> Strategjia e Zhvillimit të NVM-ve në Kosovë 2012-2016 Me Vizion 2020, Korrik, 2011, Fq.10

Politika e subvencioneve dhe granteve është shumë domethënëse, sidomos për bizneset e reja, të cilat kanë nevojë për kapital fillestar. Pavarësisht faktit që këto burime nuk janë në masa të madha, por pritet të kenë efekt në performancën e NVM-ve

## **2.1. Teoritë e rritjes së firmës**

### **2.1.1. Teoria e madhësisë**

Firmat janë organizata të cilat lindin për t'i përmbushur nevojat e tyre fillimisht, e që është të krijuarit e profitit. Për të krijuar sa më shumë profit për vetën e tyre, ato duhet t'i plotësojnë sa më shumë nevojat e shoqërisë me produkte dhe shërbime. Me këtë theksojmë se madhësia e firmës qenka e lidhur për shitjet që i realizon ajo. Kështu, sa më shumë shitje ato kanë nevojë të rriten dhe të zgjerohen. Meqë rritja e firmave është në interes të se cilës palë, ky proces është objekt studimi për shumë hulumtime. Gjithsesi, duhet shtuar faktin që shpjegimi i faktorëve të rritjes është mjaftë kompleks pasi që vet procesi i rritjes është kompleks. Fokusi i studimeve lidhur me rritjen e firmës është madhësia dhe mosha e firmës. Parimisht, duke qenë një firmë e madhe ka edhe potencial edhe strukturë menaxhuese më të lartë, dhe i jep mundësi që të jetë më komode në kërkesat e saj për rritje. Por, nga ana tjeter, firmat e mëdha hezitojnë të rrezikojnë për të provuar shanse të rritjes, ngase humbjet do të jenë të mëdha. Ndërsa, firma e vogël është më e nxitur për të shpresuar në fatin e mirë nga rastet.

### **2.1.2. Teoria e rritjes së firmës sipas Edith Penrose**

Firmat janë koleksion i kombinimit të burimeve të tyre në dispozicion, kështu thotë edhe teoria e Penrose-s, e cila njihet si ndër teoritë më të njohura mbi faktorët e rritjes. Me këtë, Penrose e vërteton faktin se si ka mundësi që njohës të së njëjtës fushë ta përshkruajnë ndryshe rritjen e firmës. Sipas saj, firma nuk është një njësi administrative, është një koleksion kombinimesh i burimeve (njerezore dhe jo njerezore), shpërndarja e të cilave bëhet nga përdorues të ndryshëm, me një nën koordinimin administrativ dhe

komunikimin autoritar që prodhon mallra dhe shërbime për shitje në treg për një fitim.<sup>27</sup> Penrose e sheh rritjen e firmës në saje të përdorimit efecient të këtyre burimeve. Ajo identifikon dy lloje ekonomive që ka në dispozicion firma për rritje: ekonomia e teknologjisë dhe ajo e menaxhmentit. Shërbimet menaxhuese janë të një rëndësie të veçantë në këtë kontekst, gjithashtu, sepse ato janë në dispozicion të firmës vetëm në sasi të kufizuara: "drejtuesit me përvojë brenda një firme të caktuar mund të gjenden vetëm brenda asaj firme ....". Prodhimi i këtyre shërbimeve kërkon kohë dhe kjo kufizon fushëveprimi i planeve të zgjerimit të një firme në çdo kohë të caktuar, po që lejon në vazhdimësi funksionimin e tij në rritje të firmës. Pra, kjo nënkupton që menaxhimi i firmës është element shumë i rëndësishëm në zgjerimin e firmës, përfaktin që ky elemente bën pikërisht lidhjen dhe kombinimin e burimeve në funksion të rritjes. Sa më gjatë që menaxhmenti të rrijë në atë firmë, vija kohore e zgjerimit zgjatet më shumë, por përvoja bën që burimet të përdoren më me eficiencë.

Idetë e Penrosë për rritje të firmës, përmbledhin si më poshtë<sup>28</sup>

- Firmat janë gjenezë e burimeve, të cilat me menaxhim të brendshëm prodrojnë mallra dhe shërbime për të realizuar fitim përmes shitjes së tyre në treg. Kufijtë e tyre përcaktohen nga fusha e koordinimit dhe "komunikimit autoritativ";
- Firmat ndryshojnë nga tregjet sepse këmbimet nuk ndodhin brenda një kuadri apo njësie administrative siç është firma;
- Sipërmarrësit janë drejtuesit e firmës dhe dëshirojnë fitime të larta për vete, të cilat i krijojnë përmes zgjerimit të firmës;

---

<sup>27</sup> Edith Penrose, *The Theory of the Growth of the Firm*, 3rd edn, Oxford, Oxford University Press, 1959, fq.24

<sup>28</sup> Christos Pitelis, London Edith Penrose's 'The Theory of the Growth of the Firm' Fifty Years Later, SSRN Electronic Journal · March 2009, Brunel University, fq.15

- Firma nga firma dallon pikërisht nga heterogeniteti i burimeve, dhe përdorimi e kombinimi i ndryshëm i tyre e thellon edhe më dallimin ndërmjet firmave që zgjerohen dhe nuk zgjerohen;
- Theksi i veçantë i burimeve të firmës është te burimet njerëzore, konkretisht ato menaxheriale, të cilat bëjnë plane për zgjerimin e firmës ndërmjet njohurive për kombinime të mira të burimeve. Përvoja i bën shërbimet edhe më unike;
- Ekzistojnë përherë burime të pa shfrytëzuara, inovacionet dhe kreativiteti, janë nxitje për zgjerimin e firmës.

Penrose është, gjithashtu, e koncentruar edhe në specifikimin e monopolit te firmat e mëdha si faktorë që i ekspozon më shumë kah mundësitë e zgjerimit. Përqendrimi në një ekonomi në rritje del kur firmat më të mëdha si një grup rriten më shpejt se firmat më të vogla, do të thotë edhe ekonomia në tërësi.<sup>29</sup> Firmat më të mëdha dhe më të vjetra kanë një 'avantazh konkurrues' për firmat më të vogla në aspektin e avantazheve jo monopoliste (madhësia, përvoja, qasja në fonde etj.), por edhe për shkak të 'fuqisë monopoliste'.<sup>30</sup> Megjithatë, jo çdo herë firmat e mëdha do të përfitojnë në një ekonomi në rritje, ngase në rrethana të tillë, do të gjenden mundësi potenciale fitimprurëse për firmat e vogla. Këto aktivitete, relativisht të padobishme për firmat më të mëdha, janë 'ndërthurjet' e ekonomisë. Kufizimet në shkallën e rritjes së firmave të mëdha dhe konkurenca e madhe e biznesit do të çojnë në një rënie të përqendrimit, megjithëse jo në madhësinë absolute të firmave të mëdha, por, gjithsesi, kjo do të jetë një situatë e favorshme për firmat e vogla. Penrose konkurrencën e sheh si thikë me dy tehe, e cila krijon avantazhe atëherë kur përdoren teknologji të reja, dhe kjo i favorizon firmat e mëdha.

---

<sup>29</sup> Edith Penrose, *The Theory of the Growth of the Firm*, 3rd edn, Oxford, Oxford University Press, 1959, fq.28

<sup>30</sup> ibid

### 2.1.3. Teoria e rritjes së firmës sipas Gibrat

Një nga modelet më të njohura të rritjes së firmës është ajo e Robert Gibrat-it, të cilën e dha në vitin 1931 dhe në këtë model ai përdori supozimin e ligjit të efektit proporcional që tani e ka marrë emrin sipas autorit, pra ligji Gibrat. Një prej pohimeve nga ky ligj, e cila përdoret dhe aprovohet më së shumti edhe nga studime të tjera, është se rritja e firmës dhe madhësia e saj janë të pavarura nga njëra tjetra. Shtojmë më tej se ligji thotë se firmat e vogla rriten me ritëm të njëjtë si ato të mëdhatë.

Modele të ndryshme studimi, si ajo e Hopenhay-t, pastaj Jovanoviç-it (1982), Cooley&Quadrini-t (2001) dhe Murto&Terviö-s (2010) rezultonin të mos e vërtetonin këtë teori, duke treguar se një teori e tillë do të zbatohej në industri ku ka gjithnjë kosto të larta të hyrjes. Në përfundimet e tij, Evans-i (1987) deklaroi se rritja e biznesit ulet në varësi me madhësinë dhe moshën e biznesit.

## 2.2. *Strategjité dhe organizatat mbështetëse për sektorin privat në Kosovë*

Duke parë rëndësinë shumë të madhe të sektorit privat në Kosovë, trajtimi i çështjeve që kanë të bëjnë me zhvillimin e sektorit privat është bërë ndër politikat prioritare në Kosovë.

Kështu, prej mbarimit të luftës, për këto çështje, Kosova ka hartuar dokumentet relevante si:

- Strategjia e zhvillimit kombëtar, e hartuar në vitin 2006, duhet të jetë zëvendësuar me kornizën afatmesme të shpenzimeve si një dokument kryesor i planifikimit strategjik në Kosovë;
- Strategjinë për punësim 2010-2012;
- Strategjinë për energji;
- Strategjinë për zhvillimin e arsimit të lartë;
- Programi qeveritar dhe plani i veprimit për parandalimin e ekonomisë joformale në Kosovë;
- Plani për zhvillimin e sektorit privat (2008, që nuk është miratuar në kuvend);
- Plani i veprimit i vizionit ekonomik të Kosovës 2011-2014;

- Strategjia e zhvillimi të NVM-ve 2012-2016 me vizion 2020;
- Strategjia për zhvillimin e sektorit privat 2013-2017 dhe
- Krijimi i Zonave Ekonomike.

NVM-të, duke qenë ndërmarrje të vogla dhe me mundësi të vogla për qasje në financime nga sektori privat, konkretisht nga sektori bankar për shkak të rrezikshmërisë së kthimit të mjeteve bazuar në koston e lartë të tyre, kanë nevojë dhe duhen mbështetur nga të tjera burime. Kërkesa dhe nevoja për mbështetje të NVM-ve ka dalë në pah edhe pas nënshkrimit të Aktit për bizneset e vogla, akt i cili i vë në spikamë profitet që rrjedhin nga ndërmarrja e vogël, e cila mbështetet në vazhdimësi, pra nga një ndërmarrje e qëndrueshme. Vendet e OECD-së kanë programe të shumta për mbështetje dhe potencojmë që  $\frac{1}{4}$  e të gjitha programeve të këtyre vendeve janë për mbështetje të NVM-ve.

Një tjetër fakt që i karakterizon bizneset kosovare është mungesa e përvojës dhe kjo reflekton në organizimet e brendshme të ndërmarrjes, politikat dhe strategjitë që ajo përdor për të operuar. Kur ndërmarrjet kanë probleme të brendshme, si rrjedhim edhe keqmenaxhim, atëherë reflekton në mundësinë e tyre për të qenë konkurrente, për të qenë të suksesshme dhe për t'i zgjeruar bizneset e tyre. Andaj, themi se edhe kjo është pengesë që i bën ato të mos kenë mundësi ta rrisin numrin e punëtoreve, dhe jo vetëm, por shumë shpesh të gjinden në pozita kur s'do të mund ti mbajnë punëtorët në punë.

Trajinimet janë rrugë apo mënyrë e mirë për ta përmirësuar performancën e udhëheqësve. Edhe këtu kemi dështime të mëdha në Kosovë, pasi që nuk mbretëron një kulturë pranuese e të mësuarit. Por problemi nuk është vetëm te ndërmarrësit, por edhe te të të punësuarit, të cilët nuk kanë një koncept të të punuarit inovativ. Shohim se përqindja më e madhe e njerëzve dinë të punojnë punë administrative, kjo ndikon negativisht në kërkesën për ndryshime.

Në Kosovë ka pasur mjaft organizata të huaja që merren me trajnime të tilla, por edhe vet institucionet shtetërore ofrojnë programe trajnimi për udhëheqës të rinj, të cilat po pritet që të reflektojnë në këtë gjeneratë. Më poshtë po i përcjellim disa nga to:

- Programi i ndërmarrësve të Rinj (YEP) / USAID;
- Zhvillimi i skemave të trajnimit profesional dhe trajnimit në kompani dhe zhvillimi i shkathtësive të ndërmarrësisë (KOSVET);
- Qendra për ndërmarrësi dhe zhvillim ekzekutiv (CEED) / SEAF, USAID, FMO SPARK;
- Qendra për themelimin e bizneseve në Kosovë (BSCK);
- Qendra për inovacion në Kosovë (ICK);
- TAM / BAS (EBRD);
- Programi për promovimin e NVM-ve në Kosovë -KOSME (Swiss & ADA);
- Fituesit e grandeve të “Zhvillimi Ekonomik dhe Regional BE”, (EURED)<sup>31</sup>

Shtojmë këtu se duke qenë në një kohë ku ekonomia dhe zhvillimet e saj janë dinamike, krahas zhvillimit dinamik të botës digitale, bizneset kosovare përballen me një tjetër kërkesë për efektivitet. Pra, që një biznes të ketë sukses, duhet ta ketë pranuar faktin që të punojë me koncepte inovative, të cilat nuk do të thotë që të zbulohet një tokë tjetër, por thjesht të bëhen gjërat në një formë të re, e cila do të krijonte avantazhe konkuruese për bizneset.

### **2.3. Studime individuale mbi kontributin e NVM-ve në rritjen e punësimit**

Sigurisht se për ta realizuar një punim doktorate referuar ndikimit të NVM-ve në ekonomi, është e domosdoshme të bazohemi dhe të konsultohemi me përvoja të bujshme të

---

<sup>31</sup> Bizneset Fillestare dhe Shërbimet për Mbështetjen e Bizneseve Fillestare në Kosovë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, fq 13.

vendeve të zhvilluara apo në zhvillim që kanë kaluar të njëjtat sfida. Këto përvoja dhe situata janë përshkruar në formë shkencore përmes punimeve të ndryshme, të cilat jepin dritë në të pasqyruarit e këtij fenomeni në përmasa botërore.

Këto studime jepin informacione nga më të ndryshme, të cilat mund të shërbejnë si baza referenca për studime të tjera. Meqë Kosova është një vend me tendenca të rritjes dhe zhvillimit ekonomik, NVM-të janë faktor shumë i rëndësishëm. Andaj, analiza dhe krahasimi i përvojave të zhvillimit dhe NVM-ve të vendeve që janë sfiduar tashmë, është një mënyrë e mirë për të gjetur modele të përshtatshme për zhvillimin e këtyre firmave. Studimet e konsultuara janë të natyrave të ngjashme duke u përafruar me hipotezat e punimit.

**Giuseppe Moscarini** dhe **Fabien Postel-Vinay (2012)**, përmes punimit të tyre “Kontributi i ndërmarrjeve të mëdha dhe të vogla në krijimin e vendeve të punës, në kohën e papunësisë së ultë dhe të lart” theksojnë se mençuria konvencionale se bizneset e vogla krijojnë vende pune më shumë, vlen vetëm në recessione, ku nuk kërkohet angazhim shumë i madh.<sup>32</sup>

Kështu, një studimi i bërë në Malajzi, nga autorët **Rafidah Ismail** dhe **Norfaridatul Akmaliah Othman (2014)**, kishte provuar të vërtetonte një lidhje pozitive në mes të përkrahjes së qeverisë dhe rritjes së NVM-ve, dhe këtë e kishte vërtetuar përmes një regresioni ku korrelacioni në mes të përkrahjes së qeverisë dhe rritjes së NVM-ve është pozitiv dhe i rëndësishëm.<sup>33</sup> Malajzia në vitet e para të pavarësisë së saj, nuk ka pasur

---

<sup>32</sup> Giuseppe Moscarini and Fabien Postel-Vinay , The Contribution of Large and Small Employers to Job Creation in Times of High and Low Unemployment, , *American Economic Review* 2012, 102(6): 2509–2539

<sup>33</sup> Rafidah Ismail, Norfaridatul Akmaliah Othman, The Effectiveness Of Government-Support Programmes Toward Business Growth, *Journal of Technology Management and Technopreneurship*, Vol. 2, No. 2, July - December 2014, pg.49

politika për mbështetje të NVM-ve, por me konstituimin e organeve shtetërore dhe, duke parë rëndësinë e ndikimit të NVM-ve në zhvillimin ekonomik, sot janë 15 ministri dhe 60 agjenci shtetërore që merren me përpilimin dhe implementimin e politikave mbështetëse për NVM-të<sup>34</sup>. Këto politika janë të fokusuara në pesë fusha kryesore: asistenca financiare dhe kreditore, asistenca teknike dhe në trajnime, këshilla për zgjerim të biznesit, kërkime tregu e marketingu dhe përkrahje në infrastrukturë.

Një tjeter studim i bërë me 47.475 biznese nga **Edinburgh Group** (2011) raporton se NVM-të edhe pas përkrahjes së qeverisë me forma të asistencës financiare, përballen me probleme financiare dhe se detyrohen t'i ndjekin linjat kreditore të vendeve të tyre, që për disa vende janë të papërballueshme. Sipas këtij studimi, kjo lloj mbështetjeje nuk garanton stabilitet të ndërmarrjes së vogël dhe e njëjtë ndërmarrje nuk mund të ndikojë në rritjen e punësimit.<sup>35</sup>

Pastaj, **M. Ayyagari, T. Beck, dhe A. Demirguc- Kunt**<sup>36</sup>, në hulumtimin tyre të titulluar “Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në tërë globin” paraqet një efekt të madh të NVM-ve në rritjen e punësimit në kushtet ekonomisë formale, ku në secilën kategori të vendeve, me paga të ulëta, të mesme apo të larta, kontributin më të madh në ato të ardhura e kanë NVM-të.

**E.B. Ntiamoah, D. Li, M. Kwamega**<sup>37</sup>, studuan ndikimin e politikave mbështetëse për rritjen e performancës së NVM-ve dhe provuan një lidhje pozitive të disa nga politikat e

---

<sup>34</sup> Ibid

<sup>35</sup> Edinburgh Group, Growing the global economy through SMEs, fq.35

<sup>36</sup> Ayyagari, M., Thorsten B, and Aslı Demirgürç-K.. “Small and Medium Enterprises Across the Globe,” Small Business Economics 2007

<sup>37</sup> Evans Brako Ntiamoah\*, Dongmei Li, Michael Kwamega, Impact of Government and Other Institutions’ Support on Performance of Small and Medium Enterprises in the Agribusiness Sector in Ghana, American Journal of Industrial and Business Management, <http://dx.doi.org/10.4236/ajibm.2016.65052> 2016

marra në studim. Konkretisht, ata përdorën modele ekonometrike për të analizuar ndikimin e këtyre politikave dhe rezultuan se NVM-të, për t'u rritur, kanë nevojë për mjete financiare dhe ato mund t'i sigurojnë nëse jo nga qeveria, atëherë kreditë janë burimi kryesor i mbështetjes financiare. Gjithsesi, si në çdo vend, edhe në Ganë, ku është bërë ky studim, burimet financiare kreditore dalin të jenë shumë të shtrenjta, andaj kërkohet që qeveria të dalë si masë më e fuqishme për mbështetje të NVM-ve. Kështu, punimi në fjalë vërteton një lidhje të fortë pozitive në mes të mbështetjes qeveritare dhe rritjes së performancës së NVM-ve. NVM-të në rritje i kontribuojnë rritjes së punësimit.

Një studim tjetër i realizuar në Indi<sup>38</sup>, tregon se NVM-të ndikojnë pozitivisht në rritjen e punësimit sepse ato kanë mundësi të përdorin më shumë procese të punës me intensitet më të madh se sa ndërmarrjet e mëdha, duke mundësuar kështu një shpërndarje më të drejtë të të ardhurave, pastaj sigurimin e mundësive për jetesë nëpërmjet aktiviteteve të thjeshta të përpunimit të vlerës së shtuar sidomos në ekonomitë bujqësore, etj. Në këtë studim, NVM-ve u atribuohet meritë e madhe në gjenerimin e vendeve të punës në sektorin e bujqësisë (45%) dhe eksportit (40%), ku citohet se, gjersa po bie punësimi në sektorin e bujqësisë, edhe industritë e mëdha po përjetojnë rritje të papunësisë. Studimi në fjalë këtë situatë ia faturon pikërisht mosorganizimit të NVM-ve në shërbim të krijimit të vendeve të punës.

---

<sup>38</sup> Afshar Jahnshahi Asghar, 2 Khaled Nawaser, 3 Morteza Jamali Paghaleh and 4 Seyed Mohammad Sadeq Khaksar, The Role of Government Policy and the Growth of Entrepreneurship in the Micro, Small (&) Medium-sized Enterprises in India: an Overview, Australian Journal of Basic and Applied Sciences, 5(6): 1563-1571, 2011

## KAPITULLI III- NDËRMARRËSIA DHE NVM-të

### 3.1 *Ndërmarrësia si proces*

Biznesi ka lindur me njeriun, ka përparuar sipas ndërrimeve në mendjen, teknikën dhe teknologjinë. Do të thotë, aq sa përparuan këto, edhe biznesi u bë më i mbaruar. Sikurse çdo krijimtari serioze njerëzore, edhe biznesi mbështet: idenë, iniciativën, vizonin, konceptin, strategjinë, takтикën, planin, organizimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen. E gjithë kjo përmbajtje përfshihet me nocionin ndërmarrësi (entrepreneurship).<sup>39</sup>

Mbështetja në ide dhe në iniciativë gjen shpjegim në literaturën shqipe edhe si sipërmarrje, që ka kuptim të njëjtë me ndërmarrësi - që përdoret në Kosovë, e që në këtë punim do të përdoret si ndërmarrësi. Ndërmarrësia, pra, i referohet marrjes përsipër të një rreziku të realizimit të një aktiviteti apo veprimi, në këtë rast veprim biznesor. Autori i njojur për ndërmarrësinë **Joseph Schumper** (1883-1950) e sheh këtë aktivitet si forcë “kreative-destruktive”, po ashtu, i njëjti autor, inovacionin e sheh si element kryesor përfaqësues të procesit të ndërmarrësisë dhe e quan nxitës kryesor të produktivitetit dhe zhvillimit ekonomik. Ndërmarrësia, kryesisht, definohet si aftesi e veprimeve kreative afariste të njeriut mbi resurset prodhuese që të krijohet aktivitet eficient ekonomik<sup>40</sup>. Një tjetër definicion, të stilit modern, e ka dhënë **Jeffry A. Timmons**, duke e përshkruar si aftesi e krijimit – që, praktikisht, nga hiçi të krijohet diçka, duke përdorur inicimin dhe energjinë për ndërtimin e sipërmarrjes apo organizatës.<sup>41</sup>

---

<sup>39</sup> Zeki Bejtullahu, Bazat E Biznesit, (parimet, konceptet, metodat, modelet, sistemet, zbatimet), Prishtinë, 2007

<sup>40</sup> Marko Kolakovic, Odredenje preduzetnistva; fq.1. Zagreb, 2010.

<sup>41</sup> Timmons, Jeffry A. New Venture creation, Irwin, 3<sup>rd</sup> ed., Homewood, IL, 1990

Ndër autorët e parë, që në mënyrë konkrete përmendi karakteristika të ndërmarrësi është Richard Cantillon, të cili e pasuan shumë studiues, duke e plotësuar atë.

Më poshtë, po paraqesim variantet si është definuar ndër vite ndërmarrësia nga autorët më të njohur.

Tabela 1. *Përshkrimi i ndërmarrësisë nga autorë të ndryshëm*

<b>Autorët</b>	<b>Definicioni</b>
<b>Cantillon (1755)</b>	<i>Ndërmarrësia është një akt i marrjes së rrezikut, duke blerë me një çmim të caktuar dhe duke shitur me një çmim të pasigurt, duke rrezikuar me luhatjet e çmimeve në treg.</i>
<b>Knight (1921)</b>	Ndërmarrësia është aftësia të tregtosh në një treg të pasigurt dhe me rrezik
<b>Schumpeter (1934)</b>	<i>Ndërmarrësia konsiderohet si kombinime të reja për të prodhuar ndryshe, për të hapur tregje të reja, për të gjetur burime tjera të furnizimit dhe organizatat e reja.</i>
<b>Kirzner (1973)</b>	<i>Ndërmarrësia është aftësia për të perceptuar mundësi të reja.</i>
<b>Casson (1982)</b>	<i>Ndërmarrësia përfshin vendimin dhe gjykimin në lidhe me koordinimin e burimeve të pakta</i>
<b>Drucker (1985)</b>	<i>Ndërmarrësia është akt i inovacionit që i referohet dhënies së burimeve ekzistuese për të shtuar pasurinë</i>
<b>Stevenson, Robert and Groesbeck (1985)</b>	<i>Ndërmarrësia është ndjekja e një mundëse pa u frikësuar për humbjen e burimeve apo kapaciteteve ekzistuese</i>
<b>Low and Macmillan (1988)</b>	<i>Ndërmarrësia është krijimi i bizneseve të reja</i>
<b>Gartner (1988)</b>	<i>Ndërmarrësia është krijimi i një procesi ose organizate përmes të cilët organizata bëhet e gjallë.</i>
	<i>Ndërmarrësia është akti i formimit të një organizimi të ri mevlerë</i>

**Bateman&  
Snell  
(1996)**

*Ndërmarrësia është aftësia për të ndërtuar krijuar diçka praktikisht nga asgjëja. Është marrja e iniciativës së të bërët, arriturit dhe krijimit të një ndërmarrje, është më shumë se ta shikosh, ta analizosh ose ta përshkruash atë. Është mprehtësi e të parit të mundësive që për të tjerët duket kaos, kontradikcion, dhe konfuzion në të njëjtën kohë.*

**Timmons  
(1997)**

**Sharma and  
Chrismen  
(1999)**

*Ndërmarrësia i referohet aktit të ndryshimeve organizacionale, rikrijimeve ose inovacioneve që ndodhin brenda ose jashtë një organizate ekzistuese.*

**Onuoha (2007),**

*Ndërmarrësia "është praktika e fillimit të organizatave të reja ose revitalizimit të organizatave të pjekura, veçanërisht bizneseve të reja, përgjithësisht në përgjigje të mundësive të identifikuara."<sup>42</sup>*

**Kuratko  
Hodgetts  
(2001)**

*Ndërmarrësia është proces i inovacionit dhe krijimit të formave të reja and Lidhjeve biznesore përmes katër dimensioneve: individuale, organizative Mejdisore, dhe proceseve.*

**Shane and  
Vanketaraman  
, 2000**

**Elaine Romanelli  
and Khessina  
2005)**

*Ndërmarrësia është si një ekzaminim shkencorë se si, prej kujt, dhe me çfarë efektesh mundësitë për të krijuar mallra dhe shërbime në të ardhmen janë zbuluar, vlerësuar dhe shfrytëzuar.<sup>43</sup>*

*Ndërmarrësia është akt i suksesshëm i themelimit të organizatave të reja*

Burimi: [Entrepreneurship and the growth of SMEs in the furniture industry in Tanzania, Nsubili Isaga,](#)

Adaptuar nga autori.

<sup>42</sup> Onuoha G., (2007) Entrepreneurship, AIST International Journal 10, 20-32.

<sup>43</sup> S. SHANE & S. VENKATARAMAN, THE PROMISE OF ENTREPRENEURSHIP AS A FIELD OF RESEARCH, Academy ol Managamenl Review 2000. Vol.25, No. 1,217-226.

Ndërmarrësia nuk është një koncept i shekullit 20, ngase shkuarja e Marko Polos në Lindjen e Largët është përcjellë me shumë fenomene e ndërmarrje të rreziqeve që ne, sot, i studiojmë dhe i njohim si elemente të ndërmarrësisë. Një tjetër autor i njohur i teknikave të menaxhimit dhe udhëheqjes, **Piter Drucker**, e sheh ndërmarrësin si “promotor dhe eksplorator të ndryshimeve.<sup>44</sup> Ndryshe, ndërmarrësia i referohet konkretizimit të ideve në realitet, i cili realitetet mund të jetë edhe humbës edhe fitues për ndërmarrësin. Pra, na vjen në radhë nocioni ndërmarrës, i cili e identifikon faktorin që personifikohet me procesin e ndërmarrësit apo lidhemi këtu me paragrafin e parë, ndërmarrësi - personifikim i ndërmarrësisë si proces. Gjithsesi, duhet kuptuar që ndërmarrësia nuk është një koncept që lidhet vetëm me veprimtarinë ekonomike, por me sjelljen e njerëzve në dukuri të ndryshme shoqërore dhe në secilën prej këtyre sferave, njerëzit gjenden para dilemave dhe vendimeve të vështira. Disa njerëz i karakterizon aftësia sipërmarrëse më shumë, ndërsa disa të tjerë janë më të ngurtë në shprehjen e idesë e sidomos në aftësinë dhe kurajën për ta konkretizuar idenë, prandaj edhe kemi njerëz të suksesshëm dhe të pasuksesshëm, biznese të suksesshme dhe të pasuksesshme.

Sipas **Cantillon-it** (1959), ndërmarrësia është përgjegjëse për të gjitha veprimet që bëhen në ekonomi, si qarkullimi ashtu edhe këmbimet. Ndërsa **Say-i**, e pa ndërmarrësinë si agjentin kryesor të prodhimit në ekonomi, Plotësuar këto të dy, ekonomisti i njohur **Alfred Marshall**, ndërmarrësinë e pa edhe si person që vazhdimisht kërkon mundësi të reduktojë koston.

---

<sup>44</sup> Besnik A. Krasniqi, Malush Tullumi,) What perceived success factors are important for Small Business Owners in a transition economy? International Journal Of Business And Management Studies, ISSN: 1309-8047 Vol 5, No 2, 2013

Ndërmarrësia është proces i krijimit të diçkaje të re me vlerë, duke i kushtuar kohë dhe përkushtim të nevojshëm, duke ndërmarrë mbi vete risk financiar, psikik dhe social, në këmbim të të ardhurave monetare, kënaqësisë dhe pavarësisë individuale.<sup>45</sup>

Sipas Hébert and Link,<sup>46</sup> ndërmarrësi është personi që është i specializuar në marrjen e përgjegjësisë së veprimit dhe gjykimit mbi manipulimin me mallrat dhe shërbimet, burimin dhe vendndodhjen e tyre.

Por, pavarësisht nocioneve të ndryshme nga aurorë të ndryshëm, parmisht të gjithë shprehin diçka nga këto tri elemente kryesore që e përshkruajnë ndërmarrësin si person, ndërmarrësinë si proces. Këto elemente janë të lidhura me sjelljen e personit dhe përfshijnë: 1) marrjen e iniciativës, 2) organizimin dhe riorganizimin e mekanizmave shoqërorë dhe ekonomikë për t'i shndërruar burimet në llogari praktike, 3) marrjen përsipër të rrezikut dhe dështimit.<sup>47</sup>

Me evoluimin e shoqërisë në aspektin konceptual e filozofik, kanë ndryshuar edhe nevojat e tyre dhe kjo ka bërë që bota biznesore të gjendet vërtet në krizë idesh për t'i plotësuar këto kërkesa. Andaj, me ndryshimin e këtyre nevojave kanë ndryshuar edhe format e të menduarit për të bërë biznes. Sot, bizneset për të mbijetuar janë vënë në shërbim të kërkesave të konsumatorëve, sepse kjo sjell fitimin për ta. Pastaj, ndërmarrjet kanë shkuar edhe më tej, jo vetëm duke plotësuar kërkesën ekzistuese, por

---

<sup>45</sup>Hisrich Peters, Entrepreneurship, (the defination is modified from the definition first develoed for the woman entreprenuer, The woman Entreprenuer, Strating, Financing, and Managing a Successful new Business) fourth edition, 1998

<sup>46</sup> Hébert, R.F. & Link, A.N. Small Bus Econ (1989) 1: 39. <https://doi.org/10.1007/BF00389915>

<sup>47</sup> Hisrich Peters, Entrepreneurship, (the defination is modified from the definition first develoed for the woman entreprenuer, The woman Entreprenuer, Strating, Financing, and Managing a Successful new Business), fourth edition, 1998

edhe duke nxitur ide dhe nevoja të reja. Këto janë punë konkrete të njërsës nga format më të shprehura dhe instrumentet më të përdorura në biznesin modern, marketingut.

Më herët, bizneset e mëdha kanë qenë në vëmendje të objektivave të shoqërisë përmes prodhimit masiv dhe homogjen, por sot shoqëria e ka filtruar tej mase shijen dhe preferencën e saj, stilin e jetës dhe vazhdon ta bëjë tërë kohës, kështu që bizneset e mëdha, me kapitalin që kanë, nuk kanë mundësi t'i përgjigjen këtij dinamizmi dhe janë bërë të papërshtatshme për vende me fluktuime të mëdha të kërkesës për produkte dhe shërbime. Si përgjigje ndaj këtyre ndryshimeve dhe kërkesave, kanë dalë bizneset e vogla, të cilat i janë përshtatur shumë mirë zgjidhjes së këtij problemi, pavarësisht se edhe për bizneset e vogla është sfidë. Në një hulumtim që është bërë në kolegjin “Babson”, shkollë londineze e biznesit, me 59 shtete, duke përfshirë edhe SHBA-në, gjetjet kanë treguar se intensiteti i bizneseve të hapura dhe aktiviteteve ndërmarrëse, më tepër ka qenë i shprehur në vendet me të ardhura të ulëta, ndërsa më pak në vende me të ardhura të larta.<sup>48</sup> Për shembull, në SHBA çdo i 13-ti amerikan i mosuar është në mënyrë aktive në aktivitete sipërmarrëse, qoftë si pronar apo menaxher i biznesit që nuk është më i “vjetër” se tre vjet e gjysmë.<sup>49</sup> Por, sigurisht, duhet bërë një dallim, se bizneset që hapen në vende me të ardhura të vogla e kanë karakterin e mbijetesës apo të detyrimit, ndërsa në vende të zhvilluara ndërmarrësit operojnë në tregje për të konkurruar, për të realizuar fitime të mëdha, për t'i dhënë tregut inovacione, produkte dhe shërbime të reja, të cilat i plotësojnë më mirë nevojat e tyre dhe shoqërisë ia bëjnë jetën më të lehtë.

Duke iu referuar këtij fakti, bizneset që janë të ndërtuara në vendet e varfra janë më pak produktive kundrejt vendeve të pasura apo të zhvilluara. Ky punim pikërisht është

<sup>48</sup> Brus R. Barniger dhe R. Duane Ireland, Entrepreneurship, fourth edition, 2012

<sup>49</sup> Niels Bosma, Sander Wennekers, José Ernesto Amorós, Entrepreneurs and Entrepreneurial Employees Across the Globe, Global Entrepreneurship Monitor 2011 Extended Report, 2012

i fokusuar në atë se si mund të funksionojnë mirë dhe të jenë produktive këto biznese në vende të varfra, si rasti i vendeve të Ballkanit Perëndimor, në veçanti Kosova, e cila është edhe objekt studimi i këtij punimi.

### **3.2 Teoritë ekonomike të ndërmarrësisë**

Aftësitë e ndërmarrësisë kanë qenë të pérhershme në çdo periudhë të njerëzimit, ani pse mënyrat e përdorimit të tyre kanë ndryshuar me evoluimin e kohës dhe teknologjisë. Për shembull, ekzistojnë shembuj të shumtë të sjelljeve prej ndërmarrësie që datojnë që nga kohët biblike (për shembull, **Jakobi**), në mesjetë (p.sh. tregtarri **Ghini**) në rilindje (p.sh. piktori **Carlo Crivelli**)<sup>50</sup>.

Për konceptin e ndërmarrësisë qasja ka ndryshuar mjaft ndër kohë, andaj është e udhës që shkurtazi, në këtë punim, të paraqiten qasjet më të shprehura nga ekonomistët më të njohur:

#### **3.2.1 Richard Cantillon (1725) Teoria më e vjetër e ndërmarrësisë.**

Personi që mban rrezik mbi veten është ndryshe nga një furnizues me kapital (**H. Peters**, 1998, fq.6). Kjo ka të ngjarë me pronarin e biznesit, i cili i jep mjetet e tij, si punën ashtu edhe kapitalin në dispozicion të menaxhuesit tjetër, në këmbim të një fitimi të mundshëm. Ai gjeti se sipërmarrësit luajnë rolin qendror. Ata luajnë rolin e koordinatorit që lidh prodhuesit me konsumatorët dhe, gjithashtu, rolin e vendimmarrësit që angazhohet në tregje për të fituar dhe për të luftuar me pasiguri<sup>51</sup>. Autori në fjalë ndau aktorët në ekonomi në tri grupe: pronarët e kapitalit (tokave), ndërmarrësit dhe

---

<sup>50</sup> Julie McFarlane, Economic Theories of Entrepreneurship, 2016, fq, 17

<sup>51</sup> Joseph M. Cherukara& Dr. James Manalel, Evolution of Entrepreneurship theories through different schools of thought, The Ninth Biennial Conference on Entrepreneurship at EDI, Ahmedabad, February 16-18, 2011

qiraxhijtë. Ndër këta të tre, **Cantillon-i** gjeti se sipërmarrësit janë lidhësit e të dy grupeve të tjera, që dolën të jenë shumë pasivë.

### 3.2.2 Teoria e kreacionit destruktiv e Joseph Schumpeter (1934):

Ndërmarrësi është novator dhe zhvillon teknologji të reja, të paprovuara (**H.Peters**, 1998). **Schumpeter-i** e kundërshtoi faktin që ndërmarrësi të kufizohej me nominimin se ai ishte vetëm një bartës i rrezikut dhe një menaxher kompanie, sepse ndërmarrësin e pa më tepër se kaq, e pa më vizonar e largpamës. Ai, në fakt, e shkëputi rrezikun nga ndërmarrësi, duke ia atribuuar këtë “aftësi” kapitalistëve.<sup>52</sup> Në librin e tij “The theory of Economic Development” (1934), ai zbuloi konceptin e ndërmarrësit, si një prishës të status quo-ekonomike, prandaj edhe ndërmarrësin e sheh si krijues destruktiv. Shkatërrues ekuilibri - është një tjetër koncept që **Schumpeter-i** e vlerëson ndërmarrësin.<sup>53</sup>

### 3.2.3 Qasja Marshalliane e ndërmarrësisë (1949):

Sipas teorisë marshalliane progresi ekonomik nuk varet nga “njeriu i madh”, por në efektin e sinergjisë të shumë njerëzve dhe fokusi i teorisë së tij në rolin inovativ dhe se prodhimi në masë paraqitet si faktor kryesor në progresion ekonomik dhe inovacionin (A.Tiryaki). Sipas Marshallit, një ndërmarrës i suksesshëm duhet të ketë këto aftësi:

- Njohja e plotë e industrisë ku tenton të hyjë,
- Aftësi të mira drejtuese dhe

---

<sup>52</sup> J. M. Cherukara& J. Manalel, Evolution of Entrepreneurship theories through different schools of thought The Ninth Biennial Conference on Entrepreneurship at EDI, February 16-18, 2011

<sup>53</sup> Hannah Orwa Bula, Evolution and Theories of Entrepreneurship: A Critical Review on the Kenyan Perspective, International Journal of Business and Commerce Vol. 1, No.11: Jul 2012[81-96] (ISSN: 2225-2436)

- Parashikimi në ndryshimet e kërkesës dhe furnizimit dhe gatishmëria për të vepruar në parashikime të tillë të rrezikshme.

Gjithsesi, janë faktorët dhe rrethanat ekonomike ekzistuese që diktojnë sjelljet e një ndërmarrësi.

#### **3.2.4 Teoria e mbajtjes së riskut sipas Frank Knight (1971):**

Është teori e cila është shumë e përafërt me atë të Cantillon-it, vetëm se ky përpinqet ta ndajë pasigurinë me rrezikun. Rreziku mund të mbulohet me një lloj sigurimi, por pasiguria paraqet një ngjarje të padijshme, p.sh ndryshimi i shijes së konsumatorit.<sup>54</sup> Gjersa për Schumpeter-in, ndërmarrësi ishte novator dinamik, Knight-i theksoi se ndërmarrësi ishte bartës i pasigurisë. Sipas Knight-it, funksioni kryesor i sipërmarrësit është të marrë pasigurinë që lidhet me ngjarje të tillë, duke mbrojtur kështu të gjithë aktorët e tjerë kundër saj. Pra, sipërmarrësi ushtron gjykimin mbi këto situata unike, pasigurinë në ekonomi dhe funksionon si agjent i sigurimit.

Këto dhe teori të tjera provuan rëndësinë e ndërmarrësisë në zhvillimin ekonomik, në forma të ndryshme. Pothuajse të gjitha teoritë, duke plotësuar njëra-tjetren, vënë në fokus ndikimin e agjentit apo ndërmarrësit në dy role kyçë:

- a. Ndërmarrësi inovator
- b. Ndëmarrësi krijues i firmave të reja

Në parim, të gjitha studimet pajtohen me faktin që ndërmarrësit janë lëvizës të situatave ekonomike dhe se mund t'i ndryshojnë ato në saj të aftësive të tyre, qoftë inovatore por

---

<sup>54</sup> Hannah Orwa Bula, Evolution and Theories of Entrepreneurship: A Critical Review on the Kenyan Perspective, International Journal of Business and Commerce Vol. 1, No.11: Jul 2012[81-96] (ISSN: 2225-2436

edhe të krijimit të produkteve dhe shërbimeve të reja përmes krijimit të institucioneve të reja.

### ***3.3 Roli dhe rëndësia e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme***

Ndikimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në shoqëri është mjaft i shprehur në shumë aspekte, më së shumti në rritjen e standardit të saj, gjë që ka efekt domino në sfera të tjera të jetës. Këto ndërmarrje, veçanërisht kanë efekt në sferën ekonomike, dhe përdëshmi janë shumë vende të botës, të cilat zhvillimin e tyre e shohin dhe e përjetojnë falë prezencës dhe performancës së këtyre ndërmarrjeve. Pavarësisht kësaj, roli i tyre është i ndryshëm përvende të ndryshme, p. sh., në SHBA, këto ndërmarrje janë mjaft të zhvilluara dhe luajnë rol të madh në jetën e amerikanëve, por në vendet e Mesdheut, sidomos në jug dhe në lindje të këtij rajoni, këto ndërmarrje nuk janë shumë të zhvilluara, por edhe nuk luajnë rolin e ndërmarrjeve të vogla, siç duhet ta luajnë. Në këto vende, mundësitet e NVM-ve që hyjnë në treg janë shumë të kufizuara për shkak të strukturave monopolistike që i karakterizojnë vendet e këtij rajoni dhe të cilat frenojnë realizimin e këtyre ndërmarrjeve.

Prandaj, zhvillimi i sektorit të NVM-ve është shumë i rëndësishëm përvendje e Mesdheut, sidomos kur kemi parasysh që problemet sociale të atyre vendeve janë, në masë të madhe, pasojë e rritjes ekonomike të pabarabartë. Zhvillimi i qëndrueshëm i rajonit kërkon shpërndarjen e kulturës së promovimit të investimeve dhe të territoreve ndërvepruesit lokalë, duke mundësuar ndarjen më të mirë të investimeve, vendeve të punës dhe pasurive, si edhe përballimin e konkurrencës, e cila intensifikohet vazhdimisht.<sup>55</sup>

Vendet e këtij rajoni përballen me pothuajse probleme të njëjtë të zhvillimit të tyre, si ato politike, pastaj janë vende të cilat kanë pasur probleme dhe konflikte të

---

<sup>55</sup> Raport mbi Rolin e “Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme në Mesdhe”, Sesion plenar i tretë Bari, 30 janar 2012

vazhdueshme me njëra-tjetrën, gjë e cila me vite të tëra i ka stagnuar politikat zhvillimore ekonomike, pasi që nuk ishin prioritete. Gjithashtu, këto vende përballen me nivele të larta të korruptionit të natyrave të ndryshme, përmendim këtu Shqipërinë dhe Italinë, prandaj edhe probleme të tilla kanë bërë që ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të mos kenë efektin e tyre të duhur dhe mendoj se deri sa këto probleme vazhdojnë të janë evidente, njëjtë do të jetë edhe performanca e këtyre ndërmarrjeve. Madje, në shumë kategorizime dhe rangime në kuadër të publikimeve të ndryshme, vendet e këtij rajoni konsiderohen si më armiqësoret për biznes, pra të pafavorshme për të investuar kapital. Kjo situatë mund të shihet pikërisht nga niveli i investimeve të huaja dhe jetëgjatësia e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Ndërmarrjet e vogla janë shumë të ndjeshme ndaj krizave në vend, për shkak se janë aq të vogla sa që nuk kanë komoditetin për t'iu përgjigjur krizës me zvogëlim të aktiviteteve dhe e vetmja përgjigje për situatën në fjalë është mbyllja e tyre, dhe një arsy që pse ato janë shumë të ndjeshme ndaj krizave, është se bartin pasojat e vështirësive që i kalojnë bizneset e mëdha.

Ashtu si në vendet e tjera, edhe në Kosovë, ndërmarrjet e vogla luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik. Ani pse këto ndërmarrje kanë filluar të funksionojnë që nga vitet e '90, ato gjithsesi janë një burim i rrjedhshëm i vendeve të reja të punës. Në atë kohë ishin regjistruar 166 ndërmarrje private, numër që, duke shkuar nga viti 1998, bie në formë radikale për shkak të shtimit të represionit të pushtuesit serb, konkretisht gjatë kësaj periudhe ishin regjistruar vetëm 22 ndërmarrje, për t'u rritur më pas, në vitin 2005, në 290 ndërmarrje.<sup>56</sup>

Gjatë kësaj periudhe, vendi ynë ka kaluar në kohë të vështirë, duke u ballafaquar me rënie të madhe ekonomike dhe kjo ka bërë që njerëzit në Kosovë edhe sot të mos kenë siguri ekonomike dhe, si rezultat, ka pasur edhe veprime nga më të ndryshmet të qytetarëve

<sup>56</sup> Ministria e Tregtisë dhe industrisë, [www.mti-ks.org/](http://www.mti-ks.org/)

për të siguruar një jetë më të mirë, përmenden këtu ikjen masive të qytetarëve të Kosovës nga vendi gjatë vjeshtës së vitit 2015, e cila ishte një përgjigje konkrete për situatën e rëndë ekonomike.

Prandaj, në saj të këtij shpjegimi mund të themi se ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (tutje NVM) kanë ndikim të madh në zhvillim ekonomik, por Kosova në situatën në të cilën gjendet nuk paraqet shembullin më të mirë për rolin dhe ndikimin efektiv të NVN-ve në këtë proces. Në Kosovë, ndërmarrjet e vogla bartin numër shumë të vogël të punëtorëve dhe të ardhura shumë më ulëta se mesatarja në Evropë e të hyrave për NVM-të.

Kategorizimi i NVM-ve dallon prej një shteti në tjetrin, e me këtë dallon edhe faktori me të cilin kategorizohet ato, që zakonisht merret numri i punëtorëve, por që, duke marrë në konsideratë faktin se shtetet tërë kohën orvaten për ta ndryshuar formën e klasifikimit dhe njëherësh duke mos qenë e unifikuar, mendoj se një klasifikim i tillë mund edhe të mos e paraqesë situatën reale. Madje, në Kosovë raportimi i rezultateve ka mospërputhje edhe me vet institucionet relevante brenda vendit. Kjo do të thotë se statistikat brenda vendit shumë shpesh nuk harmonizohen, ndërkohë që flasin për të njëjtat gjëra. Andaj, për korrektësi të studimit dhe analizës së rezultateve, më shumë do të shërbehem me të dhëna nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë<sup>57</sup> dhe ASK për përkrahjet nga institucionet shtetërore, si dhe Agjencinë e Kosovës për Investime dhe Përkrahje të NVM-ve, për mbështetje nga investimet e huaja, sigurisht edhe raporte nga ministritë përkatëse

---

<sup>57</sup> Tutje ARBK

Duke qenë të vetëdijshëm se Kosova nuk është rasti më i mirë për ta paraqitur ndikimin që kanë dhe mund të kenë NVM-të në zhvillimin ekonomik, por, në përgjithësi, duke marrë në konsideratë periudhën e luftës dhe situatën në të cilën ndodhemi tani, kur kemi rrith 99% të ndërmarrjeve të vogla që veprojnë, mund të themi se NVM-të, në secilin vend, pavarësisht situatës, praktikisht kanë rol jashtëzakonisht të madh në jetën e qytetarëve. Po të mos kishin qenë këto ndërmarrje, me efektin e tyre për krijimin e vendeve të reja të punës dhe kontribute të tjera, që do të shpjegohen në kapitujt e tjerë, Kosova nuk do të kufizohej vetëm me rrith 30%<sup>58</sup> të popullsisë të pa punë sa janë tani, por do të kishte një situatë edhe më të rëndë. Kontributi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme është duke e sfiduar në çdo aspekt rolin dhe ndikimin e bizneseve të mëdha, së këndejmi përmendim roli e tyre në shpërndarjen e të ardhurave, duke qenë se këto biznese për shkak të karakteristikave të tyre, kanë shtrirje më të madhe gjeografike, andaj edhe ju mundëson që të janë burime në numër dhe në masë më të madhe.

Nga ana tjetër, NVM-të nuk është se kanë rol vetëm në krijimin e vendeve të reja të punës, por, sidomos në ditët e sotme, ato që vihen në spikamë sa i përket kontributit të tyre janë llojet e bizneseve të vogla, të cilat po ndihmojnë në inkadrin gjithnjë e më të madh të gjinisë femërore në jetën e biznesit, grup që, historikisht, ka qenë e përfshirë në numër dukshëm më të ulët. Ndërsa, sot, falë këtyre ndërmarrjeve, ato po e gjejnë vetëm shumë lehtë në botën biznesore dhe atë me produkte dhe shërbime mjaft atraktive, të cilat po e rrisin ofertën e produkteve dhe shërbimeve në tregjet botërore. Biznese nga shtëpia, ndërmarrësi të pjesshme, biznese familjare dhe biznese të karakterit të shërbimeve profesionale janë bërë ndër bizneset që po e favorizojnë mjaft gjininë femërore dhe, sigurisht, janë duke treguar dinamizëm të paparë edhe në Kosovë, dhe vendet rreth saj, në dhjetëvjeçarin e fundit.

<sup>58</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2017, <http://askdata.rks-gov.net>

Një nga kontributet e këtyre ndërmarrjeve, për të cilat janë shqar historikisht, janë inovacionet dhe kreativiteti, që për Kosovën dhe vendet e varfra si ajo, dhe të tjera që janë në dhe gjatë procesit të tranzicionit, nuk është se janë shumë të përhapura, pasi që, konkretisht në Kosovë, ndërmarrjet e vogla janë më tepër të karakterit “edhe unë”, që nënkupton më tepës se janë imitime të ndërmarrjeve të tjera apo ideve të tjera përbiznes, se sa që janë inovacione. Të imitosh nuk do të thotë se është gabim dhe se nuk kanë efekte, por, për të krijuar vlera dhe për të bërë ndryshime e diferencime në treg, siç ndodh në vendet e zhvilluara, atëherë ky aspekt i NVM-ve në Kosovë më tepër është një objektiv se sa fakt.

Me këtë dua të them e gjersa ka dallime në përkufizimin e NVM-ve edhe efekti i tyre në vend është i paqartë dhe i padefinuar. Kjo ndodh përfakt se ndërmarrjet në Kosovë janë aq të vogla sa që shumica nga to edhe nuk janë të regjistruara fare dhe si rezultat nuk e dimë se në çfarë mase kontribuojnë ato në zhvillimin ekonomik. Pastaj, duke qenë aq të vogla edhe punonjësit janë të kategorive të tillë, si familjarë të ngushtë apo të rrethit më të gjerë, të cilat pak ose aspak kontribuojnë në hulumtimet mbi motivimin në punë, në krijimin konkret të vendeve të reja të punës, e rrjedhimisht edhe në rritjen e konkurrencës, etj.

Një problem i tillë i definimit të efektit të tyre është edhe situata transitive e vendit, pasi që ndryshe sllen ndërmarrjet në një ambient ku ka kulturë të ndërmarrësisë dhe ndryshe në vende të cilat vetëm sa e kanë përqafuar këtë koncept. Shkrime të ndryshme shkencore e akademike<sup>59</sup> tregojnë përsituata të rënda ekonomike nëpër të cilat kalojnë vendet gjatë periudhës së tranzicionit dhe në këto situata të rënda dhe variable, sipërmarrësia ka mundur ta gjejë veten duke e modifikuar tërë kohën sjelljen e saj

---

<sup>59</sup> David Smallbone and Friederike Welter, Entrepreneurship and Small Business Development in PostSocialist Economies, 2009, fq.60

konform kushteve të rënda. Prandaj, themi se bizneset e reja në këto vende janë ndërtuar për t'iu

përgjigjur gjendjes së rëndë dhe jo kërkesave për inovacione dhe kontributet në konkurrencë, çfarë edhe e kanë rolin ato.

Funksioni kryesor i NVM-ve dhe ndërmarrësisë është inovacioni, futja e metodave të reja të prodhimit të produkteve, proceseve, metodave organizative dhe teknika të marketingut në ekonomi. Publikimi në fjalë vazhdon duke shpjeguar se kjo ndodh në dy nivele themelore: duke bërë inovacione të përparuara që shtyjnë përpara kufirin teknologjik; dhe adoptimin e risive në rritje që e afrojnë ekonominë me kufirin e saj teknologjik.

Roli, rëndësia dhe ndikimi i NVM-ve në zhvillimin ekonomik dhe social ndryshon varësisht nga niveli i zhvillimit të përgjithshëm ekonomik dhe nga vetë lloji i sistemit ekonomik. NVM-të përfaqësojnë subjektet ekonomike me tipare të ekonomisë së tregut. Prona private, liria e iniciativës, si dhe ambienti i tregut paraqesin hapësirën më të përshtatshme për zhvillimin e vazhdueshëm dhe të papenguar të tyre. Andaj, këto sipërmarrje zhvillimin më të hovshëm dhe më ndikues e kanë në ekonomitë e tregut të lirë. Në dekadat e para pas Luftës së Dytë Botërore (LDB), sipërmarrje të suksesshme konsideroheshin ato sipërmarrje të cilat krijonin premisa për t'u shndërruar në sipërmarrje të mëdha dhe ekonomikisht të fuqishme, të cilat njëkohësisht luajtën rol shumë të rëndësishëm në rritjen e aftësisë konkurruese. Ky zhvillim i tyre bazohej në koncentrimin e madh të kapitalit, ambientit të përshtatshëm afarist, si dhe në kushtet e volitshme për shfrytëzimin e burimeve njerëzore dhe atyre tekniko-teknologjike. Ky zhvillim dhe fuqizim i hovshëm ekonomik solli deri në paraqiten e kompanive shumëkombëshe, të cilat e shtrinë aktivitetin e tyre prodhues, tregtar dhe financiar anembanë botës, duke kontribuar në rritjen e GDP-së, eksport, import, bilancin tregtar, punësimin e sidomos në zhvillimin qëndrueshëm ekonomik. Por, ekonomia e këtyre kompanive mbështetet dhe përfiton nga prodhimi masiv deri në një pikë të caktuar. Por, në momentin kur aktiviteti i shumëfishtë

i tyre do ta tejkalojë pikën kritike, koordinimi i funksioneve të kompanive bëhet problematik, gjë që rezulton me rritjen e shpenzimeve të tyre mesatare. Gjithashtu, është vërtetuar se këto kompani gjigante në kohën e recessionit ekonomik për shkak të fleksibilitetit të ulët, vështirë u adaptohen kushteve të reja, të krijuara në treg dhe si pasojë e këtyre veprimeve mbi vete bartin humbje të rënda, si financiare ashtu edhe afariste.

Pretendimi i NVM-ve se janë motor të zhvillimit ekonomik, parë në përgjithësi është një e vërtetë e argumentuar, nëse jo në mënyrën më të mirë të mundshme me Kosovën, në vendet e zhvilluara kanë dhënë dhe vazhdojnë të japid efekte mahnitëse.

Zhvillimi i NVM-ve ka rol të rëndësishëm edhe në kohezionin social, duke bërë të mundur reduktimin e diskriminimeve në shoqëri, pasi që rritja e NVM-ve do të shoqërohet me rritjen e të ardhurave dhe kjo do të rrisë nivelin e jetesës dhe mundësisë për të ndikuar në kërkesat e tyre për udhëheqjen e mirë.

Duke qenë kështu, punimi në fjalë është një udhëzim teorik dhe praktik se si këto ndërmarrje mund të silleshin më mirë në treg për të performuar në nivel të ndërmarrjeve të tjera të vende të zhvilluara, fundja këto ndërmarrje lindën në kohë të vështira. Andaj, zhvillimi dhe efektet e këtyre ndërmarrjeve në vendet e varfra janë sfida, por jo të pamundshme.

### 3.3.1 Klasifikimi i NVM-ve

Klasifikimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme është një problematikë, e cila asnjëherë nuk ka gjetur një përgjigje definitive se ekziston një mënyrë e vetme e klasifikimit. Klasifikimi i tyre është bërë dhe interpretuar ndryshe si nga autorë librash, si njohës të kësaj fushe, por edhe shtetet në rregulloret e tyre, identifikojnë ndryshe klasifikimin e NVM-ve. Në fakt, kur mendojmë për IBM apo edhe Samsung, pa pasur nevojë të numërojmë karakteristika të tyre, ne i identifikojmë si biznese të mëdha. Por, nga ana

tjetër, nëse shohim një kabinë të vogël, dhe nga ajo kryhen shërbime të shitblerjes së mallrave të konsumit të përditshëm dhe të zakonshëm, atëherë e identifikojnë si të vogël pa pasur nevojë t'i identifikojmë qoftë punëtorët, qoftë karakteristikat e tjera. Por, a janë të qëlluara klasifikime të tilla, a janë të drejta ato?!

Gjithsesi, klasifikimi më i qëndrueshëm për NVM-të do të jetë ai i Komisionit Evropian, i dekretuar me datën 1 Janar 2005, i cili, sipas **Günter Verheugen-it** (kryetar i Komisionit), përbën aktin më domethënës drejt përmirësimit të kushteve për NVM-të, nxitjen e ndërmarrësisë, inovacionit dhe të investimeve. Referuar këtij Komisioni, ndarja apo klasifikimi i ndërmarrjeve bëhen si në tabelën e mëposhtme.

*Tabela 2. Klasifikimi i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme në Nivel Evropian*

Kategoria e ndërmarrjeve	Numri i të punësuarve	Qarkullimi vjetor (euro)	Bilanci vjetor i gjendjes
Mirko	<10	50.000	-
Ndërmarrje		(më parë 2 milionë)	(më parë 2 milionë)
Ndërmarrje e vogël	<50	2 milionë (më parë 10 milionë)	2 (më parë 10 milionë)
Ndërmarrje e mesme	<250	10 milionë (më parë 50 milionë)	11 milionë (më parë 43 milionë)

Burimi: European Commison, The new SME definition User guide and model declaration, 2005.

Pra, ky raport e definon qartë cilat janë katër kategori të bizneseve të klasifikuara sipas numrit të punëtorëve. Ndërmarrjet që grumbullojnë apo ngarkojnë më pak se 10 punëtorë llogariten si mikrondërmarrje, bizneset të cilat ngarkojnë më pak se 50 punëtorë klasifikohen apo kategorizohen si ndërmarrje të vogla, ndërmarrjet që ngarkojnë më pak se 250 punëtorë llogariten si biznese të mesme dhe të gjitha ndërmarrjet e tjera, të cilat rrjedhimit do të kenë më shumë se 250 punëtorë, do të konsiderohen si ndërmarrje të mëdha. Kujtojmë se përvende të ndryshme, klasifikimi i NVM-ve është bërë në përgjithësi sipas numrit të punëtorëve, po cili numër i

punëtorëve është maksimal për t'u konsideruar si NVM dallon nga viti në vit. Kështu, për vende si SHBA-ja, Danimarka, Franca dhe Finlanda, numri maksimal i punëtorëve në firma si NVM është më pak se 500. Pastaj, në Kinë, Singapor dhe Tailandë numri maksimal i punëtorëve në NVM është 100. Nga ana tjeter, në Kore dhe Japoni, NVM-të kufizohen maksimalisht me 300 punëtorë.<sup>60</sup> Ndërkaq, në Shqipëri numri maksimal i punëtorëve në NVM sipas Ligjit nr.8957, dt. 17.10.2002, "Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme", numri maksimal i punëtorëve për këto ndërmarrje është 80 punëtorë.

Në vendet e Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë edhe Kosovën, vazhdon të jetë numër shumë i madh i mikrondërmarrjeve në krahasim me llojet e tjera të ndërmarrjeve. Roli i NVM-ve në zhvillimin ekonomik është parë me skepticizëm, por gjithnjë e më tepër, në politikat dhe strategjitë zhvillimore të pothuajse të gjitha vendeve, zhvillimi dhe financimi i NVM-ve është duke e marrë trajtimin e duhur. Klasifikimi i mëposhtëm do të tregojë se si është struktura e NVM-ve në Kosovë dhe vendet e rajonit dhe, në bazë të tabelës, shohim një garniturë të ngjashme të shpërndarjes së ndërmarrjeve.

Tabela 3. *Përqindja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme sipas madhësisë në vendet e Ballkanit Perëndimor*

Lloji i ndërmarrjes	Kosova	Shqipëria	Bosnja	Mali i Zi	Maqedonia
Mikrondërmarrjet	95.0%	94.6%	95.6%	98.7%	90.08%
Të vogla	4.2%	4.1%	3.2%		7.0%
Të mesme	0.7%	1.3%	1.1%	1.1%	1.8%
Të mëdha >250	0.1%		0.2%	0.2%	0.3%

Burimi: European Investment Bank, Assesment on financing needs of SEMs in the Western Balkans Countries, Sythesis Report, Augurst 2016, faqe. 6

<sup>60</sup> OECD Conference Of Ministers Responsible For Small And Medium-Sized Enterprises (Smes), Promoting Entrepreneurship And Innovative Smes In A Global Economy: Owards a more responsible and inclusive globalisation, 2004, fq.10-12

Siq shihet në tabelë, Kosova ka rreth 99% të ndërmarrjeve të përgjithshme si NVM, ndërsa shtetet e tjera sillen rreth 97-98% të të gjitha ndërmarrjeve si NVM. Edhe në vendet e zhvilluara, që e kanë kaluar tashme fazën e tranzicionit, numri i NVM-ve është dukshëm më i madh se sa i bizneseve të mëdha, por dallimi me këto vende qëndron në kontributin e NVM-ve në GDP, që në krahasim me vendet e Ballkanit Perëndimor është më i lartë.

### 3.3.2 Karakteristikat e NVM-ve

Kjo pjesë është e lidhur shumë me klasifikimin e NVM-ve, pasi që nga karakteristikat e tyre ato klasifikohen si të vogla, të mesme gjegjësisht si të mëdha. Sipas kësaj, ndarja e NVM-ve bëhet edhe sipas karakterit kuantitativ (numri i punëtorëve), por edhe kualitativ, që lidhet me karakteristikat që duhet të posedojë një biznes për t'u klasifikuar si NVM. Sipas **Muhamed Mustafës (2006)**<sup>61</sup> një biznes, për t'u konsideruar si NVM, duhet t'i plotësojë karakteristikat e mëposhtme:

- Menaxhmenti i firmës është i pavarur dhe zakonisht menaxheri është edhe pronar i biznesit;
- Kapitali është në pronësi të një individi ose një grupi të vogël njerëzish;
- Regjioni i shtrirjes është i vogël, dhe punëtorët janë nga i njëjti rajon dhe
- Madhësia e firmës në raport me industrinë ku ajo operon nuk duhet të jetë e madhe, pra biznesi nuk duhet të jetë dominant.

Pra, përpos që janë elementet të karakterit kuantitativ, që bëjnë përpjekje për t'i kategorizuar NVM-të, janë edhe këto kualitativet, të cilat me një fjalë përshtakuajnë punën që realizohet në këto biznese. Në Kosovë, rreth 96% e ndërmarrjeve e kanë këtë karakter.

<sup>61</sup> Mustafa, E. Kutllovci, P. Gashi, B. Krasniqi, Biznesi i Vogël dhe i Mesëm, 2006, fq.21

Nga specifikat e tyre, këto biznese shfaqen atraktive në industri, ku vëllimi i shkallës nuk ka përparësi. Në Kosovë, ku shkalla e prodhimit është tej mase e vogël, këto ndërmarrje paraqiten në numër kaq të madh, sepse këto biznese janë të karakterit tregtar, që nuk kërkojnë shumë kapital dhe kanë risk më të vogël. Më poshtë do t'i japim specifikat e tyre:

- Fleksibiliteti,
- Marrja e shpejtë e vendimeve,
- Strukturë e thjeshtë organizative,
- Komunikim formal- vertikal,
- Marrëdhënie direkte me të punësuarit dhe
- Ndikim i madh i pronarit në firmë.<sup>62</sup>

### 3.3.3 Kontributi i NVM-ve

Vendet e tranzicionit përballen me sfida të njëpasnjëshme si nga aspekti politik, edhe më shumë nga ai ekonomik. Më shumë do t'i referohemi aspektit ekonomik, sepse kjo edhe e trason rrugën për një zhvillim normal ose jo të bizneseve. Më lart kemi treguar se bizneset e vogla dhe ato të mesme më tepër janë të përshtatshme për të operuar aty ku kërkesa është flaktuide, sepse kjo ua mundëson që të gjejnë dhe shfrytëzojnë burime nga më të ndryshmet për t'i realizuar kërkesat dhe për t'u përshtatur me dinamikën e zhvillimit të tregjeve botërore.

Në parim, kontributet e NVM-ve do të duhej të ishin të njëjta, pra të shtonin numrin e vendeve të punës, të sillnin inovacione, të kontribuonin me vlerë të shtuar, por një kontribut i tillë apo masa e kontributit ndryshon nga vendi në vend për shkak të specifikave të caktuara të vendeve, dhe më pas edhe për shkak të menaxhimit të proceseve gjatë procesit të tranzicionit. Kjo fazë i ka rënduar mjaft vendet si Kosova, dhe

---

<sup>62</sup> Mustafa, E. Kulllovci, P. Gashi, B. Krasniqi, Biznesi i Vogël dhe i Mesëm, 2006, fq.21

të rajonit, pasi këto vende kanë probleme të mëdha në aspektin finansiar e sidomos në atë ligjor, dy faktorë këta shumë të rëndësishëm në jetën e NVM-ve. Investitorët janë shumë jotorientantë ndaj kushteve jo të favorshme ligjore, andaj edhe i përgjigjen me tërheqje të kapitalit nga vendet me defektologji të tillë.

Ndër kontributet e NVM-ve më të spikatura nga të cilat edhe rrjedhë roli dhe domosdoshmëria e tyre, janë si më poshtë:

- Kontributi procese e ndryshime teknologjike,
- Kontributi në sjelljen e konkurrencës së shëndoshë,
- Hapja e vendeve të reja të punës dhe
- Oferta e pasur e prodhimeve vendore në tregun vendor<sup>63</sup>

Gjithësi, këto kontribute të NVM-ve janë më të zbehta në vende në periudhë tranzicioni, pasi që këto vende karakterizohen me rënie të prodhimit dhe shitje të mallrave të konsumit që nuk krijojnë vlera të reja. P. sh. përmendim këtu kontributin në proceset teknologjike, të cilat kërkojnë kapital të madh, gjë që është e mangët në këto vende. Kontributi i ofertës së pasur të produkteve vendore është një tjeter mangësi e NVM-ve në vendet që kalojnë në fazë tranzicioni, sepse karakteristikë tipike e këtyre vendeve është se nuk prodhojnë mallra për treg industrial, ato vetëm shesin produkte të gatshme. Nga kjo rezulton edhe bilanci negativ i pagesave, sepse këto mallra importohen dhe krijojnë diferençë të madhe në mes të të hyrave dhe shpenzimeve për eksport-import.

Më poshtë do të paraqesim kontributin e NVM-ve në secilin nga vendet e Ballkanit Perëndimor, që janë në fazë tranzicioni të sistemit të ekonomik.

---

<sup>63</sup> Mustafa, E. Kutllovci, P. Gashi, B. Krasniqi, Biznesi i Vogël dhe i Mesëm, 2006, fq.21

Tabela 4. Kontributi i NVM-ve i Shprehur në Përqindje në Vendet e Ballkanit Perëndimor

Faktorët	Kosova	Shqipëria	Bosnja	Mali i Zi	Maqedonia	EU
Përqindja e NVM-ve	99.9%	98.7%	99.8%	99.8%	99.7%	99.8%
Punësimi	80.7%	60.3%	66.3%	-	75.6%	66.9%
Vlera e shtuar	-	50.0%	61.6%	67.2%	65.5%	57.8%
Fitimi	-	55.5%	71.7%	67.7%	67.7%	-

Burimi: European Investment Bank, Assesment on financing needs of SEMs in the Western Balkans Countries, Sythesis Report, Augurst 2016, faqe. 7

Siq shihet edhe në tabelë, kontributi i NVM-ve në të gjitha vendet është dukshëm më i theksuar te shtimi i vendeve të punës se sa në krijimin e vlerave të reja, që, rrjedhimisht, do të ishte refleksion i joefikasitetit të kompanive prodhuese. Pra, nga karakteri i këtyre ndërmarrjeve, aludojmë se ato në masën më të madhe janë të karakterit tregtar, ku shesin me shumicë ose me pakicë mallra konsumi apo mallra përfundimtare.

Situatë e njëjtë, sa i përket karakteristikave të NVM-ve, qëndron edhe në shtetet më të zhvilluara të Evropës, të quajtura si EU28, dhe më poshtë paraqesim kontributin e NVM-ve në punësim dhe në vlerën e shtuar.

Tabela 5. *Klasifikimi dhe Kontributi i Ndërmarrjeve në Vendet e EU28*

Përshkrimi	Mikro	Të vogla	Të mesme	NVM-të (total)	Të mëdha	Totali
Ndërmarrjet (%)	92,7	6,1	1	99,8	0,2	100
në numër	20,710,324	1,373,365	224,811	22,308,500	43,766	22,352,260
Punësimi (%)	29,2	20,4	17,3	66,9	33,1	100
në numër	39,274,088	27,452,716	23,257,412	89,984,216	44,438,724	134,422,944
Vlera e shtuar (%)	21,1	18,2	18,5	57,8	42,2	100
në numër	1,358	1,169	1,188	3,715	2,71	6,425

Burimi: European Commission, Annual Report on European SMEs 2014/2015, SMEs start hiring again. November 2015

Burimi: Eurostat, National Statistical Offices, and DIW Economy

Nga tabela shihet se edhe në mesatare të EU28, numri më i madh i ndërmarrjeve mikro dhe të vogla, konkretisht 99.8%, kontribuojnë në punësim me 66.8%, e që në shifër i bie 89,984,216 vende të punës.

Madje, Kosova është rast për t'u veçuar këtu, pasi që nuk kemi fare shifra përvlerën e shtuar dhe të kthimit të mjeteve. Por, dallimi nga këto vende është se në Kosovë edhe nuk mund të përcaktohet qartë ndikimi i NVM-ve në vlerë të shtuar për shkak karakteristikave të tyre, janë shumë të vogla dhe familjare dhe nuk është i matshëm efekti i tyre në vlerë, ndërkaq në disa vende të Ballkanit Perëndimor, NVM-të janë më pak të shprehura për shkak të avantazhit me bizneset e mëdha.

Lidhur me këtë situatë, mund të jap këtu arsyetimin (është përmendur edhe më lart) se Kosova më tepër shet produkte përfundimtare e më pak gjysmëprodukte. Konkretisht, rreth 86% e kompanive kosovare merren me shitjen e produkteve përfundimtare, 11% e

kompanive merren me shitjen e materialeve të papërpunuara dhe vetëm 5% e kompanive merren me shitjen e produkteve të ndërmjetme<sup>64</sup>.

### 3.3.3.1 Kontributi i NVM-ve në krijimin e vendeve të reja të punës

Patjetër që kontributi i NVM-ve është shumë i madh në zhvillimin ekonomik dhe e kemi cekur se në çfarë aspektesh roli i tyre është më i rëndësishëm dhe i fokusuar. Por, kontributi i tyre në masë të madhe është në krijimin e vendeve të punës, sidomos në vendet në zhvillim. Në këto vende, NVM-të zënë peshë me 45% të punësimit të përgjithshëm dhe 33% në të ardhurat kombëtare (PBB).<sup>65</sup> Referuar po këtij burimi, për të absorbuar me shumë se 600 milionë fuqi punëtore, do të duhen 15 vjet ta lokalizojnë këtë fuqi në vende përkatëse të punës, dhe 4 nga 5 vendet e punës, që do të duhesin të hapeshin, do të sigurohen nga NVM-të.

Shkenca sot është duke dhënë çdo ditë informacione përmes publikimeve shkencore, të cilat janë duke i promovuar NVM-të si motorin e zhvillimit ekonomik, kjo është e shprehur në masë të madhe në vendet e tranzisionit, pavarësisht faktit se NVM-të në këto vende janë të karakterizuara me pasiguri të madhe dhe jostabilitet, çka i bën të janë më pak efektive se në vendet e zhvilluara. I quajmë motor të

zhvillimit përfaktin se ato mund të gjenden shumë më mirë në vendet që janë në fazë recessioni dhe që tentojnë drejt prosperitetit. NVM-të në këto vende bëjnë të mundur inicimin e ideve të vogla, nga të cilat edhe bëhen lëvizje të mëdha të ekonomisë. Shkenca, po ashtu, vërteton edhe në formë empirike lidhjen pozitive në mes të kontributit të madh

---

<sup>64</sup> OECD Annual Report on the OECD Guidelines for Multinational Enterprises, 2013, <http://dx.doi.org/10.1787/mne-2013-en>

<sup>65</sup> <http://www.worldbank.org/en/topic/financialsector/brief/smss-finance>

të NVM-ve në punësimin e përgjithshëm dhe GDP-së për kokë banori, edhe pse shumë më e vështirë për ta matur këtë gjë në vendet me zhvillim të ngadaltë, si ato të Ballkanit Perëndimor, rasti konkret Kosova.


Pavarësisht se në tabelën e paraqitur më lart nuk ka pasur të dhëna për krijimin e vlerës së shtuar nga ana e NVM-ve, në disa vende të Ballkanit Perëndimor, kontributi më i madh i NVM-ve në këto vende ishte në krijimin e vendeve të reja të punës. Puna konsiderohet si faktor i rëndësishëm me efekt multiplikatorit, puna është aq e rëndësishme sa ka kuptim më madh se të ardhurat financiare. Ato janë një interpretim i kontributit të njerëzve për t'i dhënë vetës dhe familjes mundësinë për një jetë më të mirë dhe standard më të lartë, shoqërisë produkte apo shërbime të reja dhe të nevojshme, dhe shtetit të ardhura shtesë në formë të tatimeve, të cilat mjete shteti prapë i përdor për ta rritur mirëqenien e qytetarit. Puna ka të bëjë me refleksion emocional dhe motivues që shprehet përmes produktivitetit. Matja e saj nuk bëhet vetëm përmes orëve apo parave, ajo është lidhur me kënaqësinë e njerëzve, me dinjitetin dhe ndjenjën se janë të dobishëm. Në mungesë të punës, përpos problemeve ekonomike apo, të ashtuquajtura, kosto ekonomike, vendet përjetojnë edhe kosto sociale, dhe gjithnjë e më tepër janë në pah të tilla kosto, si p.sh. vetëvrasje, sëmundjet shëndetësore si depresioni, infarktet dhe shqetësime të tjera fizike dhe emocionale.<sup>66</sup>

Më poshtë, do të shohim edhe kontributin e NVM-ve në krijimin e vendeve të reja të punës në vendet e rajonit dhe në Evropë, si dhe në nivel të përgjithshëm të Bashkimin Evropian.

---

<sup>66</sup> Ahmet Manqellari, Sulo Hadëri, Stefan Qiriqi, Dhori Kule, Hyrje në Ekonomi, 1987

Grafiku 1. Kontributi i NVM-ve në Punësimin e Përgjithshëm




Burimi: BFC (2016); Statistical offices, EC (2015) Annual Report on European SMEs 2014 / 2015,

Nga tabela e mësipërme shohim se në Kosovë, NVM-të kontribuojnë me 81% të shumës së përgjithshme të punësimit, pastaj Italia është po në këtë përqindje, duke u ndjekur nga Maqedonia dhe të tjera me përqindje më të ultë. Përmendim këtu Shqipërinë, në të cilin vend NVM-të kontribuojnë me 60% në punësimin e përgjithshëm. Ndërkaq, vendet e tjera janë pothuajse në përqindje të njëjtë me atë të EU28-të, konkretisht 67% të punësimit të përgjithshëm.

Në saje të shpjegimit të ndikimit të NVM-ve në krijimin e vendeve të reja të punës, janë dy këndvështrime, dhe këtë e vërtetojnë publikime që janë bërë, si p.sh. në SHBA, sipas të cilave ndërmarrjet që operojnë në vende me të ardhura të larta, krijojnë apo kontribuojnë në krijimin e numrit më të madh të vendeve të punës, ndërsa një tjetër tregon se në vendet në zhvillim, NVM-të janë ato të cilat bartin përgjegjësinë e rritjes së numrit të vendeve të punës.

Më poshtë, po paraqesim tabelën në të cilën shohim paraqitjen e kontributit të firmave të vogla, të mesme dhe të mëdha në punësim duke i krahasuar me të ardhurat.

Grafiku 2. Kontributi i NVM-ve në Punësim i Krahasuar me të Ardhurat e Vendit



Burimi: IFC jobs study, Assessing private sector contributions to job creation and poverty reduction, January 2013, f.11

Ndërmarrjet e mëdha në vendet me të ardhura të larta kontribuojnë me rreth 49%, kurse në ato me të ardhura të vogla me 30%. Nga ana tjetër, NVM-të në vendet me të ardhura të vogla, kontribuojnë në punësim me 35% të numrit të përgjithshëm, kurse në vendet me të ardhura të larta, NVM-të kontribuojnë me vetëm 16%. Pra, vërtetohet edhe ajo që thamë se NVM-të më tepër janë të përshtatshme në kohë ku ekonomia nuk ndodhet në pikën më të lartë të saj apo vendeve me përqindje të lartë të ardhurash. Kjo vjen si rezultat i asaj që në kohë recessionesh është shumë vështirë të sigurosh kapital të madh financiar dhe të synosh industri ku ka të hyra të mëdha, zakonisht atë të prodhimit. Andaj, këto janë kushte të cilat e determinojnë një biznes që të jetë i vogël, i mesëm apo i madh. Ndërtë tjetra, përmendim edhe faktorët të cilët ndikojnë në formën e zgjedhjes së firmës:

- Kapitali financiar dhe planet financiare,
- Përfitimet, detyrimet dhe obligimet e pronarëve-menaxherëve,
- Tatimit dhe rregullimi qeveritar,
- Shfrytëzimi i burimeve dhe
- Rritja, ekspansioni, integrimi dhe shitja.

### 3.3.4 Ndikimi i NVM-ve në vendet të ndryshme të botës

Në kushtet e reja afariste në vitet e '80 të shek. XX, në Itali u shënua zgjerimi dhe diversifikimi i tregut me ç'rast janë krijuar edhe kushte të volitshme për zhvillimin e NVM-ve. Ardhmëria e NVM-ve me karakteristika inovative në masë të madhe është varur nga bartja e suksesshme e diturisë dhe shkathtësisë, nga ky aspekt imponohet si domosdoshmëri rasti i regionit të mirënjojohur Italian **Emilia-Romanga**, i cili paraqet modelin e dalluar për hulumtimin e NVM-ve, për arsyen e zhvillimit të jashtëzakonshëm ekonomik që është bazuar mbi potencialin e subjekteve të vogla afariste. Në Itali, 31.3 % e popullsisë beson se ka aftësi për të filluar një biznes, ku meshkujt janë të përfshirë dy herë më shumë se femrat në aktivitetin sipërmarrës. Por, frika e dështimit të NVM-ve në Itali është relativisht e lartë (49.1% e popullsisë), ndërsa mundësia për të filluar një biznes të ri në vitin 2014 shënoi rritje (26.6 % e popullatës identifikuani mundësi të reja për biznes). Sipas një ankete të realizuar nga ekspertët kombëtarë në vitin 2014, Italia radhitej më keq se vendet e mëdha evropiane në ekosistemin sipërmarrës, si në: politikat e qeverisë, programet qeveritare dhe veçanërisht mungesa e edukimit sipërmarrës. Në vitin 2012 u miratua një ligj i veçantë (DL 179/2012) që kishte për qëllim përkrahjen në krijimin dhe rritjen e sipërmarrjeve të reja.<sup>67</sup>

SHBA-të mund të konsiderohen si djepi i sipërmarrësisë. Në këtë vend, sipërmarrësia përjetoi lulëzim të plotë. Këtë e vërteton edhe themelimi i shoqatës së sipërmarrësve që nga viti 1953, që ka pasur synim të ndihmojë, mbrojë dhe të përparojë punën e NVM-ve në SHBA. Definimi në ndërmarrje të vogla dhe të mesme në SHBA më së shpeshti kryhet nëpërmjet këtyre treguesve: gjithsej aktivi (mjetet), statusi i pronës, të ardhurat e përgjithshme vjetore dhe numri i punëtorëve. Sipas këtyre kriterieve dhe definicionit mbi këto sipërmarrje, sipërmarrje të vogla konsiderohen ato që kanë më pak se 500 të punësuar, të personalizuara, të kontrolluara dhe të menaxhuara nga vetë pronarët.

<sup>67</sup> European Commission 2017 SBA Fact Sheet Italy

Gjatë krizës ekonomike që e kaploj ekonominë amerikane, sipërmarrjet e mëdha, nga paaftësia për t'u ristrukturuar dhe për t'ju përshtatur kërkesave dhe nevojave të tregut, humbën mbi 4 milionë vende pune dhe bilancet e tyre tregonin humbje të vazhdueshme në fitimeve. Kompanitë e mëdha nuk kishin mundësi ta kontrollonin tregun, të rrisin produktivitetin, të ofronin produkte dhe shërbime të reja dhe si pasojë e kësaj shumë sipërmarrje të mëdha u shitën apo falimentuan, duke lënë pasoja të mëdha si në rritjen e papunësisë, ashtu edhe në zvogëlimin e pagesës së taksave dhe tatimeve.

Si pasojë e kësaj situate të pashpresë nga recessioni ekonomik, në skenën ekonomike lindën sipërmarrje të vogla, të cilat kryesisht kanë pasur fryshtësim me orientim sipërmarrës inovativ. Duke e shfrytëzuar infrastrukturën e zhvilluar dhe klimën e volitshme për sipërmarrësinë këto NVM u përhapën shpejt dhe patën zhvillim të bujshëm dhe kanë qenë vendimtare për tejkalimin e problemeve të mëdha ekonomike. Ekonomia amerikane mbështetet, kryesisht, në idetë inovative dhe në zbatimin e shpejtë të tyre në aktivitetin e tyre ekonomik, gjë që e bëri këtë ekonomi më konkuruese në nivel botëror. Përqindjen më të madhe të zbulimit dhe zbatimit të inovacioneve në SHBA e kanë bërë NVM-të. Vetëm brenda një dekade në SHBA janë hapur 22 milionë vende të reja të punës, nga të cilat 17 milionë i kanë hapur NVM-të me orientim sipërmarrës. NVM-të kanë treguar fleksibilitet të madh në treg dhe, duke shfrytëzuar fryshtësimin e volitshme sipërmarrëse, arritën rezultate të konsiderueshme ekonomike.

Në zhvillimin e sipërmarrësisë në SHBA ndikim pati edhe liberalizimi dhe zgjerimi i tregut në nivel botëror, ndryshimet politike në ish-shtetet socialiste, si dhe zhvillimi i shpejtë i komunikacionit. Këto parakushte, sipërmarrësit amerikanë i shfrytëzuan në mënyrën më të mirë të mundshme, duke iu adaptuar kërkesave të reja të tregut dhe duke siguruar përveti dhe ekonominë amerikane fitime të larta. Sipërmarrësit amerikanë nuk parapëlqejnë ndërhyrjen dhe përkrahjen e shtetit në afarizmin e tyre. Ata më tepër parapëlqejnë që shteti të krijojë ambient të volitshëm ekonomik dhe infrastrukturë të zhvilluar rrugore, të sigurojë konkurrencë lojale dhe kushte të barabarta për të gjithë sipërmarrësit. Sistemi i

arsimit amerikan është ngushtë i lidhur me ekonominë dhe ndihmon në zbatimin e ideve novatore në praktikë.

Në fakt, SHBA-të mbajnë primatin e të qenit lider në ndërmarrësi ngase kanë avantazhe në pika shumë të rëndësishme që janë të lidhura me suksesin e procesit të sipërmarrjes. Një nga to është pjekuria e kulturës ndërmarrëse në SHBA. Ky renditet si ndër avantazhet kryesore, pasi që njerëzit tashmë janë mësuar t'i hetojnë dhe identifikojnë me kohë kërkesat dhe preferenca e konsumatorëve, dhe jo vetëm kaq, por edhe t'i paraprijnë kërkesës së tyre, kjo do të thotë se në saje të inovacioneve, ata plotësojnë kërkesa të paidentifikuara nga vet konsumatorët.

Një tjetër arsy, pse industria amerikane është e suksesshme, lidhet me faktin se kanë një lidhshmëri të fortë në mes të universitetave (shkencës) me industriisë dhe kjo nënkupton që shkenca është gjithnjë në hulumtim dhe prodhim të asaj çfarë hasë si nevojë në treg.

Avantazhi i tretë është në politikën e emigracionit që, historikisht, ka qenë mjaft e përhapur. **Vivek Wadhwa**, nga Universiteti Duke, vë në dukje se gjysma e bizneseve të Luginës së Silikonit janë themeluar nga emigrantët.

**Amar Bhidé**, nga Universiteti i Kolumbias, sugjeron një arsy të katërt për sukses të sipërmarrësisë amerikane - konsumatorë aventurierë. Amerikanët janë jashtëzakonisht të gatshëm për të provuar produkte të reja të çfarëdo lloji, ata janë, gjithashtu, jashtëzakonisht të gatshëm t'i ngacmojnë prodhuesit për t'i përmirësuar produktet e tyre.

Pavarësisht faktit se SHBA-të kanë një industri të zhvilluar në saje të aftësisë sipërmarrëse të tyre, kjo nuk do të thotë se ajo nuk përballet me probleme. Të theksuara janë problemet me licencimin e ndërmarrjeve, po ashtu sistemi tatimor është i komplikuar. Një nga problemet që është shfaqur tashmë me dinamizëm të theksuar është frika nga sulmet terroriste, e cila ka ngritur shqetësimë dhe kërkesa për procedurat e pajisjes me dokumente të qëndrimit të përkohshëm apo përhershëm në Amerikë. Sot, më

shumë se 1 milion njerëz janë duke pritur në radhë që t'u jepet statusi ligjor si banorë të përherershëm të SHBA-ve. Megjithatë, vetëm 85.000 viza në vit janë ndarë për punëtorë me kualifikim nëse ekonomia ka nevojë.

Gjithsesi, në SHBA, regjistrimi i më shumë se 15.000.000 NVM-ve i bën ato që të zënë një vend të rëndësishëm në treg, si në aspektin e furnizimit ashtu edhe në aspektin e konsumit.

Në Britaninë e Madhe për një periudhë disavjeçare (1979-1997) numri i NVM-ve u rrit nga 1.9 milionë në 2.8 milionë, që kryesisht ishin biznese familjare dhe punësonin 26% nga numri i përgjithshëm i të të punësuarve, ndërsa kjo përqindje në Gjermani është 17%, në Francë 26%, në Itali 48%. Ndërsa, NVM-të së bashku, në shumicën e këtyre shteteve, punësojnë mbi 60% nga numri i përgjithshëm i të të punësuarve.<sup>68</sup>

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në strukturën e përgjithshme ekonomike të Belgikës marrin pjesë me 97% në sektorin privat (më pak se 50 të punësuar). Është interesant fakti se 85% nga NVM-të kanë më pak se 10 të punësuar në sektorin privat, ndërsa vetëm 0.2% më shumë se 500 të punësuar në sektorin privat. Po ashtu, në bazë të analizave, NVM-të participojnë në punësimin e përgjithshëm me mbi 41%, ndërsa në PBB participojnë me 70%.<sup>69</sup> Mesatarisht, në çdo vit numri i ndërmarrjeve të posa themeluara në ekonominë belge është mbi 60.000. Në strukturën e përgjithshme të ekonomisë së Belgikës mund të dallohen tre sektorë: a) tregtia dhe hoteleria, b) aktivitetet shërbyese të konsaltingut dhe c) sektori i ndërtimitarisë.

---

<sup>68</sup> <https://www.gov.uk/>

<sup>69</sup> 2017 SBA Fact Sheet, Belgium <file:///C:/Users/Acer/Downloads/Belgium%20-%202017%20SBA%20Fact%20Sheet.pdf>

Sa i takon Austrisë, shumica e ndërmarrjeve të vogla bëjnë pjesë në sferën e tregtisë dhe të turizmit. Nuk bëhet fjalë për ndërmarrje me teknologji të lartë ose kapitali intensiv, por shumica prej tyre janë ndërmarrje të vogla që u takojnë segmenteve shërbyese dhe turistike, reparte të vogla industriale, punëtori të ndryshme kontraktore ose prodhuesit e agro-produkteve. Është interesant që dega e turizmit është një ndër degët më të rëndësishme ekonomike dhe burimi kryesor për sigurimin e mjeteve devizore. Austria paraqet shembullin tipik të një politike të suksesshme të zhvillimit të shpejt ekonomik, përmes nxitjes dhe funksionimit të NVM-ve. Përmes këtyre subjekteve të vogla afariste, Austria ka siguruar edhe shkallën më të lartë të aftësisë konkuruese të ekonomisë. Në Austri, participimi i ndërmarrjeve të vogla (deri në 100 të punësuar) në numrin e përgjithshëm të ndërmarrjeve arrin 98-99 %. Këto ndërmarrje absorbojnë afër 60% të fuqisë punëtore dhe participojnë me 50% nga vlera e PBB-së.<sup>70</sup>

Ndërsa sa i përketë Gjermanisë, si vendi më i fortë në botë dhe ndër më të pushtetshmit, ekonomia e tregut të lirë dhe e iniciativës, është shembulli më i mirë i funksionimit të një modeli të suksesshëm të ndërmarrësisë.

Ekonomia gjermane ka një karakteristikë të veçantë, andaj edhe do ta prezantojmë ndaras nga shtetet tjera anëtare të BE-së. Pas luftës së dytë botërore, ekonomia e sajë, veçanërisht sipërmarrjet e mëdha pësuan dëme të mëdha materiale. Por, qeveria gjermane duke përkrahë në mënyrë aktive sipërmarrësit ndikoi që NVM të marrin një peshë të madhe në ringjalljen e ekonomisë gjermane dhe për disa decenie përsëri bëhet ekonomia më e zhvilluar në Evropë dhe ndër më të zhvilluarat në botë. Sipas të dhënave statistikore NVM në PBB kontribuojnë me më shumë se 50% nga e gjitha vlera e krijuar,

<sup>70</sup> Report on the Situation of SMEs in Austria 2014. For further information: Austrian Institute for SME Research

ndërsa në këto sipërmarrje janë të punësuar afër 80% e të gjithë të punësuarve në sektorin jopublik.<sup>71</sup>

Në suksesin gjerman të ekonomisë së tregut kanë ndikuar shumë faktorë: tradita e punës, disiplina dhe besimi ndaj punës, kualifikimet përkatëse të njerëzve, niveli i arsimimit, niveli i kulturës së përgjithshme etj. Pas LDB-së, ekonomia gjermane kishte karakter tipik social. Zhvillimin e hovshëm e ka mbështetur në zhvillimin e NVM-ve, në bizneset familjare, në rritjen e vazhdueshme të iniciativës private, në ekonominë konkurruuese, i cili model njihet si “**modeli social i ekonomisë së tregut**”. Shteti, realisht, luante rolin e nxitësit dhe përkrahësit të NVM-ve, veçanërisht në nivel regional.

Në këtë aspekt, duhet përmendur rastin e ekonomisë së një prej krahinave më të zhvilluara gjermane - **Baden-Vitenberg**, e cila zhvillimin e vet të hovshëm e ka bazuar mbi potencialin e NVM-ve të organizuara në formë të “**punëtorive të pavarura zejtare**”. Për realizimin e këtyre qëllimeve, nëpërmjet institucioneve financiare dhe këshillëdhënëse, NVM-ve u janë siguruar mjete të nevojshme financiare, të ashtuquajtura kredi të lira.

### ***3.4 Karakteristikat e firmave të vogla si faktorë të krijimit të vendeve të reja të punës***

Ndërmarrja është si organizmi i njeriut ku vjen në shprehje teoria e **Darwin-it** për mbijetesën e gjallesave, gjë që është shumë e përafërt edhe me ndërmarrjet, pra mbijetojnë ata të cilët janë më të fortë. Ato kanë një cikël jetese e cila është e varur nga faktorët e jashtëm dhe të brendshëm. Këta faktorë, ndikimin e tyre e bëjnë në dy cilësi, atë të të qenët miqësor me veprimtarinë biznesore dhe të qenët armiqësor me këtë sektor.

---

<sup>71</sup> Annual Report on European SMEs 2016/2017 Focus on self-employment, fq. 42


### 3.4.1 Mosha e kompanisë

Lufta e ndërmarrjeve të vogla në vende të varfra është shumë e ashpër dhe e dhimbshme sepse ato nuk veprojnë për t'u zgjeruar, por për të funksionuar në atë masë deri sa mund ta mbajnë atë. Shumica e ndërmarrjeve të vogla lindin dhe vdesin si të tilla. Nga kjo del fakti se edhe mundësia e krijimit të vendeve të punës është e varur nga fazat e jetës së ndërmarrjes, apo mund ta definojmë më mirë, nga mosha e ndërmarrjes. Kur ndërmarrja është e re, ajo ka mundësi të absorbojë më shpejt brumë nga tregu dhe, si rezultat, ka mundësi të angazhojë punëtorë më shumë në punë se sa bizneset e mëdha.

Në publikimet e veta, OECD-ja thekson se ndërmarrjet më të reja se pesë vjet janë kontribuuesit neto të vendeve të punës, ndërsa ndërmarrjet e mëdha janë shkatërruesit e vendeve të punës. Një tjetër publikim që e vërteton këtë është edhe ai i **Third European Company Survey (ECS)**, e cili tregon se punësimi është i lidhur negativisht me moshën e kompanisë.

*Grafiku 3. Ndryshimi në Punësim Krahasuar me Moshën e Kompanisë për Periudhat*

2010-2013, Eu28



Burimi: Job Creation in SMEs: ERM Annual Report 2015, Eurofound, fq.25

Nga kjo grafikë shohim se, sa më shumë vite të bëjë ndërmarrja, më shumë kontribuon në uljen e numrit të vendeve të punës se sa në rritjen e tyre. Konkretisht, kur ndërmarrja është në 10 vitet e para të saj, ajo kontribuon në rritjen e numrit të përgjithshëm të krijimit të vendeve të punës me 43%, ndërsa vetëm me 19% në shuarjen e tyre. Ndërmarrjet, të cilat mbijetojnë më shumë se 10 vjet, saktësisht deri në 49 vjet, në krijimin e vendeve të punës kontribuojnë me 25%, ndërsa në shuarjen e tyre me 28%. Dhe, kur ndërmarrjet mbushin 50 vjet e tutje, ato tashmë kontribuojnë pak në krijimin e vendeve të reja të punës, konkretisht me 22%, dhe më shumë në shuarjen e tyre, konkretisht me 26%. Jo vetëm këto të dhëna vërtetojnë se NVM-të janë krijuesit më të mëdhenj të vendeve të punës, por shtete të ndryshme raportojnë, përmes të dhënavë të tyre kombëtare, përfaktin se si këto ndërmarrje ndikojnë në rritjen e punësimit. Në Finlandë, shumica e vendeve të reja të punës janë krijuar që në vitet e para të ndërmarrjeve të vogla. Në Danimarkë, vendet e reja të punës, në masën më të madhe krijojnë dy vitet e para të ekzistencës së firmave, ndërsa mbyllja e vendeve të punës bëhet nga firmat që kanë mbushur më shumë se 15. Nga ana tjetër, të dhënat gjermane, konstatojnë se norma vjetore e punësimit që vjen nga kompanitë që kanë deri në pesë vjet ekzistencë është 8.8%, e që është përf 6.8% më e madhe se e bizneseve që kanë mbi 20 vjet ekzistencë.<sup>72</sup> Pastaj, një rast tjetër është Lituania, ku, sipas të dhënavë kombëtare të këtij shteti të raportuara 73, firmat e vogla, të ashtuquajtura start-up, e që kanë më pak se pesë vjet ekzistencë, janë krijuar nga pesë vende pune më shumë se ato të mëdhatë, të dhëna këto të vitit 2013.

Në Irlandë, kompanitë që ekzistojnë më pak se pesë vjet, kontribuojnë me 24% në normën e punësimin, e që nënkupton 64% të numrit të përgjithshëm në krijimin e vendeve të reja të punës, ndërmarrjet që ekzistojnë ndërmjet viteve 5-10 kontribuojnë me 7%, kurse

<sup>72</sup> Job Creation in SMEs: ERM Annual Report 2015, Eurofound, 2016, Corell University, fq.26.

<sup>73</sup> David Osimo, The 2016 Startup Nation Scoreboard How European Union Countries are Improving Policy Frameworks and Developing Powerful Ecosystems for Entrepreneurs.fq.61

kompanitë më të vjetra se 10 vjet, kontribuojnë me 5% në krijimin e vendeve të reja të punës).

Nga të gjitha shtetet anëtare të EU-së, nga konstatimi se ndërmarrjet e reja krijojnë numër më të madh të vendeve të punës, kemi dy përjashtime: Hungaria, e cila nuk është e shqar për një sektor privat të NVM-ve shumë të begatshëm. Sipas publikimit të referuar në këtë pjesë<sup>74</sup>, në Hungari, NVM-të deri në pesë vitet e para janë të shtrënguara për të luftuar për ekzistencë dhe kjo nuk krijon kushte për të kontribuar në masë të madhe në krijimin e vendeve të reja të punës. Ndërkohë që edhe në Rumania situata është e atillë që NVM-të, në një periudhë njëvjeçare, kontribuojnë me 0,93% në punësim, për dallim nga ndërmarrjet që kanë mbi 10 vjet ekzistencë që kontribuojnë me 1.49%. Sikurse këto vende, ku NVM-të e reja nuk janë aq dinamike, janë edhe ato të krijuara në Qipro, Greqi dhe Portugali. Në Francë, Estoni dhe Lituani vetëm firmat e vogla më të reja se 10 vjet kanë treguar trende pozitive të punësimit brenda viteve 2007-2012.<sup>75</sup> NVM-të në Luksemburg ndërmjet vitit të pestë dhe atij të nëntë krijojnë numrin më të madh të vendeve të punës për periudhën 2006-2012.<sup>76</sup>

### 3.4.2 Madhësia e kompanisë

Madhësia e kompanisë është faktori sipas të cilit edhe ndahen ndërmarrjet, ndërsa, sa i përket kontributit të tyre në rritjen e vendeve të reja të punës, ato dallojnë mjaft nga vendi në vend. Parimisht, themi se NVM-të kontribuojnë që shtimi i vendeve të punës të jetë më dinamik se sa krijimi i vendeve të punës nga bizneset e mëdha, por, gjithësi, ky konstatim, duke qenë se ndryshon mjaft nga vendi në vend, atëherë nuk kemi një përcaktim të qartë. Në të gjeturat e tij, **De Koke et al (2011)**<sup>77</sup> thotë se mikrondërmarrjet,

<sup>74</sup> Job Creation in SMEs: ERM Annual Report 2015, Eurofound, 2016, Corell University, fq.26.

<sup>75</sup> Komisini Evropian, Raporti Vjetor për NVM-të, 2016, fq.78)

<sup>76</sup> Po aty,

<sup>77</sup> Jan de Kok, Paul Vroonhof Wim Verhoeven, Niek Timmermans Ton Kwaak, Jacqueline Snijders Florieke Westhof Zoetermeer, Do SMEs create more and better jobs?, November 2011.

në mënyrë të veçantë kontribuojnë në shtimin e vendeve të reja të punës, duke llogaritur mesatarisht në 1.7% të rritjes se punësimit në vit, e cila krahasohet me kontributin e ndërmarrjeve të mëdha me 0.4%, 0.5% bizneset e mesme dhe 0.7% për biznese të vogla, apo mesatarisht në gjithë rritjen e punësimit me 0.9%. Po sipas këtij autori, vërehet një rënie në mesatare e krijimit të neto vendeve të reja të punës në përputhje me rritjen e madhësisë së firmës dhe atë: 3.1% për mikrondërmarrjet, 1.6% për ndërmarrjet e vogla, 1.3% për ndërmarrjet e mesme dhe 1% për ndërmarrjet e mëdha.

Gjithsesi, raportime kombëtare të ndryshme jepin edhe të dhëna të ndryshme lidhur me këtë fakt, bie fjala këtu, për Irlandën, rënia e numrit të vendeve të reja është bërë pikërisht me rritjen e madhësisë së firmave dhe atë nga 21% (sa ishte ndërmarrje me më pak se 20 punëtorë) në 7% kur u bë ndërmarrje me 50-200 punëtorë, ndërsa e kundërtat ndodh në Qipro, ku një rritje mesatare e krijimit të neto vendeve të reja të punës në masën prej 3.3% është bërë nga ndërmarrjet e mesme, krahasuar me ndërmarrjet e vogla me 2.2% si dhe ato mikro me 2.9%.<sup>78</sup>

NVM-të më dinamike në krijimin e neto vendeve të reja të punës janë parë përpos në Irlandë, edhe në Kroaci, Finlandë Lituani dhe Sloveni, po nga ana tjetër, sipas të njëjtës burim, kontribuuesit më pak dinamikë në krijimin e vendeve të reja të punës janë në Belgjikë, Hungari, Francë, Poloni dhe Rumani.<sup>79</sup>

### 3.4.3 Sektori

Referuar gjithnjë këtij reporti gjithëpërfshirës, një tjetër faktor që i bën NVM-të të jenë kontribuuesit më të mëdhenj në krijimin e vendeve të reja të punës, është edhe sektori

---


<sup>78</sup> Jan de Kok, Paul Vroonhof Wim Verhoeven, Niek Timmermans Ton Kwaak, Jacqueline Snijders Florieke Westhof Zoetermeer, Do SMEs create more and better jobs?, November 2011.

<sup>79</sup>Ministry of Economy, 2012; Starczewska-Krzysztosek, 2012

ku ato veprojnë. Në diskutimet e lartshënuara, kemi përmendur se NVM-të në vendet e pazhvilluara janë më të përhapura në sektorë ku nuk ka nevojë për kapital të madh themeltar, sepse ne e dimë se NVM-të, si të tilla, karakterizohen edhe për faktin që nuk kanë qarkullime të mëdha. Andaj, si opsione të qëndrueshme për sektorët e përshtatshëm për NVM-të mbeten ai tregtar dhe shërbypes.

Kjo situatë është pothuajse e njëjtë në të gjitha vendet e Ballkanit, por edhe ato që janë pjesë e Unionit Evropian, EU28. Për këto vende, sektori bartës i përgjegjësisë së humbjes së vendeve të punës është pikërisht ai i prodhimit, veçojmë këtu sektorin e bujqësisë, i cili gjithnjë e më tepër po tkurret dhe po i ngufat gjithnjë e më tepër sektorët e tjera të ekonomisë. Nga ky sektor, llogaritet që humbjet e vendeve të punës të janë rreth 35%, kurse të shpallura të janë 30%.<sup>80</sup> Ndërkakq, më poshtë do të shohim shpërndarjen e punësimit sipas sektorëve për periudhën 2010-2013, e realizuar nga NVM-të në vendet e EU28

Grafiku 4. Shpërndarja e Punësimit Sipas Sektorëve në Vendet e EU28



Burimi: Third European Company Survey (ECS)\* Job Creation in SMEs: ERM Annual Report 2015, Eurofound, 2016,  
Corell University


<sup>80</sup> Job Creation in SMEs: ERM Annual Report 2015, Eurofound, 2016, Corell University, fq.28.

Nga grafiku shohim se kemi një përqindje dukshëm më të madhe të rritjes së punësimit në sektorë të shërbimit dhe më pak në sektorë të industrisë dhe atë të ndërtimit, nga ana tjetër rënien e punësimit e shohim pikërisht në këta sektorë. Gjersa rritja e punësimit në sektorin e ndërtimitarë ishte vetëm 11%, rënia e punësimit në këtë sektor për periudhën 2010-2013 ishte 30%. E njëjtë situatë është edhe tek industria, ku rritja e punësimit është përcjellë me 25%, rënia e punësimit gjatë periudhave të marra për ilustrim të kësaj dukurie, është 28%.

Ndërkaq, kur i shohim sektorët e tjera, marrim shembull atë të shërbimeve, përsëri të njëjtat rezultate të paraqitura edhe më lart nga artikuj apo raporte të tjera, se ky sektor angazhon numrin më të madh të fuqisë punëtore.

Grafiku i mësipërm ishte përvendet e EU28-ës, ndërsa më poshtë do të shohim në mënyrë të veçantë se si janë të shpërndara NVM-të sipas sektorit, rrjedhimisht edhe shpërndarjen e fuqisë punëtore.

Grafiku 5. Kontributi i NVM-ve në Punësim në Vendet e Ballkanit Perëndimor



Burimi: European Investment Bank: Assessment of financing needs of SMEs in the Western Balkans countries Synthesis Report August 2016, fq.8.

Siç shihet nga grafiku, krijimi i NVM-ve në Ballkanin Perëndimor më shumë është i koncentruar në sektorin e tregtisë dhe, sigurisht, edhe në atë të shërbimeve, meqë në raportin e fundit të Bankës Evropiane për Investime është shënuar vetëm si “të tjera”. NVM-të në sektorin e tregtisë mund të jenë shumë dinamike dhe të kontribuojnë mjaft në krijimin e vendeve të reja të punës, e kur dihet se vendet për të cilat po flasim tregtinë e bëjnë në masë të madhe me mallra të importuara, atëherë edhe vlera e shtuar do të jetë e vogël dhe po aq të qëndrueshme dhe efektive do të jenë vendet e reja të punës të krijuara nga NVM-të e këtyre sektorëve.

Nga ana tjetër, NVM-të në sektorët e rëndësishëm, konkretisht të prodhimit dhe bujqësisë, janë në numër shumë të vogël ose nuk ka fare. Përmendim këtu Kosovën, ku statistikat na tregojnë se NVM-të në sektorin e tregtisë marrin pjesë me më se 50%, në atë të shërbimeve me mbi 30%, me 0.08% në bujqësi, 13% në prodhim dhe me 7% në ndërtim.<sup>81</sup>

#### 3.4.4 Lokacioni

Një tjetër karakteristikë që NVM-të bën të jenë më pak ose më shumë të përshtatshme për ta shtuar numrin e vendeve të reja të punës. Sigurisht, aty ku popullata është më e madhe në numër, aty edhe pritet të ketë numër më të madh të NVM-ve e, rrjedhimisht, edhe angazhim të fuqisë më të madhe punëtore. Natyrshëm, qytetet janë vende më të populluara se fshatrat dhe, si rrjedhim, edhe numri më i madh i të të punësuarve është në rajone të tillë, për shkak të numrit më të madh të NVM-ve. Kryeqytet janë vende të populluara më shumë nga NVM-të, sidomos në vende të varfra si Kosova si kapitali intelektual, ashtu edhe ai financiar është i instaluar në këtë pjesë të vendit.

---

<sup>81</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës <http://ask.rks-gov.net/>

### 3.5 Faktorët që ndikojnë në rritjen NVM-ve

Pra, për të propozuar ndonjë model apo për ta parë më qartë rritjen e firmës, duhet kombinuar fotografinë që e sheh sipërmarrësi me potencialet e firmës me ato që janë jashtë firmës dhe jashtë kornizës që shëh ndërmarrësi. Firma është e kushtëzuar nga burimet e saj dhe mundësia e instalimit të këtyre burimeve në mundësitet që i jep ambienti, të cilat në rastet më të shpeshta janë ndryshe nga fotografia. Firmat e vogla kanë avantazhe dhe disavantazhe ndaj firmave të mëdha, por gjithnjë e më shumë, duke marrë në konsideratë faktin se kërkesat e konsumatorit janë duke u specifikuar tej mase, nuk ka më tregje të mëdha me aftësi monopoliste ndaj bizneseve të vogla, tashmë edhe bizneset e vogla janë konkurrente të bizneseve të mëdha, në saje të avantazheve të saj. Parimisht, të gjitha punimet rreth faktorëve ndikues në rritjen e firmave të vogla, pajtohen se janë këto dy grupe: të jashtme dhe të brendshme, pavarësisht se studiuesit e ndryshëm kanë përdorur qasje të ndryshme për t'i identifikuar faktorët.

Pra, për të propozuar ndonjë model apo për ta parë më qartë rritjen e firmës, duhet kombinuar fotografinë që e shëh sipërmarrësi me potencialet e firmës me ato që janë jashtë firmës dhe jashtë kornizës që shëh ndërmarrësi. Firma është e kushtëzuar nga burimet e saj dhe mundësia e instalimit të këtyre burimeve në mundësitet që i jep ambienti, të cilat në rastet më të shpeshta janë ndryshe nga fotografia. Firmat e vogla kanë avantazhe dhe disavantazhe ndaj firmave të mëdha, por gjithnjë e më shumë, duke marrë në konsideratë faktin se kërkesat e konsumatorit janë duke u specifikuar tej mase, nuk ka më tregje të mëdha me aftësi monopoliste ndaj bizneseve të vogla, tashmë edhe bizneset e vogla janë konkurrente të bizneseve të mëdha, në saje të avantazheve të saj. Parimisht, të gjitha punimet rreth faktorëve ndikues në rritjen e firmave të vogla, pajtohen se janë këto dy grupe: të jashtme dhe të brendshme, pavarësisht se studiuesit e ndryshëm kanë përdorur qasje të ndryshme për t'i identifikuar faktorët.

### 3.5.1 Faktorët e jashtëm

Këta faktorë e ushtrojnë ndikimin e tyre në veprimtarinë ndërmarrjeve të diktuar nga kushtet ekonomike dhe politikat zhvillimore të vendeve. Duke qenë kështu, firmat e vogla nuk kanë aftësi të kenë ndikim mbi efektin e këtyre ndikimeve, andaj kur ato janë negative, disa nga to edhe mund të zhduken, bie fjala, rritet norma e interesit, e cila do të ndikojë në krijimin e mungesës së mallrave e rrjedhimisht edhe rritjen e kërkesës për mallra, dhe do të përfundojë me rritje të çmimeve. Kjo situatë, potencialisht, bëhet e papërballueshme për firma të vogla dhe si të tilla janë të thirrura për të falimentuar. Këta faktorë i numërohen si më poshtë:

#### 3.5.1.1 Faktorët ligjor dhe rregullator

Në vendet e Ballkanit Perëndimor sidomos, të cilat merren me probleme dhe çështje politike, është krijuar një ambient shumë i papërshtatshëm për të bërë biznes. Një nga faktorët që e karakterizon ambientin jo të mirë për zhvillimin e firmave të vogla në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor është korruzioni. Ky faktor ka ndikim mjaft të madhe në keqorientimin e burimeve, ikjen e investitorëve të huaj dhe mosfunkcionimin e politikave mbështetëse për sektorin privat. Në kuadër të kësaj, përmendim ekonominë e zezë dhe atë të hirtë, si një nga shembujt më të këqij të performancës ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimor. Këto janë politika destruktive për zhvillimin e NVM-ve sepse stopojnë idetë e reja, inovacionet dhe zhvillimin e konkurrencës së lirë. Korruzioni dhe pengesat me tregtinë e lirë janë faktorë që i karakterizojnë vendet e Ballkanit Perëndimor dhe përbëjnë ndër pengesat më të mëdha të zhvillimit të NVM-ve.

**A. B. Bouazza; D. Ardouman; O Abada<sup>82</sup>** citojnë të njëjtit faktorë me ndikim negativ në rritjen e firmave të vogla, duke cituar kështu edhe **Brown**, i cili në kuadër të këtyre

---

<sup>82</sup> Asma Benzazoua Bouazza; Diabate Ardouman; Dr. Othman Abada, Establishing the Factors Affecting the Growth of Small and Medium-sized Enterprises in Algeria, American International Journal of Social Science Vol. 4, No. 2; April 2015

faktorëve ka potencuar konkurrencën si një nga pengesat e mëdha për rritje të firmave të vogla. Sistemi i dobët tatimor, mungesa e përkrahjes së firmës së vogël është një tjetër faktor i cituar në këtë artikull.<sup>83</sup>

Gjithsesi, një studim i bërë nga **International Financial Corporation (2013)**, i bërë me 45000 firma të reja, rezulton me pengesa të mëdha, duke filluar nga mungesa e investimeve, infrastrukturës, energjisë elektrike dhe prezenca e konkurrencës jolojale, pengesa këto që janë tipike për vendet e Ballkanit Perëndimor. Roli i qeverisë dhe, në mënyrë specifike, burokracia në aspektin ligjor dhe rregulator janë faktorë të tjerë që pengojnë rritjen e NVM-ve.<sup>84</sup>

### 3.5.1.2 Qasja në financa

Secila ndërmarrje për t'u rritur ka nevojë edhe për mbështetje. Një nga format, madje thelbësore, është financimi i aktiviteteve të saj, sidomos kur bëhet fjalë për zgjerimin. Në pothuajse të gjithë artikujt shkencorë dhe raportet e tjera statistikore të dala nga burime relevante, qasja në financa duket të jetë një nga pengesat shumë të rëndësishme në zhvillimin e firmave të vogla. Sigurisht, duke qenë firmë e vogël, kapacitetet e saj janë po aq të vogla për të gjeneruar mjete që i mbulojnë shpenzimet që rrjedhin nga burimet financimit. Sipas **Penrose-s**, ky është disavantazhi më i madh i firmave të vogla ndaj atyre të mëdha, për dy arsyen: për shkak të nivelit të lartë të interesit që ato duhet të paguajnë dhe të shumës së kapitalit që ato kanë mundësi të marrin.

Sipas Bankës Botërore<sup>85</sup>, NVM-të kanë pak gjasa të mbështeten në kredi dhe, kështu, ato gjejnë zgjidhje në forma të tjera më të lira, si kursimet dhe mbështetja nga miqtë. Po sipas këtij burimi, konsiderohet që hendeku finanziar është shumë i madh dhe, aq më tepër,

---

<sup>83</sup> Per Davidson, Continued Entrepreneurship and Small Firm Growth, 1989

<sup>84</sup> Business Environment and Enterprise Performance Survey-BEEPS V

Eurpoean Comission, Anual Report 2016

<sup>85</sup> <http://www.worldbank.org/en/topic/financialsector/brief/smss-finance>

kur kemi parasysh edhe NVM-të informale. Duke vazhduar tutje, rreth 70% e të gjitha ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme formale nuk kanë qasje në burime kreditore financiare, që e përkthyer në vlera monetare nënkuption që tregu formal i NVM-ve ka hendek prej 1.2 trillionë dollarëve amerikanë, ndërsa së bashku me tregun joformal të tyre, kjo shifër arrin në 2.6 trillionë dollarë amerikanë. Një studim i Grupit të Bankës Botërore<sup>86</sup> sugjeron se ekzistojnë 365-445 milionë NVM në tregjet në zhvillim: 25-30 milionë janë NVM formale; 55-70 milionë janë ndërmarrje formale mikro; dhe 285-345 milionë janë ndërmarrje joformale.

Vende të ndryshme përdorin forma të ndryshme të financimit privat, varësisht se me cilët e mendojnë zhvillimin e sektorit, këto forma konsistonë në kredi bankare, overdraft, faktoring, lising, kapital privat, kapital i jashtëm.<sup>87</sup> Gjermania karakterizohet nga përdorimi i financimeve përmes kreditit bankar më shumë se overdrafti, pastaj Japonia ka më shumë se 60% të të gjitha kredive dedikuar NVM-ve, ndërsa NVM-të e vendeve si Danimarka, Italia dhe Portugalia përdorin kredi të formës së këmbimit valutor.

Ballkani Perëndimor, pavarësisht se ka një sektor privat të NVM-ve jo shumë të zhvilluar, për sektorin bankar nuk mund ta themi një gjë të tillë, ngase, përkundrejt të gjithave, këtë sektor e karakterizon më shumë stabiliteti se kriza, pavarësisht se në periudhën 2008-2010 sektori bankare në këtë rajon është ballafaquar me numër të madh të kredive të këqija për shkak të krizës financiare të asaj kohe.<sup>88</sup> Ajo që e bën më të vështirë qasjen në këtë sektor nga ana e NVM-ve është norma e lartë e interesit, si dhe disa bariera përbizneset e vogla dhe të mesme, të cilat kanë nevojë përmjete më të mëdha se sa mikrondërmarrjet, por edhe nevojë më të vogël se bizneset e mëdha. Situata e pasigurt ekonomike bën që këto ndërmarrje të mos kenë planifikim afatgjatë dhe, si rrjedhojë, të

<sup>86</sup> Po aty,

<sup>87</sup> Mu. Mustafa, E. Kutllovci, B. Krasniqi, P. Gashi, Biznesi i Vogël dhe i mesëm, 2009

<sup>88</sup> Assessment of financing needs of SMEs in the Western Balkans countries Synthesis Report August 2016, fq.22.

mos i kenë planifikuar si duhet të hyrat dhe të dështojnë për të paguar borxhet. Nga ana tjetër, duke iu referuar raportit vjetor të Bankës Evropiane për Investim lidhur me NVM-të në Ballkanin Perëndimor, qasja në financa nuk është e vështirë për NVM-të, por nuk përshtaten kriteret për shkak se në këtë rajon është shumë i madh numri i mikrondërmarrjeve, të cilat edhe nuk mund t'i përbushin këto kërkesa bankare, si rrjedhojë kanë problem me qasjen.

Në Kosovë, sistemi bankar është mjaft stabil dhe ka nivel të lartë të likuiditetit të krijuar nga depozitat bankare.<sup>89</sup> Në saje të kësaj, ka pak stimuj për kreditimin e nevojave të NVM-ve. NVM-të në këtë rajon karakterizohen me probleme të regjistrimit kadastral për të verifikuar pronën e patundshme, identifikimi i llojit të patundshmërisë, sistemin e regjistrimit të kolateraleve dhe kredive dhe zbatueshmërinë e borxheve në raport me kolateralin.<sup>90</sup> Pastaj, problemi i qasjes në financa të këtyre ndërmarrjeve lidhet edhe me mungesën e informacioneve lidhur me kanalet dhe mënyrat e kreditimit, si dhe ngarkesat që lidhen me kreditë. Nga ana tjetër, edhe bankat ndihen të shtrënguara për të besuar në informacionet që janë në dispozicion dhe është e mundur të sigurohen për gjendjen financiare të NVM-ve, e kjo shpesh i bën pre të asimetrisë së informacioneve. Në këtë kontekst, firmat, të imponuara nga nevoja për burime financiare, krijojnë marrëdhënie afatgjata me bankat me qëllim që të reduktohen informacione të tillë.

Ky aspekt është studiuar nga **Ortiz-Morina** dhe **Penas (2004)**, për bizneset e SHBA-së, dhe **Hernandez-Canovas (2008)** për bizneset e BE-së. Këta hulumtues vërtetuan që, përpos faktorëve të tjera, sidomos marrëdhënia afatgjatë në mes të bankës dhe firmës së vogël,

---

<sup>89</sup> Task Forca për Integrim Evropian, "Tryeza Tematike Nr. 4 për Tregti, industri, dogana, tatime, treg të brendshëm, konkurrencë, mbrojtje të konsumatorit dhe atë shëndetësore", Material për diskutim për fushën e industrisë dhe NVM-ve, 01 Nëntor 2012, Prishtinë, fq.25

<sup>90</sup> Po aty,

ka bërë që të rriten shifrat e kredive për biznese, dhe kjo ka ndikuar që ndërmarrjet të zgjerohet dhe ta rrisin performancën.

Sigurisht, kreditë nuk janë i vetmi burim i financave, të cilat, në përgjithësi, paraqiten si problem në vendet me zhvillim të ultë ekonomik. Ka edhe burime nga institucionet shtetërore në formë të subvencioneve dhe atyre ndërkombëtare në formë të donacioneve dhe granteve, efektet e të cilave do t'i shqyrtojmë gjatë analizës për shtetet e Ballkanit Perëndimor në përgjithësi, dhe Kosovën në veçanti. Duke marrë parasysh numrin e madh të ndërmarrjeve në sektorin informal, sugjerohet që, nëse të njëjtat do të lëviznin dhe zhvendoseshin në sektorin formal, do të përmirësohej dukshëm qasja në financa dhe benefitet do të multiplikoheshin pasi që të njëjtat do të bëhen edhe tatimpaguese të rregullta për shtetin, do të shtonin numrin formal të punëtorëve dhe do të rrisnin shpenzimet formale për kursim, gjë që do të ndikojë në paraqitjen në reale të indikatorëve makroekonomikë.

### 3.5.1.3 Faktorët ekonomik

Çështja e stabilitetit ekonomik është mjaft domethënës për jetën e firmave sidomos të vogla. Madje, sipas autorëve të ndryshëm, njohës të ekonomisë, veprimtaria e NVM-ve është e varur nga gjendja e faktorëve që e përfaqësojnë sistemin ekonomik. Faktorë të tillë si papunësia, inflacioni, politikat e taksave, gjendja e tregjeve dhe qasja në to, politikat makroekonomike e zhvillimore të vendit, ambienti biznesor, norma e interesit, përkrahja publike, janë ndër faktorët më me peshë në performancën e NVM-ve

Secili vend ka politikat e tij lidhur me mbështetjen për NVM-të, por taksat janë ndër instrumentet më të përdorura për të përkrahur sektorin privat sidomos në vendet pazhvilluara. Në Afrikën e Jugut, shpenzimet lidhur me TVSH-në<sup>91</sup> dhe politikat tatimore

<sup>91</sup> Mark A.G. Darroch and T.A. Clover, The effects of entrepreneurial quality on the success of small, medium and micro agri-businesses in KwaZulu-Natal, South Africa, Volume 44, issue Issue 3, 23, 2005

janë ndër më të lartat në botë. Tatime të larta e reduktojnë fitimin e firmave dhe bëjnë që ato mos të jenë në gjendje për të konkurruar në treg.

### 3.5.2 Faktorët e brendshëm

NVM-të sfidohen sa i përket mundësisë së tyre për qasje në tregun e kapitalit dhe kufizimet e tjera financiare, prandaj vijnë në shprehje burimet e brendshme. Të tilla burime ose faktorë mund të konsiderohen aftësia sipërmarrëse, inovacioni, kreativiteti, organizimi i burimeve njerëzore, etj.

#### 3.5.2.1 Resurset njerëzore

Një tjetër faktor shumë i rëndësishëm dhe me ndikim në performanën e NVM-ve janë edhe burimet njerëzore. Shumë studime tregojnë se kapitali njerëzor ka lidhje pozitive me suksesin e biznesit.<sup>92</sup> Njerëzit e aftë dhe të motivuar jepin rezultate më të larta dhe, e kundërta, ata do ta çojnë në greminë ndërmarrjen. Kapitali njerëzor mund të përkufizohet si qëndrimet, angazhimet, vlerat, njohuritë, përvoja, arsimimi, shkathtësitë dhe aftësitë që ndihmojnë sipërmarrësin dhe ekipin e tij ta drejtojnë biznesit drejt rritjes dhe propseritetit, për t'i ndihmuar ata të kryejnë punë komplekse në mënyrë efikase.<sup>93</sup> Kujtojmë kur kemi thënë më lart se puna është më tepër se interpretim financiar i rezultatit të saj. Ajo shpreh reflektimin e brendshëm të njerëzve, që sinkronizohet me motivimin për të realizuar diçka në masë dhe vlerë të caktuar dhe kjo, detyrimisht, është e ndikuar nga rrethanat në të cilat ata e ushtrojnë këtë refleksion. Njerëzit në punë bartin

<sup>92</sup> Rauch, A. & Frese, M. (2000). Psychological approaches to entrepreneurial success: A general model and an overview of findings. In C.L.Cooper & I.T. Robertson (Eds), International Review of Industrial and Organizational Psychology, Vol. 15, 100-135


<sup>93</sup> Robert Baron, Gideon Markman, Beyond Social Capital: The Role of Entrepreneurs' Social Competence in Their Financial Success, Journal of Business Venturing 18(1):41-60, 2003

barrën e konvertimit të informatave në pasuri, andaj edhe themi se janë shumë të rëndësishme për jetën e ndërmarrjeve. Ndigimi i burimeve njerëzore është i njëjtë si në firmat e mëdha, ashtu edhe në ato të vogla, por mundësia e trajtimit të njëjtë, si në firmat e vogla ashtu edhe në ato të mëdha nuk është e njëjtë.

Fakte shumë interesante dalin nga një studim i bërë nga **Banka Qendrore Evropiane** së bashku me **EC DG Growth** në vitin 2014. Studimi kishte për qëllim të nxjerrë problemet kryesore me të cilat ballafaqohen NVM-të dhe studimi në fjalë paraqiti të dhëna për periudhën 2011-2014.

Të gjeturat treguan atë që citova më lartë se qasja në financa nuk duket të jetë numri një i problemit për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla. Më poshtë paraqesim grafikun ku shohim të dhëna që vërtetë të bëjnë të kuptosh ndigimin shumë të madh të NVM-ve në jetën e njerëzve.

Grafiku 6. Problemet më të Shprehura te të Cilat Ballafaqohen NVM-të - Krahasimi I  
Rezultateve të Fundit të Sondazhit SAFE



Burimi: European Commission, Annual Report on European SMEs 2014/2015, SMEs start hiring again. November 2015

Nga figura shohim një përgjigje mjaft interesante nga respondentët që janë NVM-të nga vendet e EU28-s, gjersa në vitin 2013 qasja në financa ishte vlerësuar nga respondentët me 16%, duke e ranguar kështu si faktorin e dytë barrierë në zhvillimin e tyre, në vitin 2014 ajo zbret për 3% më shumë, duke u renditur kështu më poshtë në pengesat për zhvillim.

Gjatë tekstit kam potencuar gjithnjë se kërkesat e konsumatorit janë duke u specifikuar tej mase dhe kjo po i vë në situatë shumë sfiduese ndërmarrjet në përpjekjet për t'i plotësuar ato. Andaj, pikërisht ky faktor ka dalë si pengesë kryesore, me të cilën përballen NVM-të në Evropë.

### 3.5.2.2 Aftësitë sipërmarrëse

Aftësia sipërmarrëse përbën një nga elementet më të rëndësishme të firmës sepse nga ajo varet edhe drejtimi i proceseve dhe orientimi i burimeve. Aftësimi sipërmarrës është një nga metodat më të nevojshme që NVM-të të jenë të suksesshme, sidomos për vende me ekonomi në tranzicion. Hapja e NVM-ve në këto vende karakterizohet me mbyllje të shpejta ngase vet modeli dhe mënyra e krijimit të ndërmarrjeve nuk ka bazë të fortë mbi të cilën të mbështetet apo të mbahet e gjallë. Kështu, njëra nga format më të mira për t'i ndihmuar këto ndërmarrje është që të investohet në rritjen e aftësive sipërmarrëse, në mënyrë që të krijohet një bazë e mirë, e cila garanton qëndrueshmëri së paku në ditët e para të biznesit. Duhet të shtojmë këtu se për fat kjo gjë është më lehtë për t'u realizuar për shkak se NVM-të, sot, janë më të përkushtuara të angazhojnë punëtorë të rinj dhe

mirë të aftësuar dhe karakterizohen me qasje proaktive, inovative dhe kreative se sa ndërmarrjet e vjetra.<sup>94</sup> Kjo është gjë e mirë dhe faktor që aftësimi të ketë efekt.

Aftësimi sipërmarrës nënkupton zhvillimin e njohurive mbi marrjen e riskut për të hapur një biznes, për të krijuar ide për biznes, për të qenë në gjendje të mendojnë për të ardhmen e biznesit, për të qenë në gjendje të gjejnë mjete për të financiar biznesit dhe t'i përdorin ato në mënyrë optimale etj., të cilat i kontribuojnë bërjes së një biznesi të mirë të suksesshëm.

Shtojmë këtu se këto aftësi mund të mësohen nga shkollat, institucione të larta akademike, nga kurse të ndryshme apo edhe nga eksperienca të ndryshme dhe gjatë gjithë jetës. Koncepti i edukimit të sipërmarrësisë (entrepreneurship education), vjen nga SHBA, i cili nuk nënkupton studimin e koncepteve të ekonomisë si bazë, por promovon idenë, kreativitetin, guximin dhe nevojën për të përfituar nga mundësitë në mënyrën më të mirë të mundshme.

### 3.5.2.3 Kreativiteti

Aftësitetë sipërmarrëse, kreativiteti dhe inovacioni janë faktorë vetëm të brendshme si burime fizike, por këto janë burime të paprekshme, të cilat mund të kenë vlerë dhe ndikim shumë të madh për ndërmarrjen, sidomos NVM-të, të cilat, për të mbijetuar kanë nevojë të diferencohen dhe të përqendrohen dhe lokalizohen mirë në treg.

Është bërë mjaft sfiduese gjendja e një vend në treg, që të jep siguri e komoditet, por, përsëris, në saje të këtyre faktorëve që burojnë nga mendja e njeriut, mund të sigurohen vende të tilla.

---

<sup>94</sup> Svend E. Hougaard Jensen, Tobias N. Rosmussen, Thomas F. Rutherford, Economic transition, Entrepreneurial capacity, and intergenerational distribution, October 2002

“Çfarë mund të bëjë për t’i për bërë gjërat mirë? ose çfarë mund të bëjë për të bërë gjëra të mira?”, kjo njihet si produkt i të menduarit.<sup>95</sup>

Vendet më të fuqishme në botë, si Amerika dhe Japonia, e më pas Franca e Britania e Madhe, janë të tilla ngase janë të parat në inovacione dhe kreativitete. Prandaj, është shumë e rëndësishme që vendet e tjera t’i marrin si shembull, së paku në hartimin e planbizneseve. Të gjitha këto vende, janë vatra të bizneseve të vogla, të cilat, në saje të inovacioneve e ideve kreative, u bënë gjeneratorë të zhvillimit të vendeve të tyre. Kompanitë japoneze janë ndër kompanitë me numrin më të madh të ideve për punëtorë në botë, ndër to shquhet **Toyota**, për të cilën janë shkruar edhe libra, si p.sh. “Katërdhjetë vjet dhe njëzet milionë ide”<sup>96</sup>

Kështu, **Threadless**, kompani e prodhimit të këmishëve me mëngë të shkurtra, përdori një ide mjaft interesante për të prodhuar këmisha, të cilat do të shiteshin. Në një rrjet, të cilin e frekuentonin qindra njerëz, ai postoi kërkesën për të dizajnuar këmisha ashtu si ata do të dëshironin që ato të dukeshin. Kështu, për çdo ditë, anëtarët e këtij rrjeti që e kishin bërë këtë postim, pranonin më shumë 100 ide. Pastaj, ata duhej të votonin për dizajnin më të mirë, i cili më pas do të shihet dritën e prodhimit.<sup>97</sup>

Një kompani e televizorëve në SHBA kishe përdorur një formë shumë interesante për të tërhequr njerëz kreativ. Agjencia e televizionit krijoj një reklamë misterioze, ku paraqitej një enigmë se si një automjet duhet ngarë për të gjetur rrugëdalje. Ngasja i s h t e me sekonda. E vërteta ishte se automjeti nuk kishte rrugëdalje, pos të binte në një pishinë. Për minutazhën më të shpejtë, agjencia e reklamës televizive kishte kontaktuar personin,

---

<sup>95</sup> Dr. Friday Okpara, “The value of creativity and innovation in entrepreneurship” University of Gondar , Etiopia, Volummi III, “Jurnal of Asia Enterpreneurship and sustainability” 2007

<sup>96</sup> Dr A. Blanton Godfrey Creativity,” Innovation and Quality” 2009

<sup>97</sup> Richard Draft, Organisational Theory, eight edition, 2008. Fq 412

duke e ftuar për nënshkrim të kontratës për punë në agjenci.<sup>98</sup> Kjo agjenci mori numrin më të madh të klikimeve në saje të kësaj reklame aq tërheqëse dhe atraktive. Ishte gjeniale ideja për të tërhequr njerëz kreativ, por më gjeniale ideja për të tërhequr konsumatorë, sepse kur automjeti zhytej në pishinë, paraqitej logoja e televizionit dhe informata për programet që ai ofronte.

Kompanitë nuk duhet të ushtrojnë presion në punëtorët që të jenë kreativë, ata duhet të krijojnë ambient të tillë që punëtorët ta shohin nevojën për kreacion ose ta ndjejnë se mund të bëjnë diçka të mirë. Sigurisht, jo të gjitha idetë mund të gjejnë zbatim, por kur njerëzit prodhojnë ide dhe këto ide i shpalosin për të tjerët, nga to mund të lindin ide të tjera, të cilat mund të sjellin ndryshime të mëdha.

Shumë kompani, si Procter&Gamble, W. L. Gore and Boeing, postuan në rrjetet e tyre nevojën për këshilla nga konsumatorët.<sup>99</sup> Po ashtu, **Cadillac** lëshoi 800 linja për konsumatorët dhe kërkoi nga ta ankesat lidhur me shërbimet e tyre, këto linja ishin falas. Për një muaj, **Cadillac-u** mori më shumë se 2400 thirrje, por 80% e tyre nuk ishin ankesa, por sugjerime për të përmirësuar modelet.<sup>100</sup> Prandaj, kur konsumatorët sugjerojnë, atëherë kjo është mënyra më e mirë për të prodhuar produkte të duhura. Kështu, konsumatorët u bënë burim i ideve kreative.

Të menduarit në mënyrë kreative është art i pasqyrimit të imagjinatës dhe arsyes. Njerëzit nuk i shohin gjërat njëjtë, prandaj interpretimin e tyre, natyrisht, i ndryshëm jep edhe zgjidhje të ndryshme. Kreacionet nuk janë ngjarje aksidentale të njerëzve, ato burojnë nga përvoja e tyre, nga motivi dhe nga dëshira për të parë diçka ndryshe dhe për t'u personifikuar me të. Kur themi Microsoft, ju bie ndërmend Bill Gates-i, apo me Apple

---

<sup>98</sup> Kros Oser, "Sharp Touts TV in Net Mystery Adver-Blog" Adversting Age, 2004, fq 54

<sup>99</sup> Ann Harrington, "Who's Afraid of a New Product?" Fortune (November 10, 2003), 189–192

<sup>100</sup> A. Blanton Godfrey Creativity," Innovation and Quality" 2009

kujtoni Steve Jobs-in, Isaac Newtoni ju ndërmend ligjin e shkencës së fizikës, penicilina ju lidh me Fleming-un, etj., kjo është listë pa fund.

### 3.5.2.4 Inovacioni

Për inovacionin, si nocion ekonomik dhe teknik, janë dhënë shumë definicione. Në vazhdim do t'i japim disa nga to:

Inovacion është të bërit e gjërave të reja ose të bërit e gjërave që pothuajse janë bërë nëpërmjet një rruge të re....Inovacion është një proces me anë të të cilët janë përhapur produkte dhe teknika të reja në sistemin ekonomik – **Schumpeter, 1947.**

- “ Inovacioni është komercionalizimi i parë i një ideje” **Fagerberg 2004.**
- Një inovacion është krijimi i një produkti të ri ose i një produkti shumë të përmirësuar, ose një proces, një metode e re marketingu, ose një metodë e re organizimi në praktikën e një biznesi, si dhe një plan pune i organizimit ose i marrëdhënieve me jashtë.
- Inovacioni është definuar si shfrytëzimi i suksesshëm i ideve apo kthimi ideve në produkte profitable, procese, shërbime apo praktika biznesi.

E kemi cekur se inovacioni luan rol qendoror në konkurrencën e kompanive dhe vendeve. Inovacioni kuptohet të jetë drejtuesi kryesor i produktivitetit. Inovacioni ndihmon bizneset të përmirësojnë mënyrën si produktet dhe shërbimet bëhen dhe dërgohen apo prezantojnë tërësisht të reja.<sup>101</sup> Përmes këtij procesi mundësohet që të krijohen avantazhe konkurruese në tregun e lirë.

Hulumtimet tregojnë se rreth 12% e qarkullimit të NVM-ve janë si pasojë e daljes së produkteve dhe shërbimeve të reja ose të përmirësuara dukshëm.<sup>102</sup> Të dhënrat tregojnë se kompanitë inovuese mbajnë një performancë më të lartë dhe rriten më shpejtë se ato

<sup>101</sup> Besnik Krasniqi, Inovacioni dhe tregu (ligjeratë), 2011

<sup>102</sup> Komisioni Evropian , 2007, fq5

joinovatore. Gjersa kreativiteti ishte krijimi i ideve, inovacioni cilësohet si zbulim i rrugëve për ta kthyer idenë në produkt apo shërbim. Britanikët janë njerëz shumë kreativ, por shumë shpesh dështojnë për shkak se nuk janë novatorë në gjetjen e mënyrave për t'i realizuar apo jetësuar idetë.<sup>103</sup> Nëse idetë nuk do të jetësohen, ato nuk do t'i duhen askujt sepse kur nuk gjejnë implementim, do të amortizohen. Implementimi apo vënia e ideve në praktikë shikohet nga tri aspekte: seleksionimi i idesë, zhvillimi i saj dhe komercializimi, sigurisht që këtu është e nevojshme edhe përfshirja e kreativitetit.<sup>104</sup> Moreno-ja dhe Casilias-i (2008) pohojnë se vetëm tendenca për inovacione nënkupton kërkesë për lëvizje të reja, prapa të cilave tyre qëndron rritja e biznesit. Të gjitha organizatat mund të jenë inovative. Duke u bërë një kompani inovative, do të jesh pjesë e tregut të cilit do t'i ofrosh produkte dhe shërbime të reja dhe, si i tillë, ai, tregu, do ta pranoj atë. Inovimi dhe zhvillimi i produkteve të reja është risk për organizatat, por ato duhet patjetër ta ndërmarrin këtë risk sepse produktet e reja janë një mënyrë për t'u adaptuar në treg dhe mënyrë e adaptimit të ndryshimeve që ndodhin në treg, në teknologji dhe në konkurrencë.<sup>105</sup>

Inovacioni është një proces që nuk mbaron kurrë, i bazuar mbi një burim të rinovueshëm, ndryshe i njohur si intelekti njerëzor. Me gjithë përpjekjet për ruajtjen e një mijedisi (ekonomik) të qëndrueshëm, në të ardhmen e afërt ka gjasa të realizohen shumë krijime të reja duke eliminuar të vjetrat. Kjo do të varet nga gjenerata e re e sipërmarrësve, të cilët duhet të jenë të aftë të sjellin inovacione që garantojnë rritje të standardeve të jetesës në shkallë globale dhe në të njëjtën kohë nuk cenojnë qëndrueshmërinë e mijedisit.

---

<sup>103</sup> Besnik Krasniqi, Inovacioni dhe tregu (ligjeratë), 2011

<sup>104</sup> Interview for the Innovation Exchange, 1999 (for a full interview, see <http://iexchange.london.edu>)

<sup>105</sup> Deborah Dougherty and Cynthia Hardy, "Sustained Product Innovation in Large, Mature Organizations: Overcoming Innovation-to-Organization Problems," *Academy of Management Journal* 39, no. 5 (1996), 1120–1153.

Evropa investon më pak se 2% GDP-së në kërkim dhe inovacion dhe njëherësh synon që në 2020 financimi në kërkim, zhvillim dhe inovacion të arrijë në 3% të GDP-së. Hulumtimet tregojnë se 12% e qarkullimit të NVM-ve të BE-së vjen nga produktet apo shërbimet e reja ose të përmirësuara dukshëm.<sup>106</sup> Të dhënrat tregojnë se kompanitë inovuese mbajnë performancë më të lartë dhe rriten më shpejtë se kompanitë jo inovatore. Duke marrë në konsideratë të dhënën se numri më i madh i kompanive në Kosovë janë të karakterit individual, atëherë institucionet financiare ndërkombëtare fokusimin e asistencave financiare e kanë të orientuar në zhvillimin e NVM-ve. Kujtoj se problemi i ndërmarrjeve në Kosovë nuk është vetëm mungesa e mjeteve, por problem shumë i madh duket të jetë mungesa e njohurive mbi nevojën e një trajtmi të veçantë të inovacionit dhe kreativitetit, pra problemi është se ato nuk kanë ide se çfarë biznesi të hapet. Një situatë të vështirë në këtë aspekt e krijojnë marrëdhëniet joefektive në mes të punëdhënësve dhe punëmarrësve e, duke ia shtuar edhe komunikimin joefektiv të ndërmarrjes me konsumatorin. E tëra kjo ka efekt negativ në zhvillimet ekonomike.

---

<sup>106</sup> Raporti i Komisionit Europian, 2007, fq.5.

**KAPITULLI IV- MJEDISI BIZNESOR DHE STRUKTURA E  
NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME NË KOSOVË**

#### **4.1 *Mjedisi biznesor në Kosovë***

Sektor privat luan rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit. Ndërmarrjet e reja janë burim i vendeve të punës, të cilat bëjnë të mundur që të jetësohen ide, të krijohen produktet që i kërkojnë konsumatorët, por edhe rrisin numrin e të të punësuarve, që janë objektivi kryesor makroekonomik.

Në vendet të cilat kanë probleme ekonomike dhe politike, si rasti i Kosovës, realizimi i këtij objektivi është sfidë e vërtetë, pasi që ekziston dinamizëm shumë i ultë i zhvillimit e posaçërisht ekonomik, dhe kjo ndikon direkt në mundësinë e shtetit të krijojë kushte që sektori privat, sidomos ndërmarrjet e reja, të funksionojnë, pikësëpari për shkak të kushteve fiskale e rregullative, megjithëse viteve të fundit flasim më tepër për lehtësime në drejtim të bizneseve të reja se sa për vështirësi.

Ekonomia private në Kosovë filloi të zhvillohet në pjesën e dytë të viteve të '90 të shekullit 20. Pas një zhvillimi të hovshëm ndërmjet viteve 1985-1990, fillon të bjerë shkalla e zhvillimit të biznesit privat, kryesisht për shkak të instalimit të pushtetit represiv serb në Kosovë në vitin 1989/1990. Kjo rënie vazhdon edhe në periudhën 1991-1995. Një rënie e tillë kulmon me kolapsin e plotë të ekonomisë private në Kosovë në periudhën 1996-1998, kur shumica e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme falimentojnë dhe shuhën, kurse themelimi ndërmarrjeve të reja gati bie në zero.<sup>107</sup>

Zhvillimin e ndërmarrjeve të kësaj periudhe e karakterizonte:

- Dominimi i ndërmarrjeve tregtare në strukturën e përgjithshme (mbi 65 %),

---

<sup>107</sup> Anketa e realizuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme, 2006

- Mungesa e një tradite dhe kulture të biznesit në menaxhimin e kapitalit privat,
- Mungesa e përkrahjes institucionale në financimin e zhvillimit të ndërmarrjeve private,
- Strukturat e pazhvilluara menaxheriale, mungesa e partneritetit bashkëkohor (dominim i lidhjeve familjare gjatë formimit të ndërmarrjeve të reja, mungesa e edukimit për biznes),
- Mungesa e planeve strategjike, e planeve të biznesit dhe e vizionit,
- Shkallë e lartë e riskut politik dhe jokomercial në të ushtruarit e aktivitetit ekonomik (operacionet e prodhimit, investimet, kontratat mbi bashkëpunimin me botën e jashtme). <sup>108</sup>

Pas luftës është evidentuar zhvillim masiv i ndërmarrjeve private, ndërkokë që dhe shumica e ndërmarrjeve shoqërore u privatizuan dhe u krijuar një atmosferë e volitshme për biznese private. Sipas raportit të institutit “Riinvest”, <sup>109</sup> gjatë kësaj periudhe ishin të regjistruala 29564 entitete të biznesit.

Vlerësohet se nga këto entitete të regjistruala, 14656 janë ndërmarrje, nga të cilat 14177 private, 285 ndërmarrje shoqërore, 98 ndërmarrje shtetërore, 24 kompani publike dhe 14908 ndërmarrës individualë. Prej vitit 2007 kah ai 2008, situata fillon e vështirësitet për shkak të mbushjes së tregut dhe tregut të zi. Pavarësisht ndërrimit të sistemeve

---

<sup>108</sup> FINANCIMI I ZHVILLIMIT TE NVM-ve (Draft i raportit hulumtues) Përgatitur nga Instituti për Hulumtime Zhvillimore Riinvest në kuadër të projektit “Promovimi i zhvillimit ekonomik nëpërmjet shoqërisë civile”, në bashkëpunim me Qendrën për Ndërmarrjet Ndërkombëtare Private (CIPE) nga Uashingtoni dhe i mbështetur nga USAID-i, Prishtinë, Shtator, 2001, fq.12

<sup>109</sup> FINANCIMI I ZHVILLIMIT TE NVM-ve (Draft i raportit hulumtues) Përgatitur nga Instituti për Hulumtime Zhvillimore Riinvest në kuadër të projektit “Promovimi i zhvillimit ekonomik nëpërmjet shoqërisë civile”, në bashkëpunim me Qendrën për Ndërmarrjet Ndërkombëtare Private (CIPE) nga Uashingtoni dhe i mbështetur nga USAID-i, Prishtinë, Shtator, 2001, fq.12

politike, shifrat e papunësisë nuk lëvizin në masë të ndjeshme, madje situata nga viti në vit vetëm vështirësohet.

Reforma e politikave ekonomike dhe ndërtimi i institucioneve ndihmuani në përshtatjen e domosdoshme drejt ekonomisë së tregut. Donatorët ndërkombe tarë luajtën rol pozitiv, duke mobilizuar me sukses dhe duke shpenzuar gjithsej 1.96 miliardë euro për Kosovën ndërmjet viteve 1999 e 2003.<sup>110</sup>

Pastaj, ishin reformat qeveritare që rritën për 102% shpenzimet për investime publike dhe bënë që ekonomia të ketë rritje për periudhën 2009-2010. Në këtë periudhë ndodhi edhe kriza globale, por, për shkak se ekonomia kosovare është më pak e përhapur në botë, nuk kishte shumë bartje të pasojave sikurse kishte vendet e rajonit. Gjithsesi, nuk është se kjo krizë nuk është ndjerë në vitet në vijim. Pavarësisht kësaj, ndërmarrjet vuanin nga të tjera elemente edhe pas luftës që i bënën të jenë ato joproektive dhe, krahas një zhvillimi të dobët ekonomik, sollën papunësi deri në 42%<sup>111</sup> sa ishte në vitin 2010.

Sipas hulumtimeve të bëra në atë kohë, këto ndërmarrje vuanin nga faktorë si:

- Qasja në financa (kreditimet, kamatat, afatet kohore);
- Situata e përgjithshme ekonomike;
- Energjia elektrike;
- Konkurenca jo-lojale (mes ndërmarrjeve vendore);
- Rrethanat e jashtme tregtare, etj.<sup>112</sup>

---

<sup>110</sup> Banka Botërore, Memorandum ekonomik i Kosovës, Njësia për uljen e varfërisë dhe menaxhimin ekonomik,

Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore, raport nr.: 28023 KOS, 2004

<sup>111</sup> Banka Botërore

<sup>112</sup> STRATEGJIA PËR ZHVILLIMIN E SEKTORIT PRIVAT 2013- 2017 Mars 2013. Fq.10

Këto janë probleme me të cilat ballafaqohen gjithnjë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Kosovë dhe të njëjtat i shtyjnë ato që të veprojnë në forma joligjore duke treguar në tregje joformale. Kështu, nga po ky raport,<sup>113</sup> tregohet se nga 100.000 biznese të regjistrues në Kosovë, vetëm 18,000 deklarojnë të hyra në Administratën Tatimore të Kosovës (këto statistika janë të periudhës kur është bërë hulumtimi nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë).

Sa i përket NVM-ve në vendet e Evropës Juglindore, ato kanë kaluar nëpër krizën ekonomike ngashëm sikur vendet e eurozonës, e kjo si rezultat i nivelit të lartë të integrimit ekonomik të këtij rajoni me shtetet e Eurozonës. Gjatë viteve të krizës (me përjashtim të Shqipërisë, e cila ka shënuar rritje ekonomike prej 3.3% dhe Kosova prej 4.0%) ekonomitë e të gjitha vendeve të Evropës Juglindore kanë pasur rënie nga rritja më e lartë prej -5.8% (Kroacia) në atë më të ulët prej -0.8% në Maqedoni. Edhe viti 2010 nuk ka rezultuar me rritje pozitive në vendet e rajonit, ku Kroacia, Rumania dhe Mali i zi kanë vazhduar me rritje negative të BPV-së.<sup>114</sup>

Por, prapëserapë, Kosova gjendet në vendet e para sa i përket pasigurisë ekonomike dhe gjendjes së rëndë të punësimit. Bizneset në Kosovë nuk kanë mundësi të konkurrojnë në tregjet ndërkombëtare dhe kjo po bën që të kemi bilanc negativ të pagesave. NVM-të e paafta për të dalë jashtë me produkte, pra për të eksportuar e dëmtojnë dhe pengojnë rritjen e BPV-së.

Shumica e NVM-ve në Kosovë, madje rrëth 50%<sup>115</sup> e tyre konkurrojnë në tregje të veprimtarive tregtare dhe shërbimeve, të cilat tregje janë të karakterizuara me investime fare të vogla dhe joproductive. Shërbimet e ndërtimit dhe pasuritë e paluajtshme përbëjnë masën më të madhe të tregut të shërbimeve, pasur nga shtija me pakicë.

---

<sup>113</sup> Po aty.

<sup>114</sup> European Commission “Candidate and pre – accession countries’ economic quarterly”, 2010

<sup>115</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, Platforma askdata, Statistikat Strukturore të Biznesit, 2017

Përkundër rritjes ekonomike, këta sektorë nuk kanë arritur të krijojnë vende të reja të punës cilësore dhe të qëndrueshme. Pastaj, këto lloj tregje më së shumti karakterizohen me punësim joformal, duke e rënduar tutje efektin e këtyre tregjeve në krijimin e vendeve të reja të punës. Një element mjaft i rëndësishëm në jetën e bizneseve luan edhe faktori njeri, i cili e udhëheq biznesin. Edhe këtu Kosova nuk gjendet mirë, sepse në reportin e Bankës Botërore “Të të bërit biznes” nga 138 vende, ajo radhitet e 119-ta, dhe kjo është një nga kërkasat e Implementimit të strategjisë së NVM-ve 2016.<sup>116</sup> Në këtë radhitje, Shqipëria qëndron më mirë, konkretisht radhitet e 82-ta, pas Maqedonisë dhe Malit të Zi, duke lënë pas Serbinë, Bosnjën dhe Kosovën. Pra, Kosova është e fundit sa u përket vendeve të rajonit në këtë rangim.<sup>117</sup>

Një tjetër fushë ku NVM-të në Kosovë hasin në probleme dhe nuk mund ta ushqejnë tregun me vende të reja pune dhe stabile janë barrierat legislative (shih Kapitulli II - Faktorët rregullativ). Legjislacioni deri para pak vitesh ka qenë barrë e rëndë për bizneset e reja, por që gjithnjë e më tepër është duke u ndryshuar në favor të bizneseve, sepse në Reportin e strategjisë për zhvillimin e NVM-ve 2012-2016 me vizion 2020 aspekti ligjor i përshtatshëm është ndër objektivat e shumta të saj dhe pritet që të jetë më miqësor me bizneset. Që nga viti 2008 janë shënuar të arritura kyçë, të cilat kanë rezultuar në përmirësim të mjedisit të biznesit për NVM-të në Kosovë. Që nga koha kur Kosova e shpalli pavarësinë në shkurt të vitit 2008, është bërë reformë e madhe tatimore dhe është bërë riorganizimi i arkëtimit të TVSH-së përmes arkave fiskale, përkundër kundërshtimit të disa shoqatave të biznesit. Këta ishin tre hapat kryesorë në tentimet për uljen e shkallës së informalitetit në sektorin e NVM-ve dhe për të provuar përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet komunitetit të biznesit dhe shtetit. Në këtë vit, është aprovuar edhe pakaja më

<sup>116</sup> Strategjia e Zhvillimit të NVM-ve në Kosovë 2012-2016 me vizion në 2020, fq 15.

<sup>117</sup> Po aty, fq.16

e re fiskale, e cila konsiderohet se do të arrijë të krijojë stabilitet ekonomik, duke e ndryshuar shkallën e tatimeve përmallrat dhe shërbimet luksoze prej atyre të nevojshme.

Në këto forma është duke u munduar që të arrihet një treg më konkurruesh dhe të krijojen mundësi që bizneset e reja të kenë jetë më të gjatë në treg dhe të gjenerojnë vende të qëndrueshme pune.

#### **4.1.1 Struktura e bizneseve në Kosovë**

Niveli i dobët i zhvillimit të NVM-ve në Kosovë dhe mungesa e konkurrencës në nivel ndërkombëtar, rezulton me problemin e mosbilancit të pagesave ku importet dominojnë dukshëm eksportet, kryesisht nga metalet dhe mineralet bazë të produara nga kompanitë e mëdha. I famshmi privatizim nuk arriti të krijojë rezultate të dëshiruara, me gjithë pritet e mëdha përmëtë proces. Me fondin e mirëbesimit, i cili mbahet i bllokuar, është varfëruar jashtëzakonisht shumë tregu financiar dhe janë stopuar shumë investimet e mundshme.

Një tjetër sfidë për institucionet kosovare mbetet shkalla e lartë e ekonomisë informale, e cila po tërheq nga qarkullimi një pjesë të madhe të fondeve të mundshme për investime të shëndosha, profitabile dhe utilitare.

Sipas raportit për Programin e Qeverisë për parandalimin e ekonomisë joformale në Kosovë për 2010-2012, masa e përllogaritur e ekonomisë joformale sillet nga 39% deri 45% të BPV-së.<sup>118</sup> Një “kontribut” shumë të madh përrritjen e këtij fenomeni po i jep edhe funksionimi i dobët i sistemit gjyqësor, i cili flet përmjësinë ndërtuar një sistem funksional gjyqësor si faktor në funksionimin e shtetit demokratik.

---

<sup>118</sup> Strategjia e Zhvillimit të NVM-ve 2012-2016, Qeveria e Kosovës, [www.mti-ks.org](http://www.mti-ks.org)

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë<sup>119</sup> është ajo e cila merret me krijimin e kushteve stimuluese për nxitjen e zhvillimit të sektorit privat, në veçanti për zhvillimin e bizneseve të vogla dhe të mesme.

#### **4.1.2 Klasifikimi i NVM-ve në Kosovë**

Në Kosovë, me miratimin e Ligjit Nr. 03/L-031, që ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 02/ L-5 për mbështetjen e NVM-ve, ka ndryshuar edhe klasifikimi i ndërmarrjeve sipas numrit të punëtorëve.<sup>120</sup>

Tabela 6. *Klasifikimi i NVM-ve në Kosovë*

<b>Klasifikimi i Ndërmarrjeve</b>	<b>Numri i punëtorëve</b>
Mikrondërmarrje	1 deri 9 punëtor
Ndërmarrje e Vogël	10 deri 49 punëtor
Ndërmarrje e Mesme	50 deri 249 punëtor
Ndërmarrje e Madhe	Mbi 250 punëtor

Burimi: ABRK& Ligji Nr. 02/L-123 Për Shoqëritë Tregtare

Format ligjore të bizneseve në Kosovë është e radhitura si më poshtë sipas Rregullores 2001/16 dhe Ligjet nr.02/ L123 , mbi Shoqëritë Aksionare:

- Firma individuale,
- Ortakëri e përgjithshme,
- Ortakëri e kufizuar,
- Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar,
- Shoqëri aksionare,
- Kompani e huaj,
- Ndërmarrje shoqërore,
- Ndërmarrje publike,
- Kooperativa bujqësore,


<sup>119</sup>Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Republika e Kosovë <https://mti.rks-gov.net/page.aspx?id=1,78>

<sup>120</sup> Për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme-, [www.assembly-kosova.org](http://www.assembly-kosova.org)

- Ndërmarrje nën juridikcionin e AKP (Agjencisë Kosovare të Privatizimit).<sup>121</sup>

Numri më i madh i bizneseve në Kosovë është ai i biznesit individual, por që në vitin 2016 dhe tutje vërehet koncentrim dhe interesim i shtuar për shoqërítë me përgjegjësi të kufizuar, sigurisht për shkak të ndarjes së përgjegjësive. Është duke u ndjerë një rritje e cilësisë së vlerave të ndërmarrësise, ngase ndarja e përgjegjësise dhe puna specifike janë karakteristika të mira të një ndërmarrësi të suksesshëm. Kjo fymë e funksionimit të bizneseve po ndihet gjithnjë e më tepër! Më poshtë shohim përqindjet e regjistrimeve dhe të çregjistrimeve të këtyre formave të biznesit për vitin 2017

Grafiku 7. Përqindja e Regjistrimeve/ Çregjistrimeve të Shoqërive Tregtare në Kosovë.



Burimi: Agjencia Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve, Raporti i indikatorëve bazë të performancës për regjistrimin e bizneseve në Kosovë për vitin 2017. Kalkulime nga autorë.

Rritja e numrit të bizneseve në formë të SHPK-ve vjen si rezultat i thjeshtimit të procedurave për regjistrim, por edhe ngritjes së vetëdijes së qytetarëve për bërje të biznesit, pra ajo e menaxhimit të rrezikut të humbjes. Me rritjen e numrit të SHPK-ve është rritur edhe pjesëmarrja e femrës si bashkëudhëheqëse. Kjo është një tjetër rrymë prej një ndërmarrësie të suksesshme.

<sup>121</sup> Raporti Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike në Kosovë TM4-2014, fq 9.

Ndërmarrjet private janë të shtrira në tri veprimtari: tregtare, prodhuese dhe shërbyese. Duke marrë parasysh faktin se kemi një BPV mjaft të ultë, i bie që sektori i industrisë prodhuese është shumë pak efektiv apo i ngadalshëm, ngase ky sektori bart përgjegjësinë më të madhe për të krijuar vlera të reja nga njëra anë, e vendeve të punës nga ana tjetër. Shtetet që nuk prodhojnë janë të thirrura të dështojnë ngase nuk ka eksport, gjersa import nënkuption hyrjen e mallrave të huaja në vend dhe daljen e parave vendore nga vendi për në vendin e origjinës. Andaj, edhe tregu në Kosovë është më shumë i koncentruar nga firmat tregtare dhe kjo nënkuption që vetëm kemi lëvizje të parave të njëjta, pra nuk kemi multiplikim të parasë.

Nëse e marrim në përgjithësi, numri më i madh i ndërmarrjeve në Kosovë janë private dhe ky numër është shtuar pas vitit 2000, konkretisht rreth 86% e ndërmarrjeve janë me pronësi private, 10% biznese familjare, 2% ndërmarrje të sektorit privat/publik dhe 1% degë e ndonjë sipërmarrjeje/kompanie të huaj.<sup>122</sup> Po ashtu, shumica e ndërmarrjeve janë në pronësi individuale dhe më pak format e tjera të biznesit.

Ditët mesatare të krijimit të shoqërive tregtare, me përsosjen e teknologjisë, sa vijnë e zvogëlohen, konkretisht për regjistrimin e një shoqërie tregtare ditët maksimale janë 2.40, ndërsa minimale 1.65 ditë.<sup>123</sup>

Këto biznese karakterizohen me vështirësi të mëdha në veprimtarinë e tyre, këtu përmendim mungesa e përvojës menaxhuese, mungesa e mjeteve financiare dhe e mundësisë në qasjen për mjete kredituese. Siç dihet, nga këndvështrimi ndërkombëtar ambienti biznesor në Kosovë karakterizohet si i pasigurt dhe me pengesa të mëdha sa i përket mundësisë së zhvillimit të bizneseve. Këto pengesa kanë bërë që investorët e huaj të ngurrojnë ta investojnë kapitalin e tyre në një vend me probleme ekonomike, politike, mungesë të energjisë elektrike, etj.

<sup>122</sup> Hulumtimi i Nevojave të Tregut të Punës 2013- Agjencia Kosovare e Biznesit, fq 15

<sup>123</sup> Raporti i Indikatorëve Bazë të Performancës për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë për Vitin 2017, fq.5

#### 4.1.3 Karakteristikat NVM-ve në Kosovë

Ndërmarrjet e vogla në Kosovë, siç e cekëm më lart, janë në masën më të madhe në formë të biznesit individual dhe se masa më e madhe e tyre udhëhiqen nga gjinia mashkulllore. Me zhvillimin e teknologjisë, gjithnjë e më tepër janë duke u bërë inovacione të ndryshme, të cilat po ndihmojnë që struktura gjinore e udhëheqjes si firmave apo pronarëve të tyre të zbutet, duke rritur kështu më shumë pjesëmarrjen e gjinisë femërore në pronësinë e firmës. Në Kosovë, kjo çështje më tepër ka mbetur e tillë për shkak të mospjesëmarrjes së femrës në ambiente shkolllore dhe pavarësisë financiare, dhe, si e tillë, më tepër ka qenë e përkushtuar për mbajtje të familjes. Fatmirësisht, kjo çështje në saje të trajnimeve, seminareve, projekteve për barazi gjinore, aktiviteteve ndërkulturore, si dhe angazhimit të institucioneve vendore, gjithnjë është duke marrë trajtimin e duhur dhe, fatmirësisht, më tepër i takon të kaluarës.

Aty ku ka biznese të përfaqësuara nga femrat si të vepunësuara, janë biznese familjare, por gjithnjë e më tepër janë duke u shtuar rastet kur ato janë duke hyrë në bashkëpronësi në formë të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar. Sipas Agjencisë së Regjistrimit të Biznesit në Kosovë, përqindja e femrës si pronare biznesi sillet gjithnjë 25-28%.<sup>124</sup> Ndërsa sa i përket përfaqësimit të saj si ortak apo bashkë aksionarë, përqindja është edhe pak më e ultë, konkretisht 15-18% por me tendencë të rritjes, ndërsa pjesa tjetër është e mbuluar nga gjinia mashkulllore.<sup>125</sup>

Numri i ndërmarrjeve të sektorit privat, sipas Entit të Statistikave të Kosovës varion nga viti në vit dhe, në bazë të këtyre statistikave, nga viti 2000 e tutje, numri i ndërmarrjeve aktive vjen e rritet deri në vitin 2013. Nga ky vit e tutje, numri i ndërmarrjeve aktive vjen


---

<sup>124</sup> Raporti i Indikatorëve Bazë të Performancës për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë për Vitin 2017,

<sup>125</sup> Po aty,

duke rënë vazhdimisht. Më poshtë, do të shohim një tabelë, e cila tregon trendin e ndërmarrjeve aktive në Kosovë nga viti 2008 deri më 2013.

Grafiku 8. Numri i Ndërmarrjeve Aktive në Kosovë për Periudhat 2008-2016



Burimi: Agjencioni i Statistikave të Kosovës (platforma <http://askdata.rks-gov.net>)

Nga grafiku shihet rritje e ngadaltë që nga viti 2008 e gjer më 2012, por më pas kemi rënë të dukshme të numrit të ndërmarrjeve aktive. Duhet dalluar mirë numrin e ndërmarrjeve të regjistruesha dhe atyre aktive, pasi që është karakteristikë e vendeve të pazhvilluara dhe në tranzicion që të kenë numër të madh të ndërmarrjeve të hapura dhe joaktive. Pikërisht në periudhën 2012-2013, niveli i kredive për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme bie në mënyrë të vrullshme. Konkretisht, gjatë vitit 2012 janë lëshuar kredi në emër të NVM-ve në vlerë prej rreth 42 milionë eurove, ndërsa në vitin 2013, shuma e kredive e dedikuar për NVM-të ishte rreth 24 milionë euro.<sup>126</sup>

Numri më i madh i ndërmarrjeve të reja dhe koncentrimi i energjisë është në sektorin e tregtisë, e cila dominon edhe sa i përket qarkullimit. Sipas të dhënave të ASK-së, më

<sup>126</sup> Banka Qendrore e Kosovës (Kreditë, seritë kohore)

shumë se 50% e qarkullimit të përgjithshëm nga ndërmarrjet e reja vijnë prej sektorit të tregtisë, një pjesë prej 11-12% prej sektorit të prodhimit dhe pjesën tjeter e ndajnë të gjithë sektorët e tjerë. Në të njëjtën mënyrë, edhe fuqia punëtore është e koncentruar në këtë sektor, ashtu si edhe shpenzimet janë regjistruar si më të lartat në këtë sektor.<sup>127</sup> Sektori privat në Kosovë karakterizohet me 81% të ndërmarrjeve që udhëhiqen nga pronari, ndërsa një pjesë prej 11% udhëhiqen nga menaxheri. Për shkak karakteristikave që i përshkruajnë NVM-të në Kosovë, themelimi i tyre nuk ka ndonjë rregull të caktuar. Përqindja më e madhe e tyre nuk kanë organizma brenda ndërmarrjes, si p. sh. bordet, përjashtim bëjnë bizneset e mëdha ku organizimin e kanë në formë të shoqërive aksionare.

Sipas këtij raporti, gjatë tremujorit të katërt të vitit 2014 (TM4 - 2014) gjithsej janë regjistruar 2175 ndërmarrje, ndërsa në tremujorin paraprak (TM3 - 2014) kanë qenë 1919 sosh, ku vërehet rritje mes tremujorëve të të njëjit vit për 256 ndërmarrje, e që, shprehur në përqindje, kemi për 13.3% më shumë ndërmarrje të reja në këtë tremujor.

Rritje prej 20.5% e bizneseve të reja vërehet krahasuar edhe me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak (TM4 - 2013).<sup>128</sup> Aktivitetet ekonomike më të preferuara gjatë këtij tremujori ishin: tregtia me 648 ndërmarrje të reja (29.8%), akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim me 222 (10.2%), prodhim me 216 (9.9%), bujqësi, pylltari dhe peshkatari me 168 (7.7%), ndërtimtaria me 166 (7.6%), aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike me 148 (6.8%), transport dhe ruajtje me 143 (6.5%), aktivitete të shërbimeve tjera me 120 (5.5%), informacion dhe komunikim me 80 ndërmarrje (3.7%), ndërsa aktivitetet e tjera marrin pjesë në shkallë shumë të vogël. Kategoria e numrit të të punësuarve nga 1-4 (të punësuar) përbën rreth 2118 ndërmarrje apo 97.4% të

---

<sup>127</sup> Enti i Statistikave të Kosovës, platforma <http://askdata.rks-gov.net>

<sup>128</sup> Raporti Statistikore mbi Ndërmarrjet në Kosovë TM4- 2014 fq.6

ndërmarrjeve të reja, kategoria me 5-9 me 35 (1.6%), 10-19 me 17 (0.8%), 20-49 me 4 ndërmarrje (0.2%), tek kategoria me 250+, kemi vetëm një ndërmarrje, ndërsa në kategoritë e tjera nuk është asnjë ndërmarrje e regjistruar në këtë tremujor.<sup>129</sup>

Nëse citojmë edhe të tjera seri kohore, potencojmë se në asnjë tremujor nuk ka pasur rritje të NVM-ve që kalon shifrën 3000 sosh, kjo nënkupton që diferencat janë tre shifrore që, marrë në kontekst të përgjithshëm, nuk duken ndryshime të mëdha, por në kontekstin mikro, analiza e këtyre fenomeneve, pra rritjes dhe zbritjes së numrit të ndërmarrjeve, nga një tremujor në tjetrin është shumë interesante dhe domethënëse. Dy tremujorët e parë të vitit 2016 kanë qenë shumë të suksesshëm, konkretisht kanë kontribuar me 2957 dhe 2817 ndërmarrje të reja dhe, po në atë kohë, numri i vendeve të reja të punës ka qenë më i larti në krahasim me periudhat paraprake konkretisht, në tremujorin e parë 2016 janë regjistruar 4682 vende pune, ndërkaq në tremujorin e dytë të po këtij viti, janë regjistruar 4657 vende të reja pune. <sup>130</sup>

Sa i përket shtrirjes gjeografike të ndërmarrjeve të reja në nivel të komunave ashtu si në çdo tremujorë mbizotëron Prishtina me 564 ndërmarrje të reja (shprehur në përqindje 25.9%), Prizreni me 181 (8.3%), Ferizaj me nga 152 (7.0%), Peja me 133 (6.1%), Gjilani me 124 (5.7%), Fushë Kosova me 87 (4.0%), Mitrovica dhe Gjakova të dyja me nga 79 (3.6%), ndërsa komunat tjera kanë numër më të vogël të ndërmarrjeve të regjistruara gjatë këtij tremujori.<sup>131</sup>

Tutje, kemi një tabelë në të cilën kemi paraqitur trendin e rritjes së lindjes së bizneseve të reja, parë sipas tremujorëve, për periudhën 2006-2016.


---

<sup>129</sup> Po aty,

<sup>130</sup> Po aty, fq.7

<sup>131</sup> Po aty, fq.7

Grafiku 9. *Trendi i Regjistrimit të Ndërmarrjeve të Reja në Kosovë për Periudhën 2006-2016*



Burimi i të dhënave për numrin e ndërmarrjeve: Enti i statistikave të Kosovës, platforma [askdata.rks-gov.net](http://askdata.rks-gov.net). Paraqitura e trendit nga kalkulimet e autorit.

Sipas grafikut, kemi lëvizje poshtë lart në intervale shumë të shpeshta dhe vërehet rënie, sidomos në tremujorin e fundit të vitit 2013, periudhë e cila njihet si shumë e varfër sa i përket zhvillimit ekonomik. Nga ana tjetër, duke marrë parasysh faktin se NVM-të karakterizohen me fillim të lehtë, themelimi i tyre është më i shpejtë. Por, nga ana tjetër, ato karakterizohen edhe me vështirësi që në periudhën e lindjes së tyre, janë të dobëta kundrejt kushteve të pafavorshme për biznes, nuk mund të mbijetojnë.

Duhet theksuar se është karakteristikë e NVM-ve në Kosovë të ndërrojnë statusin e tyre shumë shpesh, në mënyrë që të përshtaten më mirë me kërkuesat ligjore sa i përket pagesës së tatimit. Kështu, janë raste të shumta kur ndërmarrjet kalojnë nga biznese individuale në **shoqëri me përgjegjësi të kufizuar<sup>132</sup>** dhe në këtë rast nuk mund të themi

---

<sup>132</sup> **Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.** Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar janë ato organizata të themeluara nga një apo më shumë themelues, që janë përgjegjës vetëm deri në nivelin e kontributeve të tyre dhe të gjithë pasurisë. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar ka një emër në të cilin mund të përfshihet emri i një apo më shumë partnerëve, duke vënë përpara ose menjëherë pas tij akronimin "SH.P.K.". ARBK mund të regjistrojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar pa pasur nevojë për të siguruar dëshmi për pagesën e kapitalit. (Ligi N02/L-123. për Shoqërit Tregtare)

as se kemi pasur shuarje po as lindje të biznesit. Administrata Tatimore e Kosovës nuk ka si e trajton këtë proces për publikun, përvèç se me komunikata dhe sqarime.<sup>133</sup> Sipas të dhënave nga Enti i Statistikave të Kosovës, mesatarisht çdo vit lindin nga 7000 ndërmarrje, në përjashtim të vitit 2015-2016, ku kemi më shumë se 10000 ndërmarrje të reja të regjistrues, gjersa diferenca nga viti në vit është 400-500 ndërmarrje të reja.

Numri më i madh i ndërmarrjeve të reja të regjistrues vazhdon të jetë i koncentruar në sektorin e tregtisë me 1951 ndërmarrje të reja, pasuar nga sektori i hotelerisë me 747 ndërmarrje, sektori i prodhimit me 724 ndërmarrje, etj<sup>134</sup>

Në sektorin e prodhimit është shënuar rënia më e madhe e ndërmarrjeve të reja të regjistrues prej 211 ndërmarrje më pak<sup>135</sup>, pasuar nga sektori i tregtisë që u karakterizua me 200 ndërmarrje më pak të regjistrues.<sup>136</sup> Sektorët kryesorë që shënuan numër më të madh të ndërmarrjeve të regjistrues ishin sektori i aktiviteteve profesionale dhe sektori i ndërtimitarisë.<sup>137</sup>

Më poshtë, do shohim grafikun me numrin e ndërmarrjeve të shuara për periudhën e njëjtë të llogaritjes, sikurse grafiku paraprak.

---

<sup>133</sup> Intervistë me zyrtar pranë Drejtorisë së Teknologjisë Informative në ATK


<sup>134</sup> Raporti serik i Bankës Qendrore: Vlerësimi tremujor i ekonomisë TM3 2017, fq9.

<sup>135</sup> ASK, 2016

<sup>136</sup> Po aty.

<sup>137</sup> Raporti serik i Bankës Qendrore: Vlerësimi tremujor i ekonomisë TM3 2017, fq9.

Grafiku 10. *Trendi i Shuarjes së Ndërmarrjeve në Kosovë për Periudhat 2006-2016*



Burimi i të dhënave për numrin e ndërmarrjeve: Enti i statistikave të Kosovës, platforma [askdata.rks-gov.net](http://askdata.rks-gov.net). Paraqitja e trendit nga kalkulimet e autorit.

Në Në përgjithësi, mjedisi biznesor në Kosovë është duke kërkuar të prosperojë me të gjitha potencialet e saj. Grafikoni tregon për një rritje të trendit të ndërmarrjeve të shuara kundrejt trendit rritës për ndërmarrjet e reja. Kjo edhe pritej ngase duke parë për një kohë të gjatë numër më të madh të ndërmarrjeve të reja, meqë pjesa dërmuese e tyre janë ndërmarrje me nga 1-9 punëtorë (98%) pas një kohe pritet edhe rënia e tyre, ashtu që me gjasë pritet të ndodhë pas vitit 2016.

Gjithsesi, rënia dhe ngritja e ndërmarrjeve nuk janë vetëm efekt i moshës së tyre, por, siç kemi cekur edhe më lart, ndërrimin e statusit, ato i nënshtrohen edhe rrethanave duke e ndryshuar formën e organizimit për t'u gjetur më mirë në treg. Kjo është ndikuar edhe nga aplikimi i pajisjeve elektronike të regjistrimit të të gjitha veprimtarive ekonomike të

bizneseve që operojnë në Republikën e Kosovës, konkretisht arkave fiskale.<sup>138</sup> Por, është edhe tjetër arsy, në vitin 2015 është aplikuar dhe pakoja e re fiskale, e cila e ndryshoi normën e deriatëhershme 16% sa ishte në të gjitha produktet, në 8% për produkte bazike, dhe 18% të gjitha produktet e tjera.<sup>139</sup> Në krahasim me vendet e tjera, të dhënat mbi bizneset e regjistruara vazhdojnë të janë inkurajuese në Kosovë, marrë parasysh se mbyllja e bizneseve ende ka raportin në 1 ose 2 në 10 biznese që mbylljet, ndërsa vendet e tjera ballafaqohen me mbi 3 nga 10 biznese që mbyllen brenda viti të parë.<sup>140</sup>

Sa i përket këtij diskutimi, diferenca neto e ndërmarrjeve të shuara ndaj atyre të hapura është dukshëm pozitive. Janë rreth 3000-5000 ndërmarrje më shumë të hapura, por kjo varion nga viti në vit.

Ndërmarrjet në Kosovë janë më se të koncentruara në shërbime, aty është e koncentruar edhe masa më e madhe e fuqisë punëtore. Më poshtë paraqesim shpërndarjen e bizneseve sipas sektorëve


---

<sup>138</sup> Pajisjet Elektronike Fiskale – përfshijnë ato pajisje elektronike si: arkat fiskale, pikat elektronike të pajisjeve të shitjeve, printerët fiskal dhe pajisjet e ngjashme. PEF është një pajisje ose sistem elektronik i kompjuterizuar

<sup>139</sup> Ligi nr. 03/L- 146 PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR: Pajisja Fiskale Elektronike shfrytëzohet për lëshimin e kuponëve fiskal për të hyrat. Lëshimi i kuponëve për të hyrat nuk varet nga mënyra e pagesës (pagesa me para të gatshme, pagesa me kartelën e kreditit ose ndonjë instrument ekvivalent i pagesës p.sh me çek)

<sup>140</sup> Raporti serik i Bankës Qendrore: Vlerësimi tremujor i ekonomisë TM4 2016, fq9.

Grafiku 11. Shpërndarja e Bizneseve Sipas Sektorëve në Kosovë



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, platforma [askdata.rks-gov.net](http://askdata.rks-gov.net)

Në këtë grafik shohim se shumicën e hapësirës e kanë bizneset e reja në industrinë e tregtisë, duke u përcjellë nga ajo e ndërtimtarisë, akomodimit, si dhe prodhimit.

Të dhënat për ndarje të tillë të bizneseve janë konform kredive të dhëna, e që janë të orientuara edhe nga objektivat qeveritare përritje të sektorëve. P. sh., që nga viti 2013 janë rritur dukshëm edhe kreditë edhe grantet dhe subvencionet për bujqësi, duke i lënë të ngjashme shifrat përritje e industri.

**Gjatë vitit 2014** u regjistruan 9404 ndërmarrje të reja apo 16 ndërmarrje më pak se sa në vitin paraprak, ndërsa u mbyllën 1671 biznese apo 163 biznese më shumë se sa në vitin paraprak (figura 7). Struktura e ndërmarrjeve të reja të regjistruara është e ngjashme me vitin e kaluar ku dominojnë tregtia, hoteleria, prodhimi, ndërtimtaria dhe bujqësia. Krahasuar me vitin paraprak, është shënuar rënje e numrit të bizneseve të regjistruara në tregun e patundshmërive (198 ndërmarrje) dhe ndërtimtarisë (140 ndërmarrje), ndërsa

hoteleria dhe prodhimi kanë shënuar rritje për 123 përkatësisht 106 ndërmarrje të regjistruara. Rritje kanë shënuar edhe ndërmarrjet e regjistruara në sektorin e tregtisë.<sup>141</sup>

**Sipas statistikave të ASK-së<sup>142</sup>, 2015-ta viti 2015** u karakterizua me rritje të ekonomisë prej 3,5% kundrejt 1,4% sa ishte në vitin 2014. Nga 2015, ndërmarrjet shënuan rritje deri në 10000 sosh. Rritja ekonomike gjatë këtij viti ishte rezultat i rritjes së kërkesës së brendshme, gjegjësisht konsumit privat dhe investimeve. Në anën tjetër, neto eksportet rritën ndikimin e tyre negativ në normën e rritjes ekonomike.<sup>143</sup> Edhe gjatë vitit 2015 numri më i madh i ndërmarrjeve të regjistruara ishte në sektorin e tregtisë me 2903 ndërmarrje të reja, pasuar nga sektori i prodhimitarisë me 1047 ndërmarrje, hotelerisë me 1018 ndërmarrje dhe bujqësisë me 945 ndërmarrje.<sup>144</sup> Kundrejt periudhës së njëjtë të vitit të kaluar, sektori i bujqësisë ka shënuar rritjen më të lartë të ndërmarrjeve të regjistruara me 271 ndërmarrje më shumë, pasuar nga tregtia ku është shënuar rritje prej 89 ndërmarrjeve, si dhe sektori i prodhimit, i cili ka shënuar rritje të ndërmarrjeve të regjistruara me 69 të tilla më shumë se sa në vitin paraprak. Në anën tjetër, në sektorin e ndërtimitarisë janë regjistruar 50 ndërmarrje më pak kahasuar me vitin paraprak, në sektorin e hotelerisë 16 ndërmarrje më pak dhe në sektorin e transportit 10 ndërmarrje më pak.<sup>145</sup>

**Edhe në vitin 2016**, ekonomia e Kosovës ka shënuar progres. Është karakterizuar me rritje dhe me rënie të bizneseve. Konkretisht, në vitin 2016 janë evidentuar si të regjistruara 10530 ndërmarrje dhe u mbyllën rrëth 2811 ndërmarrje.<sup>146</sup> Ndërkaq, vetëm në vitin 2017

---

<sup>141</sup>BQK, Raporti vjetor i vlerësimit, 2014, fq29

<sup>142</sup> ASK, Llogaritë kombëtare dhe qeveritare 2015, BQK, Raporti vjetor i vlerësimit, 2015

<sup>143</sup> BQK, Raporti vjetor i vlerësimit, 2015, fq.30

<sup>144</sup> Po aty.

<sup>145</sup> Po aty.


<sup>146</sup> ASK, 2016 (plataforma [askdata.rks-gov.net](http://askdata.rks-gov.net))

janë regjistruar 9335 ndërmarrje tregtare dhe, çka është shumë e rëndësishme, që nga viti 2004 numri i SHPK-ve të regjistruesha është më i madh se ai i bizneseve individuale.<sup>147</sup>

Krahasuar me vitin 2015, pothuajse në të gjithë sektorët është shënuar rritje e ndërmarrjeve të regjistruesha. Në sektorin e bujqësisë është shënuar rritja më e lartë e ndërmarrjeve të regjistruesha me 145 ndërmarrje më shumë, pasuar nga sektori i prodhimit që u karakterizua me 134 ndërmarrje më shumë. Sektorët që shënuan numër më të vogël të ndërmarrjeve të regjistruesha ishin sektori i tregtisë dhe ai i patundshmërive.<sup>148</sup>

Më posht shohim lëvizjen e ndërmarrjeve konform veprimtarisë së tyre.

Grafiku 12. *Struktura e ndërmarrjeve aktive në Kosovë e ndarë sipas veprimtarisë së tyre për periudhat 2006-2016*



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, <http://askdata.rks-gov.net>. Kalkulime të autorit


<sup>147</sup> Raportin e Indikatorëve Bazë të Performancës për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë për vitin 2017.

<sup>148</sup> BQK, Raporti vjetor i vlerësimit, 2016, fq.30

Kontributi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, përpos krijimit të vendeve të reja të punës, është edhe kontributi që këto japid në pjesëmarrje të GDP-së përmas qarkullimit të mjeteve. Kështu, më poshtë paraqesim një grafik përmas qarkullimin e mjeteve te NVM-të, qarkullim që në modelin për matjen e efekteve, të cilin e kemi përdorur ne, paraqitet si variabël kryesor.

Grafiku 13. Qarkullimi i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme në Kosovë të Ndara Sipas

*Numrit të Punëtorëve*



Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës. Kalkulime të autorit

Fatmirësisht, ky grafik na jep një pasqyrë shpresëdhënëse për vitet në vijim, na bën të besojmë se do të kemi trend të rritjes së vazhdueshme të qarkullimit të NVM-ve. Rritja e qarkullimit është e ndikuar, përpos nga rritja e konsumit të brendshëm prej 4,8%, edhe nga rritja e investimeve për 9,2%<sup>149</sup>. Rimëkëmbja e investimeve u mbështet nga ndërtimi i vazhdueshëm i autostradës për Shkup dhe flukset hyrëse të dyfishuara të investimeve të huaja direkte (IHD). Modeli i rritjes ekonomike të Kosovës, ende mbështetet kryesisht në

<sup>149</sup> Po aty.fq.6

konsum dhe investime në infrastrukturë, ndërsa kapacitetet e tjera të prodhimit janë të pazhvilluara. Rritja mbeti e fortë në tremujorin e parë të vitit 2016, për rreth 3.8%.<sup>150</sup> Siç shihet edhe në grafik, viti 2016 për ATK-në ka pasur performancën më të mirë, ngase i ka rritur në masë të konsiderueshme të hyrat tatimore.

Rritja e qarkullimit është ndikuar edhe nga fakti se në vitin 2015 është zbatuar pakoja e re fiskale, e cila me rritjen e TVSH-së për shumicën e produkteve nga 16% në 18% e ka rritur qarkullimin e ndërmarrjeve.

Edhe sistemi bankar ka qenë injektues në këtë proces rritës, gjithsesi roli dhe ndikimi i kredive pritet të shihet më tepër me krijimin e Fondit për garantimin e kredive. FKGK-ja është themeluar në janar të vitit 2016, bazuar ne Ligjin për themelimin e Fondit kosovar për garanci kreditore. Qëllimi i FKGK-së është ta përkrahë sektorin privat në Kosovë, duke zgjeruar qasjen në financa për NMVM-të, duke mundësuar kështu edhe krijimin e vendeve të punës, rritjen e prodhimit vendor, përmirësimin e bilancit tregtar dhe avancimin e mundësive për sektorët ekonomikë më pak të shërbyer.<sup>151</sup>

Kreditë janë forma më e përdorur e ndërmarrjeve për financimin e aktiviteteve ekonomike të tyre, sigurisht në mungesë të rrugëve të tjera. Këto kredi në Kosovë janë karakterizuar me norma të larta të interesit. Këto norma të larta janë të arsyetuara për shkak të rrezikut të borxheve të këqija.

Gjendja strukurale e ndërmarrjeve në Kosovë nuk është mirëpritur nga Komisioni Evropian, pasi që i njëjti në raportin e tij të vlerësimit për Kosovën, në vitin 2016, potencoi se nuk ka pasur progres në adresimin e dobësive strukturore të sektorit privat

---

<sup>150</sup> Raporti i vitit 2016 për Kosovën\* Në përcjellje të dokumentit: Komunikata nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve Komunikata mbi Politikën e Zgjerimit të BE-së 2016, fq.35

<sup>151</sup> Ligji Nr. 05/L-057 PËR THEMELIMIN E FONDIT KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE. Fondi për garantimin e kredive është themeluar në janar të 2016-të dhe ka filluar të funksionoj në tremujorin e dytë të vitit 2016

të Kosovës, i cili vazhdon të jetë i fragmentuar dhe jo në gjendje për ta përmirësuar efikasitetin e vet.<sup>152</sup>

Tutje, raporti vazhdon se nuk ka pasur ndryshime të rëndësishme strukturore në ekonominë e Kosovës që nga viti 2008. Sektori i bujqësisë, i cili kontribuon 13.5% të vlerës së shtuar bruto (VSHB), është përgjegjës për 26.7% të punësimit të përgjithshëm dhe ofron rreth 12% të vlerës totale të mallrave të eksportuara. Mikro, si dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) vazhdojnë të japid llogari për 99% të punësimit total. Numri më i madh i ndërmarrjeve operojnë në sektorin e tregtisë (29.9%), ndjekur nga akomodimi, shërbimet e ushqimit dhe të industrisë.<sup>153</sup>

## 4.2 PUNËSIMI DHE PAPUNËSIA NË KOSOVË

Punësimi nënkuption personat, pjesë të fuqisë punëtore (e aftë për punë) dhe që janë të angazhuar në punë. Në Kosovë, që nga mbarimi i luftës (1999) e tutje, numri i të punësuarve dhe i pjesëmarrjes në fuqinë punëtore ka ardhur duke u rritur me ritëm jo shumë dinamik. Llogaritet se 66% e popullsisë janë në moshë pune dhe mosha mesatare është 27 vjeç, ndërsa 8% e popullsisë janë mbi moshën 65 vjeç.<sup>154</sup> Në Kosovë, punësimi dhe çështjet sociale janë kompetencë e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Të dhënat statistikore rreth punësimit, papunësisë dhe strukturës së regjistrimit dhe të paraqitjes së bizneseve, të raportuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, janë më të qarta nga viti 2012 e këndeja, ngase ASK-ja e publikon rregullisht Anketën e fuqisë

---

<sup>152</sup> Raporti i vitit 2016 për Kosovën\* Në përcjellje të dokumentit: Komunikata nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve Komunikata mbi Politikën e Zgjerimit të BE-së 2016, fq.42

<sup>153</sup> Po aty,

<sup>154</sup> World Bank. Republic of Kosovo – Systemic Country Diagnostic. January 2017. Burimi: <http://bit.ly/2AJwPfs>

punëtore (AFP) për çdo vit, kurse dy vitet e fundit rezultatet e kësaj ankete publikohen çdo tre muaj. Për vitet e mëhershme, konkretisht, për vitet 2001-2009, mbledhja e të dhënave është bërë përmes anketave me mostra përfaqësuese dhe kjo ka paraqitur problem sa i përket mënyrës si janë bazuar dhe paraqitur trendet. Për vitet 2010 dhe 2011 nuk ka të dhëna sipas hulumtimeve të ASK, por vetëm nga hulumtimet e agjencive, OJQ-ve apo instituteve të ndryshme.

Sigurisht, qeveria është përpjekur për të ndikuar në rritjen e punësimit në saje të hartimit dhe zbatimit të strategjive të ndryshme. Ndër to, përmendim **Strategjia e punësimit 2010-2012, Strategjia për zhvillimin e NVM-ve për Kosovën 2012-2016 (me vizion deri në 2020), Strategjia e zhvillimit të sektorit privat 2013-2017, pastaj krijimi i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK), etj.** Janë gjithsej 34 ligje në fuqi nga fusha e punësimit dhe mirëqenies sociale.<sup>155</sup> Përpos ndërmarrjes së veprimeve nga qeveria, ajo kontribuon në punësim edhe përmes marrëveshjeve ndërkombëtare, si objektiva zhvillimore të Bashkimit Evropian për Kosovën, siç janë: **Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim, Marrëveshja “Stand-by” me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN), Programi për reforma në ekonomi (PRE), Agjenda për reforma evropiane (ARE), etj.**

Më 18 shtator 2017, Qeveria aprovoi Programin qeverisës 2017-2021. Në kuadër të programit qeverisës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale parasheh arritjen e objektivave të mëposhtme:

- Rritjen e punësimit përmes masave aktive të tregut të punës;
- Punësimin e një anëtari për çdo familje që nuk e ka asnjë të punësuar;
- Ofrimin e shërbimeve të aftësimit profesional në përputhje me kërkuesat e tregut të punës;
- Avancimin e kushteve të punës të punëtorëve dhe luftimin e punësimit jo formal;

---

<sup>155</sup> LIGJI Nr. 03/L-212 I PUNËS, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: viti v / nr. 90 / 01 Dhjetor 2010

- Dialogun social dhe ngritja e kapaciteteve të Këshillit ekonomiko-social;
- Fuqizimin e organizatave jo qeveritare përmes procesit të licencimit dhe sigurimit të një fondi për financimin e projekteve për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare;
- Zhvillimin e formulës së financimit dhe grantit specifik për shërbimet sociale në nivel komunal;
- Ri-shikimin e skemave të aftësisë së kufizuar;
- Reformimin e sistemit pensional;
- Sigurimin e të drejtave të kategorive të dala nga lufta me fokus zbatimin e legjislacionit për këto kategori<sup>156</sup>

Pavarësish se disa nga objektivat janë vazhdimësi nga strategjitet e mëhershme, në fakt realizimi i tyre është problem, pasi që shumë masa ose objektiva bien ndesh me njëratjetren. Nëse themi se një nga objektivat e strategjisë së 2016-2021 ka qenë punësimi në bazë të aftësive, atëherë si do të realizohet objektiva “një anëtar për një familje në punë” në rast se subjekti i caktuar mund të mos i ketë aftësitë e nevojshme për punë?!. Madje, edhe praktikisht është vështirë e realizueshme sepse llogaritet të jenë diku rrëth 120.000 familje që nuk kanë asnjë anëtar në punë dhe i bie që të krijohen po kaq vende të reja pune.

Konsideroj se bizneset në Kosovë nuk janë në gjendje ta absorbojnë gjithë këtë numër, por, nga ana tjetër, ekzistojnë hapësira boshe në treg, të cilat edhe nuk gjejnë punëtorë. Raporti i Bankës Botërore për vendet e punës në Kosovë identifikon dy probleme kryesore, të cilat pengojnë rritjen e bizneseve: ambient i papërshtatshëm i të bërit biznes dhe mospërputhja mes vendeve të punës dhe shkathtësive e kompetencave të punëtorëve.<sup>157</sup>

---

<sup>156</sup> Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021, Prishtinë, shtator 2017, fq.72

<sup>157</sup> World Bank. Jobs Diagnostic – Kosovo. Jobs Series, Issue No.5. 2017.

Kështu, të dhënat nga hulumtimi i bërë gjatë vitit 2014 nga Agjencia kosovare e biznesit (AKB) thonë se nevojat për punëtorë janë për aktivitetet si: **saldues, punues çatie, inxhinier ndërtimtarie, operator, elektroinxhinier, hulumtues** e të ngjashme. Nga ana tjetër, kemi mbingarkesë në punët tregtare si shitje dhe administrative, ndërsa mungesë në ofertë për sektorin e ndërtimtarisë dhe infrastrukturës. Sipas Departamentit të punës dhe punësimit, mesatarisht janë 300 vende të reja pune të identikuara çdo muaj nga këshilltarët e angazhuar në zyrat e punësimit në të gjithë Kosovën.<sup>158</sup>

Po sipas këtij hulumtimi, thuhet se punëdhënësit parashikojnë një mori vende pune nga të cilat pritet të mos ketë ofertë pune, e që janë: **zdrukthëtar, këshillues shëndetësore, agjent i bursave, teknik i teknologjisë së tekstilit, riparues, mirëmbajtës të pajisjeve pneumatike dhe hidraulik.** Një tjetër hulumtim i bërë nga Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) tregon për mungesë të profesioneve të mëposhtme: **operues dhe serviser i makinave prodhuese, kuzhinier, elektro/hidro/termo instalues, automekanik, strukturues metali, përpunues i drurit, dizajnues i tekstilit.**<sup>159</sup>

Këto vende vazhdojnë të janë të lira për arsyet e ndryshme, ndër më të shprehurat janë: mungesa e interesimit për vende të tillë pune, mungesa e kualifikimit përkatës, kushtet jo tërheqëse për punë, mungesa e mundësive për karrierë, motivim i ultë, paga të ulëta dhe të tjera të kësaj natyre.<sup>160</sup>

Mungesën e punëtorëve të kualifikuar e gjejmë edhe te rezultatet e hulumtimit që ka bërë UNDP-ja për identifikimin e nevojave të tregut të punës, i cili tregon se një numër i madh i biznese në fushën e turizmit, përpunimit **të metaleve, drurit, tekstilit** dhe

<sup>158</sup> Informatat e Tregut të Punës, 12/13 ITP, Departamenti i Punës dhe Punësimit/ MPMS

<sup>159</sup> OEK- Mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar- sfidë për bizneset, Prishtinë, 2017, fq.15

<sup>160</sup> Hulumtimi i nevojave në Tregun e punës, 2013, Agjencia e Kosovës për Biznese, fq.26

**veshjes, përpunimi dhe paketimi i ushqimit** përballen me vështirësi në angazhimin e punonjësve me shkathtësi adekuate.<sup>161</sup>

Por, gjithsesi, duhet përmendur faktin se për disa nga këto profesione të kërkua ofrohen trajnime në kuadër të Qendrave për trajnim profesional (QAP), por se problemi qëndron te mosefikasiteti dhe cilësia e trajnimeve, mungesa e bashkëpunimit në mes të bizneseve dhe QAP-ve, si dhe informimi jo i mirë për trajnimet që ofrohen. Megjithatë, edhe informimi për ekzistencën e këtyre trajnimeve, madje edhe i vetë qendrës, në përgjithësi është i dobët.

Nëse do të ishte e mundur që politikat ta kishin në konsideratë këtë hapësirë, t'i orientonin resurset e nevojshme për rritje të efikasitetit të këtyre politikave, do të krijohej një situatë tjeter, e cila nëse do të ndikonte në rritjen ekonomike, do të kishte më pak njerëz pa punë. Kështu janë të gjeturat edhe nga OEK-u në hulumtimin për nevoja e tregut të punës, ku raportohet se prej 372 bizneseve, mostër e hulumtimit, 312 janë dekluaruar se do të punësonin punëtorë nëse do të gjenin të tillë kualifikuar për llojin e punës për të cilën kanë nevojë.<sup>162</sup> Niveli i ultë i aftësimit të fuqisë punëtore i penalizon ndërmarrjet atëherë kur ato tentojnë të zhvillohen.

Kjo sepse arsimi dhe programet e trajnimit profesional janë të koordinuara në mënyrë të dobët, mungojnë strategjitet e prioritetet e duhura dhe nuk i fuqizojnë strategjitet e zhvillimit ekonomik të Kosovës, konform kësaj rreth 40% e të diplomuarve me diplomë

---


<sup>161</sup> UNDP- Vlerësim i nevojave për shkathtësi: Identifikimi i nevojave të punëdhënësve në gjashtë sektorë ekonomikë në Kosovë, fq. 18-184 <http://bit.ly/2ijhvPf>

<sup>162</sup> OEK- Mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar- sfidë për bizneset, Prishtinë, 2017, fq.15

profesionale dhe 35% e të diplomuarve me diplomë universitare nuk posedojnë aftësitë e nevojshme të kërkuara nga tregu i punës.<sup>163</sup>

Baza e ngushtë e prodhimit ofron mundësi të kufizuara për punësim, sidomos në kombinim me rezultatet e arsimit të dobëta “mismatched” me kërkesat e tregut të punës.<sup>164</sup> Më poshtë paraqitet kjo situatë edhe në grafik, për të parë se si qëndron numri i të papunëve kundrejt shkollimit të tyre.

Grafiku 14. Shkalla e Papunësisë Sipas Nivelit të Arsimit në Kosovë



Burimi: Agjencia e Statisikave të Kosovës, platforma <http://askdata.rks-gov.net>

Sipas grafikut, shihet se në vitin 2017, përqindja e të papunëve me shkollim terciar ka nisur të rritet, ndërsa të bjerë ajo pa shkollim. Rënia e përqindjes së të papunëve pa shkollim është më tepër reflektimi i daljes nga forca punëtore se sa inkuadrimi i tyre në

<sup>163</sup> KOMISIONI EVROPIAN, DOKUMENT PUNE I STAFIT TË KOMISIONIT Raporti i viti 2016 për Kosovën, Bruksel, 9.11.2016, fq.50

<sup>164</sup> KOMISIONI EVROPIAN, DOKUMENT PUNE I STAFIT TË KOMISIONIT Raporti i viti 2016 për Kosovën, Bruksel, 9.11.2016, fq.52

punë. Nga ana tjetër, rritja e shkallës së papunësisë te kategoria e shkollimit terciar është refleksion i pamundësisë së fuqisë punëtore për të gjetur punën relevante me shkollimin përkatës ose edhe mungesa e aftësive dhe e kompetencave.

Sipas statistikave të fundit të ATK-së, deri në tremujorin e tretë të vitit 2017 janë të regjistruara si tatimpagues të rregullt rreth 100697 NVM, të cilat i kanë të deklaruar rreth 177233 punëtorë, që, po ashtu, konsiderohen tatimpagues të rregullt të trustit pensional.<sup>165</sup>

Ndërkaq, vlerësohet se në sektorin informal janë të punësuar rreth 45000 të punësuar të ekivalentes së punëtorit me orar të plotë, gjë që d.m.th. se 33.2% e të ardhurave personale për ekonomitë familjare janë joformale.<sup>166</sup>

Niveli i investimeve në Kosovë gjithnjë është duke rënë, përfaktin proceseve zhvilimore që janë duke ndodhur e që janë duke e dëmtuar imazhin e të të investuarit në Kosovë. Të njëjtat janë përcjellë me renie të dukshme nga viti 2015, saktësisht nga rreth 308 milionë bien në rreth 216 milionë në vitin 2016.<sup>167</sup>

Më poshtë përmes grafikut paraqesim normën e papunësisë në Kosovë.


---

<sup>165</sup> Administrata Tatimore e Kosoves, zyra për marrëdhënie me publikun , e bazuar mbi qasjen në dokumente publike (kontakti është realizuar përmes emailit)

<sup>166</sup> Agron Demi, POLITIKATE PUNËSIMIT DHE MIRËQENIES SOCIALE NË KOSOVË, Raport Vlerësimi i Politikave të Punësimit dhe Mirëqenies Sociale në Kosovë, Dhjetor 2017, fq.24

<sup>167</sup> Millennium Challenge Corporation. Kosovo Constraints Analysis. November 2017

Grafiku 15. Norma e Papunësisë në Kosovë për Periudhat 2006-2016



Burimi: Agjencja e Statistikave të Kosovës, Anketa e Fuqisë Punëtore,

Nga grafiku shohim një normë të lartë të papunësisë, e cila është edhe një faktorë që "kontribuon" që Kosova të jetë vendi i tretë më i varfër në Evropë.<sup>168</sup> Për vitin 2010 dhe 2011 mungojnë të dhënrat, prandaj këto vite edhe në matjen e efekteve në model janë marrë si mesatare e viteve të mëhershme.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur detaje mbi angazhimin dhe gjendjen e forcës punëtore në Kosovë. Të dhënrat janë të marrë nga ASK-ja, por janë adaptuar nga autorja përmes raporteve në dispozicion.

<sup>168</sup> World Bank, 2017. <http://www.worldbank.org/en/country/kosovo/overview#3>

Tabela 7. Statistika e Përpërjes së Normës së Papunësisë/ Punësimit në Kosovë për Periudhat 2006-2016

Kategoria	TË PUNËSUIT										
	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Fuqi punëtore	52.3	46.8	46.2	48.1	-	-	36.88	40.54	41.6	37.6	41.3
Të punësuar	29,0	26.5	24.3	26,4	-	-	69	70	66.66	51.9	71.3
Të punësuar të pjesshëm	23.3	16.8	17.8	16.3	-	-	11.1	11.9	8.3	7	6.3
Të përkohshëm	60.7	51.5	65.3	65.0	-	-	73	68.8	71.6	72	60
Të vetëpunësuar	24.6	21.6	24.1	22.0	-	-	19.8	22.9	23.2	22.8	34.7
TË PAPUNËT											
Kategoria	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Jo fuqi punëtore (jo aktiv)	67,5	70.2	53.8	51.9	-	-	63.11	59.45	58.4	62.4	58.6
Të papunësuar	23.3	20.4	21.9	21.7	-	-	30.9	30	35.3	48	28.6
Papunësia tek të rinjtë 15-24	75.5	70	73	73	-	-	55.2	55.9	60.99	57.6	47
Papunësi afatgjatë	91.5	85	81.8	81.7	-	-	59.8	68.9	73.8	72.2	63.5
Norma e papunësisë	44.9	43.6	47.5	45.4	-	-	28.1	26.9	35.3	32.9	28.7


Burimi: Agjencja e Statistikave të Kosovës. Kalkulime të autorit.

Njëra nga të dhënat që bie në sy nga kjo tabelë, pos normës së papunësisë që është e paraqitur edhe më lart, është shkalla e lartë e përqindjes së kohëzgjatjes së papunësisë për personat që janë aktivë, por që janë pa papunë. Nga viti 2012 shohim rënje të kësaj kohëzgjatjeje, por prapë është kritike. Me këtë nënkuftohet se sektori privat, në veçanti, nuk ka krijuar kushte për absorbimin e fuqisë punëtore në pritje.

Nga ana tjetër, pjesëmarrja shumë e vogël e personave aktivisht në tregun e punës është një tjetër problem që ngre shqetësim. Arsyet për inaktivitet përfshijnë pjesëmarrjen në shkollim ose trajnim dhe dekurajimin, d.m.th. besimin se nuk ka punë (16.3% dhe 14.1% e popullatës në moshë pune në vitin 2015), ndërsa në rastin e grave në veçanti, arsyet kryesore kanë të bëjnë me përgjegjësitë familjare.<sup>169</sup>

Më poshtë paraqesim edhe normën e papunësisë për të gjitha vendet e rajonit.

Grafiku 16. *Krahasimi i normave të papunësisë me vendet e rajonit*



Burimi: Agjencja e Statistikave të Kosovë, platforma

Bazuar në këtë paraqitje, shohim se Kosova gjendet në situatën më të rëndë, e cila rezulton me shkallën më të lartë të papunësisë, e shoqëruar nga Bosnja dhe Maqedonia. Në këtë renditje nuk gjendet më mirë as Shqipëria. Ajo ballafaqohet me rreth 27% të popullsisë së aftë të pa angazhuar në ndonjë vend pune.

<sup>169</sup> Strategjia Sektoriale 2018-2022, prishtinë, 17 dhjetor 2017, fq 14

Gjithsesi, vendet e Ballkanit Perëndimor, kush më shumë e kush më pak, gjenden në një fazë të përpjekjeve të vrazhda për përmirësimin e situatës ekonomike, e nxitur nga premtimet politike ndërkombëtare për avancimin e hapave në integrimin e tyre në institucionet më të larta evropiane e botërore, si anëtarësimi në UNESCO, OKB e NATO, apo edhe procese si liberalizimi i vizave, proces që, sa i nevojshëm, aq ka qenë edhe i dhimbshëm për Shqipërinë e Maqedoninë dhe pritet që e njëjta përvojë të tregohet edhe në Kosovë.

Sipas të dhënave të Bankës Botërore, në periudhën mes vitit 2005 deri më 2014 janë krijuar vetëm 63,000 vende të reja të punës neto, të cilat më tepër dalin si rrjedhojë e procesi të formalizimit të tregut të punës, se sa krijim real i vendeve të reja të punës.<sup>170</sup>

#### **4.2.1 Politikat e punësimit**

Kosova, përmes institucioneve të saj, duke hartuar strategji të ndryshme po bën përpjekje të vazhdueshme për ta menaxhuar normën e punësimit. Duhet kuptuar se marrja e masave për ta ndryshuar normën e punësimit, nuk do të thotë ndryshim edhe në normën e papunësisë, sepse matja e tyre ndryshon nga njëra-tjetra. Sipas **Lyuben Tomew-t**: Shkalla e punëzënisë nënkuption shkallën e të të punësuarve në krahasim me numrin e përgjithshëm të popullatës që kanë të drejtë të punojnë, ndërkaq shkalla e papunësisë nënkuption shkallën e të të papunëve në mesin e fuqisë punëtore (që është ekonomikisht aktive<sup>171</sup>

Problemet kryesore që po e pengojnë rritjen e punësimit, e që janë të cituara në strategjitet e hartuara nga institucionet shtetërore, janë të lidhura me pengesat për tërheqjen e investitorëve të huaj, problemet në sistemin e arsimimit, trajnimt dhe

<sup>170</sup> Asistencë Teknikë e Bashkimit Evropian për Kosovën. Vlerësim mbi shtrirjen e ekonomisë joformale në Kosovës, (Projekt i zbatuar nga Business and Strategies Europe) Nëntor 2017

<sup>171</sup> Tomew, L. & Meinardus, M., Employment Policies in South-East Europe, Common Challenges and Different Scenarios, 2012

aftësimit profesional, gjendjen në qendrat e regjistrimit të punëkërkuesve dhe elemente të tjera që kanë të bëjnë me punësimin. Gjetja e një vendi pune në Kosovë është shumë e vështirë dhe, sipas një raporti të MMPS-së, mbi 90% e të papunëve të regjistruar në Kosovë janë të papunë afatgjatë, të cilët janë në kërkim të një vendi të punës për më shumë se një vit. Në anën tjetër, gjatë vitit 2012, shërbimet publike të punësimit kanë ofruar vetëm 9434 vende të lira pune, prej të cilave 6166 vende janë ofruar nga sektori privat. Kjo nënkuption se një vend i lirë pune ka qenë në dispozicion për 27 të papunë.

Sipas Tomew-t, politikat e punësimit janë dy llojesh: **aktive dhe pasive**. Shprehja “politikat aktive të tregut të punës” përkufizon politika më të vazhdueshme dhe të cilat mund të dallohen nga intervenimet “pasive” në formë të benefacioneve të papunësisë.<sup>172</sup> Këto janë politika që ndërhyjnë direkt në tregun e punës duke munduar të fusin anëtarë të rindërtuar, të cilët shfaqen për herë të parë si fuqi punëtore ose vijnë nga grupei jashtë forcës punëtore. Një politikë e tillë, të cilën e ka ndërmarrë qeveria në Kosovë, është krijimi i Agjencisë së punësimit, përmes së cilës shpërndahen informacione përvende të punës, por edhe mblidhen të dhëna nga të rinjtë që janë në kërkim të vendeve të reja të punës. Maqedonia këtë e ka të rregulluar me ligj, ku çdo i ri që arrin moshën 18 vjeçare, duhet patjetër të regjistrohet në agjencinë e punësimit.

Politikat aktive zbatohen në disa forma: punësimi i subvencionuar kur zyrat e punësimit të qeverisë punësojnë njerëz në programe politike<sup>173</sup>, subvencionimi i pagave, përkrahja përmes trajnimeve përgjite të aftësive dhe shkathtësive varësisht nga nevojat e tregut, skemat publike të kualifikimit të cilat mundësojnë orientimin e fuqisë punëtore drejt sektorëve më profitabil, pastaj edhe praktikë në punë, vetëpunësim dhe promovim i

---

<sup>172</sup> Thuy Phan, Ellen Hansen dhe David Price, Shërbimi Publik i Punësimit në tregun e ndryshueshmë të punës, mbështetur nga Organizata Ndërkombëtare e Punës, Prishtinë, 2001. f.115.

<sup>173</sup> Instituti GAP, Vlerësimi i Strategjisë së Punësimit: nevoja për një strategji konkrete, Dhjetor 2013.

ndërmarrësisë. Pra politika të tilla janë ndërhyrje direkte të qeverisë me ndërmarrje të projekteve konkrete për të krijuara situata të reja.

Duke qenë se në Kosovë papunësia është e karakterizuar me një shkallë të lartë të mospërputhjes mes kërkesës dhe ofertës për punë, shteti duhet domosdoshmërisht përdor politika aktive.

Politikat pasive nënkuptionjë sigurimin e një standardi minimal të jetës për të papunët. Kjo nënkuption ndarjen e një shume të caktuar të parave që mbulon koston e jetesës për ata persona që kanë mbetur pa punë, derisa të gjejnë punë.<sup>174</sup> Kjo formë e politikave të punësimit nuk është e dobishme për rastin e Kosovës, pasi që interes i përgjithshëm është krijimi i vlerave përmes produktivitetit, e që i njëjti krijohet duke krijuar vende pune, ndërsa kjo formë vetëm e ngarkon buxhetin me shpenzime të karakterit social. Nga ana tjetër, kjo mund të krijojë edhe imunitet te njerëzit të cilët nuk bëjnë përpjekje për të punuar, e, aq më pak, për nivelin e pagave sa janë në Kosovë.

Gjithsesi, meqë MPMS-ja është përgjegjëse për këto politika, fatkeqësisht buxheti për sektorët e shërbimit për punësim ka kohë që nuk ka ndryshuar ose ka pësuar ndryshime simbolike.

#### **4.2.2 Struktura e të punësuarve/ të papunëve sipas grup moshave**

Kosova njihet si vend ku dominon popullsia e re dhe e aftë për punë. Fatkeqësisht, kemi shifër të lartë të personave joaktivë të fuqisë punëtore. Sipas ASK-së, mundësia që popullata joaktivë të rritet në mënyrë të vazhdueshme mbetet e lartë, përderisa çdo vit rrreth 36000 të rinj i shtohen popullsisë në moshë pune, ndërkohë që vetëm rrreth 10000 largohen nga popullsia në moshë pune.

---

<sup>174</sup> Po aty.

Persona joaktivë konsiderohen personat që janë të aftë për punë, por që nuk janë në kërkim të punës, do të thotë nuk janë aktivë në përpjekje për të gjetur një vend pune ose për të ofruar punën e tyre dhe konsiderohen si kategori pasive e fuqisë punëtore.

Nga ana tjetër, masa prej 81000 personave, që bëjnë pjesë në kategorinë e të të punësuarve, janë shërbyes civilë dhe administratë shtetërore, të cilat vende pune nuk janë krijuar për të prodhuar mallra dhe shërbime. Ndërsa, pjesa tjetër janë nga sektori privat, të cilët edhe marrin pjesë direkt në prodhim të mallrave dhe shërbimeve. Shqetësuese dhe dekunjuese është shifra e të papunëve nga mosha dominuese e fuqisë punëtore 15-24, ku më se 55.33% e tyre janë pa papunë, njëherësh kjo paraqet edhe shumën më të lart në këtë aspekt.<sup>175</sup> Kjo shkallë e lartë është e lidhur ngushtë me mungesën e vendeve të punës adekuate për kualifikimin e këtyre të rinjve, kështu ata janë të demotivuar sepse kanë kërkuar një kohë të gjatë punë dhe nuk kanë gjetur. Prandaj, edhe kemi largim të trurit nga Kosova për në shtetet e tjera. Nga ana tjetër, edhe bizneset, duke mos qenë në gjendje t'i rrisin kapacitetet, po kërkojnë vetëm punëtorë të përgjegjësisë më të ultë.

Në të gjitha vendet në zhvillim, normat e papunësisë së të rinjve janë vazhdimit më të larta se normat e përgjithshme të papunësisë. Ashtu si me normat e BE-28, normat e papunësisë së të rinjve kanë tendencë të jenë rreth dy herë më të larta se normat e përgjithshme e papunësisë. Në vendet në zhvillim, më shumë se një e treta e të rinjve nën moshën 25 vjeç që bëjnë pjesë në forcën e punës, ishin pa punë në Mal të Zi dhe Shqipëri, më shumë se dy të pestat në Serbi dhe në Maqedoni, tejkaluar gjysma e të gjithë të rinjve në fuqinë punëtore në Kosovë si dhe mbi tre të pestat në Bosnjë dhe Hercegovinë.<sup>176</sup> Pra, në gjithë Ballkanin Perëndimor, shkalla e papunësisë së të rinjve ka

---


<sup>175</sup> ASK, 2015.

<sup>176</sup>EUROSTAT <http://ec.europa.eu>

rënë nga 50.8%, në vitin 2010, në 47.7 %, në vitin 2015. Gjithsesi, papunësia ndër të rinjtë ende mbetet e lartë dhe larg standardeve evropiane, veçanërisht në Kosovë.<sup>177</sup>

Më poshtë kemi një paraqitje në grafikë, ku shihet trendi i punësimit, gjegjësisht papunësisë së të rinjve në Kosovë.

Grafiku 17. Papunësia tek të rinjtë në Kosovë 2016-2017



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë, <http://askdata.rks-gov.net>

Të dhënat nga grafika tregojnë për një situatë shqetësuese, pasi shohim një trend në rritje të papunësisë së të rinjve si popullsi e re, nga ana tjeter, në papunësinë e përgjithshme trendi është në rënje. Lë për të dëshiruar kjo rënje, nëse zgjat, pasi, siç shihet nga grafika, janë lëvizje ciklike të cilat luhaten në ritëm të njëjtë, andaj edhe rënia duket të jetë jo stabile. Përveç shkallës së ulët të punësimit, të rinjtë në Kosovë, po ashtu, kanë më shumë gjasa për të punuar pa kontrata pune. Kjo është një nga kërkesat më të mëdha për përmirësim të kushteve të punës, nga njëra anë, dhe, nga ana tjeter, në raportet e Të bërit biznes (**Banka Botërore 2017**) del si e metë e sektorit privat, madje Kosova ka pësuar rënje në pozitë sa i përket këtij indikatorit. Në treguesit e tjerë të rëndësishëm si lejet e


<sup>177</sup> The World Bank Group ad Viena Institute for international Economic Studies. Western Balkans Labor Market Trends 2017, April 2017

ndërtimit, qasja në energji elektrike dhe kredi, mbrojtja e investorëve minoritarë, zbatimi i kontratave, Kosova është larg nga më i miri. Të meta si këto i pengojnë firmat e reja për të hyrë në treg, ndërsa firmat ekzistuese që të zgjerohen.

Përgjatë viteve 2012-2016, në mesatare, afër gjysma e të rinxhavës së punësuar, nuk kanë pasur kontrata pune ndërsa në vitin 2016 kjo shifër ka arritur në 54.8%.<sup>178</sup> Ky është një indikatorë që NVM-të në kushte informale i kontribuojnë shumë krijimit të vendeve të punës, pasi që pavarësisht mungesës së kontratës, ata krijojnë një vlerë përmes produktivitetit dhe qarkullimin të parave në formë të ardhurash.

Në ndërkohe, në grafikun e mëposhtëm shohim pjesëmarrjen e personave në punë, të ndarë sipas grupmoshave.

Grafiku 18. Struktura e të Punësuarve Sipas Grupmoshave në Kosovë



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, <http://askdata.rks-gov.net>

<sup>178</sup> Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, PLANI I VEPRIMIT: RRITJA E PUNËSIMIT TË TË RINJVE 2018-2020, fq.6

Pra, gjersa të rinjtë e moshës 15-24, që përbëjnë 24% të fuqisë punëtore, përfaqësojnë, po ashtu, një të tretën e numrit të përgjithshëm të të papunëve. Tashmë kur Kosova është afër liberalizimit të vizave, kjo pjesë e fuqisë punëtore ka tendencë të përfitojë nga rasti për të gjetur rrugë të reja jashtë Kosovës për të jetuar e punuar.

Kosovës, sikurse shumë vendeve të Ballkanit Perëndimor, i mungojnë të dhëna mbi sektorin informal, por të dhënat e disa shteteve të reja anëtare të BE-së sugjerojnë se informaliteti është më i larti në bujqësi (80.6 për qind), pastaj në ndërtimtari (38.2 për qind) dhe në mesin e të vetëpunësuarve (83.9 për qind).<sup>179</sup> Më shumë se një e treta e sektorit joformal (36% janë të punësuar në firma të vogla; 28% janë të vetëpunësuar në punë joprofesionale; 19% janë punëdhënës në firma të vogla; dhe 17% të mbetur janë punëtorë/anëtarë të familjes që nuk paguhen).<sup>180</sup> Informaliteti i detyron firmat formale të revanshohen me ndryshim të politikave të punësimit, duke i bërë kontratat e përkohshme.

Të vetëpunësuarit që i kontribuojnë informalitetit janë të koncentruar te ndërmarrjet familjare, të cilat nuk e paraqesin veten si të punësuar duke i kontribuuar kështu rritjes së normës së papunësisë ose të popullsisë joaktive. Në përqindjen e popullsisë joaktive më së shumti merr pjesë gjinia femërore, ku nga masa e saj totale, 77.2% e femrave të afta për punë nuk janë aktive në tregun e punës, përderisa vetëm 29% e meshkujve të aftë për punë nuk janë aktivë në tregun e punës. Arsyet më të shprehura pse femrat nuk janë aktive në tregun e punës janë: dedikimi më shumë ndaj krijimit dhe përkujdesjes për familje dhe diskriminimi në raport me meshkujt në arsimim. Nga ana tjeter, edhe ato femra, të cilat janë të përfshira në vendin e punës, politikat e punësimit në sektorin privat i disfavorizojnë, duke i nxitur kështu ta lënë punën. Bie fjala, pushimi i lehonisë është barrierë për bizneset private. Ky pushim e ngarkon punëdhënësin me pagesën e 2/3 e

<sup>179</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovë, Anketa e Fuqisë Punëtore, 2012, fq.26.

<sup>180</sup> Alexandru Cojocaru. 2017. "Diagnoza e vendeve të punës në Kosovë." Banka Botërore, Washington, DC.

pushimit. Të nxitura nga kjo politikë, punëdhënësit janë të shtrënguar të mos angazhojnë në punë femra të moshës së re, duke u prirë për femra në moshë më të pjekur apo edhe në angazhimin e meshkujve në punën e caktuar. Ky është një veprim tipik i ndërmarrjeve kosovare; të vogla, mesme dhe të mëdha. Ato nuk ankohen vetëm për koston financiare të pushimit, por përballen edhe me prolongimin e proceseve si pasojë e rekrutimit të stafit të ri. Lidhur me këtë, sipas një hulumtimi të bërë nga Banka Botërore në Kosovë, nga fokusgrupet u mësua se punëdhënësit pyesin kandidatët për gjendjen sociale në familje.

#### 4.2.3 Struktura dhe trendet e papunësisë

Kosova është ndër vendet më të varfra të rajonit të Ballkanit Perëndimor, popullsia e së cilës ka kaluar nëpër sfida të shumta si ekonomike, politike e sociale, duke filluar nga kriza e fillimit të tranzicionit nga viti 1990, pastaj dëbimi i shqiptarëve nga vendet e punës e përcjellë kjo me varfëri të skajshme dhe me tortura të ndryshme, deri te lufta. Këto ngjarje dhe përpjekjet e popullit për liri, çuan në krijimin e një shteti sovran, por të varfér dhe me shumë probleme, të cilat kanë arritur të krijojnë pasiguri të madhe jetese, ku papunësia llogaritet të jetë 30.3% e popullsisë fuqi punëtore.<sup>181</sup> Kjo pasiguri jetese dhe jostabiliteti ekonomik e politik po përcillen me ikje masive të popullatës nga vendi. Kjo gjë ka dërguar në zvogëlimin e fuqisë punëtore, në rritjen e pesimizmit dhe në rritjen e dukurive jonormale në shoqëri, si vetëvrasjet, vrasjet ndër familje, kriminalitetit, sëmundjeve sidomos kardiovaskulare dhe nervore, etj. Në periudhën 2014-2016 azil nga Kosova në vendet e BE-së kanë kërkuar 110165 kosovarë, 71% e tyre në moshë pune, kurse 53% të moshës 14-34 vjeç.<sup>182</sup>

Ikja e fundit dallon nga ajo para luftës; kur shqiptarët u dëbuan nga vendet e punës, meshkujt e shtëpisë u detyruan t'i lënë familjet për të siguruar jetesën për veten dhe

<sup>181</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, [www.ask.rks-gov.net](http://www.ask.rks-gov.net), 2016

<sup>182</sup> Eurostat. Burimi: <http://bit.ly/1dBAzYR>

familjet e tyre. Ikja që po ndodh tani, për nga motivi është e njëjtë me atë para luftës: pamundësia për të siguruar një jetë për vetën dhe familjen, por tani kemi një tablo krejtësisht ndryshe sepse flasim për shpërngulje nga Kosova e lirë dhe e pavarur, të komplet familjes!

Sigurisht, këtu nuk mund të lëmë pa përmendur remitancat, të cilat, megjithatë, krijojnë dhe mbajnë gjallë njëfarë sigurie jo dhe aq në masë, por kanë qenë burim i vazhdueshëm i të ardhurave të popullsisë në Kosovë. Kosova llogaritet ndër dhjetë vendet që kanë të hyra më të mëdha nga remitancat dhe rrëth 13% e BPV-së vjen prej dërgesave nga jashtë.<sup>183</sup> Në vitin 2012, një përqindje prej 22.4% të familjeve të Kosovës ka pranuar remitanca nga anëtarët e familjes që jetojnë jashtë vendit (ASK, 2013). Shifrat e hyrjeve kanë mbetur pozitive gjatë gjithë viteve me luhatje të vogla, për shkak të krizës ekonomike në vendet dhe sektorët ku pjesëtarët e diasporës jetojnë dhe punojnë. Në vitin 2012, remitancat ishin 457 milionë € dhe përfaqësonin 9.3% të PBV-së (ASK, 2013). Deri në korrik 2013, remitancat arritën 272.4 milionë € dhe deri në fund të vitit, dërgesat kanë arritur shumën prej 632 milionë € (BQK, 2014). Këto shuma pozitive tregojnë se remitancat janë një nga komponentët më të rëndësishme të bilancit të pagesave dhe ndihmojnë uljen e deficitit të llogarisë rrjedhëse. Për më tepër, remitancat ndihmojnë në financimin dhe rritjen e konsumit në Kosovë, pasi që shumica e fondeve të dërguara shpenzohen për konsum.<sup>184</sup>

Duke e pasur parasysh numrin e popullsisë së diasporës në krahasim me popullatën rezidente në Kosovë (rrëth 700,000/1.8 milionë), ndikimi ekonomik i këtyre transaksioneve është i madh në raport me prodhimin e brendshëm të Kosovës dhe me rëndësi të madhe për hyrjet rezervë ndërkombëtare të Kosovës. Vetëm dërgesat personale përbënin 17% të BPV-së në vitin 2012, duke e bërë Kosovën një nga 15 vendet

---

<sup>183</sup> USAID, Kosovë: 2014-2018, Strategjia për Bashkëpunim dhe Zhvillim të Vendit

<sup>184</sup> Klima e biznesit në Kosovë- Zyra e Bashkimit Evropian, botues Instituti Riinvest, 2014

e para për sa i përket pranimit të remitancave në mbarë botën, në proporcion me madhësinë e ekonomisë vendore.<sup>185</sup> Madje, mund të themi se remitancat në Kosovë kanë treguar edhe një qëndrueshmëri më të madhe ndaj efekteve të krizës së fundit financiare globale, ndoshta nga fakti se diaspora kosovare më tepër është e përqendruar te shteti gjerman dhe ai zviceran, që karakterizohen me stabilitet finansiar dhe ekonomi të zhvilluar. Më ndryshe kanë kaluar shqiptarët e Shqipërisë, që jetojnë e punojnë në Greqi apo Itali, ku kriza është ndjerë shumë dhe vazhdon të ketë pasoja.

Megjithatë, këtu flasim për një gjendje mjaft të brishtë ekonomike. Pavarësisht përpjekjeve nga diaspora, pastaj edhe të instancave të tjera financiare ndërkombëtare për rimëkëmbje të ekonomisë, Kosova edhe sot e kësaj dite ballafaqohet me varféri të nivelit të lart, konkretisht sipas ASK-së, varfëria në Kosovë përfshin 44% të popullsisë dhe 14% e popullsisë është në varféri të skajshme, ndërkaq shkalla e papunësisë sillet rrehet 18%.<sup>186</sup> Sigurisht, këtu nuk flasim vetëm për mungesë të parave, por flasim për edhe për elemente të tjera që mundësojnë jetë normale dhe pa brenga. Një nga këto elemente që në Kosovë dominon më shumë dhe efektet e të cilës shihen në çdo instancë të jetës së njerëzve është papunësia.

Papunësia dhe varfëria janë elemente të cilët tregojnë nivelin e zhvillimit të një vendi. Kjo nuk do të thotë se papunësia në masën më të madhe tregon edhe nivelin e varfërisë, por, megjithatë, është faktor mjaft i madh, nga i cili edhe derivon varfëria. Pra, këto të dyja janë në korrelacion të drejtë njëra me tjetrën. Lexuesit mund të thonë po, sigurisht, ku ka papunësi ka edhe varféri. Edhe është drejtë të thuash kështu. Por, në realitet ndodh edhe

---

<sup>185</sup> Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë 2014, Migrimi si forcë për zhvillim, UNDP

<sup>186</sup> VARFËRIA NË KONSUM NË REPUBLIKËN E KOSOVËS NË PERIUDHËN 2012 - 2015  
Banka Botërore Rajoni i Europës dhe Azisë Qendrore Praktika Globale për Varfërinë dhe Barazinë [www.worldbank.org](http://www.worldbank.org)

Agjencia e Statistikave të Kosovës Departamenti i Statistikave Sociale Sektori i Standardit Jetësor [www.ask.rks-gov.net](http://www.ask.rks-gov.net) Prill 2017.

kështu: që varfëria të jetë e lartë, e të mos ketë papunësi të lartë, ose të rritet varfëria e të mos rritet papunësia dhe e kundërta.

Papunësia nuk është e lidhur vetëm për individin, ajo shkakton probleme zinxhir që i shkaktojnë humbje të mëdha dhe afatgjata vendit dhe të gjitha këto bëjnë që vendi të bëhet i varfër edhe vatër e korruptionit dhe problemeve të mëdha sociale. Papunësia në Kosovë karakterizohet me elemente ndryshe nga të gjitha vendet e tjera të rajonit, sepse hyrjet në tregun e punës apo fuqia punëtore e re vetëm e rrisin numrin e të papunëve, por, gjithashtu, edhe daljet nga tregu i punës janë të mëdha, duke e lëshuar vendin apo edhe duke pushuar së kërkuar punë. Të papunë konsiderohen njerëzit, të cilët nuk janë në një marrëdhënie pune, por që janë fuqi punëtore dhe se janë në kërkim aktiv të punës ose presin të rikthehen në punë.<sup>187</sup> Kosova ka një popullsi prej 1.8 milionë banorësh<sup>188</sup> ku 297.090 familje kanë nga 5.9 anëtarë.<sup>189</sup>

Përpos që është një situatë e rënduar me papunësi të madhe, edhe ata punëtorë që janë të inkuadruar në tregun e punës mund të shihen si problem, pasi shumica e vendeve të punës në sektorin privat janë të paqëndrueshme. Pjesa dërrmuese e punëve në Kosovë llogaritet si e paqëndrueshme. Meshkujt kanë më shumë gjasa për të mbajtur punë të tilla të paqëndrueshme (25.0% e meshkujve të punësuar krahasuar me 18.9% të femrave të punësuara). Shprehur në numra, 80,700 nga 338,364 të punësuar i përkasin kategorisë së punësimit të paqëndrueshëm.<sup>190</sup>

Po ashtu, në bazë të disa fakteve të publikuara nga Banka Botërore, llogaritet se Kosova ka BPV-në më të ultë nga shtetet e rajonit, konkretisht gjer në vitin 2013, Kosova numëron vetëm 2708€ për kokë banori në vit, duke u përcjellë nga Shqipëria, që numëron rrëth

---

<sup>187</sup>A. Manfellari, S. Hadri, Dh. Kule, S. Qiriçi. Hyrje në Ekonomi. Tiranë, 2002. fq. 341

<sup>188</sup>Sipas Entit të Statistikave të Kosovës, nga regjistrimi i popullsisë bërë me 21 shtator 2012


<sup>189</sup>Po aty. 2014

<sup>190</sup>Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore 2013 në Kosovë, ASK

3.092€, pastaj vjen Bosnja me 3.430€, për t'u pasuar nga Maqedonia me 3545€, Serbia me 3930€, ndërsa Mali i Zi llogaritet si shteti fqinjë me BPV-n më të lartë në vitet e fundit, me rreth 5.275€.<sup>191</sup>

Gjithsesi, kur flasim për papunësinë duhet shtuar se të dhënat përqindjet luhaten, ngase në Kosovë janë tri institucione shtetërore që merren me përpilimin dhe publikimin e këtyre të dhënave; Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (Raporti i performancës, Puna dhe punësimi), Agjencia e Statistikave të Kosovës (Anketa e fuqisë punëtore), si dhe Fondi i Sigurimeve Pensionale të Kosovës, (Raportet vjetore mbi kontributet/pensionet). Ne, në pothuajse tërë punimin, do t'i referohemi të dhënave nga ASK-ja. Në fakt, në bazë të statistikave të disponueshme nga ASK-ja, numri i të të punësuarve rritet me një ritëm shumë më të shpejtë se numri i të papunëve.

Grafiku 19. *Papunësia/ Punësimi e Shprehur në Numra në Kosovë për Periudhat 2006-2016*



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, [http://askdata.rks-gov.net\\*](http://askdata.rks-gov.net*), Aleanca Kosovare e Bznsit\*\*, Kalkulime të autorit.<sup>192</sup>

<sup>191</sup> [www.worldbank.org](http://www.worldbank.org) 2014


<sup>192</sup> **Shënim:** baza e është dhënavë për llogaritje të numrit të të punësuarëve gjegjësisht të papunëve janë përqindjet e deklaruara në Anketën e Fuqisë punëtore të raportimeve tremujore të ASK-së, ndërsa është

Siç shihet nga grafika, numri i të papunëve, sidomos në vitet e fundit, ka rënë dukshëm dhe po në njëjtën kohë, është rritur dukshëm numri i të të punësuarve. Shtojmë këtu se, nëse i krahasojmë me një logjikë të thjeshtë me ritmin e numrit të ndërmarrjeve të reja, atëherë janë në proporcion të drejtë.

Pjesa më e madhe e të të punësuarve janë në sektorin e tregtisë me pakicë dhe me shumicë, sektor në të cilin është i koncentruar investimi më i madh i mjeteve.

Gjithsesi, e kemi shpjeguar edhe më lart se ndërmarrjet prodhuese që nga viti 2008 kanë pasur ngritje dhe kjo ka bërë që edhe numri i të punësuarve të rritet për këtë sektor

*Grafiku 20. Trendi i Rritjes së të Punësuarve në dy Industritë më të Zhvilluara në Kosovë për Periudhat 2008-2016*



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, <http://askdata.rks-gov.net>. Kalkulime të autorit

Shohim se në të dyja kategoritë kemi rritje të trendit, por që numri i të punësuarve rritet më shpejtë se sa numri i të papunëve. Në bazë të rezultateve të cilat janë të paraqitura në

---

marrë një pjesë edhe nga Raporti i Hulumtimit të Tregut të Punës nga Alenaca Kosovare e Biznesit AKB për vitet 2006-2008 dhe 2010-2011 në mungesë të të dhënave nga AFP-ja. Nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, përqindja e nurmit të të punësuarve është përkthyer në numër, në kalkulim me numrin e të punësuarëve nga AKB-ja.

pjesën e metodologjisë, rritja e numrit të të punësuarve është dashur të jetë efekt i rritjes së performancës së NVM-ve, por duket se punësimi informal e arsyeton faktin se pse politika të tillë si kreditë dhe subvencionet nuk arrin të rezultojnë me ndikime të ndjeshëm në punësim formal.

#### **4.2.4 Manifestimi i papunësisë përmes varfërisë në Kosovë**

Varfëria është koncept më i gjërë se sa të thuash se njerëzit nuk janë të punësuar dhe se nuk kanë të ardhura mujore ose në periudha të tjera. Vendet me probleme ekonomike dhe atyre të pasluftës janë vendet tipike nga të cilat mund të nxjerrim në pah kuptimin e plotë të varfërisë.

Varfëria absolute i referohet mungesës së kërkesave bazë për ruajtjen e ekzistencës fizike e të shëndetshme, ushqim dhe strehim (mungesa e ujit të pijshëm, e kulmit mbi kokë).<sup>193</sup> Në Kosovë, siç kemi cekur më lart, niveli i varfërisë është 44% dhe varfëri e skajshme deri në 14%, të dyja këto përbëjnë varfërinë në total<sup>194</sup> dhe përbëjnë nivelin më të ultë të BPV-së për kokë banori, konkretisht 1.117 euro. Shqipëria llogaritet, po ashtu, si ndër vendet e varfra, e cila, sidomos ndërmjet viteve 1950-1990, kishte kaluar një periudhë të vështirë sa ishte nën sundimin e sistemit komunist, kur vendi ishte i izoluar nga vendet e tjera. Shqiptarët jetuan si mos më keq, sistemin e karakterizonte sidomos sistemi i keq shëndetësor, gjë që reflektonte mungesën e ndjenjës për përkujdesje ndaj popullit, ndërkohë që motoja e pushtetit ishte “Shëndeti i popullit është në qendër të politikës së shtetit”!.<sup>195</sup>

Shtrirja e papunësisë në Kosovë është më tepër e shprehur në zonat rurale e manifestuar në forma të ndryshme dhe kjo më së shumti në rajonin e Mitrovicës, Gjakovës dhe

---

<sup>193</sup> Measuring Inequality, The World Bank, 2011.

<sup>194</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, Hulumtimi i buxhetit të familjeve kosovare 2012-2013, fq 7.

<sup>195</sup> Kushtet e jetës dhe të pabarazia në Shqipëri. Regjistrimi i popullsisë 2001. INSTAT

Prizrenit. Konform kësaj, edhe niveli i jetesës është më i ultë, e që transmeton ndoshta shkallën më të lartë të varfërisë në Kosovë.

Në vitet e fundit edhe Prishtina është duke u karakterizuar me rritje të shkallës së varfërisë. Cekim këtu se pas luftës ka pasur emigrim të individëve në masë të madhe nga komunat e Kosovës për në kryeqytet - Prishtinë, diku rrëth 500 mijë persona, ndërsa shpërndaja e buxhetit është bërë vetëm për rrëth 210 mijë banorë, sepse aq banorë mendohet se ka Prishtina (ende nuk ka ndonjë regjistrim, kjo e fundit sipas Zyrës së sektorit të popullsisë në ASK).

Për shkak se kemi zhvillim të ngadalshëm të ekonomisë në Kosovë, kjo nuk na lejon të themi nëse kemi dallime fshat-qytet sa i përket varfërisë. Kemi një përqindje shumë të vogël, deri në 2% më të ultë në qytet, por nuk ka ndonjë element që e mbështet faktin nëse ka dallime të dukshme si shkallë e varfërisë në përgjithësi. Megjithatë, nëse i marrim përbazë elementet specifike të varfërisë, ky 2% është i shprehur në elemente si mundësia e qasjes në institucione shëndetësore, infrastruktura, mundësia e lëvizjes së njerëzve, kushtet e jetesës, këtu potencojmë që zonat rurale janë më të varfra se ato urbane. P. sh. në familjet që jetojnë në zonat rurale vetëm 10% e tyre posedojnë ngrohje qendrore në shtëpi, ndërsa në familjet që jetojnë në zonat urbane pothuajse të gjitha kanë. Kurse, sa i përket qasjes në shkolla dallimi sa vjen e zgjedhur sepse gjithnjë e më shumë janë duke u krijuar kushtet për arsim edhe në zonat rurale. Këtu theksojmë se, për shkak të migrimit masiv të popullatës pas luftës nga zonat rurale në ato urbane, cilësia e arsimit në zonat rurale ka rënë për shkak të mungesës së pedagogëve të përgatitur dhe mundësisë së inkadrimit të kuadrit të kualifikuar nga institucione arsimore të shquara.

Pastaj, qasja në institucione shëndetësore është më e vogël dhe kjo vështirëson jetën e qytetarit dhe rrit presionin e sigurisë shëndetësore. Kushtet e banimit gjithnjë e më shumë janë duke u përmirësuar në fshatra dhe janë duke ulur pabarazinë në shpërndarje të ujësjellësit deri në shtëpi dhe infrastrukturës rrugore. Po ashtu, mundësitet e

transportimit të udhëtarëve janë rritur në fshatra dhe kanë arritur ta ulin pabarazinë me situatën në pjesën urbane

Ndërkojë që themi se varfëria është më e shprehur te familjet me më shumë anëtarë dhe me fëmijë me moshë të përafërt, të cilët duke u rritur përnjëherë, i rrisin edhe kërkosat po ashtu, dhe kjo krijon presion dhe e rrit shkallën e varfërisë në familje.<sup>196</sup> Numri i madh i anëtarëve në familje është element që i karakterizon familjet shqiptare dhe në zonat rurale në veçanti.

Në Kosovë, varfëria është më shumë e shprehur te familjet që nuk kanë të ardhura mujore, që do të thotë nuk janë të në marrëdhënie pune apo edhe nuk kanë ndonjë të hyrë, e cila do t'u siguronte blerjen e mallrave dhe shërbimeve të mjaftueshme, dhe kjo i bën që ato të mos jenë në gjendje t'i plotësojnë kërkosat e tyre.

Po ashtu, pas luftës, shumë familje kanë mbetur me kryefamiljare femra dhe kjo ka ndikuar që ato të kenë më pak qasje në jetën dinamike dhe të krijojnë, në forma të ndryshme, të hyra përfëmijët.

Përmendim këtu edhe një fakt tjeter, që një kategori e këtyre grave kryefamiljare të një moshe më të madhe, mbesin jashtë tregut të punës jo se hezitojnë, por se ato janë të një gjenerate më të vjetër (flasim përgatitje si pasojë e luftës) më pak të arsimuar, gjë që i penalizon në përfshirjen në punë, duke e shtuar kështu numrin e popullsisë inaktive në tregun e punës. Ato mundohen që me artizanate dhe me prodhime bujqësore ta mbajnë familjen. Në Kosovë, diskriminimi gjinor ka rënë dukshëm, por është ende i shprehur

---

<sup>196</sup> Këto të dhëna janë bazuar në hulumtimin e bërrë në vitin 2007 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (atëherë Enti i Statistikave të Kosovës), dhe në mungesë të të dhënave tjera.

diskriminimi në proceset e vendimmarrjes dhe përfaqësimit të bindjeve qoftë të familjes apo grupeve shoqëror, bie fjala përfaqësimi i grave në politikë.

Kohët e fundit është shfaqur një tjetër fenomen, ai i braktisjes së vendbanimeve sidomos zonat rurale, dhe kjo ka bërë që të bjerë dukshëm numri i nxënësve, që është më shumë indikatorë i tendencës për rritje të varfërisë. Në vitin 2014, numri i nxënësve në arsimin fillor dhe atë të mesëm në sektorin publik dhe privat, ishte 275,887 nxënës.<sup>197</sup> Ndërsa në vitin shkollor 2013/2014 numri i përgjithshëm i nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm ishte 460,969.<sup>198</sup> Si pasojë e kësaj lëvizjeje, shumë shkolla janë mbyllur, cilësia e atyre që kanë mbetur me më pak nxënës (1-10) ka rënë dukshëm dhe ekziston rreziku i mbylljes së tyre. Kjo i kontribuon rënies së numrit të të punësuarve.

#### 4.2.5 Dobësitë e zhvillimit të NVM-ve në Kosovë

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Kosovë përballen me shumë bariera, përveç atyre me të cilat përballen në përgjithësi NVM-të. Arsyja e parë është se ato kanë mungesë të mjeteve dhe bankat nuk janë faktor që i mbështesin ato në emër të themelimit të tyre. NVM-të si burime të tjera financimi i kanë burimet familjare, të cilat janë pa kushte dhe afatgjata, por që nuk janë të mjaftueshme.

Sipas një hulumtimit të bërë si rezultat i konsulencës intensive, konsulentët e korporatave ndërkombëtare, kanë rezultuar me përfundime shumë interesante për ekosistemin e NVM-ve në Kosovë apo rrethanat dhe faktorët me të cilët ballafaqohen ato.<sup>199</sup>

Sipas këtij raporti, NVM-të karakterizohen nga këto pengesa zhvillimore, që i bëjnë të jenë joproduktive dhe aq më tepër, jokonkurrente:

---

<sup>197</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2015

<sup>198</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2014

<sup>199</sup> Bizneset Fillore dhe Shërbimet për Mbështetjen e Bizneseve Fillore në Kosovë, Mistria e Tregtisë së Kosovës

- **Treg i mbrojtur** - Kosova është një vend i vogël dhe shumë i kufizuar, si nga vëllimi i aktiviteteve, shtrirjes dhe kapaciteteve. Si e tillë, ajo nuk është shumë joshëse për shitësit e huaj të mëdhenj, pasi që Kosova nuk është mjedis biznesor për shitje të produkteve me cilësi e standarde të larta. Kështu që tregu mbetet i lirë për tregtues të vegjël, të cilët, duke shfrytëzuar paga të ulëta, bëjnë përfitime të mëdha dhe cilësi të ulët menaxhimi.
- **Perceptimi i çmimit të ultë** - është një tjetër element që e karakterizon veprimtarinë e NVM-ve në Kosovë. Perceptimi se vetëm mallrat me çmime të ulëta shiten, ka bërë që aspektet e tjera të produktit të mos kenë ndikim dhe se i vetmi është çmimi përmes të cilit bëhen diferencime, ndërsa produktet kopjohen.
- **Menaxhimi nga familja** - është tipike e qasjes së kulturës kosovare të të bërit biznes, pasi që njerëzit nuk kanë besim te njerëzit e tjerë në mënyrë që t'ua besojnë punën menaxhuese me kapitalin e tyre. Pa njerëz të kualifikuar e profesionalë nuk mund të hartohen strategji zhvillimore të biznesit, andaj funksionimi i tyre bëhet ad hoc, nuk i garanton qëndrueshmëri biznesit.
- **Mungesa e fokusit:** në këtë raport është shpjeguar shumë mirë se si bizneset në Kosovë janë të shtrira në biznese të gjera si : mobileri, ndërtim, përpunim të ushqimit, etj. Ato menaxhohen nga një persona dhe është treg i gjerë. NVM-të duhet të krijojnë biznese të veçanta në mënyrë që tëjenë në gjendje ti orientojnë potenciale ka fusha më të gjera të biznesit.
- **Mungesa e perspektivës strategjike** - është një tjetër faktor që, sipas këtij raporti, e dëmton zhvillimin e NVM-së në Kosovë. Fitimet e shpejta i kanë bërë pronarët dhe menaxherët e firmave të vogla ta harrojnë strategjinë zhvillimore afatgjatë. Biznese të tilla janë lindur dhe ideja ka ndezur “aksidentalish” dhe është bërë referencë për hapje të firmave tjera, të cilat e ngopin tregun dhe kështu shuanjë mundësitë përrritje të firmave ekzistuese.
- **Standardet internacionale dhe certifikimi** - Këto dy procese nga kompanitë kosovare shihen si të panevojshme, të kushtueshme dhe thjesht një letër në mur.

Por, sipas raportit, thuhet se blerësit ndërkombëtarë nuk do të rrezikojnë të blejnë produkte të pabazuara në ndonjë certifikim e standardizim të cilësisë. Një gjë të tillë e ka bërë edhe Shqipëria, duke i detyruar të gjithë shitësit në vend t'u nënshtrohen këtyre proceseve.

- **Lodhja nga trajnimet** - edhe kjo karakteristikë është tipike për kulturën e të bërit biznes në Kosovë. Vendimmarrësit në bizneset e Kosovës nuk besojnë se një formalizim i njohurive menaxheriale do të kishte ndikim në rritjen e firmës apo përmirësimin e performancës së saj.

Mund të themi se deri më tanj, ndoshta, ndihma më e frekuentuar dhe më e shpeshta ka qenë ofrimi i ligjëratave apo trajnime për rritje të cilësisë së të menaxhuarit, duke u ofruar praktika të ndryshme nga raste të ndryshme. Mendoj se këto trajnime nuk kanë pasur ndonjë kontroll të mirëfilltë për përbajtjen, rëndësinë dhe impaktin që ato mund të kenë në arritjen e objektivave të tyre. Kjo mund të vërehet nga disponimi i menaxherëve apo vendimmarrësve të bizneseve për të marrë pjesë fizikisht në të shumtën e rasteve, por edhe nga aktivizimi ose jo i atyre që marrin pjesë.

Kjo situatë ka krijuar tek ata rezistencë për të qenë kontribuues në rritjen e efektit të këtyre mbështetjeve. Realisht, nuk është vërtetuar se nëse ata do të jenë vërtet aktivë dhe të interesuar për të qenë pjesëmarrës konstruktivë, se do të ketë rritje apo jo. Por, një gjë është e sigurt; mësimi nga praktika të mira është një instrument shumë i mirë për t'i ndihmuar vendimmarrësit ta drejtojnë kapitalin e tyre në rrugë fitimprurëse.

- Si dhe e fundit karakteristikë e nxjerrë nga ky raport, thuhet se NVM-të në Kosovë mbështeten shumë në grante. Grantet janë një formë shumë e mirë e përkrahjes së bizneseve, sidomos atyre fillestare, por në vende të varfra si Kosova, me nivel të lart të korruptionit dhe GDP të ultë, në të shumtën e rasteve dështojnë të realizojnë misionin e tyre.

Grantet janë mjete të cilat jepen për qëllim të motivimit të iniciativave dhe rritjes e zhvillimit të bizneseve ekzistuese. Nëse kjo mundësi do të shfrytëzohej dhe mendohej gjithnjë në formën vetëm që të përfitohen meqë janë mjete pa kthim, është e rrezikshme pasi që përpos që iniciativat mund të jenë të bazuara në projekte fiktive, edhe ndërmarrjet ekzistuese mund të bëhen të varura dhe mos të kenë mundësi të zhvillohen pa u mbështetur. Andaj, mendoj se kjo ka ardhur si rezultat i mungesës së një kornize afatgjatë të zhvillimit të bizneseve të reja dhe mungesës së analizës së thuktë ose neglizhencës së nevojave të sektorëve të veçantë përkrahje, pra aty ku ka mundësi të krijohen e zhvillohen ide të reja, ide ndryshe.

## KAPITULLI V- FORMAT E PËRKRAHJEVE TË NVM-VE NË KOSOVË

Roli i NVM-ve është i pakontestueshëm kur e kemi fjalën te pjesëmarrja në zhvillimin ekonomik. Ato, pra, janë bartëse të zhvillimit ekonomik përmes krijimit të ideve të reja, duke sjellë ndryshime përmes qasjeve inovative dhe kreative. Për shkak të karakteristikave të cilat janë përshkruar në kapitullin e tretë të këtij punimi, në kohë krizash këto ndërmarrje janë shumë të ndjeshme. Kështu, një ambient armiqësor nuk është i përshtatshëm për zhvillimin e tyre. Madje, këto rrethana bëhen edhe shkaktare të falimentimit të tyre, andaj edhe duhet menaxhuar dhe trajtuar mirë këtë sektorë të ekonomisë. Sipas **Hatten, T.S.**<sup>200</sup>, ndër shkaktarët kryesorë të dështimit të bizneseve janë: menaxhimi joadekuat dhe financimi joadekuat.

Andaj, për zhvillimin e qëndrueshëm të tyre, ato kanë nevojë që të përkrahen finansiarisht dhe jo vetëm finansiarisht. Kompanitë e mëdha më nuk janë në gjendje të përcjellin dinamizmin e zhvillimit ekonomik, pavarësisht se është karakteristikë e bizneseve të mëdha që ta nuhasin rrezikun më herët se ato të voglat. Ato nuk janë në gjendje të adaptohen lehtë në kushte dhe rrethana të ndryshuara ose t'u përshtaten lehtë rrethanave të reja. Nga ana tjeter, ndërmarrjet e vogla karakterizohen më shumë me fleksibilitet. Këto ndërmarrje nuk kërkojnë shumë kapital fillestar, ato kërkojnë më shumë ambient të përshtatshëm për ta ushtruar veprimtarinë e tyre dhe mbështetje në fazat e para të lulëzimit. Në vende ku rrethanat janë të rrezikshme për iniciativat e lira, aftësitë sipërmarrëse nuk mund të vihen në mënyrë të drejtë në funksion. Kështu, kriyat e fundit nëpër botë, kanë vënë më pah nevojën për politika imediate dhe më efektive për përkrahje të sektorit privat në përgjithësi, e bizneseve të vogla në veçanti.

---

<sup>200</sup> Hatten, T. S., & Coulter, M. K. (1997). *Small business: Entrepreneurship and beyond*. Upper Saddle River, N.J: Prentice Hall

Që të nxitet zhvillimi ekonomisë së ndërmarrësisë është e nevojshme që shteti të krijojë sistem për përkrahjen e zhvillimit të tij. Ky fakt, te vendet e zhvilluara është pasqyruar qartë që nga vitet '80 të shekullit XX dhe njëherësh rezultatet e kësaj përkrahjeje janë të pakontestueshme. Në këtë sistem të përkrahjes janë kyçur shteti, agjencitë e ndryshme qeveritare, organizatat vullnetare, organizatat joqeveritare, institutet dhe agjencitë publike, të cilat janë organizuar dhe aftësuar që të ofrojnë shërbime dhe përkrahje të ndryshme ndaj NVM-ve.

Ndërmarrësia është term i cili më së shumti zë vend dhe adaptohet në ekonomitë e tregut të lirë, atëherë lind pyetja; pse vallë gjithmonë rekomandojmë që ato duhet të ndihmohen, gjersa implementimi i idesë do të bëhej më së miri me një ndërhyrje minimale të faktorëve tjerë, e sidomos e shtetit?

Thamë edhe më lart se NVM-të kanë më shumë nevojë për ambient të sigurt se sa për përkrahje financiare. Qëllimi i përgjithshëm i përkrahjes së NVM-ve dhe ndërmarrësisë është që t'u ndihmohet më së shumti atyre ndërmarrjeve të cilat kanë perspektive të mirë në të ardhmen, si në procesin e prodhimit ashtu edhe në atë të realizimit, e, nga ana tjetër, shpenzimet e ndërmarrjeve disi të minimizohen. Përkrahja bëhet nëpërmjet rrjeteve të organizuara institucionale - publike, private, shtetërore dhe vullnetare.

Në dekadat e fundit nga përkrahja klasike e zhvillimit të NVM-ve dhe ndërmarrësisë (nëpërmjet përkrahjes financiare, lehtësimeve tatimore, doganore, subvacioneve, etj.), gradualisht është kaluar në forma të tjetra të përkrahjes, e cila bëhet nëpërmjet inkubatorëve të biznesit, rrjeteve biznesore, engjëjt e biznesit, fondet e riskut, parqeve shkencore e biznesore etj.

Fondet joformale të financimit të bizneseve të reja luajnë rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e tyre. Me këto fonde nënkuptojmë fonde të angazhuara nga palë që nuk paraqesin ndonjë institucion apo etnitet, të tillë janë fondet vetanake, fondet nga familja dhe ato të siguruara nga shoqëria të ashtuquajtura "engjëjt e biznesit", e që në Kosovë rolin e engjëjve të biznesit e luajnë fondet nga diaspora. Në SHBA, sipas **Jeffreyu Sohlu-t**,

janë të regjistruara 300-350 mijë si aktive këto lloje organizimesh, të cilët gjatë vitit investojnë më shumë se 30 miliardë dollar, në mbi 50.000 projekte dhe është vendi lider në përdorimin e kësaj forme të financimit.<sup>201</sup> Në Evropë janë të regjistruar rreth 75 mijë të tillë, me një shumë vjetore të investimeve prej rreth 4 miliardë eurosh, që paraqet një përfaqësim shumë më modest të këtij burimi të financimit. Në Mbretërinë e Bashkuar ka 20.000-40.000 engjëj biznesi, të cilët investojnë tërësisht prej 0.5-1 miliardë funte gjatë një viti në 3.000-6.000 sipërmarrje. Ata përfaqësojnë burimin më të madh joformal të kapitalit të investuar për NVM-të dhe mesatarisht 9 nga 10 investitorë engjëj hyjnë në fazën fillestare (start-up) të kompanive me rreth 20 të punësuar. Me këtë themi se aty ku ka investime më të vogla për ndërmarrjet e vogla dhe ato të reja (start-up) edhe performanca dhe produktiviteti i tyre janë të zbehta.

Ndërsa të gjitha mjetet tjera që nuk janë nga këto lloje fondesh, konsiderohen si fonde të huazuara nga etnitete të organizuara si qeveria, organizata jo qeveritare, institucionale bankare, mikrofinanciare, investimi në aksione, e fonde të tjera.

Në fazën fillestare dhe fazën start-up, kursimet personale dhe kreditë nga familjarët dhe miqtë janë burimi më i rëndësishëm i financimit për shumicën e ndërmarrësve. Financimi nga huamarrja nga bankat komerciale dhe institucionet e tjera financiare do të përdoret vetëm nëse është tërësisht e nevojshme dhe me kusht që ajo të jetë në dispozicion. Huamarrja në këtë fazë është shumë problematike për shkak shkallës së lartë të rrezikut dhe pasigurisë së rezultateve të biznesit të ndërmarrjes. Programet e ndryshme shtetërore për mbështetje të fillestarëve në biznes, gjithashtu janë një burim i rëndësishëm për sigurimin e mjeteve financiare.

Përzgjedhja e financimit për aktivitetin ndërmarrës dhe realizimi i suksesshëm është një nga segmentet kryesore të zhvillimit të NVM-ve. Këtu duhet theksuar se pjesa më e

<sup>201</sup> Best Practice Guidance for Angel Groups – Deal Screening Shira Cohen, Columbia University July, 2007

madhe e financimit të ekonomisë, veçanërisht të NVM-ve, bëhet në tregun formal të kapitalit.

Të dyja format e investimit apo financimit të NVM-ve janë të pranishme edhe në vendet e zhvilluara dhe jo të zhvilluara, vetëm se masa e tyre dhe efekti varet nga niveli i zhvillimit ekonomik. S'do shumë mend për të kuptuar që në vendet e zhvilluara, masa e financimeve nga kapitali formal është më e madhe dhe, duke marrë në konsideratë faktin se përqindja më e madhe e financimit të NVM-ve bëhet nga kapitali formal, këto vende janë më prosperuese duke iu falënderuar këtyre bizneseve.

Në vendet në zhvillim, nevoja për përkrahje nga fondet formale të financimit është shumë e madhe, por në fakt ato më shumë përkrahen nga kapitali joformal. Në Kosovë, remitancat, sidomos, historikisht kanë luajtur rol shumë të rëndësishëm qoftë në mbijetesën e njerëzve, por dhe në zhvillimin e biznesit privat

Menjëherë pas luftës, fondet formale në mënyrë shumë dinamike kanë dhënë efekte dukshme në zhvillimin e bizneseve të reja sidomos sektori bankar.

### **5.1 PËRKRAHJA NGA QEVERIA**

Formë shumë e veçantë e përkrahjes së NVM-ve është ajo nga programet shtetërore të financimit. Këto janë në përgjithësi forma të financimit të pakthyeshme, siç janë, fjala vjen, subvencionet dhe grantet.

Qeveria është faktor shumë i rëndësishëm për jetën e ndërmarrjeve sepse ajo në mënyrë direkte dhe indirekte ndikon në proceset zhvillimore të saj. Qeveria, përmes dikastereve të saj, cakton normat tatimore, shumë të rëndësishme për të ardhurat e firmës, pastaj cakton ligjet për themelimin, shuarjen dhe për të gjitha veprimet ekonomike që mund t'i bëjë një firmë. Qeveria krijon industri dhe kushte përfunksionimin e industrive në mënyrë që ta reduktojë importin, duke krijuar mundësi prodhimi dhe tregti të produkteve vendore. Ato ndihmojnë përmes formave të ndryshme si trajnimet, asistenca teknike,

grantet e subvencionet, financimi i teknologjive të reja, dhënia në shfrytëzim e tokave, lehtësim për qasje në financa kryesisht përmes garantimit të kredive, promovimin e tyre jashtë vendit, dhënie të informacioneve dhe këshillimeve biznesore, ekspertizave, krijimin e inkubacioneve, etj. Andaj, pa përkrahjen e institucioneve publike, sektori privat nuk funksionon.

Sigurisht, meqë sektori privat shihet si treg i lirë, ndërhyrja e shtetit në veprimtarinë e lirë tregtare është parë ndryshe nga shkencëtarë të ndryshëm, duke krijuar edhe shkolla e qëndrime të ndryshme lidhur me këtë çështje, përmendim këtu shkollat më të njohura: shkolla klasike dhe ajo kenjsiane. Qëllimi i përkrahjes së programeve shtetërore për zhvillimin e NVM-ve është i fokusuar në ndërtimin e një ambienti të përshtatshëm për biznes, duke iu krijuar lehtësi financiare, administrative dhe teknike. NVM-të janë një pjesë e sektorit privat, ato janë pjesë e mundësive të mëdha të zhvillimit ekonomik, por në saje të mundësive të tyre zotërojnë masën prej 60% të zhvillimit ekonomik, **rreth 80.7%** e punësimit dhe rreth 99% e të gjithë sektorit të ndërmarrjeve, prandaj është e rëndësishme ta vëmë në pah rolin e politikave mbështetëse për këtë sektor.

Janë shumë punime të cilat shkruajnë për ndikimin e qeverisë në sektorin privat përmes formave të ndryshme, e veçanërisht përmes mbështetjes së iniciativave të reja dhe start-up-ve .<sup>202</sup> Ato tregojnë për rolin thelbësor që ka qeveria në zhvillimin e ndërmarrjeve në

---

<sup>202</sup> A.A. Jahanshahi , K.Nawaser , S. M.Sadeq Khaksar, A. R. Kamalian, The Relationship between Government Policy and the Growth of Entrepreneurship in the Micro, Small & Medium Enterprises of India, , J. Technol. Manag. Innov., Volume 6, Issue I, 2011.

R. A. Blackburn and M.T. Schaper, Government, SMEs and Entrepreneurship Development Policy, Practice and Challenges, , Indiana University, USA, October 2012

T. Tambunan, IJAPS, SMEs Development In Indonesia: Do Economic Growth nd Government Support Matter?, Vol. 4, No. 2 November 2008, fq 122.

S. H. Mohamad, N. A. Othman1 , J. Jabar , I. A. Majid, M. F. Kamarudin. Journal of Technology Management and Technopreneurship, Vol. 2 No. 2 July - December 2014, ISSN: 2231-7996

përgjithësi, e të të rejave në veçanti. Pavarësisht faktit se në Kosovë është një numër i konsiderueshëm i dikastereve që merren me çështjet e zhvillimit ekonomik, por krijimi i Ministrisë së Ndërmarrësise dhe Inovacionit është një hap i mirë për të nxitur e zhvilluar ide të reja. Pastaj, qeveria e Kosovës ka formuar edhe agjenci për mbështetje të NVM-ve, siç është agjencia KIESA, përmes programeve të shumta të mbështetjes financiare dhe jofinanciare dhe funksionon në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, pastaj Agjencia për regjistrimin e bizneseve në Kosovë që kontribuon në përmirësimin e kushteve për themelim të NVM-ve, Agjencia kosovare për standardizim e cila ndihmon krijimin e një konkurrence lojale përmes miratimit dhe harmonizimit të standardeve për aktiviteteve ekonomike, pastaj krijimi i lehtësive për ndërmarrjet private përmes themelimit të zonave të lira ekonomike dhe parqeve biznesore.

### **5.1.1 Ndryshimet mbi ligjin e tatimeve**

Qeveria e Kosovës, për ta ndihmuar sektorin privat, ka realizuar edhe një sërë ndryshimesh fiskale. Në mars të vitit 2015, qeveria vuri në fuqi pakon e re fiskale e nxitura nga një deficit i lartë buxhetor dhe shpenzime të larta kapitale, por edhe rritja e pagave në sektorin publik, si dhe refleksioni i zgjedhjeve elektorale. Përpos ndryshimit të normës së reduktuar të TVSH-së nga 16% në 8% për produkte të zakonshme, ka rritur normën

---

F. M. Simiyu, G. S. Namusonge, M. Sakwa. Effect of Government Policy and Regulations on the Growth of Entrepreneurial Women Micro and Small Enterprises in Kenya, International Journal of Research in Business Studies and Management , Volume 3, Issue 10, October 2016, fq. 12-26,

G. Moscarini and F. Postel-Vinay The Contribution of Large and Small Employers to Job Creation in Times of High and Low Unemployment, *American Economic Review* 2012, 102(6): 2509–2539

DAVID C. TOOMEY , South African small business growth through interfirm linkages, , RHODES UNIVERSITY, 1998, fq 100

S. OUM, D. NARJKO, C. HARVIE Constraints, Determinants of SME Innovation, and the Role of Government Support, , May 2014

standarde nga 16% në 18% me qëllim për ta nxitur konkurrencën në tregun e brendshëm dhe për ta zvogëluar evazionin fiskal. Ndryshimet janë bërë edhe në Ligjin për TVSH-në për ta ulur pragun prej 50,000 në 30,000 euro të të ardhurave, që nënkupton se bizneset që e tejkalojnë këtë shumë të ardhurash, janë të obliguara që të regjistrohen për pagesë të TVSH-së. Sipas një shkrimi të institut GAP (prononcime nga ATK-ja) nga ky ndryshim i ligjit për TVSH-në, numri i bizneseve që do të paguajnë TVSH-në është rritur nga 14560 në 16350.

Pastaj, për t'i lehtësuar kushtet për sektorin privat, i cili përballet me vështirësi për qasje në financa dhe kosto të lartë të kapitalit, reforma fiskale përfshin edhe lirimin nga TVSH-ja në import të linjave të prodhimit dhe inputet për prodhuesit vendorë. Numri i bizneseve të cilat kanë aplikuar për lirime në lëndën e parë nga TVSH-ja në periudhën dhjetor 2015-shtator 2016 është gjithsej 183, ndërsa numri i lëndëve të aprovuara 242. Ndërsa, vlera e importit të lëndës së parë të liruar nga dogana në periudhën janar-gusht 2016 është rreth 62.3 milionë euro apo 10.2 milionë euro ngarkesë e TVSH- së.<sup>203</sup>

Në mënyrë të ngjashme, pajisjet e teknologjisë informative janë përjashtuar nga TVSH-ja në kufi derisa në funksion është futur norma e reduktuar e TVSH-së për produktet farmaceutike.<sup>204</sup> Janë 11 biznese pajisjesh të teknologjisë informative që janë liruar nga TVSH-ja, ndërsa vlera e importit e liruar nga TVSH-ja në dogana është 1 milion euro.<sup>205</sup>

Gjithsesi, çështja e pakos fiscale dhe efektet e saj nuk janë të paraqitura në këtë hulumtim për faktin se ajo ka hyrë në funksion në vitin 2015 dhe është ende herët për t'u parë efektet e saj, e aq më pak në krijimin e vendeve të reja të punës që është fokus i këtij

---

<sup>203</sup> ATK, Lista e t/p që u janë aprovuar Lirimet e TVSH në importim të mallrave të liruar nga TVSH, Lënda e parë, Burimi: <http://bit.ly/2dGMXzq>

<sup>204</sup> Korniza Afatmesme e Shpenzimeve- 2017-2019, Korniza Fiskae, fq 25

<sup>205</sup> ATK, Lista e t/p që u janë aprovuar Lirimet e TVSH në importim të mallrave të liruar nga TVSH, Pajisje të teknologjisë informative, Burimi : <http://bit.ly/2dFCS4Y>

studimi. Parimisht, meqë ndryshimi i normave në 8% për produkte të zakonshme dhe 18% për produkte luksoze nuk do të japë efekt të dukshëm, pasi që zhvillimi i Kosovës nuk varet nga këto produkte..

### 5.1.2 Subvencionet

Zhvillimi i NVM-ve është brengë e vendeve të zhvilluara dhe të pazhvilluara. Është temë diskutimi se cilat do të ishin programet më të përshtatshme dhe që do të kenë efekt më shumë në zhvillimin e tyre. Ndër politikat që përdoren shumë dhe janë temë e studimit dhe vlerësimit të shumë punimeve shkencore, janë grantet dhe subvencionet, si programe mbështetëse të dhëna nga qeveria.

Grantet dhe subvencionet janë mbështetje 1) financiare të pakthyeshme dhe 2) jofinanciare në formë të mbështetjes përmes ligjeve dhe politikave fiskale, si p.sh. lirimi nga taksat apo diferencimi i bizneseve përmes krijimit të zonave ekonomike, varësisht nga politikat zhvillimore. Interesi i këtyre granteve është që të lehtësohet puna e bizneseve që janë në nevojë dhe që janë të rëndësishme për zhvillimin e vendit ose edhe të mbajë nën kontroll çmime të produkteve të caktuara në treg që të mos e rëndojnë qytetarin.

Sipas marrëveshjes së OBT-së, subvencionet iu referohet elementeve të më poshtme<sup>206</sup>:

- një kontributi finanziar,
- nga një qeveri dhe,
- me një përfitim.

Do të thotë se bashkimi i këtyre tri elementeve përbën ekzistencën e një subvacioni. Ndryshtë, subvencionet cilësohen edhe si transfere të mjeteve nga qeveria për sektorë të ndryshëm privat.

---

<sup>206</sup> <http://www.wto.org>

Është një çështje e cila është trajtuar shumë për faktin se NVM-të kanë nevojë për mbështetjen që mund ta bëjë qeveria si institucion dhe jo dikush tjetër. Thelbi i punimeve (edhe i këtij që po e lexoni) në fakt është të dihet nëse programet të cilat përdoren nga qeveria për mbështetje të këtyre bizneseve në nevojë kanë arritur t'i përmbushin objektivat. Punime të ndryshme i kanë shikuar ato nga këndvështrime të ndryshme, pasi që grantet dhe subvencionet jepen për shumë arsy, p.sh. arsim, trajnime, aspekte të kërkim-zhvillimit të ndërmarrjeve, rrugë, lehtësira në pagesë të tatimeve, në norma të interesit për kredi, në promovimin e produkteve, në krijimin e ambientit joshës për të bërë biznes, etj. (**Schumpeter 1934; Birch 1987; Weiss 1981; Davidsson. 2006; Lopriore 2010; Audretsch 2002**). Këtu nuk interpretohet vetëm nëse politikat në fjalë kanë pasur sukses, por se a është e nevojshme dhe e arsyeshme ndërhyja e qeverisë në krijimin e kushteve për biznes (**G. E. Fombasso & M. Cincerato**)<sup>207</sup>.


Subvencionet janë formë shumë e shprehur e financimit të deficiteve të ndërmarrjeve private apo publike. Ndarja e tyre për fusha të caktuara bëhet nga nevojat e paraqitura dhe objektivave markoekonomike dhe vendimin për shpërndarjen e tyre e bën ose kryetari i komunës apo ministri i ministrisë përkatëse, varësisht si është rregulluar sistemi i subvencionimeve apo transfereve.

Më poshtë shohim një grafik të shpërndarjes së subvacioneve nga qeveria.

---

<sup>207</sup> Gilles Eric Fombasso\* and Michele Cincerato. OPTIMAL EFFECTIVENESS OF GOVERNMENT INTERVENTION IN THE SME SECTOR: EVIDENCE FROM THE BRUSSELS-CAPITAL REGION, Cite Working Paper 2015 - 017

Grafiku 21. *Vlera e Subvencioneve dhe Transfereve të Shpërndara nga Buxheti i Kosovës për Periudhat 2006-2016*



Burimi: Ministria e Financave [www.mf.rks-gov.net](http://www.mf.rks-gov.net)

Sipas grafikut, këto forma të përkrahjes janë duke marrë trajtimin e duhur parë nga rëndësia që kanë për zhvillimin e sektorit privat. Këto forma deri në vitin 2016 përbën 26.6% të buxhetit.<sup>208</sup> Shihet se gjatë periudhës së ngritjes së investimeve kapitale gjatë ndërtimit të autostradave apo rrugëve me rëndësi kombëtare e ndërkombejtare 7 dhe 6, i kanë dëmtuar nevojat e tjera kombëtare, andaj edhe nga viti 2008 ka filluar të bjerë vlera e subvencioneve.

Këto politika janë shumë të rëndësishme për funksionimin e sektorit privat sidomos. Është tipike për vende si Kosova, që subvencionet të jepen për të ndihmuar përfituesin dhe jo të shihen efektet afatgjata të tyre, duke parë produktivitetin dhe performancat e përfituesve. Sipas Institutit kosovar për qeverisje lokale, vetëm për vitin 2017, për të gjitha komunat, shuma e mjeteve të ndara për kategorinë e subvacioneve është 2,576299 euro, gjersa në vitin 2016 kjo shumë ishte pak më e vogël, konkretisht

<sup>208</sup> Instituti GAP, "Ndarja e subvencioneve nga komunat dhe ministritë", Korrik 2017

2,447,811 euro.<sup>209</sup> Ndër komunat që kanë arritur të marrin më shumë nga kjo pjesë e mjeteve të ndara për subvencione dhe transfere është Prishtina, pastaj vjen Prizreni, i përcjellë nga Ferizaji, e kështu me radhë. Një problem, i cili shfaqet në shpërndarjen e subvencioneve, është se gati në asnjëren komunë nuk është një vijë e menaxhimit dhe e procesimit të kërkesave për subvencione. Fushat në të cilat ndahen subvencionet kanë të bëjnë me kulturë, sport, rini, bujqësi, zhvillim ekonomik, arsim, shoqëri civile, shëndetësi dhe mirëqenie sociale. Ndërkaq, sa i përket ndarjes së subvencioneve të ndërlidhura me programin qeverisës, vetëm komuna e Gjakovës cek se kriteret janë të ndërlidhura me planin e punës së drejtoreve të komunës, më konkretisht për projektet e rinisë dhe subvencionet për persona fizikë.<sup>210</sup> Ndërkaq, subvencionimi i OJQ-ve bëhet vetëm për aktivitete edukative, trajnuese, kulturore, punësim të të rinjve, etj.

Përkushtimi më i madh i subvencioneve ka qenë në bujqësi për ta rritur prodhimin vendor. Kritikat për ndarje të këtyre mjeteve i adresohen faktit që ndarja është bazuar në masën e shfrytëzuar e jo në rendiment.<sup>211</sup> Kështu i janë aderuar si probleme edhe nga përfituesit dhe jopërfituesit, sepse kjo çështje po bëhet pistë e mundshme për manipulim, e që, pikërisht kjo ka ndodhur. Projektet e subvencionuara e kanë paraparë masën, supozojmë, prej pesë hektarëve ndërkaq janë punuar 1-2 hektarë, gjë që jo vetëm që nuk e ka arritur rendimentin e paraparë, por nuk ka ndikuar as në punësim.

Një instrument tjetër i praktikuar ka qenë edhe projekti i subvencionimit të pagave, i cili i ka ndarë obligimet me bizneset për pagat e punëtorëve. Ky projekt ka përfunduar në fund

---

<sup>209</sup> Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGI) Analizë: Buxhetet e Komunave të Kosovës 2017, Prishtinë Tetor 2016, fq.25

<sup>210</sup> Instituti GAP, “Ndarja e subvencioneve nga komunat dhe ministritë”, Korrik 2017

<sup>211</sup> Komente nga përfaqësues të Kuvendit të Republikës së Kosovës për draft analizën mbi ndarjen e subvencioneve

të vitit 2017, por që efekti i tij ishte shumë afatshkurtër. Bashkëpunimi në mes të biznesit dhe qeverisë për subvencionimin e pagave ka zgjatur 6, 9 ose 12 muaj, por jo më shumë.

### 5.1.3 Fondi i Garantimit të Kredive

Ky fond është krijuar në mbështetje të NVM-ve, duke marrë parasysh faktin se ato e kanë të vështirë të qasen në shuma të mëdha të mjeteve në banka dhe kjo ka bërë që këto biznese të mos prosperojnë si duhet. Kështu, një formë e tillë e garantimit të kredive nga ana e qeverisë është paraqitur si politikë e efektshme që kanë përdorur edhe vende të tjera, si Shqipëria, Maqedonia, Sllovenia, Kroacia, Bosnja, Serbia, etj.

Përvoja e vendeve të tjera ka treguar se fonde të tillë garantuese preferohen më shumë se sa subvencionet. Për shkak se kreditë administrohen nga bankat komerciale, duke pasur parasysh faktin se bankat janë më efikase dhe më të mira se agjencitë publike në shpërndarjen e fondevë vendet e duhura, në fund ato jepin rezultate më të mira për ekonominë në përgjithësi, krahasuar me metodat e administruara nga agjencitë publike. Zakonisht, përfituesit e fondevë të tillë janë biznese të vogla, të cilat nuk u sjellin shumë fitim bankave. Për këtë arsy, kur jepin kredi të tillë të garantuara prej fondit, bankat e konsiderojnë potencialin e kredimarrësve për t'u rritur dhe për të gjeneruar më shumë fitim për vetë bankën, përpara se ta aprovojnë atë kredi.<sup>212</sup>

Themelimin e këtij fondi e ka iniciuar qeveria e Kosovës përmes Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, ndërsa zhvillimin e këtij projekti i ka mbështetur USAID-i. Ligji për funksionimin e këtij fondi ka hyrë në fuqi që nga janari i vitit 2016<sup>213</sup>, por vet fondi është etnitet i pavarur. Për krijimin e këtij fondi qeveria e Kosovës merr pjesë me 27.23% apo rreth 2 milionë euro, ndërsa USAID-i, si donatori më i madh, merr pjesë me 72,77% ose

---

<sup>212</sup> LOAN GUARANTEES: Costs of default and benefits to small firms allan I. riding and GEORGE HAINES JR. Carleton University, Ottawa, Ontario, Canada Journal of Business Venturing 16, 595-612, 2001

<sup>213</sup> LIGJI Nr. 05/L-057 PËR THEMELIMIN E FONDIT KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE

5,345,141,07.<sup>214</sup> Kredia e parë nga ky institucion është lëshuar në shtator të vitit 2016, ndërkoq që bankat e regjistruara në këtë fond janë: Raiffeisen Bank, NLB Banka, Banka Ekonomike, ProCredit Bank, Banka për Biznes, TEB Bank dhe Banka Kombëtare Tregtare.

Qëllimi i themelimit të tij është pikërisht mbështetja e zhvillimit të NVM-ve përmes skemave të garantimit të kredive, duke lehtësuar kështu qasjen në financa, pasi që një nga barrierat që hasin NVM-të në Kosovë është pikërisht qasja në financa. Përmes këtyre skemave synohet të mbështetet iniciativa e lirë për t'i rritur produktet vendore, krijimin e vendeve të reja të punës dhe zhvillimin ekonomik në përgjithësi.<sup>215</sup> 100% e kredive të garantuara i dedikohen zhvillimit të NVM-ve dhe shumica e fondeve të garantuara kreditore janë shfrytëzuar për blerje të aseteve fikse, konkretisht 58 % e tyre janë shfrytëzuar për blerje të pajisjeve dhe makineri për prodhim, 31% e tyre për blerje të tokës dhe pjesa tjetër në renovim e kapital pune.<sup>216</sup>

Sigurisht, gjersa përqindja më e madhe e bizneseve në Kosovë funksionojnë në sektorin e tregtisë dhe industrisë, ashtu është edhe përbërja e portofolit të Fondit të kredive të garantuara, konkretisht 33% e tyre mbulojnë kredi për sektorin e tregtisë, 26% për atë të prodhimit, 9% të bujqësisë dhe pjesa tjetër për sektorë të tjera

Për kaq kohë sa funksionon fondi, janë aprovuar për garantim shuma e mjeteve prej 53,377,076 € ( gjithsej 2861 kredi), e cila në masën më të konsiderueshme është ndarë për NVM-të në komunën e Prishtinës, pastaj për Prizrenin, Ferizajin, Mitrovicën, Gjilanin e Gjakovën. Ndërsa, sa i përket sektorit, tregtia ka përfituar më së shumti, por edhe ka krijuar numër më të madh të punëtorëve, ngaqë është planifikuar, pastaj renditen shërbimet, prodhimitari e bujqësia.<sup>217</sup>

---

<sup>214</sup> Raporti Vjetor i FKGK-së (Fondit Kosovar për Garanci Kreditore), fq.18

<sup>215</sup> Fondi Kosovar për Garantimin e Kredive <http://fondikgk.org>

<sup>216</sup> Raporti Vjetor i FKGK-së (Fondit Kosovar për Garanci Kreditore), fq.23

<sup>217</sup> Zhvillimi i Portofolios për vitin 2016, prezantim nga FKGK-ja

Shuma e Fondit për garantim gjithnjë e më shumë rritet dhe kjo ndikon në rritjen dhe zhvillimin e NVM-ve.

Grafiku 22. *Shuma e Mjeteve si Garanci e Kredive për NVM-të në Kosovë*



Pra, siç shihet nga grafiku, shuma e mjeteve si garanci për kredimarrje gjithnjë vjen duke u rritur. Kjo ka bërë që të rritet numri i kredive të marra nga bizneset.

Sipas strategjisë së themelimit të këtij fondi, parashihet që huat e marra të rriten për 360 milionë euro, ndërsa një nga kontributet shumë të nevojshme të këtij fondi është synimi i tij në rritjen e numrit të vendeve të reja të punës, konkretisht parashihet të krijojë rreth 20,000 vende të reja.<sup>218</sup>

Strategja në fjalë është themeluar në saje të kritikave të vazhdueshme të raporteve evropiane për qasje të kufizuar në kredi të NVM-ve dhe mundësinë e marrjes së shumave të nevojshme kreditore, e cila po paraqet sfidën më të lartë për zhvillimin e tyre. Sipas raportit të Bankës Botërore për rankimin në “**Doing Biznes**”, tek indikatori i qasjes në financa, Kosova gjatë vitit 2015 nga vendi i 19-të, ku ishte më 2014, ka rënë në vandin e 23-të<sup>219</sup>. Andaj, marrë në konsideratë likuiditetin e kapitalit kreditor të

<sup>218</sup> Koncept dokument përfushon e themelimit të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, Qershor 2015, fq.3

<sup>219</sup> World Bank Group Flagship Report , Doing business 2017, Economy Profile Kosovo

bankave dhe nevojën e NVM-ve për mjete financiare, është parë si emergjente gjetja e politikave për t'i mbështetur NVM-të në këtë drejtim.

Nga ky program do të përfitojnë lloje të NVM-ve, të cilat janë cilësuar me qasjen më të vështirë në financa, konkretisht:<sup>220</sup>:

- Biznese të reja me më pak se 3 vjet,
- NVM-të pa shuma të mëdha të kapitaleve fikse për kolateral (që i bie të jenë shumica e NVM-ve),
- Biznese në pronësi të grave,
- Biznese në pronësi të minoritetave,
- Biznese në Veri të Kosovës,
- Biznese me produkte dhe shërbime inovative,
- Bizneset urbane dhe rurale,
- NVM-të që duan të rrisin produktin vendore dhe të zëvendësojnë importin dhe për eksport,
- Bizneset që implementojnë programe për energji të ripërritshme dhe eficiencë të energjisë,
- Bizneset TIK dhe
- Bizneset e teknologjisë.

Sipas po këtij dokumenti, fermerët, gratë në biznes, inovatorët, etj., përbëjnë më pak se 2% të portofolios aktual të kredive në Kosovë, ndërsa vetëm 5% e tyre janë për biznese bujqësore. Në veri të Kosovës nuk financohet pothuajse asnjë biznes, në ndërkokë që vlerësohet se 500,000 milionë euro është hendeku i financimit të NVM-ve në Kosovë. Ndërkaq, raporti në mes të depozitave dhe kredive në Kosovë është 74.2%.

---

<sup>220</sup> Koncept dokument për fushën e themelimit të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, Qershor 2015, fq.15

Politikë e ngashme me këtë fond ishte projekti AZHK-së,<sup>221</sup> i cili kishte pak a shumë qëllimin e njëjtë të financimit të bizneseve në nevojë, por me fokus në biznese bujqësore. Ky projekt ishte i USAID-it dhe u realizua në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe me Ministrinë e Zhvillimit Rural.

#### 5.1.4 Formimi i zonave ekonomike

Krijimi i zonave ekonomike është një tjetër forma përkrahjeje e qeverisë për funksionimin e NVM-ve dhe sektorit privat në përgjithësi. Zona ekonomike i referohet një territori që ka status të veçantë ekonomik, i cili mund të emërohet si: park industrial, zonë e lirë, park teknologjik dhe inkubator biznesi.<sup>222</sup> Pra, me këtë nënkuptojmë një zonë gjeografike brenda territorit të Republikës së Kosovës, që është krijuar për të ndihmuar e lehtesuar afarizmin e bizneseve private. Qëllimi i krijimit të zonave ekonomike është pikërisht dhënia e mundësisë për NVM-të që më lehtë ta realizojnë misionin e tyre në Kosovë, atë të krijimit të vendeve të reja të punës. Përpos këtij objektivi, krijimi i zonave të lira ekonomike ka për qëllim që të nxise investimet e jashtme, nxitjen e kreativitetit dhe inovacionit, sjelljen e teknologjive të reja nga jashtë, krijimin e një mjedisi të sigurt për bizneset që ato të afarojnë në konkurrencë të pastër, nxitjen e bizneseve vendore, etj.

Krijimi i zonave ekonomike është i rregulluar me Ligjin për zonat ekonomike, i cili është miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ligi për zonat ekonomike rregullon krijimin, funksionimin, mbikëqyrjen dhe zhvillimin e zonave ekonomike, shfrytëzuesve që veprojnë në to, llojin e veprimtarive që kryhet brenda tyre, si dhe mënyrën e përcaktimit të lokacionit për zonat ekonomike.<sup>223</sup> Qëllimi i krijimit të zonave të lira ekonomike është:

---

<sup>221</sup> Agjencia për Zhvillim Kreditor

<sup>222</sup> Ligji Nr. 03/L-129 për Zonat Ekonomike

<sup>223</sup> Ligji Nr. 03/L-129 PËR ZONAT EKONOMIKE

- nxitja dhe inkurajimi i investimeve në Kosovë, duke iu ofruar investorëve infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive afariste;
- nxitja e investimeve private në veprimtaritë prodhuese;
- ndihma në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik në Kosovë;
- hapja e vendeve te reja te punës dhe krijimin e të ardhurave;
- përqendrimi i bizneseve në një vend të caktuar dhe promovimin e tyre;
- zgjerimi i bashkëpunimit mes bizneseve;
- krijimi i kushteve për biznese për qasje më të lehtë në transport, furnizim me energji, ujë dhe shërbime në mbështetje të biznesit;
- rritja e konkurrencës në biznesin vendor dhe ndërkombëtar;
- tërheqja e teknologjive të përparuara dhe rritja e konkurueshmërisë se prodhimeve dhe shërbimeve vendore;<sup>224</sup>

Zona e parë ekonomike është ajo e krijuar në vitin 2005 në Drenas, i quajtur Parku i Drenasit, për të vijuar më tej në vitin 2009 me Parkun teknologjik në Skenderaj, i cili asnjëherë nuk është funksionalizuar. Më vonë, është krijuar edhe Parku i biznesit në Mitrovicë.

Përpos këtyre zonave ekonomike, janë krijuar edhe zona të tjera që nuk janë tërësisht të llojit të zonave ekonomike, por njihen si hapësira apo inkubatorë të biznesit, e që janë:

- Zona e agrobiznesit- Suharekë (funksional)
- Parku i biznesit- Drenas,
- Parku industriale holandez (Zinkunie) – Prizren
- Parku teknologjik – Shtime (jo funksional),
- Zona ekonomike – Gjilan / Kamenicë (funksional),
- Zona ekonomike – Ferizaj,
- Zona e lirë ekonomike – Gjakovë,]] dhe

---

<sup>224</sup> Po aty,

- Zona Ekonomike - Vushtrri (2018).

Zonat ekonomike më funksionale në rajon janë ato të krijuara në Serbi Maqedoni, konkretisht në Shkup, Tetovë dhe Stip.

Këto zona apo parqe janë krijuar për t'ua lehtësuar punën bizneseve, duke iu krijuar kushte të favorshme të mjedisit biznesor. Kushtet për përcaktimin e zonës ekonomike janë të vendosura me ligjin për zonat ekonomike.

#### **5.1.5 Skemat e mbështetjes për NVM-të nga agjenci shtetërore KIESA**

Agjencia për investime dhe përkrahjen e ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) është agjenci shtetërore e Kosovës, mandati i së cilës është të promovojë dhe mbështesë investimet, eksportin, turizmin, NVM-të dhe zonat e veçanta ekonomike në Republikën e Kosovës.

Shërbimet e kësaj agjencie janë të lidhura më shumë me përkrahjen e NVM-ve, duke krijuar kushte më të favorshme që ato të veprojnë e funksionojnë. Këto ndihma nuk nënkuqtojnë në shuma të mëdha të mjeteve, por forma të përkrahjes shumë të nevojshme dhe të dobishme. Kështu, agjencia afron<sup>225</sup>:

- Përkrahja e NVM-ve përmes dhënies së kuponëve për certifikim të produkteve dhe këshillime,
- Mbështetje për ndërmarrësit e rinj dhe gratë përmes krijimit të aktiviteteve si: punë praktike në ndërmarrje, startup biznese dhe panairi "Gratë në biznes"
- Avokimi për NVM-të përmes aktiviteteve si: ditët e biznesit të vogël dhe konferanca informuese me bizneset
- Trajnine për biznese dhe ndërmarrës potencial përmes: përkrahjes së aktiviteteve të marketingut, trajnimet menaxheriale dhe profesionale në kuadër të të cilave

---

<sup>225</sup> <https://kiesa.rks-gov.net/>

jepen këshillime për menaxhimin e projekteve, investimeve, të planeve të biznesit, menaxhim të ndërmarrjes, etj.

Qeveria, si në vendet e industrializuara edhe në ato në zhvillim, ofron larmi programesh për t'i ndihmuar NVM-të. Përkundër suksesit të strategjive të NVM-ve në disa vende, shumica e vendeve në zhvillim kanë gjetur se ndikimi i programeve të tyre të zhvillimit të NVM-ve në ecurinë e ndërmarrjeve ka qenë më pak i kënaqshëm.<sup>226</sup> Referuar kësaj të dhëne, shumë vende të zhvilluara dhe në zhvillim kanë arritur ta kuptojnë rolin e NVM-ve në procesin e zhvillimit ekonomik. Ata janë parë të karakterizohen nga dinamizmi, risitë e mprehtësitë, efikasiteti dhe masa e tyre e vogël lejon proces më të shpejtë vendimmarrjeje. Operacionet e NVM-ve nxiten nga teoria dinamike, gjë që i bën ata të efektshëm dhe të prirë ndaj ndryshimeve të vazhdueshme (Akabueze, 2002).

## 5.2 Përkrahja përmes investimeve kapitale

Investimet kapitale si faktorë shumë i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik në tërësi, e sektorit privat në veçanti, kanë marrë vëmendjen

dhe trajtimin e duhur dhe gjithnjë e më shumë janë duke treguar efekte, ani pse këto investime karakterizohen me afat të gjatë kohor të realizimit dhe efektet shihen pas një kohe. Pa investime kapitale nuk mund të gjenerohet zhvillim ekonomik. Ato janë baza e zhvillimit ekonomik dhe njëherësh edhe sinjale përfitimin e investimeve të huaja. Asnjë investitor i huaj nuk dëshiron të investojë në një vend ku nuk ka infrastrukturë rrugore, ligjore dhe të komunikacionit të mirëfilltë e ku nuk ka energji elektrike. Fokusi i

---

<sup>226</sup> Ayeni-Agbaje, Abiodun Rafiat , Osho, Augustine Ejededawe, COMMERCIAL BANKS ROLE IN FINANCING SMALL SCALE INDUSTRIES IN NIGERIA (A STUDY OF FIRST BANK, ADO-EKITI, EKITI STATE, uropean Journal of Accounting, Auditing and Finance Research Vol.3, No.8, pp.52-69, August 2015 Published by European Centre for Research Training and Development UK ([www.eajournals.org](http://www.eajournals.org))

investimeve kapitale në Kosovë ka qenë pikërisht infrastruktura rrugore, konkretisht në realizimin e projektit të autostradës Kosovë-Shqipëri “Ibrahim Rugova” dhe është në realizim lidhja me autostradën Prishtinë-Merdarë. Pastaj, janë bërë investime edhe në një pjesë të Korporatës Energjetike të Kosovës, duke e privatizuar pjesën distribuive që sot njihet si KED-si, disa projekte të dështuara për privatizimin e Postës dhe Telekomit të Kosovës si dhe koncesionimi i Aeroportit të Prishtinës. Pastaj, janë në realizim e tutje “Ruga 6” (Prishtinë-Hani i Elezit), ajo Prishtinë-Pejë, Prishtinë-Gjilan, Drenas-Skenderaj, pastaj rrugët nga Prishtina për në Mitrovicë e Podujevë, si dhe zgjerimi i rrugës Dollc-Gjakovë. Qeveria aktuale synon projektin e vazhdimit të rrugës Pejë-Deçan-Gjakovë-Prizren.

Këto investime janë e ardhme e ndritur pasi që lidhin Evropën Juglindore me Evropën Perëndimore dhe kjo hap rrugët për zhvillim ekonomik të këtij rajoni, por edhe integrimin e tij në tregun e përbashkët evropian

NVM-të nuk është se kanë përfitime direkte nga këto investime, por, duke përfituar akterët me të cilët ata veprojnë dhe organizojnë bizneset e tyre si: furnitorët, mundësia e kontakteve me investorë të tjera, e bashkëpunime të tjera, lehtësimi në qasjen te lënda e parë, i çelë rrugë zhvillimit të sektorit privat, konkretisht NVM-ve. Por, ndërtimi rrugëve të reja ka efekt edhe në gjenerimin e vendeve të reja të punës, si dhe në inkurajimin e iniciativave të reja si rezultat i kontakteve në mes të palëve të interesit, sidomos kur bëhet fjalë për rrugë me rëndësi ndërkombëtare. Sipas studimeve të autorëve si **M. G. Evamaria, L. M. Mayer, A. L. Paffhausen**<sup>227</sup> dhe **Mayer M.**<sup>228</sup> ndërtimi


---

<sup>227</sup> Michael Grimm Evamaria, Lutz Monika Mayer, Anna Luisa Paffhausen, KFW Research Studies and Proceeding, Employment effects of road construction and access-to-energy interventions – Evidence from a review of the literature, 2015

<sup>228</sup> Mayer M. An Analysis of the Effects of Road Construction Projects on Enterprise Performance and Employment in Low- and Middle-Income Countries. 2014,

i rrugëve të reja mund ta lehtësojë qasjen në tregjet e punës, mund të rrisë edhe nivelin e vetëpunësimit përreth saj, gjithashtu mund të lehtësojë qasjen në lëndën e parë, por të gjitha janë efekte indirekte të projektit që vështirë se mund të maten. Rritja e punësimit përmes këtyre projekteve gjigande ka qenë edhe fokus i qeverisë kosovare. Gjithsesi, këto janë punë të përkohshme dhe, sipas deklarimeve të obligimeve për punëtorë në ATK, kompania përfituese për projektet Rruga 6 dhe 7 brenda një viti ka angazhuar jo më shumë se 1000 të punësuar, gjersa gjatë vitit ka pasur projekte të ndryshme që kanë skaduar me pesë ose gashtë muaj. Më poshtë paraqesin nivelin e investimeve kapitale në Kosovë për periudhën e hulumtimit.

Grafiku 23. *Vlera e Investimeve Kapitale në Kosovë për Periudhën 2006-2016*



Burimi: Minsitria e Financave, seritë fiskale kohore, <https://mf.rks-gov.net>

Sic edhe mund të vërehet, në kohën kur subvencionet kanë shënuar rënje, investimet kapitale kanë shënuar rritje, konkretisht nga viti 2008-2015, gjersa në vitin 2015 rriten subvencionet dhe nisin të bien investimet kapitale. Kjo nënkupton se kemi zëvendësim të kapitalit dhe, kur kemi të tillë veprime në ekonomi duhet të llogaritet edhe kostoja oportune, e cila nuk tregohet në raportet dhe analizat e publikuara nga entitetet relevante.

Shohim se gjatë kohës së investimeve në autostradën “Ibrahim Rugova” dhe asaj “Arbën Xhaferi” janë rritur kërkesat për investime kapitale. Kjo është e konfirmuar edhe në Raportin e progresit të Komisionit Evropian (2016) lidhur me efektet e shpenzimeve kapitale. Në vitin 2015, pjesa e buxhetit për shpenzime në investime vazhdon të ulet, duke arritur në 25.8% nga 38.2% në vitin 2011. Shpenzimet më të mëdha kapitale u bënë në rrugë, me projektin Route 6, e cila morri 35.1%. Zbatimi i dobët i projekteve të finançuara nga donatorët thekson mangësitë e kapaciteteve institucionale në nivel qendror dhe vendor.<sup>229</sup>

### 5.3 Përkrahja nga sektori bankar

Tregjet financiare të Kosovës mbështeten në kreditë bankare tradicionale, ndërkoqë që burimet e tjera të financimit mbeten të pazhvilluara. Sistemi financiar i Kosovës është i dominuar nga sektori bankar, i cili përbën 69.0% të aseteve totale të sektorit financiar. Sektori bankar mbetet kryesisht në pronësi të huaj (89.9%). Totali i aseteve të sistemit financiar u rrit për 8.1%, duke arritur në 86.0% të PBB-së në vitin 2015 dhe aktivitetet e kreditimit u përshtypuan në krahasim me një vit më parë (një rritje prej 7.3% në totalin e kredive). Vlera e gjithsej kredive në shtator 2016 arriti në 2.18 miliardë euro. Rritja e kreditimit gjatë vitit 2016 kryesisht i atribuohet rritjes së kërkesës për kredi, si dhe përmirësimi të ofertës së kreditimit nga sektori bankar përmes uljes së normës së interesit, rritjes së shumës së kredisë së aprovuar dhe uljes së tarifave tjera të jo interesit. Kategoria me rritjen më të madhe të kredive ishte kategoria e ekonomive familjare, duke paraqitur kështu edhe kontribuuesin kryesor në rritjen e gjithsej kredive të sektorit bankar, dhe pjesa më e madhe e këtyre kredive ishte për kredi konsumuese. Kreditë për

---

<sup>229</sup> KOMISIONI EVROPIAN, Raporti i vitit 2016 për Kosovën, Në përcjellje të dokumentit “Komunikata nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve Komunikata mbi Politikën e Zgjerimit të BE-së 2016, fq.43

ndërmarrje shënuan rritje më të vogël, ku rreth 44% e kredive janë të karakterit jo investues. Pastaj, përqindja më e madhe e kredive për ndërmarrjet janë për tregti dhe ndërtimtari, ku pjesa më e madhe e mallrave me të cilat operojnë e funksionojnë janë të importuara.

Kreditë e reja për ndërmarrjet (kryesisht për sektor të shërbimeve dhe industrisë), po ashtu, kanë shënuar rënje edhe përkundër rënies së normave të interesit, duke u karakterizuar edhe me rënje të kredive investuese për 29.2%, ndërsa ato jo investuese regjistruan rritje vjetore prej 1.3%. Gjithashtu, vlen të theksohet se afati i maturimit për kredi në përgjithësi ka tendencë të rritet, gjersa në vitet e mëhershme në përgjithësi vitet e maturimit kanë qenë dy.

Raporti i kredive me BPV-në në Kosovë konsiderohet të jetë 16%, ndër më të ulëtit në rajon, bie fjala në Bosnjë dhe Hercegovinë i njëjtë raport është 30%, në Kroaci mbi 35%, në vendet aziatike dhe Amerikë Latine mbi 60%, ndërkaq në vendet e zhvilluar mbi 120%.

Kreditë bankare janë burim finansiar shumë i rëndësishëm për NVM-të. Me rritjen e aktiviteteve afariste të NVM-ve paraqitet nevoja e rritjes së mjeteve kryesore, lëndëve të para, stoqeve, kërkesave nga blerësit, që njëherësh nënkupton edhe rritjen e nevojave për më shumë mjete financiare. Me anë të kredive nga bankat komerciale ndërmarrjet i financojnë nevojat e tyre për investime, mjete të qarkullimit dhe për stoqet. Kushtet e kreditimit për NVM-të janë të ndryshme, por edhe më të ndryshme na dalin kur i krahasojmë me ato për biznese të mëdha. Shpesh ndodh që bankat t'i refuzojnë kërkesat për kredi dhe arsyet më të shpeshta të refuzimit të kredive bankare janë: mospasja e evidencës kontabël adekuate, pamjaftueshmëria e sigurimit të kredisë (kolateralit), menaxhimi i dobët me sipërmarrjen dhe rejtingu i ulët kreditues i sipërmarrjes.<sup>230</sup> Problemet më të mëdha të NVM-ve gjatë shfrytëzimit të këtyre kredive janë: shkalla e

<sup>230</sup> European Commission, [https://ec.europa.eu/commission/index\\_en](https://ec.europa.eu/commission/index_en)

lartë e interesit, vlera e kufizuar e kredisë, afati i shpejtë i kthimit, procedura të gjata dhe të shtrenjta për përpunimin e kërkesës dhe akordimin e kredisë, etj.

Kreditë në vendet e varfra si Kosova, janë të shtrenjta dhe me kritere të larta për përbushje. Ato janë të paafta t'u përgjigjen me kohë dhe në mënyrë të rregullt kredive me kërkesa të mëdha për dokumentacione për mbulesë të kredisë, si dhe norma të larta të interesit. Kostot e larta të ndërmjetësimit bankar janë tipike për vende të varfra, pikësëpari nga arsyja e riskut të lartë që i karakterizojnë kreditë. Janë disa faktorë që i karakterizojnë njëjtë vendet e varfra për nga arsyet e çmimit të lartë të kredisë, si:

- niveli i ulët i kursimeve në vendet përkatëse, ndërkokë që kërkesa për kredi paraqitet e lartë dhe me tendencë rritëse,
- akses i kufizuar në burimet financiare ndërkombëtare për të mundësuar rritjen e konkurrencës dhe ulje e çmimit të kredisë struktura e tregut (pronësia e bankave, niveli i përqendrimit bankar, shkalla e konkurrencës etj.),
- mungesa e zbatimit të ligjit në rastin e mbledhjes së detyrueshme të kredive të këqija (problemi me shitjen e hipotekave- kolateralit)
- kostove, relativisht të larta operative të bankave,
- shkalla e lartë e informalitetit që qon në informacion të gabuara për kredimarrësinë dhe rritë masën e kredive të këqija (raportet e rrejshme financiare).<sup>231</sup>

Shuma e mjeteve të ndara kredi në total, në fund të vitit 2017, arriti vlerën prej 2.41 miliardë eurosh, që nënkoponte rritjen prej 10.2% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kjo gjë u adresohet politikave lehtësuese për kredimarrje nga NVM-të.

<sup>232</sup> Sipas këtij raporti, kreditë për NVM-të në këtë periudhë në krahasim me të njëjtën

---

<sup>231</sup> Instituti Riinvest, Sistemi bankar ndihmesë apo barrierë, 2015, fq.47

<sup>232</sup> Banka Qendrore e Kosovës, Raporti tremujor i Ekonomisë, TM4 2017, fq.14

në vitin e kaluar janë rritur për 31.9%. Në fakt, këto të dhëna nuk mund të tregojnë rritje reale në ekonomi, pasi që **rreth 41% e kredive për NVM-të janë dhënë për kredi jo investuese, gjë e cila nuk ka ndikuar në rritjen e kapaciteteve të ndërmarrjeve.**

Në një raport të bërë nga një institut kosovar në vitin 2015, del se nga totali i kredive të lëshuara rreth 67.4% kane shkuar për NVM-të, përqindje kjo e konsideruar e ulët krahasuar me mesataren e regjionit. Edhe pse tregu i kredive ka pasur një trend në rritje në këto tri vitet e fundit, kjo rritje është zhvendosur nga kompanitë në amvisëri, ku 30.1% e totalit të kredive kanë shkuar për amvisëritë krahasuar me rritjen vjetore prej 29.5% në vitin 2010. Ndërsa, kreditë për ndërmarrjet kanë pësuar rritje, ku në 2011 ato u rritën me 4.8%. Ky aktivitet i ulët i kredive për NVM-të në këto dy vitet e fundit është i lidhur për krizën globale (2009-2010) si dhe me krizën evropiane të borxheve (2010).<sup>233</sup>


Janë këto arsy që kanë ndikuar në shpërndarjen e kredive për amvisëri më shumë se sa për ndërmarrjet. Pikërisht, kjo periudhë e krizës financiare, pra 2009-2011, ka bërë që qasja ndaj financave të konsiderohet problematike nga vetë ndërmarrjet edhe publikimet e ndryshme si ato të [Instituti Riinvest, 2015](#), UNDP-së, HDR-së (2011) etj.

Vendet e rajonit kanë të njëjtin fat me përbërjen e sistemit bankar, atë të prurjes së bankave të huaja në vend (Maqedoni 93%, Shqipëria 91%, Serbia 75%, etj.,) Investimet e huaja kanë qenë një derë e hapur për mundësinë e rritjes së financimeve.

---

<sup>233</sup> Instituti Riinvest, Sistemi bankar ndihmesë apo barrierë, 2015, fq.23

Grafiku 24. Vlera e Krediva për NVM-të Në Kosovë Për Periudhat 2006-2016



Burimi: Ministria e Financave, Seritë Fiskale Mujore <https://mf.rks-gov.net/>

Gjithsesi, bankat sado që janë të orientuara për shpërndarje të potencialit financier kah ndërmarrjet, trendët për to janë rënëse dhe rritëse për familjarët. Kështu, për dallim nga viti 2014, rritja e kredive për ndërmarrjet në vitin 2015 ishte vetëm 4.1%, kurse për ekonomitë familjare ishte 11.3%.<sup>234</sup>

Në viti 2014 normat e interesit ishin 10,6%<sup>235</sup> duke rënë në vitin 2015 në 10%<sup>236</sup> dhe kjo përbënë normën më të lartën në rajon për periudhën në fjalë, por, edhe ashtu, Kosova në çdo periudhë karakterizohet me normën më të lartë në rajon.<sup>237</sup> Sipas një hulumtimi të Institutit Riinvest<sup>238</sup>, vetëm 6.5% e NVM-ve që kanë qenë pjesë e hulumtimit (Anketë,

<sup>234</sup> Banka Qendrore, Vlerësimi Tremujor i Zhvillimeve Makroekonomike, 2015

<sup>235</sup> Banka Qendrore e Kosovës “Raporti i Stabilitetit Financiar” Nr. 6, Dhjetor 2014

<sup>236</sup> Banka Qendrore e Kosovës “Buletini Major Statistikor”Nr.166, Qershori 2015

<sup>237</sup> World Development Indicator, Real Interest Rates. <http://bit.ly/1Pc1M8S>


<sup>238</sup>Klima e biznesit në Kosovë, nga perspektiva e NVM-ve, Maj 2017, fq 19.

2016), kishin aplikuar për kredi në vitin 2016. Pjesa dërmuese e atyre që nuk kanë aplikuar (82%) janë shprehur se nuk kanë pasur nevojë për financim të tilla të jashtme gjersa ata që kishin aplikuar dhe ishin refuzuar, kishin deklaruar që arsyet kryesore silleshin si kolaterali i pamjaftueshëm, qarkullimi i dobët si dhe mungesa e një plani të biznesit lidhur me arsyet e investimit. Një pjesë e vogël e investimeve, rreth 6%, ishin bërë duke u mbështetur në lidhjet e ndryshme qofshin familjare apo miqtë nga jashtë apo në Kosovë.

Mbi 50% e portofolios së kredive i takon sektorit të tregtisë. Ndërsa, sektori i bujqësisë, si pjesë e sektorit prodhues, përbën vetëm 3.6% të kredive. Raporti i kredive ndaj depozitave totale në bankat e Kosovës është 78.1%. Kjo tregon se bankat komerciale kanë likuiditet të pashfrytëzuar. Për më tepër, bizneset kanë listuar normat e larta të interesit dhe vështirësitetë në qasje në financa si dy nga sfidat më të mëdha.<sup>239</sup>

Kostoja e kredisë e parë në normën e interesit, gjithnjë e më shumë është duke rënë. Më poshtë shohim normat e interesit për vitet e hulumtimit 2006-2016.

Grafiku 25. *Norma Reale Interesit për Kreditë në Kosovë për Periudhat 2006-2016*



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës, seritë kohore

<sup>239</sup> Instituti GAP, Fondi Kosovar për Garanci të Kredive: modelet e menaxhimit dhe efektiviteti, 2015

Realisht, kreditimi i NVM-ve në Kosovë është mjaft i kufizuar në kuptimin që janë të strukturuara dhe administruara në atë formë që këto ndërmarrje mos të kenë aftësi t'i përbushin ose t'u përbahen. Andaj, shumica prej tyre edhe nuk hyjnë fare në marrëdhënie kreditore nga njëra anë, ose kënaqen me pak mjete për t'i kthyer në afat të shkurtër kohor, në anën tjetër. Arsyё tjetër qëndron se ndërmarrjet nuk duan t'ia dinë për kriteret e përgjithshme, kur ato shohin që në fillim se nuk mund ta plotësojnë kushtin për kolateral.

Problemi i financimit të NVM-ve është bërë tematikë sfiduese për kërkuesit dhe hulumtuesit shkencorë. Disa nga punimet e kohëve të fundit në këto aspekte përfshijnë autorë si<sup>240</sup> **Arnold (1998), Dorn (1998), Inang dhe Ukpong (2002)** dhe **Aruwa (2004)**. Në gjetjet e tyre, katër probleme në financimin e NVM-ve janë bërë periodike: kostoja e kapitalit, rreziku, kushtet për kreditë bankare dhe mungesa e kapitalit të vet. Hendeku i kërkimit që ende ekziston, pavarësisht këtyre përpjekjeve kërkimore, është kapaciteti i opsiioneve të tjera të financimit për të mbushur vakumin e krijuar nga dështimi i institucioneve financiare formale për t'i plotësuar nevojat financiare të NVM-ve në Nigeri (aty ku është bërë hulumtimi). **Aruwa (2004)** vëren se, duke qenë se bankat kanë demonstruar paaftësinë e tyre për ta marrë dhe menaxhuar interesin e NVM-ve, skemat joformale të kursimeve jo vetëm që e mbushin vakumin e krijuar, por ato, gjithashtu, përbëjnë një formë të re të akumulimit të kapitalit të bazuar në solidaritet dhe bashkëpunimin midis komuniteteve dhe bizneseve. **Golis (1998)** identifikoi mundësi financimi në ndërmarrjet e kapitalit për NVM-të.

---

<sup>240</sup> S.A.S. Aruwa,. (2009). "Financing Options for Small and Medium Scale Enterprises in Nigeria". *Nigerian Journal of Accounting Research*. Vol. I (2), ABU., Zaria, December.

## KAPITULLI VI- METODOLOGJIAA HULUMTUESE SHKENCORE

Më lartë, pothuajse se cilin kapitull e kemi filluar duke interpretuar faktin se ndërmarrjet e vogla dhe të mesme rrisin punësimin përmes krijimit të vendeve të reja të punës, për shkak të karakteristikave të tyre. Në fillim të këtij punimi, teorikisht është pohuar një gjë e tillë, porse fokusi i punimit ishte të shikohej nëse politikat mbështetëse për NVM-të janë të efektshme apo jo, në mënyrë që t'i shërbejnë edhe më shumë rritjes së punësimit. Përtatë pasur më konkret dhe më të saktë ndikimin e politikave mbështetëse në rritjen e punësimit përmes mbështetjes së rritjes së NVM-së, interpretimi dhe analizimi i gjetjeve janë bërë përmes dy modeleve ekonometrike: përmes **Ordinary Least Square Regression - OLS** dhe **Generalized Method of Moments - GMM**.

Ndërkaq për kalkulimin dhe analizimin e të dhënave, kemi përdorur programin statistikor STATA (versioni 13).

Përmes modelit të regresionit të thjeshtë OLS është bërë matja e ndikimit të politikave mbështetëse, që kanë qenë pjesë e analizës së këtij punimi doktorate, si: subvencionet, kredit, norma reale e interesit dhe investimet kapitale. Përmes këtij modeli është matur dhe llogaritur ndikimi i këtyre politikave në rritjen e NVM-ve, e parë në qarkullimin e tyre.

Ndërsa, për të llogaritur efektin indirekt të këtyre politikave në rritjen e punësimit, gjegjësisht në uljen e papunësisë, është përdorur modeli GMM. Përmes këtij modeli i është dhënë përgjigje hipotezës kryesore; asaj se sa a kanë ndikuar këto politika në uljen e papunësisë nëpërmjet rritjes së NVM-ve, e parë nga rritja e qarkullimit.

Përtë realizuar analizën e këtij disertacioni, jemi bazuar në hipotezat e vëna në fillim të realizimit të punimi, të cilat janë si më poshtë:

**H1:** Përkrahja e NVM-ve nga qeveria përmes subvencioneve ndikon pozitivisht në rritjen e tyre;

**H2:** Kreditë për NVM-të, kanë ndikim pozitiv në rritjen e NVM-ve;

**H3:** Norma e interesit ndikon negativisht në rritjen e NVM-ve;

**H4:** Rritja e investimeve kapitale ndikon pozitivisht në rritjen e NVM-ve dhe

**H5:** Rritja e NVM-ve ndikon pozitivisht në rritjen punësimit.

Duhet potencuar edhe këtu që rritja e NVM-ve është parë nga qarkullimi i tyre.

### **6.1 Burimi i të dhënave**

Të dhënat në dispozicion për ta elaboruar analizën janë të siguruara nga institucione relevante të Republikës së Kosovës.

Konkretnisht, qarkullimi i NVM-ve është e dhënë nga Administrata Tatimore e Kosovës, që paraqet burimin kryesore të të dhënave të tillë. Këto të dhëna janë kryqëzuar me madhësinë e ndërmarrjes, por e parë nga numri i punëtorëve dhe jo nga masa e qarkullimit, siç janë të ndara në këtë institucion. Kemi potencuar edhe më lartë se ndarja e NVM-ve është bërë sipas numrit të punëtorëve, ashtu siç është e përcaktuar me Ligjin mbi NVM-të.<sup>241</sup>

Në po këtë institucion (ASK) është siguruar edhe numri i saktë i të dhënave për periudhat që janë pjesë e analizës. Ka pasur vështirësi në kompletimin e kësaj të dhënë në tërësi, p. sh. në vitin 2010 dhe 2011, në këtë rast është marrë për bazë mesatarja e tri periudhave paraprake.

Nga ana tjeter, të dhënat si subvencionet dhe investimet kapitale kanë pasur burim kryesor Ministrinë e Financave të Republikës së Kosovës.<sup>242</sup>

---

<sup>241</sup> [www.atk-ks.org](http://www.atk-ks.org)

<sup>242</sup> [www.mf-ks.org](http://www.mf-ks.org)

Ndërkaq, të dhënat si vlera e kredive për NVM-të dhe norma e interesit për kredi që kanë marrë NVM-të për periudhën kohore të analizës 2006- 2016, janë siguruar nga raportet mujore të Bankës Qendrore të Kosovës.<sup>243</sup>

Numri i ndërmarrjeve që ekzistojnë në Kosovë është e dhënë e siguruar nga Agjencia Kosovar për Regjistrimin e Bizneseve.<sup>244</sup> Në fakt, kjo është një e dhënë që është modifikuar, duke u plotësuar me informata nga **Administrata Tatimore e Kosovës**. Dihet se ATK-ja posedon numrin e saktë të ndërmarrjeve në Kosovë, duke i numëruar si tatimpagues. Por, në fakt, në ATK, një tatimpagues mund t'i ketë 4-5 biznese, të cilat mund të janë veprimtari të ndryshme, andaj është marrë numri nga ARBK-ja, edhe pse edhe këtu kemi rezerva ndaj të dhënavë, pasi që mund të janë ndërmarrje jofunksionale sipas ATK-së, ndërsa në ARBK ende figurojnë si biznese. Këto janë të paraqitura në limitet e punimit.

## 6.2 *Modeli i regresionit OLS*

Bazuar në literaturën e konsultuar në këtë studim mbi temën: “**Kontributi i NVM-ve në rritjen e punësimit në Kosovë- politikat mbështetëse dhe efektet**” kemi ndërtuar dhe përshtatur modelin e regresionit të shumëfishtë konkretisht modelin **OLS – Ordinary Least Square Regression** me qëllim të vlerësimit të ndikimit që kanë pasur politikat mbështetëse në rritjen e punësimit, përmes mbështetjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Metoda e katorëve të vegjël (OLS) është metoda më e thjeshtë për analiza dhe është vlerësues i përafruar i mesatares së kushtëzuar të variablit të varur, kur i kemi të dhëna një apo më shumë variabla të pavarura. Ky model konsiston në minimizimin e shumës së distancave në katorë.

---

<sup>243</sup> [www.bqk-ks.org](http://www.bqk-ks.org)

<sup>244</sup> [www.arbk-ks.org](http://www.arbk-ks.org)

OLS – për të parën herë u prezantua nga matematikani francez **Legendre (1805)** kurse ‘regresioni’ si term u prezantua nga **Galton-i** dhe më pas u vërtetua nga **Pearson-i**, gjegjësisht i njojur *për ligjin e regresionit universal të gjatësisë së njerëzve.*

Regresioni i OLS është një nga teknikat kryesore që përdoret për t'i analizuar të dhënat dhe formon bazën e shumë teknikave të tjera (për shembull ANOVA dhe modelet lineare të përgjithësuara). Dobia e teknikës mund të shtrihet në masë të madhe me përdorimin e kodimit variablate dummy<sup>245</sup> për të përfshirë variabla shpjegues të grupuar dhe metodat e transformimit të të dhënave.<sup>246</sup>

Ky model ekonometrik paraqet një abstrahim të realitetit. Në modelin e regresionit të thjeshtë kemi variablin e varur dhe një variabël shpjegues, përfshirë edhe gabimin e rastit që nënkupton të gjithë faktorët e tjerë, që mund të ndikojnë në variablin e varur, por nuk janë marrë parasysh në model.

Pra, variabla e varur = konstantja + variablat shpjeguese + gabimi i rasti

Në anën e majtë të barazimit është variabli i varur kurse në anën e djathtë të barazimit paraqiten:

$$\gamma_i = \beta_0 + \beta_1 X_1 + \mu_i$$

- a) Konstantja
- b) Variablat shpjeguese dhe
- c) Gabimi i rastit

Në modelet ekonometrike ndikimi i variablate vlerësohet përmes

---

<sup>245</sup> Variabla “dummy” është një ndryshore artificiale e krijuar për të përfaqësuar një atribut me dy ose më shumë kategori / nivele të dallueshme, Smita Srivani, Principal Statistician, MoreSteam.com LLC

<sup>246</sup> Graeme Hutcheson, Ordinary Least-Squares Regression, In L. Moutinho and G. D. Hutcheson, The SAGE Dictionary of Quantitative Management Research. Pages 224-228. 2011

- T – statistics;
- P – vlera (**probability value**); paraqet nivelin e saktë të signifikancës: tregon nivelin më të ulët të signifikancës në të cilën mund të refuzojmë hipotezën zero.

Koeficienti i determinacionit (përcaktueshmërisë) i shënuar me  $R^2$  na tregon se sa afër janë observimet me vijën e regresionit. Koeficienti i determinacionit merr vlera:

$$0 \leq R^2 \leq 1$$

- 1) Rasti  $R^2=1$  të gjitha observimet shtrihen në vijën e regresionit ( e pamundur ).
- 2) Rasti  $R^2=0$  asnjë observim nuk shtrihet në vijën e regresionit.
- 3) Koeficientët e vlerësuar duhet të paraqiten dhe interpretohen duke u kushtuar rëndësi njësive matëse si dhe të shpjegohet rëndësia ekonomike dhe praktike e variablate të përfshira në model.
- 4) T-statistik ose p-value, varësisht nga preferanca grup autorësh preferojnë të paraqesin njërin apo tjetrën formë.

### 6.2.1 Analiza e rezultateve të regresionit

Analiza e regresionit interpreton lidhjen në mes të një variabli të dhënë dhe një apo më shumë variablate të tjera shpjegues, të njojur si variabla të pavarur. Për të testuar rëndësinë e variablate kemi shfrytëzuar programin softuerik STATA. Në këtë model, si variabël e varur është marrë qarkullimi i NVM-ve, ndërsa variabla të pavarura janë marrë subvencionet, vlera e kredive të dhëna për NVM-të, norma e interesit e aprovuar për kredi për NVM, si dhe investimet kapitale. Një variabël e varur konsiderohet variabla, e cila është vënë në testim si faktorë i ndikuar ose jo nga faktorë të tjera si të pavarur. Andaj, variabla e varur është variabla që nuk është duke u testuar si e ndikuar, por si faktor ndikues në një faktor tjetër.

Shkurtesat e përdorur në model janë

***QI*** – qarkullimi i NVM-ve

***sub*** – subvencionet

***Cr*** – vlera e kredive për NVM-të

***rI*** – norma e interesit për kredi për NVM-të

***CI*** – vlera e investimeve kapitale

***Unemp*** – shkalla e papunësisë

Programi STATA na ka prodhuar të dhënat mbi të cilat e ndërtojmë edhe modelin ekonometrik në formën numerike. Modeli ekonometrik merr formën si në vijim:

$$\log(QI) = \log(\beta_0 \log) + \beta_1 \log(sub) + \beta_2 \log(Cr) + \beta_3 \log(rI) + \beta_4 \log(CI) \\ + \beta_5 \log(unemp)$$

Rezultatet na tregojnë se modeli është signifikant dhe e sqaron rritjen e NVM-ve nga politikat aktive mbështetëse, parë nga prizmi i të dhënavëve të inkorporuara në model.

$$\log(QI) = 22.66413 + 0.1755 \log\_sub - 0.42 \log\_cr - 0.373 \log\_rI \\ + 0.236 \log\_CI - 0.45 \log\_unemp$$

**P-vlerat** me dy anë testojnë rëndësinë statistikore të çdo variabli të pavarur të përzgjedhur. Kështu nëse p-vlera është më e vogël se 0.01, 0.05 ose 0.1, atëherë themi se koeficenti është i rëndësishëm përkatësisht në nivelin 1 për qind, 5 për qind ose 10 për qind. Në tabelat e rezultateve të regresionit niveli i rëndësisë do të shënohet me ‘\*\*\*’, ‘\*\*’ dhe ‘\*’.<sup>247</sup>

---

<sup>247</sup> \*p < 0.1 (10% nivel rëndësie), \*\* p < 0.05 (5% nivel rëndësie) \*\*\* p < 0.01 (1% nivel rëndësie).

**F-statistika** tregon nëse tërë variablat e marra së bashku janë statistikisht të rëndësishme (ose modeli në tërësi) ndryshe nga t-vlera, e cila teston rëndësinë statistikore në mënyrë të veçantë të çdo variabli të pavarur. Nëse p-vlera (F) është më e vogël se 0.05 (<1), mund të themi se në tërësi modeli është statistikisht i rëndësishëm, d.m.th. variablat e pavarur ndikojnë te variabli i varur. Pra, përshtatshmëria e modelit e përfaqësuar nga statistikat F, në rastin tonë është e nivelit 14.66, i cili është signifikant në nivelin 1%. Kjo vërteton, në fakt, se është një marrëdhënie e rëndësishme lineare midis variablave shpjeguese (**Sub, Cr, I, CI, Unempl**) dhe variables së varur (**QI**).

**R-sqaure**, konkretisht koeficienti i determinimit në model, na tregon rëndësinë e modelit dhe me një koeficient prej 0.7308 themi se 73% të variablave të pavarura e sqarojnë variabalin e varur. Rikujtojmë që analiza e regresionit përdoret për ta vlerësuar varësinë statistike mes variablave. Kjo mbështetet më tej nga koeficienti i rregulluar i përcaktimit (**Adjusted R-squared**), i cili merr në konsideratë shkallën e lirisë (Dr. Aguwamba S.M.& Ekienabor .E.E, 2017). Kjo tregon se modeli ka një përshtatshmëri të përfaqësuar nga koeficienti i vlerës së përcaktimit të 0.7308 dhe një fuqie të lartë parashikuese të modelit me një koeficient të lartë, të rregulluar, të përcaktimit të 0.6810.

Koeficientët e regresionit tregojnë ndryshimin mesatar të Y, kur ndryshorja përkatëse ndryshon për një njësi dhe faktorët e tjera mbeten konstantë.

Koeficientët janë signifikantë dhe kanë p-vlera më të ulët se 0.05. Në vazhdim është interpretuar rezultati i prodhuar nga programi softuerik STATA.

Kështu, për të parë efektin e këtyre politikave, është përdorur modeli OLS i cili përmes STATA program, ka dhënë këto rezultate:

Tabela 8. Rezultatet Empirike – OLS Modeli

	<b>Variabla e varur: Qarkullimi i NMVM – ve (QI)</b>		
<b>Variablat</b>	<b>OLS modeli</b>		
	<b>Koeficienti</b>	<b>Gabimi stan</b>	<b>P – value (signifik</b>
<b>logSub</b>	.1755986	.0771223	<b>0.031**</b>
<b>logCr</b>	-.0419259	.0524306	0.431
<b>logRI</b>	-.3737244	.1848514	<b>0.053**</b>
<b>logCI</b>	.2362083	.0448941	<b>0.000***</b>
<b>Logunempl</b>	-.4511358	.2451428	0.077*
<b>Constant</b>	22.66413	3.035998	
<b>Observations</b>	33		
<b>R – squared</b>	0.7308		
<b>F (5, 27)</b>	14,66		

Burimi: kalkulime të autorit

Nga rezultatet e regresionit vijmë në përfundim se elasticiteti i subvencioneve në variablen e varur Qarkullimi i mjeteve të NVMV- ve (QI) është 0.175. Përveç testimit të hipotezës 0, se elasticiteti i subvencioneve në **QI (qarkullimin e NVM-ve)** është zero, e cila është refuzuar në nivel të lartë statistikor **ie 0.05** nivel të singifikancës, mund të shqyrtojmë edhe koeficientin në qoftë se është i ndryshëm nga 1 ( $\neq 1$ ).

Meqë në këtë rast është 0.17%, që do të thotë më i vogël se 1, kjo na jep një indikacion se elasticiteti apo shkalla e reagimit është më e vogël se 1 ( $>1$ ). Pra, një përqindje

ndryshimi në subvencione është e shoqëruar me vetëm 0.17% ndryshim në qarkullimin e NVM-ve.

Realisht, subvencionet janë një nga instrumentet shumë efektive për të ndihmuar rritjen e NVM-ve në Kosovë, pasi që janë mjete të pakthyeshme, pra nuk janë borxhe, dhe se financimi është i orientuar nga stabilimentet dhe makineritë e nevojshme për realizimin e aktivitetit të ndërmarrjeve

Nga ana tjetër, indeksi **logcr** (kreditë) rezulton të kenë ndikim negativ dhe jo signifikant për rritjen e qarkullimit të NVM-ve. Kjo nënkupton që kreditë me rr Ethanat e disponueshme në Kosovë nuk janë të qasshme për pjesën dërmuese të NVM-ve.

Kreditë paraqesin një mjet mjaft të rëndësishëm për financim të aktiviteteve biznesore.

Në fakt, ato kanë ndikim të tillë sepse, përveç se është çmimi i kredisë ai që përcakton strukturën e kredimarrjes, NVM-të diktohen edhe nga afati kohor i kredisë, sepse nuk mund të paguajnë shuma të mëdha për këste kreditore, prandaj janë të shtrënguara t'u qasen afateve të gjata dhe normave të larta të kredisë. Nga ana tjetër, bizneset kanë nevojë për shuma të mëdha të mjeteve e për shuma të mëdha bankat kërkojnë kritere shtesë, si hipoteka e kolateral,<sup>248</sup> dhe të tjera kërkesa, të cilat e ashpërsojnë dhe rëndojnë edhe më shumë mundësinë e firmës së vogël për t'i arritur këto standarde.

Duke qenë kështu, ajo detyrohet që të paraqesë të dhëna fiktive për të arritur mbështetjen nga banka. Këto veprime janë tipike për biznese të vogla dhe në vende ku nuk ka burime të tjera të financimit, p. sh., qeveria është e varfër dhe nuk mund ta mbështesë me mjete firmën e vogël.

<sup>248</sup> Financing Constraints of SMEs in Developing, Thorsten Beck, This draft: May 2007, fq.5

Në raportin e BQK-së për stabilitetin ekonomik, raportohet se kërkesa për kredi sidomos për ndërmarrje të vogla është dedikuar për financim të investimeve fikse të ndërmarrjeve, për financim të kapitalit punues dhe ristrukturim të borxhit.<sup>249</sup> Kjo nënkuption që kosto e kredisë për këto ndërmarrje për shkak të kushteve të saj është bërë edhe më e rëndë kur ato janë munduar ta ristrukturojnë për t'i përshtatur kritereve.

Norma e interesit që gjendet si faktor shumë i rëndësishëm për mundësinë e ndërmarrjeve për të rritur, rezulton me ndikim negativ dhe signifikant. Dhe kjo është përgjigje konkrete dhe që mbështet rezultatin e koeficientit **logcr**. Norma interesit del faktor i rëndësishëm për qarkullimin e ndërmarrjeve, por që, sigurisht, ndikim i saj është negativ në trendin e qarkullimit të NVM-ve. Konkretisht, një ndryshim prej 1% e variables së normës së interesit, është i shoqëruar me një ndryshim prej – 0.37% tek variabla e qarkullimit të NVM-ve, që do të thotë se shkalla e ndryshimit është më e vogël se 1.

Dhe në fund, koeficienti i investimeve kapitale **logcl**, si variabël e pavarur, ka ndikim pozitiv dhe singifikant në qarkullimin të NVM-ve.

Sipas rezultateve të regresionit, ndryshimi i 1% të investimeve kapitale do të shoqërohet me një ndryshim pozitiv prej vetëm 0.23%.

Vlen të theksohet se të gjitha variablat nuk janë unitare, pra të barabartë me 1, që nënkupton se me rritjen e 100% të variables së pavarur, do të ketë ndikim të qindpërqindtë në variabilen e varur. Pra, të gjitha variablat, në bazë të rezultatit të regresionit, rezultojnë të jenë më të vogla se 1, ( $>1$ ).

---

<sup>249</sup> Raporti i stabilitetit makroekonomik, BQK, 2017, fq.41

### 6.2.2 Të gjetura empirike nga studiues të tjera

(IOSR Journal of Business and Management (IOSR-JBM) e-ISSN: 2278-487X, p-ISSN: 2319-7668. Volume 17, Issue 4.Ver. I (Apr. 2015), PP 23-26 [www.iosrjournals.org](http://www.iosrjournals.org))

Sipas **Oke&Aluko, O. A (2015)**, duke përdorur regresionin të dhënave të panelit, vijmë në rezultatin se bankat komerciale kanë ndikim të rëndësishëm në financimin e NVM-ve, bazuar në rezultatet e efektit të vazhdueshëm, efektin fiks dhe modele të efekteve të rastit, të cilat tregojnë se kreditimi i NVM-ve nga bankat komerciale ka ndikimi pozitiv. Autorët në fjali konkludojmë që bankat komerciale kanë ndikim pozitiv në rritjen NVM-ve.

*Punimi 2: (IOSR Journal of Economics and Finance (IOSR-JEF) e-ISSN: 2321-5933, p-ISSN: 2321-5925. Volume 5, Issue 6. Ver. II (Nov.-Dec. 2014), PP 41-51 [www.iosrjournals.org](http://www.iosrjournals.org))*

Sipas **Sebastian et,al (2014)**, sistemi bankar i kreditimit të NVM-ve në rastin e Nigerisë nuk është signifikant dhe kështu nuk ndikon në rritjen e NVM-ve.

*Punimi3: (International Journal of Innovation and Economic Development ISSN 1849-7020 (Print) ISSN 1849-7551 (Online) URL: <http://dx.doi.org/10.18775/ijied.1849-7551-7020.2015.32.2004>)*

Sipas **Zirra&Charls (2015)**, kreditë e bankave ndaj NVM-ve nuk kanë ndonjë ndikim të rëndësishëm në rritjen ekonomike në Nigeri, si dhe normat e interesit të ngarkuara me kredi nuk kanë efekt në zgjerimin e biznesit të NVM-ve në këtë vend.

*Punimi 4. Imperial Journal of Interdisciplinary Research (IJIR) Vol-3, Issue-3, 2017 , ISSN: 2454-1362, <http://www.onlinejournal.in>*

Sipas **Aguwamba S. M & Ekienabor E. E. (2017)** duke përdorur modelin e OLS, ka nxjerrë përfundime se kreditë i rrisin ndjeshëm NVM-të në Nigeri, pasi që rezultoi me gjelje se me rritjen 1% të kredive, NVM-të do të rriten me për 0,016% në Nigeri.

Punimi 5. International Journal of Business and Social Science, Vol. 5, No. 9(1); August 2014

Sipas **Kennedy Imafidon&Joy Itoya**, kredia e bankës komerciale për ndërmarrjet e vogla nuk ka zbuluar ndonjë efekt të rëndësishëm në Nigeri brenda periudhës së studimit. Kjo i atribuohet faktit se operatorët në shkallë të vogël nuk kanë qasje në kredi, që është një problem i madh për ndërmarrjet në shkallë të vogël në Nigeri pasi institucionet financiare tradicionale nuk kanë qenë në gjendje t'i plotësojnë nevojat e tyre për kredi. Qeveria duhet ta inkurajojë ndërmarrjen në shkallë të vogël përmes skemës së tyre të mikrokredisë, të japë kredi të buta dhe të ri-prezantojë skemën e kredisë për biznese të vogla në mënyrë që përfituesit t'i përdorin ato për të drejtuar ndërmarrjet në shkallë të vogël.

Punimi 6. Journal of Educational Policy and Entrepreneurial Research (JEPER)  
[www.iiste.org](http://www.iiste.org) Vol.1, N0.2, October 2014. Pp 251-261

Sipas **Moughale, L. E.&Ismaila, M.**, kredia e bankave komerciale për ndërmarrjet e vogla ka një marrëdhënie të parëndësishme pozitive me rritjen e NVM-ve që sugjerojnë se kontributi i saj në këtë sektor është i ulët, si rezultat i politikës së rreptë të vënë në vend për ta vlerësuar objektin e kredisë nga banka dhe afërsinë e bankës me SME-të.

Analiza e regresionit është e bazuar në metodën OLS me ndihmën e Microfit 4.1, ku një test për integrimin dhe mekanizmin e korrigjimit të gabimit është përdorur për analizimin e të dhënavë. Po sipas këtij hulumtimi, norma e interesit ka pasur efekt negativ dhe singifikant në rritjen e NVM-ve.

Pastaj, një tjetër studim i bërë në Malajzi, nga autorë si **Rafidah Ismail** dhe **Norfaridatul Akmaliah Othman (2014)**, provoi të vërtetonin një lidhje pozitive në mes të përkrahjes së qeverisë dhe rritjes së NVM-ve, dhe këtë e vërtetuan përmes një regresioni ku

korrelacioni në mes të përkrahjes së qeverisë dhe rritjes së NVM-ve është pozitiv dhe i rëndësishëm.<sup>250</sup>

Teorikisht, hipoteza e zhvillimit të udhëhequr nga financimi siguron një kornizë të vërtetë dhe të qartësuar që jep shpjegim për lidhjen midis kredisë së bankave dhe rritjes së NVM-ve. Kjo teori, e cila u propozua nga **Schumpeter-i (1912)**, pohon se aktivitetet e institucionit finanziar shërbejnë si mjet i dobishëm për të rritur kapacitetin prodhues të ekonomisë. Në terma konkretë, hipoteza e rritjes së financave thekson se ekzistenca e institucionit finanziar do të siguronte shpërndarje efikase të burimeve duke rritur kështu investimet, të cilat, në anën tjetër nxisin rritjen ekonomike.

Një tjetër teori që ofron një shpjegim të dobishëm mbi marrëdhëniet midis kredive dhe bankave dhe rritjes së NVM-ve është *teoria e kanalit të kapitalit bankar të politikës monetare*. Sipas kësaj teorie, politika monetare ndikon në furnizimin e kredisë së ndërmjetme, veçanërisht në kreditë bankare dhe është aktive nëpërmjet saj një treg i papërsosur për borxhin bankar. Duke pasur parasysh mekanizmat e ndryshëm të transmisionit, përmes të cilave politika monetare ndikon në aktivitetet ekonomike, një politikë monetare ekspansioniste do të rrisë ofertën e parasë, e cila do të kthehet në rritje të rezervës së bankave komerciale dhe aftësisë së tyre për të krijuar kredi për investorët, duke përfshirë edhe NVM-të në reduktim të normave të interesit

International Journal of Business and Social Science Vol. 3 No. 6; [Special Issue -March 2012]

Sipas **Mumba S. F. Gakure W. R. Karanja**, investimet kapitale dalin të jenë burimi më i rëndësishëm në rritjen e ndërmarrjeve në shtetin e Kenias. Në të gjeturat e tij potencoi

---

<sup>250</sup> Rafidah Ismail dhe Norfaridatul Akmaliah Othma, The Effectiveness Of Government-Support Programmes Toward Business Growth, Journal of Technology Management and Technopreneurship, Vol. 2 , No. 2 July - December 2014, pg.49

se investimet kapitale kanë ndikim pozitiv në rritjen e ndërmarrjes. Të gjeturat e tij u konfirmuan edhe në studimet e **Steiner and Solem (1988)**, **Cuba, et al (1983)**, **Khan and Rocha (1982)**, si **United States Small Business Administration (1980)**, të cilat si variabël për të matur performancën e NVM-ve, kishin shitjet e tyre, pra qarkullimin e NVM-ve.

### 6.2.3 Testimi i modelit të OLS

Duke dashur të dimë në qoftë se modeli i OLS, i ilustruar më sipër është adekuat, dhe se rezultatet janë të besueshme dhe indikative, janë realizuar edhe testimet post vlerësuese si ai i shpërndarjes normale, heteroskedasticitetit dhe autokorrelacionit

### 6.2.4 Testi Shapiro-Wilk W për shpërndarje normale të të dhënave

Duke pasur parasysh një mostër  $X_1, \dots, X_n$  e vëzhgimeve të vlerësuara me vlerë reale, testi Shapiro-Wilk (**Shapiro dhe Wilk, 1965**) është një provë e hipotezës së përbërë që të dhënat janë i.i.d. (të pavarur dhe të shpërndarë identikisht) dhe normale, dmth.  $N(\mu, \sigma^2)$  për disa  $\mu$  reale të panjohur dhe disa  $\sigma > 0$ .

Rezultatet e më poshtme tregojnë për një shpërndarje normale të të dhënave :

Tabela 9. *Testimi për Shpërndarje Normale të të Dhënave- Modeli OLS*

<b>Varibla</b>	<b>W</b>	<b>V</b>	<b>z</b>	<b>Prob &gt; z</b>
U	0.95832	1.423	0.734	0.23158

Burimi: kalkulime të autorit

Hipoteza zero për këtë test është se të dhënat shpërndahen normalisht. Vlera  $Prob < W$  e renditur në dalje është p-vlera. Nëse niveli i zgjedhur i alfa është 0.05 dhe vlera p është më pak se 0.05, atëherë hipoteza e pavlefshme që shpërndahen normalisht është refuzuar. Nëse vlera p është më e madhe se 0.05, atëherë hipoteza zero nuk refuzohet. Kjo nënkonpton që shpërndarja e të dhënave është normale.

### 6.2.5 Testi Breusch-Pagan / Cook-Weisberg për heteroskedasticiteti

Kujtojmë se OLS e bën supozimin se  $V(\varepsilon_j) = \sigma^2$  për të gjithë  $j$ . Kjo ndodh kur termat e gabimit kanë variancë konstante dhe quhet homoskedasticitet. Nëse termat e gabimit nuk kanë variancë konstante, thuhet se ato janë heteroskedastike.<sup>251</sup> Heteroskedasitcteti mund të jetë shumë problematik duke sjellë rezultatet mashtruese dhe të paragjykuara.

**Preusch-Pagan/Cook-Weisberg** teston hipotezën e pavlefshme se variancat e gabimit janë të gjithë të barabartë kundrejt alternativës se variancat e gabimit janë një funksion multiplikativ i një ose më shumë ndryshoreve. Testet e heteroscedasticitetit nënkuqtojnë dy hipoteza të mëposhtme.

**H0 (hipoteza null):** të dhënat janë homoskedastike.

**Ha (hipoteza alternative):** të dhënat janë heteroscedastic.

Nëse vlera përshtetë më e vogël, ju refuzoni H0 ose homoskedasticitet.

Rezultatet nga testi Preusch-Pagan / Cook-Weisberg janë si më poshtë:

Tabela 10. *Testi Breusch-Pagan / Cook-Weisberg për Heteroskedasticitet- Modeli OLS*

<b>Lag</b>	<b>chi2(1)</b>	<b>Prob &gt; chi2</b>
1	= 0.02	= 0.8990

Burimi: kalkulime të autorit

<sup>251</sup> Richard Williams, Heteroskedasticity, University of Notre Dame, <https://www3.nd.edu/~rwilliam/> Last revised January 30, 2015

Nga kjo që u tha më lartë dhe nga rezultati që shohim refuzohet hipoteza alternative, dhe pranohet hipoteza zero.

### 6.2.6 Testet për autokorrelacion

#### a. Testi Durbin-Watson

Statistikat e testit Durbin-Watson testojnë hipotezën e pavlefshme se mbetjet nga një regresioni i zakonshëm më pak me katorë nuk është i autokorreluar kundrejt alternativës që mbetjet ndjekin një proces AR1. Shkalla e **Durbin-Watson** shkon në vlerë prej 0 deri në 4. Një vlerë afër 2 tregon jo-autokorrelacion; një vlerë drejt 0 tregon autokorrelacion pozitiv; një vlerë ndaj 4 tregon autokorrelacion negativ ([Savin and White 1977](#)).

Sipas rezultateve të regresionit, gjetjet për autokorrelacion janë si më poshtë:\

Tabela 11. *Testi Durbin-Watson për Autokorrelacion- Modeli OLS*

Lag	chi2	Prob > chi2
1	1.723	0.1894

Burimi: kalkulime të autorit

mund të vërejmë, vlera e p-së nuk është signifikante, me çrast kjo bën që të pranojmë hipotezën zero që nënkupton se variablat nuk posedojnë autokorrelacion.

Për më tepër kemi edhe një paraqitje tabelare të rezultateve për autokorrelacion. Kemi përdoru modelin e **Breusch-Godfrey LM**. Testi i **Breusch-Godfrey** është provë e tipit LM të dyanshëm të bazuar në gjasat, që është prova më e përshtatshme për zbulimin e autokorrelacionit në modelet dinamike. Testi BG u zhvillua nën hipotezën zero,

$$H : 0 \rho = ,$$

dhe alternativa

$$Ha : 0 \rho \neq$$

Nga rezultatet e regresionit, e testuar me testin e Breusch- Godfrey Lagrange Multiplier, të dhëna nuk kanë korrelacion serial.

Tabela 12. *Testi Breusch- Godfrey Lagrange Multiplier për Autokorrelacion- Modeli OLS*

Lag	chi2	Prob > chi2
1	2.051	0.1522

Burimi: kalkulime të autorit

Tabela na paraqet rezultatet e testit për autokorelacion të Lagrange-multiplier- LM, ku siç mund të vërejmë, vlera e p-së nuk është signifikante, me çast kjo bën që të pranojmë hipotezën zero që nënkupton se variablat nuk posedojnë autokorrelacion në vonesat kohore

### 6.3 Modeli II- GMM (*Generalized Method of Moments*)

Metoda e përgjithësuar e momenteve (GMM) është një metodë statistikore që kombinon të dhënat e vëzhguara ekonomike me informacionin në kushtet e momentit të populacionit për të prodhuar vlerësimë të parametrave të panjohur, të përcaktuara në model ekonomik. "Metoda e përgjithësuar e momenteve" u prezantua nga L. Hansen në punimin e tij në vitin 1982. Ka një numër tekstesh të mira moderne që mbulojnë GMM-në, por shquhet Hayashi (2000), i cili paraqet pothuajse të gjitha teknikat e vlerësimit në kuadër të GMM-së. Një tekst konciz, online, që mbulon GMM-në është Hansen (2000).

GMM është shumë e përshtatur pikërisht për llojin e informacionit që po nxjerrim nga modelet tona ekonomike.

Metoda e përgjithësuar e momenteve (GMM) kërkon vetëm kushte të momentit të caktuar, që nënkuptohen nga supozimi i modelit bazik ekonometrik. Metoda GMM është térheqëse në disa raste si:

- Nëse ekziston shumëlojshmëri e momenteve ose kushteve të ortogonalitetit, që janë nxjerrë nga supozimi i modelit teorik;
- Nëse modeli ekonomik është i ndërlikuar, d.m.th.,, është e vështirë të shkruash një traktat dhe funksioni i zbatueshëm i gjasave dhe
- Për të kapërcyer kompleksitetin kompjuterik të lidhur me vlerësuesin ML.

### 6.3.1 Përkufizimi i vlerësuesit GMM

Pyetja jonë e hulumtimit nënkuption kushtet e castit të populacionit  $E [m(wi, \theta)] = 0$  mështë

$q \times 1$  vektor i funksioneve vlerat e pritshme të të cilit janë zero në populacionin  $wi$  janë të dhënët për populacionin  $I$   $\theta$  mështë  $k \times 1$  vektor i parametrave,  $k \leq q$ . Mpmente të mostrës që korrespondojnë memomentet e populacionit janë

$$m(\theta) = (1/N) PN i = 1 m(wi, \theta) Kur k < q.$$

GMM përgjedh parametrat që janë aq afër sa të jetë e mundur për të zgjidhur sistemin tepër të komplikuar të momentit në kushtet

$$\theta_b GMM \equiv \arg \min \theta m(\theta) 0Wm(\theta),$$

Ne përdorim vlerësues GMM për të trajtuar problemin e endogenitetit në regresion. Pas **Arellano dhe Bond (1991)**, **Arellano dhe Bover (1995)** dhe **Blundell dhe Bond (1998)**, ne zgjidhim problemin e variablate të varur si një variabël shpjegues, i cili mund të lidhet me efektin fiks të vendit në terma gabimi, duke e vënë atë në dallimin e parë. Duke transformuar variablat në dallimin e parë, efekti fiks i vendit do të hiqet. Dallimet e mbeturës shtypësit përdoren si instrumente në vlerësimin e GMM-së. Që nga

ndryshuesi shpjegues mund të lidhen me afat të gabimit, unë e zgjidh këtë problem duke përdorur variablin shpjegues si instrument.

Vlerësuesi i GMM zakonisht përdoret për të korriguar paragjykimin e shkaktuar nga variabla shpjegues endogjene.

### 6.3.2 GMM ESTIMATOR:

Idea është që të zgjidhni vlerësimet e parametrave duke vendosur momente mostre për të qenë afër homologëve të popullsisë. Për të përshkruar modeli i momentit bazë dhe vlerësuesi i GMM,  $\beta$  le të tregojë një  $p \times 1$  parametri vektor,  $w_i$  një vëzhgim të të dhënave me  $i = 1, \dots, n$ , ku  $n$  është madhësia e mostrës. Le të  $g_i(\beta) = g(w_i, \beta)$  të jetë një  $m \times 1$  vektor i funksioneve të të dhënave dhe parametrave. Vlerësuesi i GMM është i bazuar në një model ku, për vlerën e vërtetë të parametrave  $\beta_0$  kushtet e momentit  $E[g_i(\beta_0)] = 0$  janë plotësuar.

Vlerësuesi është formuar duke zgjedhur  $\beta$  kështu që mesatarja e mostrës së  $g_i(\beta)$  është afér vlerë së saj zero të populacionit.

Le të jetë

$$\hat{g}(\beta) \stackrel{\text{def}}{=} \frac{1}{n} \sum_{i=1}^n g_i(\beta)$$

tregojnë mesataren e mostrës së  $g_i(\beta)$ . Lë të jetë  $A$  një matricë gjysmë-definitive  $m \times m$ .

Vlerësuesi i GMM është dhënë nga

$$\hat{\beta} = \arg \min_{\beta} \hat{g}(\beta)' \hat{A} \hat{g}(\beta).$$

$\beta$  është vektori i parametrave që minimizon formën kuadratike  $g(\beta)' A g(\beta)$ , vlerësuesi GMM zgjedh  $\beta$  kështu që mesatarja e mostrës  $g(\beta)$  është afér zeros

$$\hat{\beta} = \arg \min_{\beta} \|\hat{g}(\beta) - 0\|_{\hat{A}}.$$

### 6.3.3 IV – GMM

Vlerësuesi standard IV është një rast i veçantë i Metodës (GMM). Supozimi se instrumentet **Z** janë ekzogjenë mund të shprehen si **E (Ziui) = 0**. Instrumentet **L** na japin një sërë momentesh **L**,

$$g_i(\hat{\beta}) = Z'_i \hat{u}_i = Z'_i(y_i - X_i \hat{\beta})$$

ku **gi** është **L × 1**. Eksogeniteti i instrumenteve do të thotë se ka kushte **L** moment, ose kushte ortogonalitet, që do të jetë e kënaqur me vlerën e vërtetë të **β**. Secili nga momentet **L** ekuacionet korrespondojnë me një moment mostër, dhe ne i shkruajmë ato **L** momente të mostrës si:

$$\bar{g}(\hat{\beta}) = \frac{1}{n} \sum_{i=1}^n g_i(\hat{\beta}) = \frac{1}{n} \sum_{i=1}^n Z'_i(y_i - X_i \hat{\beta}) = \frac{1}{n} Z' \hat{u}$$

Intuita prapa GMM është që të zgjedhë një vlerësues për **β** atë q zgjidh **g (β) = 0**.

### 6.3.4 Përshkrimi statistikor

Në modelin e GMM-së do të tregohet impakti që kanë qarkullimi i NVM-ve, kreditë, subvencionet, norma e interesit dhe investimet kapitale në rritjen e punësimit. Për të nxjerrë rezultate të besueshme, për dallim nga modeli OLS, të dhënat për modelin GMM janë të serive kohore mujore për periudhën 2006-2016. Burimi i të dhënavës është shënuar më lart dhe ne jemi bazuar në ato të dhëna si të besueshme, pasi që janë zyrtare. Më poshtë paraqesim një tabelë të statistikave përmblehdhëse për punimin.

Tabela 13. *Statistikat Përbledhëse të variablate ekzogjene dhe endogjene*

Variablat	Observimet	Mesatarja	Devijimi nga mesatarja	Min	Max
<i>Innr_punsu</i>	132	13.37255	1.64	11.47037	16.31
<i>Inqarkullimi_j</i>	132	19.98063	.4221174	18.48769	21.111
<i>Insubvencione_t</i>	130	8.501653	1.146403	0	10.00
<i>Inkreditë</i>	132	6.887021	.3348383	5.977569	7.2515
<i>Innorm_in – t</i>	132	2.45325	.2406932	1.900614	2.678
<i>Ininvest_k – e</i>	126	9.93025	1.394215	3.171784	11.805

Burimi: Kalkulime të autorit.

### 6.3.5 Gjetjet nga modeli GMM

Të dhënrat e përdorura në model përfshijnë variablin e varur - numrin e të punësuarve në NVM-të, dhe variablat e pavarur shpjeguese të modelit, ku variablin e instrumentuar e kemi përcaktuar normën e interesit, kurse instrumentet në model përfshijnë qarkullimin mëjor te NVM-ve,

- (i) subvencionet,
- (ii) investimet kapitale,
- (iii) kreditë dhe
- (iv) Norma e interesit.

Duke shfrytëzuar programin softuerik STATA specifikojmë modelin e **Variablate instrumentale GMM** ose konkretisht **IV-GMM** dhe vijmë në rezultatet e mëposhtme:

Tabela 14. Rezultatet Empirike- GMM Modeli

	<b>Variabla e varur:</b> Numri i të punësuarve		
<b>Variablat</b>	<b>GMM modeli</b>		
	<b>Koeficienti</b>	<b>Gabimi standarde</b>	<b>P – value (signifikanca)</b>
<b>Innorma_interesit</b>	-6.384808	.1859896	.0000***
<b>Inqarkullimi_muj</b>	.0577396	.0692319	.404
<b>insubvencionet</b>	.0030032	.0415869	.942
<b>Ininvestimet kapit.</b>	.0376963	.0210624	.074*
<b>Constant</b>	27.42467	1.628267	
<b>Observations</b>	126		
<b>R – squared</b>	0.946		

\*\*\* p<0.01, \*\* p<0.05, \* p<0.1

Burimi: Kalkulime të autorit

- (i) **Variabli norma e interest me p – value 0.000** është signifikante por ka efekt negative në rritjen e numrit të punësuarve;;
- (ii) **Variabli qarkullimi mujor me p value 0.4** është jo signifikante në model dhe për arsyet të jo significances e njëjta nuk interpretohet.
- (iii) **Variabli Subvencionet** në modelin tonë empirik janë po ashtu jo signifikante dhe kështu nuk e sqarojnë rritjen e numrit të punësuarve.
- (iv) **Variabli investimet kapitale me p value 0.074** është signifikant dhe ka efekt pozitiv në rritjen e numrit të punësuarve. Gjithsesi, edhe këtu shpjegimi i referohet që i referohemi rritjes një përqind e investimeve kapitale do te shoqërohen me rritje prej 0.037 perqind te rritjes se numrit te punësuarve.

Duke iu referuar gjetjeve nga literature empirike e konsultuar iu referohemi disa punimeve si:

**Economic Modelling Volume 5, Issue 1, January 1988, Pages 32-40**

**Wim D., Paul J.N.**, kishin kritikuar rezultatet e hulumtimeve se subvencionet do të ndikonin pozitivisht në punësim (hulumtimi u bë sipas modelit makroekonomik të Byrosë Qendrore të Planifikimit, Holandë). Të njëjtit, sipas një hulumtimi, kanë ardhur në përfundime se subvencionet kanë impakt negativ në punësim kur merret parasysh roli i kostove kapitale.

Një studim tjeter në Indi (**A. J. Asghar, K. Nawaser, M. J. Paghaleh and S. M.Sadeq Khaksar, 2008**) tregon se NVM-të ndikojnë pozitivisht në rritjen e punësimit sepse ato kanë mundësi të përdorin më shumë procese të punës me intensitet më të madh se sa ndërmarrjet e mëdha, duke mundësuar kështu një shpërndarje më të drejtë të të ardhurave, pastaj sigurimin e mundësisë për jetesë nëpërmjet aktiviteteve të thjeshta të përpunimit të vlerës së shtuar.

Një studim tjeter në Indi (**A. J. Asghar, K. Nawaser, M. J. Paghaleh and S. M.Sadeq** sidomos në ekonomitë bujqësore, etj. Në këtë studim, NVM-ve u atribuohet meritë e madhe në gjenerimin e vendeve të punës në sektorin e bujqësisë (45%) dhe eksportit (40%), ku citohet se, gjersa po bie punësimi në sektorin e bujqësisë, edhe industritë e mëdha po përjetojnë rritje të papunësisë. Studimi në fjalë, këtë situatë ia faturon pikërisht mosorganizimit të NVM-ve në shërbim të krijimit të vendeve të punës

**IOSR Journal Of Humanities And Social Science (IOSR-JHSS) Volume 22, Issue 9, Ver. 13 (September. 2017) PP 43-50 e-ISSN: 2279-0837, p-ISSN: 2279-0845.**  
**[www.iosrjournals.org](http://www.iosrjournals.org)**

Sipas **Mohammed B. Sh.**, një hulumtim me ndërmarrjet që kishin më pak se 240 punëtorënë tërë vendun. Pavarësisht faktit se NVM-të janë motori i gjenerimit të vendeve

të reja të punës, përfat të keq ato nuk kanë luajtur rol të rëndësishëm sa pritet të luajnë në rritjen dhe zhvillimin e ekonomisë. Bazuar në gjetjet e studimit, NVM-të në Nigeri kanë përparrë një rrugë të gjatë deri sa sektori i caktuar të jetë mjaft produktiv dhe të luajë rolin e kurorëzimit që pritet të jetë në raport rritjet e punësimit. Kështu që efekti ka qenë pozitiv, po jo signifikant.

**Policy Research Working Paper 5631, The World Bank Development Research Group**  
**Finance and Private Sector Development Team, April 2011**

**Meghana A. Asli D.-K. Vojislav M.**, në studimin e tyre me titull “E Vogla vs firma të reja nëpër botë, kontributi në punësim, krijimin e vendeve të reja të punës, rritja ekonomike” vërtetuan se NMV-të në vendet në zhvillim kanë ndikim signifikant në krijimin e vendeve të reja të punës. Rëndësia e firmave të vogla në ekonomitë në zhvillim është me rëndësi pasi dihet se në këto vende, firmat e vogla përballen me shumë kufizime institucionale, si qasja e kufizuar në financa. Nuk ka të dhëna nëse këto ndërmarrje ulin papunësinë, por janë të rëndësishme me efekt pozitiv në krijimin e vendeve të reja të punës.

## Përfundimi

Kosova, edhe 19 vjet pas luftës, ende nuk ka arritur të sigurojë stabilitet ekonomik, ndër të tjera e ka rritur pasigurinë ekonomike sidomos, gjë e cila ka shpënë në emigrimin masiv të qytetarëve në vendet perëndimore. Rreziku i emigrimit të qytetarëve do të jetë edhe më i shprehur me procesin e liberalizimit të vizave, proces ky që pritet të ndodhë shumë shpejt. Vetëm gjatë vitin 2015 kanë kërkuar azil 68.000 kosovarë, shifër kjo që në disa raporte krahasohet me ikjet nga konfliktet (luftërat). Kapaciteti prodhues i Kosovës po rritet, por është i vogël, i koncentruar dhe jokonkurrues. E gjithë ekonomia është duke u mbajtur nga sektori i shërbimeve.

Pavarësisht faktit se Kosova ka rritjen më të madhe të BPV-së në rajon, ajo nuk është përkthyer edhe në rritjen e punësimit.

Reformat e ndërmarra në fushën e biznesit dhe politikat zhvillimore, fatkeqësisht, nuk kanë arritur të krijojnë situatë me rezultate të mira dhe optimiste. Pavarësisht ngritjes së vazhdueshme në raportet e progresit të të bërit biznes, nuk mund të flasim për përmirësim të performancës ekonomike. Struktura e bizneseve në Kosovë dhe funksionimi i tyre nuk po arrijnë të krijojnë vlera të reja, që do të mundësonte edhe krijimin e potencialeve për vende të reja të punës

Në këtë punim, kontributi i NVM-ve në rritjen e punësimit në Kosovë dhe ndikimi i politikave për t'i mbështetur NVM-të të krijojnë vende të punës është testuar duke përdorur modeleve ekonometrike. Janë përdorur dy modele: OLS dhe GMM, për të matur NVM-të, si në çdo vend tjeter, edhe në Kosovë përbëjnë përqindjen më të lartë të bizneseve në një vend, në saje të karakteristikave që i kanë. Struktura e bizneseve në Kosovë është e atillë sa të sigurojë një mbijetesë për ndërmarrjen dhe nuk ka as kushte për të menduar t'i zgjerojë kapacitetet në mënyrë që të krijojë vende të reja të punës.

**Andaj, në bazë të analizave dhe testimeve, lidhja ndërmjet këtyre politikave dhe performancës së NMV-ve ka rezultuar të jetë e dobët,** e cila ka shpënë në rezultatin që

sektori privat të **mos jetë në gjendje të krijojë vende të reje të punës dhe të absorbojë tërë fuqinë punëtore e cila është e gatshme për punë.** **Kjo nënkuption se hipoteza që NVM-të kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e punësimit në Kosovë, për periudhat 2006-2016 nuk është vetëtuar.** Punësimi apo papunësia mbetet ndër çështjet më problematike dhe shumë shqetësuese të Kosovës. Nga ana tjetër, sistemi arsimor më shumë se kurrë është duke prodhuar kuadro për tregun e punës, por të cilët nuk arrijnë me vite të inkuadrohen në tregun e punës, ani pse hulumtimet tregojnë se tregu për profile të caktuar është duke dështuar në mungesë të kuadrove profesionalë. Kjo nënkuption se në shërbim të një sektori privat joperformues është një sistem arsimor jocilësor. Cilësia e ultë e arsimit dhe e shërbimeve publike në përgjithësi krijon kushte që firmat e vogla të mbisin të tilla dhe i nxisin ato të punojnë e veprojnë në tregun informal. Gjatë punimit, informaliteti ka marrë vëmendje të theksuar, pasi që, realisht, është i masave të gjera, rreth 35%, e që tenton në 40%, kjo bën të kuptojmë që, nëse do ta kishim formalizuar këtë përqindje, sektori privat do të jetë burim i mirëfilltë i gjenerimit të vendeve të reja të punës. Por, pyetja është se a do të mund të mbijetonin firmat në kushtet dhe rr Ethanat ekzistuese si të çështjeve ligjore, administrative, kreditore e fiskale, në rast se do ta mendonim si të formalizuar këtë përqindje?!

Për të kontribuar në përmirësimin e normës së punësimit janë të angazhuara të gjitha instancat shtetërore dhe bankare, por ja që këto modele, statistikisht të vërtetuara në këtë punim, nuk tregojnë për një efektshmëri të këtyre politikave, të paktën jo në sektorin formal. Se NVM-të nuk janë rritur thuhet edhe në raportin e serive kohore lidhur me vendet e punës nga Banka Botërore, i cili raport, ndër të tjera, thotë se **vetëm katër për qind e firmave që fillojnë si mikro rriten mbi nëntë të punësuar mbrenda pesë viteve**, simptoma këto të një ekonomie statike.

Duket që ndërrimi i shpeshtë i qeverisë ka bërë që të mos ketë strategji të mirëfillta për zhvillimin e sektorit privat. Orientimi i subvencioneve dhe granteve është ndërruar sa herë që janë ndërruar qeveritë, ndërkohë që objektivat e hartuar në strategjitet zhvillimore kanë mbetur pa u realizuar. Prandaj, gjetjet tregojnë se subvencionet dhe

grantet kanë ndihmuar në mënyrë afatshkurtër NVM-të, dhe kjo duket më tepër të jetë realizimin i pretimeve elektorale se sa ndikim real i politikave në rritje të performancës së NVM-ve. Këto subvencione janë dhënë pa ndonjë analizë të qartë. Njëjtë thuhet edhe në Raportin e progresit të **Komisionit Evropian për Kosovën (2016)**, sipas të cilit nuk ka pasur progres në zhvillimin e kapaciteteve institucionale për të kontrolluar ndihmën shtetërore dhe subvencionet janë ende duke u dhënë pa një strategji dhe vlerësim të duhur.

Madje, as subvencionimi në bujqësi, që ka qenë fokusimi më i madh i shtetit, nuk ka dhënë efekte të dukshme në produktivitet. Marrja e masave përmes politikave aktive, duke i punësuar studentët në institucione shtetërore në formë të praktikave, krijimi i qendrave të aftësimit profesional, trajnimeve dhe mbështetjeve në realizimin e projekteve promovuese për bizneset, nuk kanë arritur ta zbusin normën e papunësisë. Qendrat e aftësimit profesional nuk japidin efektet e tyre për shkak të cilësisë së dobët dhe, nga ana tjetër, përqindja më e madhe e kompanive nuk e kanë idenë se çfarë në të vërtetë ato ofrojnë ose pse ekzistojnë. Edhe zonat ekonomike nuk janë analizuar mirë. Përzgjedha e regjoneve për shpallje të zonave të lira ekonomike është duke u bërë karshi interesave të partive në pushtet dhe jo objektivave.

Aktivitetet të cilave qeveria u ka kushtuar rëndësi dhe ka aluduar në rritje të numrit të të punësuarve, si çështja e subvencionimit të pagave, nuk kanë të bëjnë me investime afatgjata dhe me mbështetje të ndërmarrjeve, thjesht janë krijim i punëve të përkohshme që, pos që e kanë lëvizur numrin e të papunëve drejtë të punësuarve për 3-6 muaj nuk kanë shtuar vlerë tjetër, nuk e kanë rritur pjesëmarrjen në fuqi punëtore.

**Me këtë themi që hipoteza se subvencionet kanë ndikuar në rritjen e NVM-ve parë në garkullimin e tyre, është vëretuar, pavarësisht se ka rezultuar me një ndikim të vogël.**

Kreditë qëndrojnë si formë e domosdoshme për financimin e ndërmarrjeve, por pavarësisht faktit se ato janë të orientuara për t'i ndihmuar ndërmarrjet, potenciali kreditor është shpërndarë në masë më të madhe në ekonomitë familjare se në

ndërmarrje, madje edhe atëherë kur normat e interesit janë duke rënë. Po ashtu, kreditë, të cilat janë dhënë për ndërmarrjet, një pjesë e konsiderueshme e tyre janë dhënë për qëllime jo investuese. Nga ana tjetër, pjesa më e madhe e kredive investuese është e shpërndarë në sektorin e tregtisë dhe të shërbimeve, kur një përqindje e konsiderueshme e të të ardhurave shkojnë në vendet prej nga importohen mallrat me të cilat janë realizuar investimet. **Me këtë nënkuftojmë që hipoteza se kreditë kanë arritur të rrisin qarkullimin e NVM-ve nuk është vërtetuar.**

Norma e interesit, si njëra nga politikat që janë përdorur në model, ka rezultuar me ndikim negativ në rritjen e NVM-ve. Sigurisht, për çfarëdo arsyet e janë përdorur kreditë apo në çfarëdo forme t'i kenë shpërndarë bankat, normat e interesit kanë reduktuar fitimet e firmave dhe kanë bërë që ato mos të janë në gjendje të rriten. Normat e interesit kanë filluar të bien, por, nga ana tjetër, janë rritur mjaft edhe shpenzimet administrative dhe kostot e tjera përcjellëse të kredive, të cilat edhe dalin të mos janë mbështetëse si instrument. **Kjo nënkufton që hipoteza se norma e interesit ka ndikuar negativisht në rritjen e NVM-ve e parë në qarkullimin e tyre, është vërtetuar.**

Ka një ndikim dhe lidhje pozitive në mes të investimeve kapitale dhe rritjes së NVM-ve, e cila më tepër është e koncentruar në infrastrukturën rrugore, gjë e cila përpos efektit praktik, ka pasur një efekt pozitiv psikik te njerëzit. **Me këtë themi që hipoteza se investimet kapitale kanë ndikuar në rritjen e NVM-ve e parë në qarkullimin e tyre, është vërtetuar.**

NVM-të nuk është se janë të lidhura direkt me investimet kapitale, por janë faktorë me të cilat janë të varur si p.sh., furnitorët, duke reduktuar koston e transportin, po edhe akterët e tjerë që kanë përfituar nga mundësitet e kontakteve më të lehta me vendet e tjera. Investimet kapitale, si dukuri, vetyvet karakterizohen me rritje të numrit të të punësuarve dhe nxitje të startup-ve.

Nga ana tjetër, përmes modelit GMM është matur efekti i NVM-ve në punësim, e cila lidhje ka rezultuar e parëndësishme, gjë që e arsyeton edhe interpretimin e gjetjeve nga matjet përmes OLS të politikave mbështetëse për NVM-të.

Në fillim të tekstit kemi thënë se NVM-të në Kosovë nuk luajnë rolin e gjeneruesit të vende të reja të punës, siç do të duhej ta kishin, por të shtrënguar nga pasiguria ekonomike dhe koncentrimi i energjisë në ngjarje politike, ka bërë që ky sektor të informalizohet dhe të çojë në rezultate paradoksale, si ajo që NVM-të nuk po arrijnë të gjenerojnë vende të reja të punës.

Një aspekt shumë i rëndësishëm, që ka marrë, po ashtu, fokus në këtë studim, është korrrupsioni dhe një skemë e paaftë politike, e dështuar për të krijuar politika efektive ose për t'i zbatuar në mënyrë të efektshme, e koncentruar në politika ad hoc, pa ndonjë konsistencë mes politikave ndërmjet sektorëve, sidomos arsimit me sektorin e biznesit.

Një çështje e komentuar edhe në raportet e Komisionit Evropian janë të dhënat në dispozicion, të cilat duket të janë të shthurura dhe jokonsistente. Mungojnë të dhëna për periudha të tëra dhe të cilat përsëriten si mesatare e viteve paraprake. Të tilla të dhëna ndikojnë në rezultatet e punimit, por që janë cituar edhe si limitim i punimit.

Për të përfunduar, themi se kërkohet një koncentrim më i madh i investimeve dhe politikave zhvillimore në krijimin e mundësive konkrete të NVM-ve bazuar, fillimisht, në nevojat e sektorëve të veçantë për zhvillim pastaj edhe në mundësitë e vet sektorëve. Objektivat e përcaktuar në Strategjinë zhvillimore të hartuara për NVM-të janë të qarta dhe konkrete, por që zbatimi i tyre nuk ka mundur të bëhet në mënyrën e planifikuar. **Lufta e organeve politike duhet bazuar në uljen e shkallës së informaliteti, por gjithnjë duke krijuar kushte për të ruajtur stabilitetin e ndërmarrjeve.**

## Rekomandimet

Bazuar në këto përfundime, punimi vë në pah faktin se NVM-të në Kosovë janë shumë të varura nga faktorët e jashtëm, konkretisht burimet e financimit. Ato janë të rëndësishme për funksionimin dhe qarkullimin e NVM-ve. Mungesa ose mosefikasiteti në shpërndarjen e tyre rrezikon hyrje të reja të dështuara në treg dhe të ardhme të zbehtë për ekzistueset. Pra, në formë indirekte, këta faktorë mund të ndikojnë në rritjen e punësimit, por që për rastin e studimit në rrethanat ekzistuese, nuk ka argumente faktike se mund ta bëjnë një gjë të tillë. Politikat mbështetës, konkretisht subvencionet, grantet dhe investimet kapitale, duke qenë mjete pa kthim, kanë ndihmuar ndërmarrjen e vogël që të krijohet, ndërsa atë ekzistuesen të zgjerohet, por, nga ana tjetër nuk kanë arritur t'i ndihmojnë ato të rriten në masën sa t'i shtojnë aktivitetet aq sa të ketë nevojë për rritje të numrit të vendeve të punës. Ndërsa, kreditë dhe norma e interesit kanë dokumentuar lidhje të dobëta dhe nuk arrijnë t'i plotësojnë nevojat prosperuese të ndërmarrjeve ekzistuese, e aq më pak të krijojnë mundësi për krijimin e ndërmarrjeve të reja.

Andaj, në saj të këtyre përfundimeve, mund të rekomandojmë si më poshtë:

- subvencionet që dalin të jenë si të rëndësishme, por me ndikim jo të theksuar në performancën e NVM-ve, **themri se qeveria duhet ta rishikojë strategjinë e zotimit dhe ndarjes së tyre, pasi që të jenë përcaktuar prioritetet**. Për të ndikuar në rritjen e punësimit përmes mbështetjes së ndërmarrjeve, subvencionet duhet të jenë hartuar e vlerësuar konform objektivave dhe me një qasje strategjike ndaj alokimit e zotimit të tyre. Në vendet në tranzicion, ekziston një euforizëm për të përfituar nga grantet në saje të projekteve “edhe unë”, por edhe të projekteve të hartuara për hir të grantit e jo jetësimit të idësë. Andaj, referuar këtij rreziku, **qeveria duhet të bëj një plan afatgjatë për zotim e alokim të subvencioneve dhe t'u referohet, po ashtu, planeve afatgjata të projekteve.**

- **Qeveria duhet t'i fuqizojë politikat aktive të punësimit, si p.sh. programet e trajnimit për çështje si organizimi, vendimmarrja në biznes, negocimi në biznes, komunikimi në biznes.** Po e njëjtë duhet ta rrisë cilësinë e tyre për të térhequr vëmendjen e ndërmarrësve të rinj për pjesëmarrje aktive në këto trajnime. Po ashtu, ajo përmes krijimit të grupeve këshilluese duhet të menaxhojë rezistencën e shumicës së ndërmarrësve në Kosovë në mospranimin e këshillave që vijnë nga trajnime të tillë. Kjo bëhet duke realizuar takime më të shpeshta me ndërmarrës përmes seminareve dhe konferencave biznesore me pak më shumë angazhim të shoqatave biznesore. Biznesmenët e rinj janë duke u rritur dhe zhvilluar në ide e koncepte të reja, andaj mësimi nga të tjetër është më i pranueshëm.
- Qasja e vështirë në kredi si forma të financimit e bën këtë instrument të parëndësishëm për NVM-të në rastin e këtij studimi. Duke qenë kështu, ato, duke mos dashur të rrezikojnë me kredi përdorin mjetet vetanake, por këto mjete nuk mjaftojnë për t'u rritur. Nga ana tjetër, tregu është i ngarkuar dhe hyrjet e reja janë shumë të rrezikshme, kështu NVM-të, duke mos pasur mundësi qasjeje në burime kreditore, hezitojnë t'i hedhin mjetet e tyre në provë, prandaj edhe nuk mund ta zgjerojnë aktivitetin që të hapin vende të reja të punës. Krijimi i Fondit të garantimit të kredive nga ana e qeverisë pritet të japë efekte në lehtësimin e qasjes në këto burime financimit. **Duke u bazuar në këtë fakt, bankat do të duhej të reflektonin në mënyrë që ta lehtësojnë këtë proces për NVM-të, duke i bërë kriteret e kredimarrjes më të arritshme për NVM-të në Kosovë. Nga ana tjetër, bankat duhet shtojnë masat e tyre për të parë dhe vlerësuar cilësinë e planeve të biznesit ose shtimit të kapaciteve si dhe mënyrën e përdorimit të mjeteve të tyre. Ato mund ti ndihmojnë bizneset duke i këshilluar ato për përdorimin eficentë të mjeteve kreditore karshi projektit të deklaruar.** Normal e interesit janë duke rënë, por kjo është duke u shoqëruar me rritje të shpenzimeve përcjellëse të kredive dhe administrative. Pavarësisht kësaj, bizneset mund ta shfrytëzojnë këtë normë në rënje për projekte të ardhshme.

- Kërkohet të intensifikohet angazhimi në menaxhimin dhe harmonizimin e kërkesave dhe objektivat në mes të sektorit të arsimit dhe biznesit, në mënyrë që burimet të përdoren mirë.
- Një mënyrë e mirë për të rritur numrin e punëtorëve përmes ndërmarrjeve të vogla janë subvencionimi i shkollave profesionale dhe nxitja e nxënësve për orientim profesional. Dyndja e nxënësve në nivele të shkollimit akademik ka prodhuar vetëm numër të studentëve me aftësi të pamjaftueshme përkérkesat e tregut, andaj orientimi i nxënësve në shkolla profesionale do t'i u mundësonte atyre të pavarësosheshin nga njëra anë, e reduktimin e presionit në punët e “nivelit të lartë” nga ana tjetër. Kjo do të mundësonte edhe ngritjen e nivelit të cilësisë dhe produktivitetit
- Korruzioni edhe më tutje mbetet sfidë dhe kërkesë emergjente për trajtim serioz, sepse po reflekton në secilën hallkë të proceseve zhvillimore, duke shkaktuar efekt domino. Njëri nga efektet më shqetësuese, i ndikuar nga ky fenomen, është alokimi jo i drejtë i mjeteve dhe si rezultatet objektivat me prioritet humbasin kuptimin, pasi prolongohet realizimi i tyre.

## Referencat

### 9.1 Referencat nga punimet dhe hulumtimet shkencore

- Agbaje A., Rafiat A., Osho, Ejededawe A.(2015) Commercial Banks Role In Financing Small Scale Industries In Nigeria (A Study Of First Bank, Ado-Ekiti, Ekiti State, European *Journal of Accounting, Auditing and Finance Research* Vol.3, No.8, pp.52-69,; ([www.eajournals.org](http://www.eajournals.org))
- Aguwamba S. M, Ehijiele E. E., (2017) Bank Lending and its Impact on Small Scale Enterprises in Nigeria, *Imperial Journal of Interdisciplinary Research (IJIR)* Vol-3, Issue-3, ISSN: 2454-1362; <http://www.onlinejournal.in>
- Anaoui F., Karami A.,(2003) Strategic Management in Small and Medium Enterprises, fq. 276;
- Aruwa S.A.S.,(2009) “Financing Options for Small and Medium Scale Enterprises in Nigeria”. Nigerian *Journal of Accounting Research*. Vol. 1 (2), ABU., Zaria;
- Aschheim J., Tavlas S. G.,(1988) Economic Modelling Volume 5, Issue 1, January, Pages 32-40
- Asli A., M., Kunt D., Maksimovic V., (2011)Small vs. Young Firms across the World Contribution to Employment, Job Creation, and Growth, *Policy Research Working Paper 5631*;
- Ashcroft B., Love H. J.,(1996) Firm births and employment change in the British Counties: 1981-89, Apers In Regional Science: *The Journal of the RSAI* 75; <http://www.geo.ut.ee/nbc/paper/smallbone.htm>
- Ayuba B., Z. Mohammed, (2015) Impact of Banking Sector Credit on the Growth of Small and Medium Enterprises (SME's) in Nigeria, *Journal of Resources Development and Management ISSN 2422-8397 An International Peer-reviewed Journal*, Vol.15; [www.iiste.org](http://www.iiste.org)
- Ayyagari, M., Thorsten B., Aslı Demirgüç K. (2007) Small and Medium Enterprises Across the Globe, *Small Business Economics*;
- Baptiste R., Escaria V., Madruga P.,(2007) The Effects of New Businesses on Economic Development (January 2008), *Small Business Economics* Vol. 30, pp. 49-58;
- Barniger R. Brus., dhe Ireland D. R.,(2012) “Entrepreneurship”, fourth edition;
- Baron R., Markman G.,(2003) Beyond Social Capital: The Role of Entrepreneurs' Social Competence in Their Financial Success, *Journal of Business Venturing* 18(1):41-60,

- Becchetti L., Trovato G., (2002) The determinants of growth for SMEs sized firms. The role of the availability of external finance, fq.13;
- Bejtullahu Z., (2007) Bazat E Biznesit, (parimet, konceptet, metodat, modelet, sistemet, zbatimet), Prishtinë,
- BFC (2016); Statistical offices, EC (2015) Annual Report on European SMEs 2014 / 2015,
- Blackburn A. R., Schaper T. M., (2012) Government, SMEs and Entrepreneurship Development Policy, Practice and Challenges, , Indiana University, USA;
- Blanton A. (2009) Innovation and Quality, Godfrey Creativity;
- Bosma N., Wennekers S., Amorós E. J., (2011) Entrepreneurs and Entrepreneurial Employees Across the Globe, *Global Entrepreneurship Monitor 2011 Extended Report, 2012*
- Bouazza B. A. Ardjouman D., Abada O., (2016) Establishing the Factors Assessment of financing needs of SMEs in the Western Balkans countries Synthesis Report, fq.22.
- Bouazza B. A., Ardjouman D., (2015) Affectng the Growth of Small and Medium-sized Enterprises in Algeria, *American International Journal of Social Science* Vol. 4, No. 2;
- Bula O. H., (2018) Evolution and Theories of Entrepreneurship: A Critical Review on the Kenyan Perspective, *International Journal of Business and Commerce* Vol. 1, No.11: 81-96] (ISSN: 2225-2436);
- Carree, M., Klomp L. (1996) "Small Business and Job Creation: A Comment", *Small Business Economics* 8, , p.20-26;
- Cherukara M. J., Manalel J., (2011) Evolution of Entrepreneurship theories through different schools of thought, The Ninth Biennial Conference on Entrepreneurship at EDI, Ahmedabad, February 16-18,
- Cohen Sh., (2007) "*Best Practice Guidance for Angel Groups – Deal Screening*", Columbia University;
- Cojocaru A. (2017) Diagnosis of Jobs in Kosovo, World Bank, Washington, DC. Licensa: Creative Commons Attribution CC BY 3.0 IGO;
- Davidson P., Lindmark L., Olofsson Ch., (1998) The extent of overestimation of small firm job creation - an empirical examination of the "regression bias" *Small Business Economics*, fq. 87-100;

- Davidson P.,(1989) Continued Entrepreneurship and Small Firm Growth, Business Environment and Enterprise Performance Survey-BEEPS V;
- Davis J. S. Hliwanger J. (1992) Gross Job Creation, Gross Job Destruction, And Employment Reallocation *The Quarterly Journal of Economics*, Vol. 107, No. 3, pp. 819-863,  
<http://www.jstor.org/stable/2118365?origin=JSTOR-pdf>;
- Davis J. S. Hliwanger J. Schuh S.(1993) Small Business and Job Creation: Dissecting the Myth and Reassessing the Facts, *Small Business Economics*, October, Working Paper No.4492;
- Davis, S.J., Haltiwanger J.C., Schuh S. (1994). Small Business and Job Creation: Dissecting the Myth and Reassessing the Facts, *Business Economics*, July;
- Davis, S.J., J.C. Haltiwanger and S. Schuh (1996). Job Creation and Destruction. MIT Press;
- Delmar, F. and Davidsson, P. and Gartner, W.(2003) Arriving at the high growth firm. *Journal of Business Venturing* 18(2):pp. 189-216;
- Dougherty D., Hardy C., (1996) Sustained Product Innovation in Large, Mature Organizations: Overcoming Innovation-to-Organization Problems, *Academy of Management Journal* 39, no. 5 1120–1153;
- Draft Richard, (2008) Organisational Theory, eight edition,. Fq 412;
- Dupuy, R. and G. Picot (1995). “Job Creation by size Class: Recent Evidence from Canada”, paper presented at the OECD Industry Committee Working Party on Small and Medium-sized Enterprises High-level Workshop on SMEs: Employment, Innovation and Growth, Washington D.C.
- Edinburgh Group,(2012) Growing the global economy through SMEs, fq.35
- European Commission,(2015) Annual Report on European SMEs 2014/2015, SMEs start hiring again;
- European Investment Bank, (2016) Assesment on financing needs of SEMs in the Western Balkans Countries, Sythesis Report.
- Eurostat, National Statistical Offices, and DIW Economy
- Europoean Comission, (2016) Annual Report on European SMEs.

- Evamaria G. M., Mayer M. L., Paffhausen L. A.,(2015) KFW Research Studies and Proceeding, Employment effects of road construction and access-to-energy interventions – Evidence from a review of the literature
- Evans, D. S., (1987) “The Relationship between Firm Growth, Size and Age: Estimates for 100 Manufacturing Industries”, *Journal of Industrial Economics*;
- Farlane Mc Julie,(2016) Economic Theories of Entrepreneurship. fq, 17;
- Fombasso E. G., Cincerato M.,(2015) Optimal Effectiveness Of Government Intervention In The Sme Sector: Evidence From The Brussels-Capital Region, Cite Working Paper;
- Harrington A.,(2003) Who’s Afraid of a New Product?, Fortune, November 10, 189–192;
- Hébert, R.F. Link, A.N.(1989) In search of meaning enretpreneurship. *Small Bus Economics* 1: 39;  
<https://doi.org/10.1007/BF00389915>
- Henrekson M., Johansson D., (2009) Gazelles as Job Creators – A Survey and Interpretation of the Evidence, *IFN Working Paper No. 733*, January 22,
- Herman E.,(2012) Emerging Markets Queries in Finance and Business, *SMEs and their Effect on the Romanian Employment*, Procedia Economics and Finance 3, fq. 290 – 297;
- Herzberg, F., Mausner B. and. Snyderman B., (2010) The motivation of work, (originali i publikuar në 1959);
- Hutcheson G., Moutinho L.,(2011) Ordinary Least-Squares Regression, The SAGE Dictionary of Quantitative Management Research. Pages 224-228.
- IFC jobs study (2013), Assessing private sector contributions to job creation and poverty reduction, f.11;
- Imafidon K., Itoya J., (2014)An Analysis of the Contribution of Commercial Banks to Small Scale Enterprises on the Growth of the Nigeria Economy, *International Journal of Business and Social Science*, Vol. 5, No. 9(1);
- Imoughele, L. E., Ismaila, M.(Ph.D), (2014) The Impact of Commercial Bank Credit on the Growth of Small and Medium Scale Enterprises: An Econometric Evidence from Nigeria (1986 - 2012), *Journal of Educational Policy and Entrepreneurial Research (JEPER)* www.iiste.org Vol.1, N0.2, Pp 251-261;

- Islami Xh., Mulolli E., (2016) Drejtimi i politikave qeveritare në mbështetjen e NVM-ve në Kosovë, Reforma, KDU: 33/34 (05)
- Ismail R., Othma A. N., (2014) The Effectiveness Of Government-Support Programmes Toward Business Growth, *Journal of Technology Management and Technopreneurship*, Vol. 2 , No. 2. pg.49;
- Jahanshahi A.A., Nawaser K., Khaksar S. M.S., Kamalian A. R., (2011) The Relationship between Government Policy and the Growth of Entrepreneurship in the Micro, Small & Medium Enterprises of India. *Technology Management Innovation*, Volume 6, Issue I;
- Jahnshahi A., Khaled N., Paghaleh J. M., Khaksar S. M. S., (2011) The Role of Government Policy and the Growth of Entrepreneurship in the Micro, Small (&) Medium-sized Enterprises in India: an Overview, *Australian Journal of Basic and Applied Sciences*, 5(6): 1563-1571;
- Jensen H. E. S., R. Tobias N., Rutherford F Th.,(2002) Economic transition, Entrepreneurial capacity, and intergenerational distribution.
- Katua Th. N. (2014) The Role of SMEs in Employment Creation and Economic Growth in Selected Countries. *International Journal of Education and Research* Vol. 2 No. 12. 461. fq.467
- Kolakovic M., (2010) Odredenje preduzetnistva; fq.1. Zagreb;
- Krasniqi B., Tullumi M.,(2013) What perceived success factors are important for Small Business Owners in a transition economy? *International Journal Of Business And Management Studies*, ISSN: 1309-8047 Vol 5, No 2;
- Krasniqi B.,(2011) Inovacioni dhe tregu (ligjëratë);
- Krasniqi, B. A. (2007). Barriers to entrepreneurship and SME growth in transition: the case of Kosova. *Journal of Developmental Entrepreneurship*, 12(01), 71
- Makina D., Fanta B. A., Mutsonziwa K., Khumalo J., Maposa O., (2015) Financial Access and SME Size in South Africa, December;
- Manqellari A, Hadri S., Kule Dh., Qiriçi S.(2002) "Hyrje në Ekonomi". Tiranë, fq. 341
- Mark A.G. Darroch and T.A. Clover., (2005) The effects of entrepreneurial quality on the success of small, medium and micro agri-businesses in KwaZulu-Natal, South Africa, Volume 44, issue Issue 3, 23;

Mayer M. An Analysis of the Effects of Road Construction Projects on Enterprise Performance and Employment in Low- and Middle-Income Countries. 2014,

Ministry of Economy, 2012; Starczewska-Krzysztosek, 2012

Mirela I. A., Daniela L. T., Andreea C.Ş, (2012) The role of small and medium enterprises in improving employment and in the post-crisis resumption of economic growth in Romania, *Theoretical and Applied Economics Volume XXI*, No. 1(590), pp. 87-102;

Mohamad S. H., Othman N. A., Jabar J., Majid I. A., M. Kamarudin F.,(2014) Journal of Technology Management and Technopreneurship, Vol. 2 No. 2 ISSN: 2231-7996

Moscarini G., Vinay P. F., (2012) The Contribution of Large and Small Employers to Job Creation in Times of High and Low Unemployment, *American Economic Review*, 102(6): 2509–2539;

Mustafa M., Kutllovci E. Krasniqi B., Gashi P.,(2006) Biznesi i Vogël dhe i mesëm, fq.21

Ntiamoah B. E., Li D., Kwamega M.,(2016) Impact of Government and Other Institutions' Support on Performance of Small and Medium Enterprises in the Agribusiness Sector in Ghana, *American Journal of Industrial and Business Management*,;  
[http://dx.doi.org/10.4236/ajibm.2016.65052 2016](http://dx.doi.org/10.4236/ajibm.2016.65052)

Oaya Tizhe Z.C., Mambula I C. J. The Impact of SMEs Financing on Business Growth in Nigeria: A Study of Keffi and Mararaba Metropolis (*International Journal of Innovation and Economic Development* ISSN 1849-7020, URL: <http://dx.doi.org/10.18775/ijied.1849-7551-7020.2015.32.2004>);

Oke, M.O., Aluko, O.A., Impact of Commercial Banks on Small and Medium Enterprises Financing In Nigeria (IOSR Journal of Business and Management (IOSR-JBM) e-ISSN: 2278-487X, p-ISSN: 2319-7668. Volume 17, Issue 4.Ver. I (Apr. 2015), PP 23-26; [www.iosrjournals.org](http://www.iosrjournals.org))

Okpara F., (2007) "The value of creativity and innovation in entrepreneurship" University of Gondar , Etiopia, Volummi III, *Jurnal of Asia Enterpreneurship and sustainability*;

Onuoha G., (2007) Entrepreneurship, *AIST International Journal* 10, 20-32;

Oser K.,(2004) "Sharp Touts TV in Net Mystery Adver-Blog" Advertising Age, fq 54;

Oum S., Narjoko D., Harvie C., (2014) Constraints, Determinants of SME Innovation, and the Role of Government Support;

Penrose E.,(1959) 'The Theory of the Growth of the Firm', 3rd edn, Oxford, Oxford University Press, , fq.24

Peters H.,(1998) Entreprenuership, (the defination is modified from the definition first develoed for the woman entreprenuer, The woman Entreprenuer, Strating, Financing, and Managing a Successful new Business) fourth edition;

Phan Th., Hansen E., Price D., (2001) The public employment service in a changing labour market, International Labour Organization.

Pitelis Ch., (2009) 'The Theory of the Growth of the Firm' Fifty Years Later, London Edith Penrose's, *SSRN Electronic Journal* · March, Brunel University, fq.15;

Rauch, A. & Frese, M. (2000). Psychological approaches to entrepreneurial success: A general model and an overview of findings. In C.L.Cooper & I.T. Robertson (Eds), *International Review of Industrial and Organizational Psychology*, Vol. 15, 100-135;

Riding I. and Jr Haines G.,(2001) Loan Guarantees: Costs of default andbenefits to small firms allan. Carleon University, Ottawa, Ontario, Canada, *Journal of Business Venturing* 16, 595-612;

Rois R., Basak T., Mhod. M.r Rahman, M. K. Ajit One-Sided Wald Test for Restricted Higher Order Autocorrelation in Dynamic Linear Model, June – 2012 Volume – 1, Issue – 3 Article #03, IJASER Research Paper ISSN: 1839-7239

Rois R., Basak T., Rahman M. M., Majumder K. A.. Modified Breusch-Godfrey Test for Restricted Higher Order Autocorrelation in Dynamic Linear Model – A Distance Based Approach, , *International Journal of Business and Management*; Vol. 7, No. 17; 2012 ISSN 1833-3850 E-ISSN 1833-8119, Canadian Center of Science and Education;

Sebastian O. Uremadu, PhD, Ogechi I. Ani, Odili O., (2014) Banking System Credit to Small and Medium Scale Enterprises (SMEs) and Economic Growth in Nigeria: A Co-integration Approach (*IOSR Journal of Economics and Finance (IOSR-JEF)* e-ISSN: 2321-5933, p-ISSN: 2321-5925.Volume 5, Issue 6. Ver.; [www.iosrjournals.org](http://www.iosrjournals.org)

Simiyu F. M., Namusonge G. S., Sakwa M.(2016) Effect of Government Policy and Regulations on the Growth of Entrepreneurial Women Micro and Small Enterprises in Kenya,

*International Journal of Research in Business Studies and Management*, Volume 3, Issue 10, fq. 12-26;

Sithiphand Ch.,(1983) Testing employ motivation based on Herzberg's motivation hygiene theory in selected thai comercial banks;

Smallbone D., Welter F., (2009) Entrepreneurship and Small Business Development in Post Socialist Economies, fq.60;

Shane S., Venkatarama.,(2000) The promise of Entrepreneurship as a Field of Research, *Academy o Management Review* Vol.25, No. 1,217-226;

Shettima B. M.,(2017) Impact of SMEs on Employment Generation in Nigeria, *IOSR Journal Of Humanities And Social Science (IOSR-JHSS)* Volume 22, Issue 9, Ver. 13 PP 43-50 e-ISSN: 2279-0837, p-ISSN: 2279-0845; [www.iosrjournals.org](http://www.iosrjournals.org)

Tambunan T.,(2008) SMEs Development In Indonesia: Do Economic Growth And Government Support Matter?, *International Journal of Asia Pacific Studies*, Vol. 4, No. 2. fq 122.

Timmons, J. A.(1900) New Venture creation, Irwin, 3rd ed., Homewood, IL.

Tomew, L., Meinardus, M.,(2012) Employment Policies in South-East Europe, Common Challenges and Different Scenarios,

Toomey C. D.,(1998) South African small business growth through interfirm linkages, Rhodes University, fq. 100;

Thorsten B. Demirguc-Kunt A., (2006) Small and medium-size enterprises: Access to finance as a growth constraint, *Journal of Banking & Finance* 30, 2931–2943;

Thorsten B., Demirguc-Kunt A., Levine R. (2005) "SMEs, Growth, and Poverty: Cross-Country Evidence," *Journal of Economic Growth*.

Thorsten B.,(2007) Financing Constraints of SMEs in Developing, May 2007, fq.5;

Williams R.,(2015) Heteroskedasticity, University of Notre Dame,  
<https://www3.nd.edu/~rwilliam/> Last revised January 30;

World Bank. (1995) Private sector development in low income countries, Washington, D.C;

## 9.2 Referenca nga raporte, dokumente dhe publikime nga institucione vendore e ndërkombëtare

Administrata Tatimore e Kosovës, Lista e t/p që u janë aprovuar Lirimet e TVSH në importim të mallrave të liruar nga TVSH, Lënda e parë, Burimi: <http://bit.ly/2dGMXzg>

Administrata Tatimore e Kosovës, Zyra për Marrëdhënie me Publikun, e bazuar mbi qasjen në dokumente publike (kontakti është realizuar përmes emailit)

Agron Demi, Politikat e Punësimit dhe Mirëqenies Sociale Në Kosovë, Raport Vlerësimi i Politikave të Punësimit dhe Mirëqenies Sociale në Kosovë, Dhjetor 2017, fq.24

Agjencia e Statistikave të Kosovë, Anketa e Fuqisë Punëtore, 2012, fq.26.

Agjencia e Statistikave të Kosovës Departamenti i Statistikave Sociale Sektori i Standardit Jetësor [www.ask.rks-gov.net](http://www.ask.rks-gov.net) Prill 2017.

Agjencia e Statistikave të Kosovës Raporti Statistikore mbi Ndërmarrjet në Kosovë TM4- 2014 fq.6

Agjencia e Statistikave të Kosovës, Hulumtimi i buxhetit të familjeve kosovare 2012-2013, fq 7.

Agjencia e Statistikave të Kosovës, Platforma askdata, Statistikat Strukturore të Biznesit, 2017

Agjencia e Statistikave të Kosovës, Raporti Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike në Kosovë TM4-2014, fq 9.

Anketa e realizuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme, 2006

Annual Report on European SMEs 2016/2017 Focus on self-employment, fq. 42

Asistenca Teknike e Bashkimit Evropian për Kosovën. Vlerësim mbi shtrirjen e ekonomisë joformale në Kosovës, (Projekt i zbatuar nga Business and Strategies Europe) Nëntor 2017

ATK, Lista e t/p që u janë aprovuar Lirimet e TVSH në importim të mallrave të liruar nga TVSH, Pajisje të teknologjisë informative, Burimi : <http://bit.ly/2dFCS4Y>

Banka Botërore Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore Praktika Globale për Varfërinë dhe Barazinë [www.worldbank.org](http://www.worldbank.org)

Banka Qendrore e Kosovës (Kreditë, seritë kohore)

Banka Qendrore e Kosovës "Buletini Mjutor Statistikor" Nr.166, Qershor 2015

- Banka Qendrore e Kosovës "Raporti i Stabilitetit Financiar" Nr. 6, Dhjetor 2014
- Banka Qendrore e Kosovës, Raporti vjetor i vlerësimit, 2016, fq.30
- Banka Qendrore e Kosovës, Raporti i stabilitetit makroekonomik, , 2017, fq.41
- Banka Qendrore e Kosovës, Raporti tremujor i Ekonomisë, TM4 2017, fq.14
- Banka Qendrore e Kosovës, Vlerësimi Tremujor i Zhvillimeve Makroekonomike, 2015
- Banka Qendrore e Kosovës: Vlerësimi tremujor i ekonomisë TM4 2016, fq9.
- Bizneset Fillestare dhe Shërbimet për Mbështetjen e Bizneseve Fillestare në Kosovë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, fq 13
- European Commission "Candidate and pre – accession countries' economic quarterly", 2010
- European Commission Observatory of European SMEs 2003, No. 7 Responsible entrepreneurship. A collection of good practice cases among small and medium-sized enterprises across Europe, EU, Enterprise DG, Brussels; <http://europa.eu.int/comm/enterprise/csr/index.htm>
- High-Growth SMEs and Employment, Organisation For Economic Co-Operation And Development, 2002, fq.10—28
- Hulumtimi i nevojave në Tregun e punës, 2013, Agjencia e Kosovës për Biznese, fq.26
- Informatat e Tregut të Punës, 12/13 ITP, Departamenti i Punës dhe Punësimit/ MPMS
- Instituti GAP, "Ndarja e subvencioneve nga komunat dhe ministritë", Korrik 2017
- Instituti GAP, Fondi Kosovar për Garanci të Kredive: modelet e menaxhimit dhe efektiviteti, 2015
- Instituti GAP, Vlerësimi i Strategjisë së Punësimit: nevoja për një strategji konkrete, Dhjetor 2013.
- Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGI) Analizë: Buxhetet e Komunave të Kosovës 2017, Prishtinë Tetor 2016, fq.25
- Instituti Riinvest, Sistemi bankar ndihmesë apo barrierë, 2015, fq.23
- Interview for the Innovation Exchange, 1999 (for a full interview, see <http://iexchange.london.edu>)
- Intervistë me zyrtar pranë Drejtorisë së Teknologjisë Informatike në ATK
- Job Creation in SMEs( 2015) ERM Annual Report, Eurofound, 2016, Corell University,
- Klima e biznesit në Kosovë- Zyra e Bashkimit Evropian, botues Instituti Riinvest, 2014

Klima e biznesit në Kosovë, nga perspektiva e NVM-ve, Maj 2017, fq 19.

Komenti nga përfaqësues të Kuvendit të Republikës së Kosovës për draft analizën mbi ndarjen e subvencioneve

KOMISIONI EVROPIAN, DOKUMENT PUNE I STAFIT TË KOMISIONIT Raporti i vitit 2016 për Kosovën, Bruksel, 9.11.2016, fq.50

Komisioni Evropian, Raporti Vjetor mbi NVM-të evropian 2014/2015, fq.83.

Koncept dokument për fushën e themelimit të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, Qershori 2015, fq.3

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve- 2017-2019, Korniza Fiskale, fq.25

Kushtet e jetës dhe të pabarazia në Shqipëri. Regjistrimi i popullsisë, INSTAT, 2001

Ligji nr. 03/L- 146 Për Tatimin Mbi Vlerën E Shtuar

Ligji Nr. 03/L-129 për Zonat Ekonomike <https://kiesa.rks-gov.net/>

LIGJI Nr. 03/L-212 I PUNËS, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: viti v / nr. 90 / 01 Dhjetor 2010

Ligji nr. 05/I-057 për themelin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore.

Material për diskutim për fushën e industrisë dhe NVM-ve, 01 Nëntor 2012, Prishtinë, fq.25

Millennium Challenge Corporation. Kosovo Constraints Analysis. November 2017

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, PLANI I VEPRIMIT: Rritja e Punësimit të të Rinjve 2018-2020, fq.6

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Republika e Kosovë <https://mti.rks-gov.net/page.aspx?id=1,78>

OECD (Small businesses, job creation and growth: facts, obstacles and best practices, The Council of Europe Development Bank (CEB) 2011),

OECD Annual Report on the OECD Guidelines for Multinational Enterprises, 2013, <http://dx.doi.org/10.1787/mne-2013-en>

OECD Conference Of Ministers Responsible For Small And Medium-Sized Enterprises (Smes), Promoting Entrepreneurship And Innovative Smes In A Global Economy: Owards a more responsible and inclusive globalisation, 2004, fq.10-12

OECD, Enhancing SME access to diversified financing instruments, Plenary session 2. Fq 6.

OEK- Mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar– sfidë për bizneset, Prishtinë, 2017, fq.15  
Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e  
Rajoneve Komunikata mbi Politikën e Zgjerimit të BE-së 2016, fq.42  
Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021, Prishtinë, shtator 2017, fq.72  
Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore, raport nr.: 28023 KOS, 2004  
Raport mbi Rolin e “Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme në Mesdhe”, Sesion plenar i tretë  
Bari, 30 janar 2012  
Raporti I Indikatorëve Bazë të Performancës për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë për Vitin 2017, Fq.5  
Raporti i Komisionit Evropian, 2007, fq.5.  
Raporti i vitit 2016 për Kosovën\* Në përcjellje të dokumentit: Komunikata nga Komisioni për  
Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e  
Rajoneve Komunikata mbi Politikën e Zgjerimit të BE-së 2016, fq.42  
Raporti i vitit 2016 për Kosovën\* Në përcjellje të dokumentit: Komunikata nga Komisioni për  
Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë 2014, Migrimi si forcë për zhvillim, UNDP  
Raporti Vjetor i FKGK-së (Fondit Kosovar për Garanci Kreditore),  
Raportin e Indikatorëve Bazë të Performancës për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë për vitin 2017.  
Referanca tjera nga dokumente dhe raporte të ndryshme  
Report on the Situation of SMEs in Austria 2014. For further information: Austrian Institute for  
SME Research  
Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore 2013 në Kosovë, Agjencia e Statistikave të Kosovës  
Strategjia e Zhvillimit të NVM-ve në Kosovë 2012-2016 Me Vizion 2020, Korrik, 2011  
Strategjia e Zhvillimit të NVM-ve 2012-2016, Qeveria e Kosovës, [www.mti-ks.org](http://www.mti-ks.org)  
Strategjia për zhvillimin e sektorit privat 2013- 2017 Mars 2013.  
Shërbimi Publik i Punësimit në tregun e ndryshueshmë të punës, mbështetur nga Organizata  
Ndërkombëtare e Punës, Prishtinë, 2001. f.115.  
Task Forca për Integrim Evropian, “Tryeza Tematike Nr. 4 për Tregti, industri, dogana, tatime,  
treg të brendshëm, konkurrencë, mbrojtje të konsumatorit dhe atë shëndetësore”,  
The World Bank Group ad Vienna Institute for International Economic Studies. Western Balkans  
Labor Market Trends 2017, April 2017

Udhëzuesi i praktikave më të mira për një klimë më pozitive për biznesin dhe investimet, OSCE 2006, Përketshyri nga Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, fq, 116-118

UNDP- Vlerësim i nevojave për shkathtësi: Identifikimi i nevojave të punëdhënësve në gjashtë sektorë ekonomikë në Kosovë, fq. 18-184 <http://bit.ly/2ijhvPf>

USAID, Kosovë: 2014-2018, Strategjia për Bashkëpunim dhe Zhvillim të Vendit

Varfëria në konsum në Republikën e Kosovës në periudhën 2012 - 2015 Banka Botërore, UKAID, Agjencja e Statistikave të Kosovës

World Bank Group Flagship Report , Doing business 2017, Economy Profile Kosovo

World Bank. (2017) Republic of Kosovo – Systemic Country Diagnostic. Burimi: <http://bit.ly/2AJwPfs>

World Bank. Jobs Diagnostic – Kosovo. Jobs Series, Issue No.5. 2017

World Development Indicator, Real Interest Rates. <http://bit.ly/1Pc1M8S>

Zhvillimi i Portofolios për vitin 2016, prezantim nga Fondi i Kosovës për Garantimin e Kredive

### ***9.3 Linjet e shfrytëzuara***

[https://www3.nd.edu/~wevans1/econ30331/Durbin\\_Watson\\_tables.pdf](https://www3.nd.edu/~wevans1/econ30331/Durbin_Watson_tables.pdf)

EUROSTAT <http://ec.europa.eu.com>

World Bank, 2017. <http://www.worldbank.org/en/country/kosovo/overview#3>

<http://web.worldbank.org/> Mesuring inequility, 2011

<http://www.worldbank.org/en/topic/financialsector/brief/smes-finance>

Fondi i Kosovës për Garantimin e Kredive <http://fondikgk.org>

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

<http://www.ebrd.com/pubs/econo/beeps.htm>

Ministria e Financave të Kosovës <https://mf.rks-gov.net/>

Platforma elektronike e sistemimit të të dhënave statistikore në Kosovë, mbikëqyrur nga

Agjencioni i Statistikave të Kosovës <http://askdata.rks-gov.net>

<https://kiesa.rks-gov.net/>

Banka Qendrore e Kosovës <https://bqk-kos.org>

## Shtojcat

```
regress log_QI log_sub log_Cr log_rI log_CI log_Unemp
```

Source	SS	df	MS	Number of obs	=	33
Model	2.60972838	5	.521945676	F( 5, 27)	=	14.66
Residual	.961298691	27	.035603655	Prob > F	=	0.0000
Total	3.57102707	32	.111594596	R-squared	=	0.7308
				Adj R-squared	=	0.6810
				Root MSE	=	.18869

	Coef.	Std. Err.	t	P> t	[95% Conf. Interval]
log_sub	.1755986	.0771223	2.28	0.031	.0173568 .3338405
log_Cr	-.0419259	.0524306	-0.80	0.431	-.1495046 .0656527
log_rI	-.3737244	.1848514	-2.02	0.053	-.7530081 .0055594
log_CI	.2362083	.0448941	5.26	0.000	.1440933 .3283233
log_Unemp	-.4511358	.2451428	-1.84	0.077	-.9541273 .0518557
_cons	22.66413	3.035998	7.47	0.000	16.43478 28.89348

```
. predict U, residuals  
(11 missing values generated)
```

```
. swilk U
```

Shapiro-Wilk W test for normal data

Variable	Obs	W	V	z	Prob>z
U	33	0.95832	1.423	0.734	0.23158

```
. estat hettest
```

Breusch-Pagan / Cook-Weisberg test for heteroskedasticity  
Ho: Constant variance  
Variables: fitted values of log\_QI

```
chi2(1)      =      0.02
Prob > chi2  =  0.8990
```

```
. estat durbinalt
```

Number of gaps in sample: 7

Durbin's alternative test for autocorrelation

lags(p)	chi2	df	Prob > chi2
1	1.723	1	0.1894

H0: no serial correlation

. estat bgodfrey

Number of gaps in sample: 7

Breusch-Godfrey LM test for autocorrelation

lags(p)	chi2	df	Prob > chi2
1	2.051	1	0.1522

H0: no serial correlation

. ivregress gmm lnemploi linqarkullimi\_muj lnsubvencionet lninvest\_kapitale ( lnnorma\_interesit = lnkredit > e lnsubvencionet)

Instrumental variables (GMM) regression

Number of obs = 126

Wald chi2(4) = 2071.26

Prob > chi2 = 0.0000

R-squared = 0.9406

Root MSE = .39522

GMM weight matrix: Robust

lnemploi	Robust					
	Coef.	Std. Err.	z	P> z	[95% Conf. Interval]	
lnnorma_interesit	-6.384808	.1859896	-34.33	0.000	-6.749341	-6.020275
lqarkullimi_muj	.0577396	.0692319	0.83	0.404	-.0779525	.1934316
lnsubvencionet	.0030032	.0412869	0.07	0.942	-.0779176	.0839241
lninvest_kapitale	.0376963	.0210634	1.79	0.074	-.0035873	.0789798
_cons	27.43467	1.628267	16.85	0.000	24.24333	30.62601

Instrumented: lnnorma\_interesit

Instruments: lqarkullimi\_muj lnsubvencionet lninvest\_kapitale lnkredite